

# **LEGJISLACIONI BIZANTIN DHE GJURMËT E TIJ NË TRADITËN E SË DREJTËS SHQIPTARE**

Bernina Kondi


Dorëzuar  
Universitetit European të Tiranës  
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në  
Shkencat juridike, me profil E Drejta Private, për marrjen e gradës shkencore  
“Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.As.Dr.Irakli Kocollari

Numri i fjalëve: 75.175

Tiranë, Dhjetor 2016



## **DEKLARATA E AUTORËSISË**

*©E drejta e autorit: Bernina Kondi. Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit*

Nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim nuk është botuar apo prezantuar më parë, por është shkruar prej meje sipas kërkesave të Shkollës Doktorale të Universitetit Europian të Tiranës.

## ABSTRAKT

*“Nomos Georgigos”- Ligji Agrar Bizantin është shtylla kryesore e paketës ligjore që ka vepruar në trojet shqiptare. Ky ligj fundamental ka një shtrirje kohore nga shekulli VII deri në shekullin XIV dhe përbënë bazën ku Perandoria Bizantine mbështeti veprimtarinë e saj. Nqs i referohemi emërtimit të tij të krijohet ideja se kemi të bëjmë me një ligj që rregullon fushën e bujqësisë por në fakt ai përmban norma që rregullojnë tërë veprimtarinë administrative, financiare, fiskale, penale, etj të territoreve dhe popullsive që përfshiheshin në kufijtë e Bizantit dhe mes tyre ato të qyteteve arbërore.*

*Ligji Agrar nga bashkjetesa shumë shekullore me normat zakonore ka marrë nga traditat tona juridike ashtu si dhe kanunet kanë marrë prej tij duke lënë gjurmë në aspektin juridik të kohës në trojet dhe qytetet shqiptare që iu nënshtruan sundimit të kësaj Perandorisë Bizantine.*

*Nga ana tjetër e drejta zakonore shqiptare me vecoritë krahinore, ndarë në të folme dhe në dialekte, na paraqitet në shumë pamje. Ajo përbëhet nga një skelet i fortë normash me burim tepër të lashtë vendas, por ka edhe ndikime nga jashtë, nga kodet e ndryshme greko-bizantine, romane, sheriati, nga zakonet e vendeve të ndryshme që sunduan në trevat tona për shekuj me rradhë. Ndikimet e huaja kanë lënë gjurmë jo të barabarta në treva të ndryshme.*

*Kjo vihet re nga fakti që për situata të njëjta kanune të trevave të ndryshme parashikojnë pasoja të ndryshme. Këto kundërthënie për të njëjtat dukuri e për elemente të vecantë shpjegohen nga tre arsye: së pari forma shumë arkaike e normave e formave të evoluara; së dyti normat vendase që bien në kundërshtim me disa norma të hyra nga jashtë; së treti, krahas një shtrese unitare mbaretnike ka dhe vecori të caktuara krahinore që kushtëzohen nga vecoritë gjeografike, klimatike, burime ekonomike si më të hapura e më të mbyllura drejt qëndrës.*

*Pikërisht ky punim ka për qëllim që të parqesë dhe identifikojë gjurmët e ligjit agrar në të drejtën kanunore dhe statutore shqipëtare duke evidentuar, analizuar dhe krahasuar sistemet juridike kanunore dhe statutore të orgnizimit të qyteteve arbërore, me qëllim identifikimin e pikave të përbashkëta.*

## ABSTRACT

*“Nomos Georgigos”-The Byzantine Agrarian Laë is the backbone of a legislative package that has operated in the Albanian lands. This fundamental laë has a time span of VII century until the fourteenth century and represents the base where the Byzantine Empire supported its*

activities. If his nomination refers the creation of the idea that we are dealing with a law that regulates the agriculture area, but in fact it contains norms that regulate all administrative, financial, fiscal, criminal operations, etc. territories and populations included in the borders of Byzantium and the cities of Arberia.

The Agrarian Law because of the coexistence for many centuries received from our legal traditions as well as the statutes have left traces in judicial terms of that time in the Albanian lands and cities and towns that were ruled by the Byzantine Empire.

On the other side the Albanian customs law with its peculiarities and dialects, is represented to us in many views. It consists of a strong skeleton of norms with different ancient domestic sources, but there are also influences from the outside by different Codes Greco-Byzantine, Romanesque, Shari'ah, from the customs of different countries that ruled our region for centuries. Foreign influences have left their non equal marks in different regions.

This is shown by the fact that for similar situations the canons of different regions provided different consequences. These contradictions of the same phenomenon to explain specific elements can be explained by three reasons: firstly archaic forms more evolved forms ; secondly the national norms that contradict the norms from abroad; thirdly, besides a national unitary has certain regional features that are conditioned by geographical, climate, economic resources features.

Precisely this paper intends to file and identify traces of agrarian law in the Albanian canon law and statute by highlighting, analyzing and comparing canon legal systems and statutes of different cities in Arberia, to identify common items.

## **DEDIKIMI**

*Këtë punim ja dedikoj dy vajzave të mija Rashelit dhe Rezalindës.*

## **PËRMBAJTJA E LËNDËS**

### **KAPITULLI I: HYRJE DHE BAZIM TEORIK**

1. Historiku, Qellimet, dhe Parametrat e Studimit.....	9
2. Hipoteza e punimit.....	11
3. Pyetjet kërkimore të punimit.....	12
4. Metodrat dhe metodoogjia e përdorur, Termi "Kultura Ligjore" dhe aplikimi i saj ne Ligjin Bizantin.....	12
5. Burimet.....	15
6. Bazat e jurisprudencës bizantine.....	16

### **KAPITULLI II: BIZANTI, NJË PERANDORI SHUMËDIMENSIONALE, LINDJA, ZHVILLIMI DHE RISITË E SAJ SI PJESË E PERANDORISË ROMAKE**

1. Lindja e Bizantit nga Perandoria Romake.....	18
1.2. Bizanti dhe qytetërimi Agrar Mesdhetar, Karakteristikat dhe tiparet origjinale te komunitetit rural bizantin.....	22
1.3 Prejardhja e një qytetërimi të përbashkët agrar në Mesdhe.....	24
1.4 Sinkronizimi i ngjarjeve.....	27
1.5 Karakteristikat dhe tiparet origjinale të komunitetit rural bizantin.....	29
1.6 Shqipëria dhe Bizanti.....	31
2. Reformat ligjore të Perandorisë Romake si burimë të Bizantit të mëvonshëm.....	33
2.1. Periudha e kodifikimit te ligjeve (867-886).....	34
2.2. Ligjet e Kostandinit VII.....	39
2.3. Ligjet e Bazilit II.....	41
3. Risitë e Perandorisë së Bizantit krahasuar me Perandorinë Romake.....	41

### **KAPITULLI III: LIGJI AGRAR, GJENEZA E TIJ, ZHVILLIMI DHE KARAKTERISTIKAT**

1. Gjeneza e ligjit Agrar.....	43
--------------------------------	----

2. Analizë juridike – krahasuese e ligjit Agrar me të drejtën zakonore shqiptare.....	45
2.1. Marrëdhëniet e pronësisë dhe detyrimet.....	49
3. Marrëdhëniet e pronës në bashësinë fshatare nën efektin e Ligjit Agrar.....	53
4. Krahasimi i ligjit Agrar me të drejtën Romake.....	56

#### **KAPITULLI IV: REFLEKTIMI I LEGJISLACIONIT BIZANTIN NË TË DREJTËN DOKESORE SHQIPTARE**

1. Nocioni i të drejtës zakonore, lindja e saj.....	61
2. Gjurmët e ligjit Bizantin në kanunet dhe statutet e qyteteve shqiptare.....	65
3. Analizë krahasimore e Stautit të Shkodrës si burim i së drejtës zakonore me ligjin Bizantin.....	68
4. Analizë krahasimore e Kanunit të Skënderbeut si burim i së drejtës zakonore me ligjin Bizantin.....	72
5. Analizë krahasimore e Kanunit të Lekë Dukagjinit si burim i së drejtës zakonore me ligjin Bizantin.....	80
5.1. Ndikimi i ligjit Agrar te Kanuni i Lekë Dukagjinit.....	86
6. Kanuni i Labërisë vështrim krahasimor me normat bizantine.....	88
7. Analizë krahasimore e Statutit të Durrësit si burim i së drejtës zakonore me ligjin Bizantin.....	93

#### **KAPITULLI V: LEGJISLACIONI AGRAR BIZANTIN DHE AI VENEDIKAS NE SHQIPËRI**

1. Vendosja e rregjimit venedikas në trevat shqiptare.....	96
2. Legjislacioni që u aplikua nga Venediku në Arbëri .....	99

#### **KAPITULLI VI: LEGJISLACIONI OSMANE NË SHQIPËRI,VËSHTRIM KRAHASUES ME LIGJIN BIZANTIN**

1. Pushtimi otoman, vendosja e rregjimit të tij.....	108
2. Karakteristikat e administrimit osman.....	112
3. Legjislacioni otoman që u zbatua në Shqipëri.....	122
3.1. Kanunamet ose ligjet laike.....	125

3.2. Reformat në fushën agarare para Tanzimatit.....	138
3.3. Zëvendësimi i sistemit të timareve me atë të pronës çifligare, shkaqet dhe pasojat që kjo reformë pati në trevat e vendit.....	145
4. Idetë mbi ligjin, që u zhvilluan nën osmanët .....	174
5. Analizë krahasimore e ligjit Bizantin me legjislacionin otoman.....	183
6. Analizë krahasimore e ligjit osman me të drejtën zakonore shqiptare.....	198
<b>KAPITULLI VII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME.....</b>	<b>202</b>
<b>BIBLIOGRAFIA.....</b>	<b>206</b>



## KAPITULLI I

### Hyrje dhe bazim teorik

#### 1. Historiku, qëllimet dhe parametrat e studimit

Shtysë për këtë studim ishte një artikull i botuar në vitin 1989 nga historiani bizantin Aleksandër Kazhdan<sup>1</sup>, i cili e fillon kritikën e tij në fushën e së drejtës bizantine duke vënë në dukje se teksti klasik mbi këtë temë i Karl Eduard Zaharia fon Lingenthal (*Karl Eduard Zacharia von Lingenthal*) “*Geschichte des griechisch-römischen Rechts*”, i botuar së pari në vitin 1846<sup>2</sup>, edhe pse kishin kaluar 150 vjet, nuk ishte arritur apo tejkaluar nga ndonjë punë tjetër. Në shkrimin e tij A. Kazhdan ankohej se historianët e ligjit ishin të interesuar dhe të përqendruar vetëm në historinë e burimeve normative bizantine, të tilla si romanet perandorake, librat e së drejtës dhe traktatet ligjore. Ai mbështet idenë se studimi i ligjit bizantin duhej të përfshinte burimet joligjore, si historitë mbi jetën e shenjtoreve dhe romancat, se ligji bizantin duhej të bëhej një histori e institucioneve dhe jo vetëm e shkencave juridike dhe se studimi duhej të zbulonte realitetin e statusit të njeriut, të të drejtave dhe transaksioneve, të punës së zhvilluar nga gjykatat

---

1. Kazhdan P. Alexander (1989), *Do We Need a New History of Byzantine Law?*, JÖB 39, pp 1–28. Shih idem, Κοινωτία (1988), *Che cosa chiede lo storico di bisanzio allo storico del diritto?*, pp 129–144.

2. Lingenthal von Zachariä K. Eduard (1892), *Geschichte des griechisch-römischen Rechts*, 3rd edition, Berlin, *Wiedmannsche Buchhandlung*, f. 128.

3. Shih, Kazhdan P. Alexander, (1989), f.28.

gjyqësore dhe jo vetëm imazhet greke të jurisprudencës romake, që në të vërtetë ishin interesante, por shpesh mjaft larg realitetit të përditshëm<sup>3</sup>.

Për të konkretizuar këtë kritikë të Kazhdanit është e nevojshme të ndalemi pak në historinë e së drejtës bizantine.

Edhe pse mund të thuhet se studimet moderne mbi ligjin bizantin kanë filluar në shekullin e 11-të është e rëndësishme të theksohet se ligji bizantin edhe në periudhën e hershme moderne kishte një funksion utilitar<sup>4</sup>. Një fakt interesant në ligjin bizantin përkon me kodifikimin e së drejtës romake, e cila ka shërbyer si bazë për shtet-kombet moderne europiane, të tilla si *Allgemeines Landrecht* për Prusinë (1794), të Kodit Civil (1804) për Francën dhe *Das Allgemeine bürgerliche Gesetzbuch für das Kaisertum Österreich* (1811) për zotërimet e Habsburgëve. Historianët e parë që kanë studiuar ligjet bizantine janë trajnuar si avokatë, të tillë si juristi francez Jean Anselme Bernard Montreuil<sup>5</sup> dhe figura kryesore në studimin e historisë ligjore bizantine Karl Eduard Zaharia fon Lingenthal, shkrimet e të cilit u shtrinë në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të, ndër të cilat kanë spikatur studime mbi burimet ligjore bizantine dhe botime të shumta të teksteve dhe historisë të së drejtës bizantine, që kanë vënë një bazë të fortë.

Në ditët e sotme studimet bizantine ligjore të shekullit të 19-të kanë vazhduar përkatësisht në nivelin e kritikave dhe përshkrimeve të teksteve normative ligjore<sup>6</sup>, por në të vërtetë ka ende shumë punë për t'u bërë në këtë fushë. Një botim përfundimtar modern i kodit më të rëndësishëm ligjor të periudhës së mesme bizantine, "Bazilika", mungonte deri 25 vjet më parë<sup>7</sup>. Edhe kur Kazhdan në vitin 1981 prezantoi për herë të parë idetë fillestare të "A kemi nevojë për një histori të re të ligjit bizantin" në një konferencë në Frankfurt, ka marrë kritika të konsiderueshme nga historianët e ligjit që punonin me Dieter Simon në *Max-Planck-Institut für europäische Rechtsgeschichte*. Përgjigjet mbi propozimin e Kazhdanit janë shkruar nga Ludvig Burgman dhe Dieter Simon në vitet që pasuan. Një nga pikat e Burgmanit ishte se ndarja që bëri Kazhdan midis ligjit dhe realitetit i cilësonte studimet historike ligjore si pozitivizëm

---

3. Shih, Kazhdan P. Alexandër, (1989), f. 28.

4. Troje, H. Erich (1971), *Graeca leguntur: die Aneignung des byzantinischen Rechts und die Entstehung eines humanistischen Corpus iuris civilis in der Jurisprudenz des 16. Jahrhunderts*, Cologne: Böhlau, f. 44.

5. Anselme. J & Mortreuil B. (1843), *Histoire du droit byzantin: ou du droit dans l'Empire d'Orient, depuis la mort de Justinien jusqu'à la prise de Constantinople, en 1453*, 3 vols. Paris: E. Guibert, f. 6.

6. Lingenthal von Zachariä K. Eduard (1839), *Historiae juris graeco-romani delineatio. Cum appendice ineditorum* (Heidelberg: sumtibus Christiani Friderici Winter), f. 24.

7. Th. Bochove E. (1996), *To date and not to date: on the date and status of Byzantine law books*, Groningen: E. Forsten, f. 112.

juridik. Propozimi *Institutionengeschichte* i Kazhdan, modeluar mbi punën e Maks Kaser dhe Leopold Venger, nuk lejon përfshirjen e burimeve juridike jonormative. Nënvizimi i burimeve normative ligjore nga historianët ligjorë që u përfshinë në ekspertizën e tyre, ishte e kuptueshme. Pavarësisht kritikave dhe qëndrimeve pozitive, vetëm në vitet e fundit pati një progres në realizimin e propozimit të Kazhdanit. Botimi “*Ligji dhe shoqëria në Bizant*”, që u karakterizua nga kontributi i artit, ligjit dhe historisë sociale të Bizantit, pati një fillim mjaft të mirë<sup>8</sup>.

Puna e bërë nga Ruth Macrides, e cila ishte e përqendruar në fazat e mëvonshme të historisë bizantine, ka shërbyer si një model i përsosur për historianët që shkruajnë mbi ligjin bizantin<sup>9</sup>.

Edhe pse ky studim, “*Ligji agrar i Bizantit*”, nuk është historia e re e ligjit bizantin që kishte parashikuar Aleksandër Kazhdan, shumë shpejt do të bëhet e qartë për lexuesin se në konceptimin dhe zbatimin e tij është i kushtëzuar nga debati që filloi tridhjetë vjet më parë me bizantinistin e shquar rus kur ai paraqiti propozimin e tij për një histori të re të së drejtës bizantine në vitin 1981. Pavarësisht karakteristikave të gabuara të historisë dhe historianëve ligjorë, ajo që thoshte Kazhdan se puna në të ardhmen e historisë bizantine ligjore duhej të përfshinte plotësisht burimet e disponueshme dhe jo vetëm burimet normative juridike, është zbatuar në mënyrën më të ndërgjegjshme. Nga ana tjetër, ajo çka do të jetë e dukshme menjëherë për lexuesin është se ky studim vjen si meritë e dijetarëve dhe debatit të historianëve që kanë trajtuar dhe studiuar ligjet bizantine. Për sa i përket materialit burimor ky studim vjen dhe ndikohet nga vizioni i Aleksandër Kazhdanit lidhur me faktin se si do të duken punimet e ardhshme mbi ligjin bizantin dhe i ndikuar sidomos nga Dieter Simoni<sup>10</sup>, i cili me analizën e tij nënvizoi disa nga komponentet kryesore të kulturës ligjore bizantine (ndonëse Simoni nuk e ka identifikuar atë si të tillë): parimet e krishterimit ortodoks, mënyrat eklektike të përfshirjes së teksteve ligjore dhe rolin e klasës sociale. Shqyrtimi i këtyre modeleve dhe mënyrës me anë të së cilës ato bashkëveprojnë me regjimin normativ juridik në këtë studim po e quajmë “kultura juridike bizantine”.

## 2. HIPOTEZA E PUNIMIT

---

8. Angeliki E. Laiou and Simon. D (eds), (1994), *Law and Society in Byzantium: Ninth—Twelfth Centuries*, Washington, D.C.: Dumbarton Oaks Research Library and Collection, f. 65.

9. R.J. Macrides (1999), *Kinship and justice in Byzantium, 11th-15th centuries*, Variorum collected studies series (Aldershot, Hampshire, Great Britain; Brookfield, Vt: Ashgate/Variorum).

10. Simon. D. (1973), *Rechtsfindung am byzantinischen Reichsgericht*, Wissenschaft und Gegenwart; Juristische Reihe 4 (Frankfurt am Main: V. Klostermann).

Ligji Agrar si shtyllë kryesore e paketës ligjore Bizantine ka vepruar në trojet shqiptare në simbiozë shumë shekullore me normat zakonore, duke rregulluar tërë veprimtarinë administrative, financiare, fiskale, penale, të territoreve arbërore dhe popullsive që përfshiheshin në kufijtë e Bizantit.

### **3. PYETJET KËRKIMORE TË PUNIMIT**

1. Si lindi Ligji Agrar si pjesë e legjislacionit Bizantin dhe kur filloi të aplikohet në Shqipëri ?
2. A mund të konsiderohet ky ligj si një përzgjedhje me pjesë nga veprat juridike të Justinianit I apo bëhet fjalë për pjesë të marra nga një libër juridik i Justinianit II që nuk ka arritur deri tek ne?
3. A ekzistojnë gjurmë të Kulturës Ligjore Bizantine në strukturën shoqërore të fshatit në treva të ndryshme të Shqipërisë?
4. Çfarë rëndësie pati zhvillimi i kulturës ligjore bizantine për studimet e ardhshme të ligjit dhe shoqërisë Bizantine?
5. Cilat janë të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet Ligjislacionit Bizantin dhe të drejtës zakonore Shqipëtare?

### **4. METODAT DHE METODOLOGJIA E KËRKIMIT**

Metodat e kërkimit që kam përdorur në këtë studim janë: metoda historike, përshkuese ,analitike dhe krahasimore , për të trajtuar çështjet dhe problematikat e parashtruara në disertacion.

Këto metoda janë përdorur për të studiuar Ligjin Agrar të Bizantit si pjesë e të drejtës zakonore shqiptare në dimensione e ndryshme të zhvillimit dhe ndikimit të qytetërimit agrar bizantin dhe ndikimit që ky qytetërim ka pasur në shoqërinë shqiptare e parë kjo në vështrim krahasues me Kanunet.

*Metoda historike* është përdorur për të pasqyruar kontekstin historik të lindjes dhe zhvillimit të Ligjit Agrar të Bizantit si pjesë e rëndësishme e mozaikut juridik të qytetërimit agrar bizantin. Është paraqitur një trajtim i hollësishëm historik i lindjes së Perandorisë Bizantine si rrjedhojë e ndarjes së asaj romake duke nxjerrë në pahë nevojën për lindje dhe zhvillimin e një pakete të re ligjore e cila duhet të paraprinte rregullit të ri shoqëror që po vendosej në

Lindje.Gjithashtu punimi ka ecur duke iu referuar kësaj metode edhe në momentet e tjera të daljes në skenë të pushtuesve të ndryshëm si Venediku apo pushtimi sllav apo ai otoman të cilët kërkonin të dëgjoheshin e të sundonin mbi bazën e rregullave të tyre juridik.Trajtimi historik bënë të mundur të nxjerrë më në pahë nevojën e aplikimit, të përshtatjes apo mbijetesës së legjislacionit bizantin në trevat shqiptare.

**Metoda përshkruese** e përdorur në këtë punim për të përshkruar dhe për të bërë një trajtim të plotë të kuadrit rregullator të Ligjit Agrar të Bizantit si pjesë e të drejtës zakonore shqiptare me qëllim evidentimin e gjurmëve, risive dhe ndikimit që ka pasur qytetërimi agrar Bizantin në Shqipëri.Përshkrimi në mënyrë të hollësishëm i normave juridike të legjislacionit Bizantin mundëson trajtimin krahasimor të tij me normat zakonore shqiptare të cilat përvec origjinalitetit të tyre arritën të huazonin edhe element të huaj për një përshtatje më të mirë të kohës. Ky studim kërkon që të kryhet një përshkrim i hollësishëm i elementit historik bashke me atë juridik për të hedhur dritë mbi një periudhë të rëndësishme të njerëzimit që ka lënë gjurmë të shumta deri në ditët e sotme.Duke patur parasysh shtrirjen e gjatë kohore të mbijetesës së perandorisë Bizantine , ka qënë disi e vështirë që një studim i vetëm të mund të citoj cdo moment historik të saj .Jemi përpjekur të ndalemi tek elementet më të spikatur të asaj kohe që kanë qënë determinant në gjurmët e lëna në kohë, i kemi cituar, përshkruar sipaslinjës së këtij studimi duke i bërë prezent sic kanë qënë dhe çfarë kanë sjellë deri tek ne.Një përshkrim i hollësishëm mundëson më pas një analizë më të saktë dhe një krahasim më të detajuar të legjislacioneve që përshkruhen gjatë këtij studimi.

**Metoda analitike** bazohet në analizën dispozitive të Ligjit Agrar dhe ne Analizën e Kanuneve të trajtuara në këtë studim, të drejtës zakonore shqiptare.Duke patur parasysh se legjislacioni bizantin dhe në vecanti ligji Agrar rregullonin pjesë të ndryshme të jetës në Shqipëri , janë marrë në analizë dispozita të vecanta si psh në fushën penale dhe janë analizuar parë në këndvështrim krahasues me të drejtën zakonore shqiptare.Në analizë janë marrë edhe normat juridike që aplikoi Venediku , pushtimi otoman të cilët u vendosën pas pushtimit bizantin , duke parë ndikimin e tyre, përplasjen apo përshtatjen si me ligjin bizantin ashtu edhe me normat zakonore shqiptare.

Metoda analitike ndihmon të nxjerrë në pahë qëllimin që ka ky studim, për të sjellë të gjitha risitë e legjislacionit bizantin deri në kohët e sotme.

**Metoda krahasuese** është përdorur për të krahasuar Ligjin Agrar të Bizantit si pjesë e paketës ligjore të Bizantit me të drejtën zakonore shqiptare, Kanunet e tjera me qëllim identifikimin e të përbashkëtave dhe dallimeve midis tyre. Kjo metodë shërben për të skanuar simbiozën e gjatë mes tyre, krahasimi i hollësishëm i normave juridike të secilës prej tyre mundëson nxjerrjen në pahë të evoluimit të së drejtës shqiptare në periudha të ndryshme historike. Krahasimi tregon origjinalitetin e së drejtës dhe masën e ndikimit të elementëve të huaj pushtues të cilët me uzurpimin e territoreve të ndryshme, aplikonin dhe rendin e tyre juridik. Studimi i këtij punimi plotësohet me trajtimin krahasues të normave juridike i cili analizohet përkrah trajtimit historik në periudha të ndryshme.

#### **4.1 Metodologjia**

Përmes një vëzhgimi të hollësishëm dhe aplikimit të metodave kërkimore shkencore hulumtuese dhe krahasuese, synoj të trajtoj nga pikpamja historike një pjesë të legjislacionit Bizantin i cili ka lënë gjurmë në çdo hap të historisë së vendit tonë.

#### **Termi “kultura juridike” dhe aplikimi i saj në ligjin bizantin**

Termin “kultura juridike” e ndeshim në fushën e antropologjisë ligjore dhe është bazuar në mendimin se ligji nuk mund të kuptohet dhe analizohet jashtë kontekstit të gjerë kulturor dhe shoqëror ku ka lindur dhe ka vepruar<sup>11</sup>. Fillimisht antropologjia ligjore është zhvilluar si një mënyrë e analizimit të kulturës orale, që nuk bazohej në një traditë të shkruar ligjore<sup>12</sup>.

Laurenc Fridman e përfshiu termin “kultura ligjore” në fushën e sociologjisë së ligjit si bashkim të ideologjisë së një shoqërie juridike me praktikën dhe presionet shoqërore. Ai bënte dallimin ndërmjet kulturës së brendshme ligjore dhe asaj të jashtme. Brenda skemës së Fridmanit kultura e brendshme ligjore përfshinte profesionistët ligjorë, ndërsa kultura e jashtme i referohej pjesës tjetër të shoqërisë. Sipas Fridmanit, ndikimi i së parës është ekzagjeruar shpesh nga studiuesit

---

11. Mark Goodale and Elizabeth Mertz, “Anthropology of Law” in *Encyclopedia of Law & Society*, vol. 1, f. 69–78.

12. Keebet von Benda-Beckmann, “Legal Anthropology” in Stanley N. Katz (ed.), (2009), *The Oxford International Encyclopedia of Legal History* (e-reference edition) (Oxford [UK]; New York: Oxford University Press).

ligjorë<sup>13</sup>. Kohët e fundit kultura ligjore është përdorur në lidhje me shtet-kombet moderne për të përshkruar, për shembull, faktorët kulturorë që përbëjnë normat e procesit gjyqësor për vendet e ndryshme europiane<sup>14</sup>.

Pavarësisht dobisë së kulturës ligjore, si një mjet orientues për analizën historike, përdorimi i saj është kritikuar për paqartësi: shumë shpesh kultura ligjore është një term i përdorur për të shpjeguar atë që nuk mund të shpjegohet në mënyrë tjetër, domethënë kultura bëhet përfituese e afatit të mbetur në ekuacione të qarta<sup>15</sup>. Në këtë studim termi bizantin “kultura ligjore” u referohet kryesisht aspekteve të ndërveprimit ndërmjet regjimit normativ ligjor dhe fenomeneve të ndryshme, qofshin këto ide rreth drejtësisë, zakoneve, praktikave të një grupi të caktuar shoqëror apo ndikimit të teksteve jonormative ligjore në shoqërinë e Bizantit të mesëm. Duhet të theksohet se nuk është i pari ky studim ku përdoret termi “kultura ligjore bizantine”. Ky term u përdor ndër të tjerë edhe nga bizantinisti rus Medvedev, i cili në monografinë e tij “*Kultura ligjore e Perandorisë Bizantine*” e përdor termin krejt ndryshe<sup>16</sup>.

## 5. Burimet

Pse koncepti “kultura ligjore” është veçanërisht i përshtatshëm për studimin e “*Ligjit agrar të Bizantit*”? Kjo përshtatje u zgjodh pjesërisht për shkak se ajo mund të lidhet me llojet dhe sasinë e burimeve, veçanërisht të burimeve ligjore, që historianët kanë mundësi të shfrytëzojnë për këtë periudhë, që mund të jenë një numër i madh librash mbi ligjin, romane perandorake dhe tekste ligjore (të cilat do të referohen si burime normative ligjore), por të dhënat për raste apo shembuj të asaj që historianët ligjorë e klasifikojnë si “ligji në veprim” janë të paktë. Ky çekuilibër ka cenuar rëndë punën e bërë nga historianët ligjorë bizantinë.

---

13. Nelken, D, “*Culture, Legal*” in David S. Clark (ed.), (2007). *Encyclopedia of Law & Society: American and Global Perspectives*, 3 vols. (Los Angeles: Sage Publications, vol. 1, f. 370–376.

14. Bell, J. (2001). *French Legal Cultures, Law in Context* (London: Butterworths,); Blankenburg, E and Bruinsma, F. (1994), *Dutch legal culture*, 2nd ed. (Deventer; Boston: Kluwer Law and Taxation Publishers).

15. James L. Gibson and Gregory A. Caldeira, “The Legal Cultures of Europe”, *Law & Society Review* 30.1 (1996), f. 55–86; here f. 56.

16. I.P. Medvedev (2001), *Правовая культура Византийской империи* (St. Petersburg: Aletei ia).

Janë bërë shumë studime lidhur me burimet bizantine normative ligjore<sup>17</sup>, të cilat përfshijnë librat mbi ligjin, romanet perandorake, tekstet ligjore, komentet mbi burimet e tjera ligjore dhe traktatet ligjore. Ndër librat mbi ligjin duhet të bëjmë një ndarje ndemjet atyre zyrtarë, atyre të sanksionuar të së drejtës perandorake dhe të ashtuquajturve “koleksione privatë”. Këto u plotësuan dhe u sanksionuan nga regjimi perandorak dhe përfaqësonin ligjin zyrtar të tokës.

Koleksionet privatë të ligjit, të tilla si ligji agrar, për pjesën më të madhe nuk kishin origjinë të qartë dhe nuk ishin të sanksionuara nga Perandoria, edhe pse ndonjëherë disa histori të pavërteta iu bashkëngjiten këtij koleksioni. “Funksioni i koleksioneve privatë ligjore në Perandorinë Bizantine dhe në kulturat fqinjë” ishte një përpjekje për t’iu përgjigjur njërës prej pyetjeve më të ndërlikuara me të cilën u përballen historianët ligjorë bizantinë: cili ishte funksioni i koleksioneve të shumta juridike privatë që vijnë nga periudha e mesme bizantine? Në këtë studim jemi përpjekur të argumentojmë se, megjithëse nuk ishin të përfshira në koleksionet zyrtare ligjore, këto të fundit janë përdorur nga zyrtarët që ishin të trajnuar nga ana ligjore me miratimin e Perandorisë, që kishte lehtësuar përdorimin e tyre. Një rëndësi e veçantë i kushtohet së drejtës zakonore shqiptare, me synim identifikim e gjurmëve të ligjit agrar në shoqërinë dhe të drejtën shqiptare, duke bërë një analizë të thellë dhe gjithëpërfshirëse të përmbajtjes së ligjit të parë në vështrim krahasues me mozaikun e kanuneve shqiptare.

## 6. Bazat e jurisprudencës bizantine

Ligji bizantin në fillim ishte një sistem i kodifikuar. Në një sistem të tillë gjyqtari duhej të bazohej në një ose më shumë etapa, nene të një kodi ligjor të lëshuar paraprakisht nga ligjvënësi. Me fjalë të tjera, gjyqtari ka nevojë për autoritetin e ligjvënësit dhe e ka të pamundur të krijojë vetë një ligj apo të mbështetet mbi një gjykim të mëparshëm të ashtuquajtur “precedent”. Është ky aspekti që bën diferencën nga ligji anglo-amerikan me ligjin e kodifikuar kontinental<sup>18</sup>.

Studiuesit e ligjit e kanë klasifikuar prej kohësh ligjin e Bizantit të mesëm si një sistem të kodifikuar, ose një sistem ligjor që e zbatonte ligjin mbi bazën e rregullave të shkruara. Nga një pikëpamje e përgjithshme ky klasifikim është korrekt. Pavarësisht çfarëdolloj devijimi nga ligji

---

17. Lingenthal von Zachariä K. Eduard, *Historiae juris graeco-romani delineatio*; N. van der Wal and J.H.A. Lokin (1985). *Historiae iuris graeco-romani delineatio: les sources du droit byzantin de 300 à 1453* (Groningen: E. Forsten).

18. Bernard H. Stolte. (1998), “Not new but novel. Notes on the historiography of Byzantine law”, *BMGS* 22: f. 264–279; here f. 270–271.



romak, nuk ka asnjë dyshim se ky i fundit ishte ai ku bazohej çdo argumentim. Në fillim të shekullit të 12-të studiuesit ligjorë përcaktuan një vazhdueshmëri të rëndësishme të traditës së ligjit romak në periudhën bizantine. Edëin Hammond Freshfield<sup>19</sup>, një përkthyes i saktë i koleksioneve ligjore bizantine në gjuhën angleze, në vitin 1928 deklaroi se “*unë duhet t’u kujtoj sërish studentëve se nuk pati asnjë ndërprerje në vazhdimësinë e ligjit romak*”.

Po ashtu edhe Peter Pieler në shkrimet mbi literaturën ligjore në *Hochsprachliche profane Literatur der Byzantiner* theksoi vazhdimësinë e ligjit romak në atë bizantin<sup>20</sup>. Që nga ajo kohë nuk ka më arsye që të dyshohet për forcën e vazhdimësisë së ligjit romak, dhe këtë do ta trajtojmë më vonë në këtë kapitull. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se shumë nga shembujt e jurisprudencës që mbijetojnë nga periudha bizantine e mesme pothuajse të gjitha vendimet janë përshtatur brenda së drejtës romake.

Çështja e rolit të ligjit romak në atë bizantin ka dominuar për shekuj me radhë. Pikëpamja tradicionale është se bizantinët kanë vepruar si konservatorë të traditës ligjore romake. Brenda 40 vjetve të fundit historianët ligjorë bizantinë kanë dhënë shumë nuanca të rolit që kishte ligji romak në ligjin dhe sistemin ligjor bizantin. Bernard Stolte ka argumentuar se me anë të ligjit romak pikëpamja ligjore bizantine ishte më fluide sesa mund të duket në shikim të parë: “Duke iu rikthyer ligjit të Justinianit dhe duke mos ndryshuar ligjin e rregulluar nga pikëpamja normative, - thotë ai, - nuk duhet të jetë shenjë e konservatorizmit dhe pandryshueshmërisë së shoqërisë bizantine.” Për më tepër, burimet zyrtare nuk janë në gjendje të tregojnë dhe përcaktojnë gjithë historinë. Problemi qëndron në faktin se ne kemi shumë informacione për legjislacionin në fuqi, që nuk mund të na tregojë se si është marrë praktika ligjore me këtë legjislacion. Duhet pranuar me të vërtetë se na mungon një korpus i plotë i teksteve për të dokumentuar se si u zbatua ligji gjatë kësaj periudhe.

Duke u mbështetur mbi disa interpretime të ligjit bizantin, “Bazilika”, një përmbledhje e legjislacionit të Justinianit, përfaqëson një shtrirje të sistemit ligjor të kodifikuar. Përveç “Bazilikës” ekzistojnë dy burime të tjera të legjitimuara të autoritetit ligjor: zakonet<sup>21</sup> dhe vetë perandori. Në kuadër të ligjit romak zakonet u sanksionuan ligjërisht aty ku nuk ekzistonte asnjë

---

19. Freshfield E. Hanson. (1928), *A Manual of Eastern Roman Law: the Procheiros Nomos*, (Cambridge [Cambridgeshire]: University Press, f. vii.

20. Peter E. Pieler, “Byzantinische Rechtswissenschaft” in Hubert Hunger (ed.), *Die hochsprachliche profane Literatur der Byzantiner*. Handbuch der Altertumswissenschaft 12/5, 2 vols (Munich: Beck, 1978), vol. 2., f. 343–480.

21. Shih, Alexandër Kazhdan and Mark C. Bartusis, “Custom” in *ODB*, vol. 1, f. 565–566.

ligj i shkruar. Për këtë Ulpiani ka deklaruar se “zakonet merren në konsideratë si precedent në ato situata kur ligji nuk është i shkruar”. Një pasazh më tej Ulpiani shpjegon se lidhur me çështjet për të cilat nuk ka një ligj të shkruar duhet të respektohen zakonet dhe traditat. Nëse kjo dështon, duhet të ndiqet ajo që është më e përshtatshme dhe më e saktë në çështjen nën hetim. Dhe nëse asnjë nga këto metoda nuk jep rezultat, atëherë ligji që aplikonte Roma duhej të merrej në konsideratë. Sipas traditës antike, vëzhgohet në vend të së drejtës. Ashtu si përpilimi i një ligji mund të jetë me shkrim ose jo, edhe shfuqizimi i tij mund të vijë nëpërmjet një ligji të shkruar apo jo, që është në rastin e mospërdorimit.

Në mendimin klasik juridik romak diferenca ndërmjet ligjit dhe zakonit ishte ajo ndërmjet ligjit të shkruar dhe atij të pashkruar. Një dijetar anonim i “Bazilikës” shpjegon se “ligji dhe zakoni ndryshojnë vetëm në një aspekt: ligji është një zakon i shkruar, ndërsa zakoni është një ligj i pa shkruar”.

Burime të tjera të legjitimitetit të autoritetit ligjor tregojnë se autoriteti më i lartë pas Zotit ishte vetë perandori. Zyrtarisht perandori nuk ishte subjekt i ligjeve të Perandorisë, megjithëse nga pikëpamja morale dhe ekonomike nuk ishte e nevojshme. Shtrirja e kontrollit perandorak mbi ligjin e shkruar u bë shumë e qartë me thënien “çfarëdo që kërkon perandori është ligj”. Fuqia për të ndryshuar ligjet e shkruara u aplikua në formën e dekreteve, por këto dekrete shpesh vërtetuan shkelje të sistemit ligjor<sup>22</sup>.

## **KAPITULLI II**

### **Bizanti - një perandori shumëdimensionale. Lindja, zhvillimi dhe risitë e saj si pjesë e Perandorisë Romake**

#### ***1. Lindja e Perandorisë Bizantine***

---

22. Sarris. P. (2011), “*Law & Custom in the Byzantine Countryside from Justinian to Basil II (c. 500–1000)*” in Alice Rio(ed.), *Law, custom, and justice in Late Antiquity and the Early Middle Ages: Proceedings of the 2008 Byzantine Colloquium* (London: Centre for Hellenic Studies, King’s College London, Occasional Publications, f. 49–62.

1123 vjet e 18 ditë shënon në historinë botërore ekzistenca e Perandorisë Bizantine: nga 11 maji 330, kur e themeloi Konstandini i Madh, e deri më 29 maj 1453, kur sulltani Mehmeti II e pushtoi atë. Një perandori e Lindjes me ndryshime esenciale nga ajo e perëndimit, por edhe me trashëgimi të dukshme bazuar në tri shtylla kryesore: strukturë shtetërore romake, kulturë greke dhe besim i krishterë. Nuk mund të kuptohet ekzistenca e kësaj perandoria pa këto tre elemente. Do të ishte sinteza e kulturës greke dhe besimi i krishterë mbështetur te struktura shtetërore romake që mundësuan lindjen dhe zhvillimin e një prej perandorive më mbresëlënëse në historinë e njerëzimit. Gjeneza e epokës bizantine shënohet nga dy ngjarje të mëdha: vendosja e krishterimit dhe zhvendosja e qendrës politike të Perandorisë në Lindjen helenike. Perandoria Bizantine duhet kuptuar si vazhdimësi e Romës së vjetër ose si një periudhë e re e historisë romake. Kjo del qartë edhe nga fakti se me krijimin e kësaj perandorie perandorët e saj vazhdonin ta quanin veten “perandor romak” dhe më vonë u përdor termi “Bizant”. Qeverisja e kësaj Perandorie u realizua mbi një mendësi romake, duke i qëndruar besnik traditës shtetërore romake. Karakteristika kryesore e kësaj Perandorie ishte realizimi i idesë së universalizmit, një ide romake, që u vu në themel të gjithë veprimtarisë së perandorisë së re. Pretendohej që çdo shtet që ndodhej në truallin e dikurshëm romak të përfshihej nën këtë Perandori dhe në këtë mënyrë u krijuan shumë shtete, në krye të cilave qëndronte perandori bizantin, i konsideruar si kreu i botës së krishterë<sup>23</sup>.

Por me gjithë tendencat e shfaqura për t’i qëndruar besnik traditës së vjetër romake realiteti i kohës tregoi se Bizanti u largua shumë nga kjo traditë. Elementi grek dominoi në kulturë dhe në gjuhë, iu dha shumë pushtet gjithëpërfshirës kishës, gjithë zhvillimi i Bizantit ishte tepër dinamik, dhe kjo solli vendosjen e një sistemi të ri ekonomiko-shoqëror, një sistem administrativ krejt të ndryshëm nga Roma. U deshën plot tre shekuj që të ndodhte e ashtuquajtura “shkrirje” e Perandorisë Romake në atë Bizantine, periudhë gjatë së cilës format e jetës së Romës së lashtë shuhën pak nga pak, duke u zëvendësuar me dukuritë e reja të qytetërimit bizantin. Ky ndryshim vihet re te dy qytetet karakteristike të tyre: Venecia, provinca e parë e Perandorisë, qyteti që në bazilikën e Shën Markut, e frymëzuar ndër të tjera edhe nga kasa e apostujve të shenjtë të Konstandinit. Nga ana tjetër, Kostandinopoja që vazhdimisht e kërcënuar; rrethimet pasonin njëri-tjetrin dhe në të shumtën e herëve kishte shpëtuar vetëm falë heroizmit të perandorit dhe shtetasve të tij. Ndryshimi vihet re edhe në mendësinë e dy qyteteve: venerianët

---

23. Krh.G.Ostrogorsky (1936), *Die byzantinische Staatshierarchie*, SK 8.

karakterizoheshin nga shpirti tregtar dhe ishin me këmbë në tokë, ndërsa bizantinët ishin mistikë dhe kishin në gjak Krishtin, Shën Marinë dhe shenjtorët. Edhe nga pikëpamja e organizimit politik ndryshonin. Venecia qeverisej nga komitetet pa emër, nga njerëz të veshur me të zeza, që zgjidheshin dhe ndryshonin vazhdimisht, punonin në heshtje dhe merrnin vendime të përbashkëta, duke iu shmangur çdo lloj epërsie individuale. Bizanti ishte një autokraci me një perandor të gjithëpushtetshëm, që trajtohej në një rang me apostujt, mëkëmbës i Zotit, zot i gjithëpushtetshëm i jetës së çdo shtetasi të vet. Kjo ishte perandoria më e krishterë e të gjitha kohëve.

Një faktor shtytës në krijimin e Perandorisë Bizantine ishte edhe kriza ekonomike e shekullit të tretë, e cila e rrënoi pjesën perëndimore të Perandorisë Romake, ndryshe nga Lindja, e cila tregoi aftësi të mëdha rimëkëmbjeje, duke sjellë në këtë mënyrë një terren premtues për lindjen dhe zhvillimin e një perandorie të re<sup>24</sup>. Në këtë kohë u shfaq dukuria e zhvillimit të latifondeve, lindja e pronës së madhe, që solli eliminimin gradual të pronës së vogël.

Kjo perandori kishte një pozicion gjeografik shumë strategjik në portat e Azisë. Në pikën lindore të një kepi të madh trekëndor të lagur në jug nga deti Marmara dhe në verilindje nga një gji i thellë e i lundrueshëm, i njohur që në antikitetin e hershëm si Briri i Artë, Bizanti ishte një port i shkëlqyer natyror dhe një kështjellë e pathyeshme, aq sa mjaftoi të fortifikohej vetëm nga ana e Tokës. Ishte e vështirë ta sulmoje nga deti, pasi deti Marmara është i mbrojtur nga dy ngushtica të gjata e të ngushta: Bosfori në lindje dhe Helesponti, apo Dardanelet, në perëndim. Qytetërimi bizantin ka pasur shumë elemente të përbashkëta me qytetërimin helen, si një forcë njësuëse dhe homogjenizuese.

Në Bizant perandori nuk është më vetëm komandant suprem i ushtrisë, por dhe gjykatësi më i lartë dhe legjislatori i vetëm. Ai është mbrojtësi i kishës dhe i besimit, konsiderohet i zgjedhuri i Zotit dhe objekt i një kulti të veçantë politiko-fetar. Një rol parësor në historinë e Bizantit ka luajtur Konstandini i Madh, dardan nga Nishi i sotëm<sup>25</sup>, i cili dallohet për dy vendime të rëndësishme që mori. I pari i referohet adoptimit të krishterimit si fe zyrtare e Perandorisë, ndërsa i dyti ishte transferimi i kryeqytetit nga Roma në Kostandinopojë, një qytet i ri i ndërtuar mbi Bizantin e lashtë, një qytet që do të mbante emrin e tij për 16 shekuj me radhë.

---

24. Krh. Rostovtzeff, *Gesellschaft und Wirtschaft*, II 238 e në vijim, A.H.M. Jones (1940), *The Greek City from Alexander to Justinian*, Oksford, 85 e në vijim.

25. Aristidh P. Kola, *Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve*, f. 128.

Kur Konstandinopoja u bë qendër e latinizmit të vonë, nisën të qarkullonin shumë legjenda mbi rrethana të mbinatyrshme të themelimit të tij. Fillimisht ky qytet nuk u destinua si kryeqytet i lindjes, ky mendim Konstandinit i lindi kur zhvilloi vizitën e dytë në Romë. Ai arriti të kuptonte se Roma, me gjithë atë traditë republikane dhe pagane, nuk kishte si të ishte zemra e perandorisë së re të krishterë. Roma kishte mbetur mbrapa nga pikëpamja intelektuale dhe kulturore dhe nuk mund të ndiqte mendësinë e re dhe më të përhapur të botës helenike. Bibliotekat, akademitë e saj nuk mund të krahasoheshin me ato të Aleksandrisë, të Antiokisë apo të Pergamosit. Nga ana tjetër, ekonomia ishte në krizë, popullsia ishte mbërthyer nga malaria, që po shfaroste popullsinë. Nga ana tjetër, shihej një pasuri e pafundme e madhe prej orientalit, e cila joshte çdo njeri dhe nuk mund të shpërfillej nga qeveritarët romakë. Zhvendosja e qendrës së Perandorisë drejt Lindjes u pa dhe si një vendim i mençëm strategjik për ta mbrojtur atë nga rreziqet që vinin nga Lindja, kryesisht persët. Pika kyçe e Perandorisë ishte Miloni, aty ku gjendej guri i parë miliar (gur miljesh në rrugët romake). Katër harqe triumfuese formonin një shesh katror, me një kupolë përsipër, mbi të cilën qe vendosur një relikte e krishterë e vjetër: Kryqi i Vërtetë, që perandoresha Helenë e kishte sjellë nga Jerusalemi vite më parë. Milioni ishte pika zero nga ku matëshin gjithë largësitë e Perandorisë, pra ishte kërthiza e botës. Pak më në lindje, aty ku më parë kishte qenë tempulli i Afërditës, u ndërtua kisha e parë e madhe e krishterë e kryeqytetit të ri, “Shën Irena”, e cila nuk i kushtohej ndonjë shenjtojeje apo martireje, por Paqes së Shenjtë të Zotit. Përkrah saj u ndërtua edhe kisha “Shën Sofia”, kisha e mençurisë hyjnore. U ndërtua një forum oval me dysheme mermeri, me një kolon në mes të marrë Helipolit të Egjiptit, brenda të cilit kishte shume relikte tepër të çmuara, si sëpata me të cilën Noa kishte ndërtuar arkën, copërat e bukës me të cilat Krishti pati shënuar urinë e njerëzve, shishja e pomadës e Maria Magdalenës dhe statuja e Athinës, që Eneja e kish marrë me vete nga Troja. Në maj të kolonës ngrihej një statujë, me trupin e një Apoloni të Fidias, dhe kokën e Konstandinit rrethuar me një brerore në formë rrezesh, i cili në dorën e djathtë mbante skeptrin, ndërsa në të majtën një glob, që kishte brenda një copë të Kryqit të Vërtetë. Kuptohet qartë se kjo ishte një përzierje elementesh kristiane e paganë, si një tablo e lartësisë së perandorit.

Pesë vjet më parë Bizanti ishte thjesht një ndër qytetet e shumta greke. Tani, i rilindur dhe i pagëzuar sërish, ishte *Roma e Re*, siç thuhej plot mburrje në shkrimin e gdhendur në një kolonë të gjykatës së sapoformuar. Natyrisht, Roma e vjetër ruante tërë privilegjet e dikurshme, madje dhe tregtia vazhdonte si më parë, por disa nga familjet senatoriane më me emër kishin marrë

rrugën e Bosforit, të joshur nga premtimet për pallatë të mrekullueshme në qytete dhe për prona të mëdha në vende të ndryshme.

Sovrani i fundit që mbretëroi në Perandorinë e bashkuar Romake ishte Flavio Teodosi, i njohur si Teodosi i Madh. Me vdekjen e tij Perandoria e Perëndimit nisi të shkonte drejt rënies për gati 80 vjet. Nga ana tjetër, Perandoria e Lindjes mbijetoi, duke fituar pak e nga pak personalitetin e vet. Latinishtja ia la vendin greqishtes dhe intelektin ia la vendin shpirtit, por tradita klasike vazhdoi pa u ndërprerë. Një nga frytet më të rëndësishme të punës së tij ishte *Kodi Teodosian (Codex Theodosianus)*, një përmbledhje e sistemuar e të gjitha ligjeve në fuqi në Orient dhe në Perëndim që nga koha e Konstandinit.<sup>26</sup>

Në vitet 438 u bë bashkimi i dy perandorive, që më tepër sesa një bashkim i vërtetë ishte një fasadë, pasi Perandoria e Lindjes dhe ajo e Perëndimit thuajse që në fillim zgjodhën rrugë të ndryshme dhe rrallë, për të mos thënë asnjëherë, ligjet e njërës zbatoheshin tek tjetra.

Shumë interesante paraqitet hyrja në skenë e perandorit Justinian, gjurmët e të cilit janë tepër domethënëse në legjislacion. Ishte fundi i sundimit të mbretit Anastas. Në kërkim të personit që do t'i kalonte fronin, ai thërret tre nipërit e tij për darkë në shtëpi, të cilëve, kur u shtroi për të pushuar pas darke, u vendosi mbi një jastëk një pusullë me shënimin "*regnum*". Por parashikimi i tij nuk u përmbush, pasi asnjë nga nipërit nuk e vuri kokën në jastëkun ku ndodhej pusulla. Atëherë ai vendosi që personi që do të hynte i pari në dhomën perandorake të nesërmen në mëngjes, do të ishte pasardhësi i tij. Hyri Justini, një 65-vjeçar nga Traka, komandanti i rojave, me aftësi të mëdha ushtarake, ambicioz, dinak dhe me një e nuhatje të madhe. Asi i tij nën mëngë ishte nipi i tij Justiniani, personi që realizoi paqen me Kishën e Romës. Pas 35 vjet ndarjeje, rriti shumë lulëzimin e Kostandinopojës. Në vitin 528 Justiniani ngriti një komision të drejtuar nga Triboniani, një gjykatës i emëruar kuestor, i cili në më pak se 14 muaj përpiloi *Codex-in* e ri, që hyri në fuqi në vitin 529 dhe u bë autoriteti më i lartë në gjithë gjykatat e Perandorisë. Më vonë, po përsëri nën drejtimin e Tribonianit, u ngrit një komision i dytë, i cili kishte si detyrë të mblidhte gjithë shkrimet e juristëve të lashtë romakë. Kjo përmbledhje u titullua "*Digesta*" ose "*Pandette*", që ishte përpjekja e parë për të sistemuar burimet juridike. Më në fund, në vitin 533 u botua një përmbledhje e dy vepra të sipërpërmendura e titulluar "*Institutionet*", i përpiluar për të gjitha shkollat e Perandorisë. Me vdekjen e Justinianit përfundoi

---

<sup>26</sup> Aristidh P. Kola, *Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve*, f. 158.

një nga epokat më të lavdishme të Perandorisë Bizantine, pasi ai ishte perandori i fundit i vërtetë romak që u ul në fronin e Bizantit, i cili kishte mendësinë e një latini dhe arsyetonte me logjikën e Perandorisë së lashtë Romake. Justiniani ishte prototipi i autokracisë dhe kishte një energji që i linte të mahnitur njerëzit që e rrethonin dhe një qëndrueshmëri të pashtershme në punë. Ai zgjeroi kufijtë e Perandorisë, zbatoi në mënyrë shumë të thjeshtëzuar ligjet, la një trashëgimi të shkëlqyer të veprave publike dhe gjurmë të thella në Perandorinë Bizantine.

## **1.2. Bizanti dhe qytetërimi agrar mesdhetar**

Historia e ekonomisë agrare dhe shoqërive rurale të mesjetës për disa kohë njihej si një nga fushat më premtuese të historisë së krahasuese<sup>27</sup>. Megjithatë, duhet pranuar se zhvillimi agrar në rajonin mesdhetar ka qenë shumë mbrapa në krahasim me atë të dy qytetërimeve të mëdha të Perëndimit mesjetar: atë të rajoneve të hapura fushore të Europës Veriore dhe atë të fushave të rajoneve të Atlantikut të Veriut të Europës Perëndimore. Pra, kjo histori ekonomike e Bizantit i jep mundësinë një specialisti në çështjet agrare të bëjë krahasimin mes strukturave agrare dhe shoqërive rurale të zonave greke dhe latine të Mesdheut.

Duhet bërë disa vërejtje paraprake para se të hyjmë në thelbin e çështjes. Duhet të theksojmë se gjatë 20 vjetve të fundit shumë zhvillime paralele kanë lehtësuar dhe përmirësuar krahasimin ndërmjet realitetit rural të botës bizantine dhe atij të Perëndimit latin.

Së pari, një nga elementet që na ndihmon në shqyrtimin e materialit burimor përmes metodës së krahasimit janë dokumentet që nën emërtime të ndryshme dhe diplomatike si dhe për qëllime të ndryshme juridike (regjistrat fiskalë, praktikant në Bizant etj.) kanë një subjekt të përbashkët: listat rurale, ku regjistroheshin punëtorët dhe çdo e dhënë tjetër që lidhej me punën dhe jetën e tyre. Dokumente të tilla na japin mundësinë të kemi informacione për demografinë, gjendjen e fshatarësisë, mënyrën e mbrojtjes së tokës dhe politikën administrative të agjentëve kryesorë ekonomikë.

Elementi i dytë që favorizon një pasqyrë më të qartë krahasuese është zhvillimi i arkeologjisë agrare në botën e Mesdheut në të gjitha format e saj. Arkeologjia e zgjeruar, siç është quajtur ndryshe, nënkupton eksplorimin sistematik të sipërfaqeve të zonave që janë përkufizuar si baza të kritereve të parapërcaktuara historike, dhe këto të fundit zakonisht bazohen në dokumentet e shkruara. Kjo lloj arkeologjie rezultoi një progres i jashtëzakonshëm, pasi subjekt i saj kanë qenë

---

27. M. Bloch. (1995). *Histoire et historiens*, Paris, pp. 85–144.

vendet e banuara e në veçanti fshatra të braktisura dhe të vogla, si dhe instalime të infrastrukturës (mullinj, sistemet e ujitjes dhe të kullimit në zonat bregdetare) së bashku me instalimet e kontrollit ushtarak (kullat e vëzhgimit, fortifikime të izoluara). Zbulimet kanë hapur perspektiva të reja në një numër fushash (teknikat e ndërtimit, teknologjia arkeologjike, kultura materiale, llojet e industrisë së përpunimit në mjedisin rural).

Nga ana tjetër, studimi i *paleoenvironment*<sup>28</sup> falë përdorimit të teknikave me origjinë gjeologjike, veçanërisht sedimentit natyral dhe studimit të botanikës, është aplikuar edhe në botën bizantine. Por kjo formë e studimit, siç është rasti në botën latine, është një burim i pasur për kërkime në lidhje me pushtimet e tokës, lëvizjet e popullsisë dhe zhvillimet e peizazheve agrare dhe natyrore që janë formuar nga njeriu. E përbashkët për këto kërkime të fundit është karakteri i tyre lokal apo rajonal. Përtej këtyre zonave të veçanta të konvergencës, vëmendja është përqendruar kryesisht në çështje të caktuara të rëndësishme, të cilat krijojnë kushte më të mira për një studim krahasues. Çështje të tilla të rëndësishme si: roli i luajtur nga qytetet dhe fshatrat e mëdha, por dhe nga qendra të vogla urbane në forcimin e ekonomisë agrare<sup>29</sup>, problemet e lidhura me qarkullimin monetar dhe funksionin e parave në mjedisin rural, ripërkufizimi dhe konceptet e tregtisë rurale, ngritja e çmimeve bujqësore si dhe kostot e pagave (në veçanti të punëtorëve të bujqësisë), në ekonominë parakapitaliste janë dominuar prej shumë kohësh nga një referencë e nënkuptuar dhe anakronike të ditëve të sotme<sup>30</sup>. Përparësitë e paraqitura nga një asimilim i zgjeruar i arritjeve të antropologjisë ekonomike dhe juridike janë duke u vlerësuar kudo. Këto arritje janë me rëndësi të madhe në dy fusha të privileguara: në atë të strukturës dhe të rregullimit të shkëmbimit (K. Polangi), si dhe në ato të konceptit të shtetit kontribues (S. Amin, P. Chalmers, P. Eëchard). Pikërisht në kontekstin e kësaj klime të re të konvergencës së objektivave, metodave dhe problemeve të studimit historik do të shihet edhe diskutimi në vijim.

### **1.3. Prejardhja e një qytetërimi të përbashkët agrar në Mesdhe**

Studimi i ligjit agrar dhe i jetës rurale në botën bizantine të lë përshtypjen se bota bizantine i përket një qytetërimi agrar të Mesdheut, elementet strukturore të të cilit janë në kushte mjaft të

---

28. Mjedisi që mbizotëronte në një kohë të caktuar në të kaluarën gjeologjike.

29. Shih, H. K. Schulze, ed. (1985), *Staätisches Um- und Hinterland in vorindustrieller Zeit*, Cologne- Vienna.

30. Spoleto (1993), *Mercati e mercanti nell'alto medioevo: L'area euroasiatica e l'area mediterranea*, f. 23–50.



ngjashme si në Lindje, ashtu dhe në Perëndim. Komentet e bëra mbi këtë temë, të cilat janë të dobishme si për studentët e Perëndimit ashtu dhe anasjelltas, janë ide që ndihmojnë për të hedhur dritë mbi pyetjet e ngritura në botën bizantine në tërësi. Këtu do të përmendim karakteristikat në lidhje me prodhimin konstant bujqësor. Dikush mund të konstatojë se Bizanti nuk përjetoi një revolucion bujqësor në mesjetë në kuptimin e vërtetë më shumë se çfarë bëri bota latine e Perëndimit<sup>31</sup>.

Elementet kryesore të zhvillimit agrar mund të përmbliken në zhvillimin (që u kompletua nga shekulli i 12-të deri në shekullin e 13-të) e parcelave bujqësore të përbashkëta dhe përdorimin e tyre në bazë të një game të përbashkët tipologjike: 1) dru frutor bazuar në kultivimin e pemëve të ndryshme në të njëjtën zonë bujqësore, në afërsi të dy komuniteteve rurale apo në qendrat urbane të konsumit bazuar në akumulimin e punës manuale, në burimet e ujitjes dhe disponueshmërisë së kufizuar të plehut organik, karakteristikë e një sistemi të prodhimit që është e gjitha një stallë kuajsh; 2) fusha të specializuara që kanë një performancë të lartë relative (vreshta, ara, fusha të mbjella me bimë foragjere etj.); 3) tokat e kultivimit të drithërave, plantacione të gjera pemësh të tilla si ullishte.

Nga shekulli i 14-të një prirje e favorshme demografike nuk rezultoi vetëm me një rritje të thjeshtë sasiore të zonës së punueshme dhe të vëllimit të përgjithshëm të prodhimit, por gjithashtu solli pasoja të konsiderueshme në aspektin cilësor: 1) një përmirësim në rendimentet e lidhura për zgjerimin e zones së kultivimit, por dhe me zhvillimin e praktikave bujqësore dhe disponueshmërinë e punës dhe përmirësimet e ndryshme teknologjike; 2) një specializim më i theksuar dhe diferencimi i tokës bujqësore, që shihet në ngritjen tipike të parcelave; 3) një organizim më i logjikshëm i tokave që përbejnë një zonë të caktuar bujqësore, nëse ata i përkisnin një komune të caktuar rurale apo një prone. Kjo rritje, e cila erdhi në mënyrë empirike dhe delikate, arriti të përdorte në mënyrën më të mirë atë që i ofronte mjedisi.

Bota e Mesdheut, në Bizant dhe në Mesdheun Perëndimor, nuk ishte në gjendje, për shkak të kufizimeve të vendosura nga këto mjedise, të zhvillonte sisteme të reja të prodhimit të drithërave bazuar në praktikën më produktive, siç ishte korrja e grurit çdo dy vjet dhe rotacioni agrar, të trashëguara nga agronomia e lashtë. Megjithatë, përparime të rëndësishme në produktivitet janë arritur me anë të zbatimit të teknologjive të reja, për shembull: zhvillimi në tokat e bimëve leguminoze, që janë të një vlere të lartë ushqyese, përmirësimi i ekipeve të lërimet dhe i kafshëve

---

31. A. Veerhulst (1989), *Agrarian Revolutions: Myth or Reality?*, Sartoriana 2: 71–95.

duke përdorur foragjeret bishtajore si ushqim. Është e rëndësishme të theksohet se këto vlerësime konvergjente mbi prodhimin e drithërave të Mesdheut janë në konkluzion të krahasueshëm në lidhje me botën latine perëndimore dhe atë të Bizantit të Lindjes në dy pika shumë të rëndësishme, për shkak se ato janë treguese. Së pari, për sa i përket çështjes me rendimentin e grurit, një temë për të cilën historiografia perëndimore është pesimiste<sup>32</sup>, shifrat që sot konsiderohen më të besueshme janë identike me ato të regjistruara për fushat e drithërave në botën bizantine. Në lidhje me zbulimin e minimumit të nevojshëm të zonave të kultivuara për të mbështetur një familje fshatare standarde (domethënë një familje e përbërë nga 4–6 persona), shifrat e paraqitura në të dyja rastet vënë në dukje faktorët ekuivalentë, sipas një uniformiteti të rasteve aktuale, që janë konfirmuar nga një shpërndarje identike e parcelave të tokave që përbëjnë çdo fermë, sipas llojeve të ndryshme të tokës bujqësore të renditura më sipër.

Në fusha të tjera më specifike, të tilla si teknologjitë për përpunimin e prodhimeve bujqësore, natyra fragmentare e dokumentacionit të shkruar, e kombinuar me shtetin më pak të avancuar të studimit arkeologjik agrar të botës bizantine, shpjegon arsyen pse zhvillime paralele, të cilat dyshohen se kanë qenë edhe në mesjetë, mund të konfirmohen vetëm në periudhën e vonë mesjetare, kur burimet bizantine bëhen më të bollshme. Ky është rasti i mullirit me ujë, të cilin, me sa duket, në mesjetë e kanë përdorur dhe përhapur pronarët e mëdhenj, që kanë qenë agjentët kryesorë ekonomikë<sup>33</sup> si në Lindje, ashtu dhe në Perëndim. Por edhe këtu, në kundërshtim me tezat që u bënë të njohura në artikullin e falshëm të Marc Bloch<sup>34</sup>, 13 veprat e fundit të gjetura konfirmojnë praninë e mullirit me ujë në gjithë pjesën perëndimore të Rumanisë në fillim të antikitetit të vonë.

Një tregues tjetër i natyrës paralele të zhvillimeve në këtë fushë është se përhapja e mullirit me ujë nga shekulli i 12-të deri në shekullin e 13-të si në Bizant, ashtu dhe në Mesdheun Perëndimor pasqyron më qartë aftësinë e komuniteteve agrare për të ndërtuar dhe ruajtur instalimet teknike të zonave të ujitura për përdorim komunal.

Me interes të madh është fakti se si në Mesdheun Lindor, ashtu dhe në atë Perëndimor vendosja progresive nga shekulli i 9-të deri në shekullin e 12-të të një agrosistemi agrar të bazuar në

---

<sup>32</sup> G. Duby. (1962). *L'économie rurale et la vie des campagnes dans l'Occident médiéval*, Paris, 1:85–87 and 184–91.

<sup>33</sup> E. Champion. (1996). *Moulinset meuniers carolingiens*, Paris. pp. 34.

34. M. Bloch, “Avenement et conquêtes du moulin à eau,” in *Annales d'histoire économique et sociale* 7 (1935): 538–63, repr. in idem, *Mélanges historiques* (Paris, 1963), 2:800–821.

diferencimin ndërmjet bujqësisë në tokat e kultivimit u shoqërua me forcimin e strukturave të banimit rural të grupuara në fshatra. Ky përqendrim i fshatarësisë ishte e vetmja mënyrë për të siguruar drejtimin racional të një zone agrare. Në Perëndim ky trend gjendet më i përsosur, shpesh dhe mbizotërues në formën e tij, një fshat malor i grupuar dhe i fortifikuar në Bizant. Megjithatë, në një kontekst të ndryshëm institucional dhe shoqëror bota bizantine mbështetej në civilizimin agrar të formuar nga shoqata strukturore, që bazohej në grupimin e fshatrave të përcaktuar, të ndarë në seksione të ndryshme, një përdorim që në të dyja rastet, bizantin apo latin, është i përbashkët. Uniteti i këtij qytetërimi agrar është shprehur më së miri në fund, nga ngjashmëritë strukturore që karakterizojnë mbrojtjen tipike të fshatit: mbajtësi fshatar banon në fshat dhe njëkohësisht shfrytëzon një numër ngastrash, të shpërndara sipas shfrytëzimit të tokës. Kjo shpërndarje siguron ekuilibrin produktiv të një mbajtësi që ka si qëllim të sigurojë jetesën e një familjeje fermerësh të angazhuar në shfrytëzimin e drejtpërdrejtë të mbajtjes së tyre.

Së fundi, një karakteristikë e rëndësishme e këtij agrosistemi qëndron në shkëputjen ndërmjet sektorit bujqësor dhe atij baritor, që mund të shihen në shkallë të ndryshme. Kjo është treguar për herë të parë në nivelin e vetë realiteteve agrare. Një ballafaqim gjithmonë i pranishëm ndërmjet një fushe në terren dhe asaj baritore jashtë terrenit theksohet nga përdorimi i shprehjeve ekuivalente si në Perëndim të Mesdheut, ashtu dhe në Bizant. Kudo karakteri autonom i përparimeve që lanë shenjë në sektorin baritor në formën e organizimit progresiv të lëvizjes së tufave nga kullotat verore në male në kullotat dimërore në ultësira dhe rajone bregdetare kanë qenë në nivelin ekonomik, si rezultat i një niveli shumë të ulët të integritit të sektorit baritor në jetën bujqësore. Përmendur herë pas here në Bizant nga fundi i shekullit të 11-të, për shembull, tipike e Gregory Pakourianos, këto praktika, të cilat deri në shekullin e 13-të ishin vetëm eksperimentale, zhvillohen paralelisht me krijimin e pronave të fshatit në zonën e ndërmjetme midis vendbanimeve të përhershme dhe tokave bujqësore. Gjithsesi, këto praktika nuk kishin qëllim vendosjen në Perëndim deri në shekullin e 12-të apo dhe më vonë.

Më vonë ato u forcuan si në Perëndim, ashtu dhe në Lindje, duke ndjekur vendime ekonomike të konsideruara në mënyrën më të mirë, të ndërmarra nga aristokracia, si dhe për pasojë të rritjes së kërkesës, kryesisht urbane, për produktet dhe materialet e papërpunuara me origjinë baritore (lesh, djathëra). Në këtë mënyrë këto zgjidhje paraprinin krizën e madhe demografike të dekadave që vijuan.

#### 1.4. Sinkronizimi i ngjarjeve

Duket qartë një konvergjenca e parë: historia ekonomike e në veçanti historia agrare e botës bizantine është vendosur në sfondin e lëvizjeve demografike shumë të ngjashme me atë që karakterizon Perëndimin në të njëjtën periudhë.

Dihet tashmë se ka një rritje të vazhdueshme, pa katastrofa demografike, gjatë dy epidemive të mëdha, që në njëfarë mënyrë dallojnë në mesjetë: plaga e Justinianit dhe “vdekja e zezë” në fund të vitit 1340. Këto dy ngjarje të rëndësishme dhe të mëdha janë një sinjal si në Lindje, ashtu dhe në Perëndim për të ndaluar krizën demografike<sup>35</sup>. Duhet theksuar se tani kemi një tregues të saktë për fenomenin e përsëritjes së murtajës në Lindje dhe në Perëndim në gjysmën e parë të shekullit të 8-të dhe nga viti 1347 deri në vitin 1420, që ndikojnë në të dyja fushat gati në të njëjtën mënyrë. Fundi i këtyre ngjarjeve, që është konfirmuar nga 740, së bashku me rritjen e qëndrueshme të popullsisë, efektet e ta cilave u ndien edhe në gjashtë shekujt e ardhshëm, është një faktor i rëndësishmen që kontribuoi në zhvillimin agrar, dhe kjo duket më së miri në periudhën nga mesi i shekullit të 8-të deri në mesin e shekullit të 14-të. Megjithatë, si në Lindje, ashtu dhe në Perëndim kishte dhe kriza okazionale; mangësi, zi buke dhe incidente lokale apo rajonale të vdekshmërisë kanë pasur efektin e tyre në afat të shkurtër. Vlen të përmendet fakti se këto kriza kanë ngjashmëri interesante. Kështu, në dimrin e viteve 927–928 uria e dëshmuar në Bizant, e cila solli legjislacionin pasardhës perandorak të Romanos Lekapeus dhe Konstandinit VII, është krejt e ngjashme me atë që ndodhi në perandorinë franke në vitet 792–793 dhe 805–806. Në të dyja rastet autoriteti publik ishte i shqetësuar për shkak të krijimit të mekanizmave korrigjues përmes ndërhyrjes së shtetit: në Perëndim duke vendosur çmimin e dispozitave dhe duke u përpjekur për të rregulluar tregun përmes themelimit të hambarëve publikë, ndërsa në Lindje duke kontrolluar borxhin fshatar dhe trazirat me çmimin e tokës.

Qëllimi i përbashkët i Karlo Magnos dhe i perandorëve bizantinë ishte mbrojtja e shtresës së lirë të fshatarëve, që ishin goditur më rëndë nga kriza. Ndarja e tokës dhe rritja e çmimit të drithërave për të fituar më shumë, ishin bërë shumë kritike. Këto kriza, të cilat nisën si pasojë e kushteve klimatike, që është shkaku i përbashkët i tyre, janë dokumentuar më së miri. Ato çuan në reduktimin drastik të rezervave, në rënien e mekanizmave normalë të tregut, në rritjen e çmimit të drithërave nga pronarët e mëdhenj, gjë që çoi në shpërthimin e trazirave popullore. Gjithsesi,

---

35. N. Biraben and J. Le Goff. (1969), “*La peste dans le haut Moyen Age,*” *Annales ESC* 6: 1484–1508.

ka limitet e saj. Në periudhën midis shekullit të 9-të dhe të 13-të ka pasur shumë kriza dhe paralelizmat mes Lindjes dhe Perëndimit janë të vlefshme vetëm për shekullin e 9-të dhe të 10-të, koha kur shteti në Perëndim kishte ende kapacitetin për të ndërhyrë. Gjatë kësaj kohe roli i shtetit ishte në drejtimin e kontrollit të shpërndarjes dhe çmimit të depozitave, ndërsa në Lindje synonte kryesisht, por jo ekskluzivisht, në mbrojtjen e interesave të fshatarësisë. Në Perëndim ndërhyrja e shtetit, si për shembull në komunat italiane në shekullin e 12-të, provon se shteti gjithmonë vepronte në mekanizmat e rregullimit të çmimit kur kishte mungesa dhe jo si në Bizant, që vepronte në drejtim të rregullimit të tregut të tokës. Qëndrimi i Bizantit që paraqitet këtu, i vendosur kundër përparimeve më të fundit të historiografisë perëndimore, nxjerr në dritë pikëpamjen për të pasur një zhvillim pa asnjë bashkëpunim. Si në Perëndim, ashtu dhe në Lindje ideja e një rilindjeje ekonomike që ishte përhapur në shek. e 11-të dhe 12-të, u braktis në favor të një periudhe më të hershme për fillimin e zgjerimit ekonomik.

Së fundi, ekzaminimi i krizave të shekujve të mëvonshëm të mesjetës dhe efekti i tyre mbi popullimin dhe zhvillimin e fshatit na ndihmon për të evidentuar ngjashmërinë midis tyre, por dhe për të vënë në pah limitet e tyre. Shekulli i 13-të<sup>36</sup> përcjell një përshtypje të qartë të një bote të ngopur kur përfundoi ekosistemi rural që ekzistonte në shekullin e 9-të dhe të 10-të. Në rastin e Bizantit kjo përshtypje lind nga disa përfundime të nxjerra nga një dokumentacion që tashmë gjendet në rajone të caktuara. Ashtu si në botën latine perëndimore, pasojat sociale të ngopjes së një mjedisi rural në limitet e kapacitetit të tij për t'u zgjeruar janë varfëria, zotërimet e pakta fshatare, mungesa e pajisjeve të duhura bujqësore dhe prishja e tregut të tokës në dobi të pronarëve të mëdhenj. Një shqetësim tjetër për të dyja zonat ishte mbrojtja e mjedisit dhe i asaj që kishte mbetur nga pylli. Natyra gjithnjë e më zhgënjyese e operacioneve të fundit dhe mosmarrja e masave të duhura sollën si pasojë braktisjen e tokës. Braktisja e tokës u zbulua si në gjysmën e parë të shekullit të 13-të në Lindje dhe Perëndim, ashtu dhe në fillim të shekullit të 14-të, para fillimit të epidemive të mëdha. Kemi sinkronizime që meritojnë vëmendje dhe na detyrojnë të shqyrtojmë argumentimin tonë lidhur me braktisjen e fshatit në mesjetën e mëvonshme.

Të gjitha aspektet e fenomenit të “vdekjes së zezë” të vitit 1348 janë regjistruar në rastin e Perëndimit dhe në rastet e studiuara të ofruara nga dokumentacioni grek i periudhës 1340–1420: evakuime të plota dhe të pjesshme; evakuimet përfundimtare dhe të përkohshme; braktisje e

---

36. P. Alexandre (1987), *Le climat en Europe au Moyen Age*, Paris. f. 18.

tokave marginale për të lejuar mbijetësen e habitatit, i shoqëruar me ristrukturimin e komunitetit agrar me një numër të reduktuar të zotërimeve dhe anasjelltas; shkretimi i plotë i fshatit, që ka sjellë si pasojë asimilimin e tokave më të mira brenda kufijve të një fshati të mbijetuar. Në rastet më të favorshme ajo që u zbulua nga dokumentacioni i malit Athos ishte se burimet e kombinuara të teksteve dhe shqyrtimi i vendeve lejonin një qasje më të saktë. Duke u bazuar në llojet dhe normat e evakuimeve, kërkimet krahasuese nuk të japin asnjë përshtypje për ngjashmërinë në amplitudë dhe për efektet afatgjatë në zhvillimin agrar në shekullin e 14-të dhe të 15-të<sup>37</sup>.

### **1.5. Karakteristikat dhe tiparet origjinale të komunitetit rural bizantin**

Tiparet origjinale të komunitetit rural bizantin evidentohen nga prania e një sistemi publik të tatimit, qoftë direkt, qoftë i caktuar për përfituesit privatë. Këmbëngulja e fiskalitetit publik ndikon në klasifikimin ligjor të kategorive të ndryshme të vartësve, të pronave dhe kushteve që rregullojnë lëvizjen e Tokës dhe të njerëzve. Krahasuar me botën latine perëndimore, duhet theksuar shkalla relativisht e lartë e ekonomisë rurale, e cila nga njëra anë i atribuohet pagimit të taksave, tatimeve dhe efektit e tyre në ekonominë lokale. Kjo ishte periudha kur një lloj simetrie, erozioni dhe brishtësia e mekanizmave të ashtuquajtur *feudalë* detyronin pronarët në Perëndim të favorizonin qiratë dhe kontratat.

Një element tjetër që zbulon forcën monetare të ekonomisë bizantine agrare ishte rëndësia e fuqisë punëtore bujqësore, që deri në shekullin e 13-të ishte më e madhe se në Perëndim, si dhe rëndësia e të punuarit me rrogë në ekonominë rurale në përgjithësi. Ekzistenca e rrogës në Perëndim kishte një terminologji të veçantë dhe caktonte të gjitha llojet e punës rurale të paguar, qoftë dhe atë të fshatarëve, mbajtja e të cilëve ishte e pamjaftueshme për një jetesë më të mirë. Në këtë mënyrë i përkiste një nivel më të ulët të punëtorëve të varfër dhe të keqpaguar ose punëtorëve që kishin detyra më të specializuara (barinjte, shoferet), si pjesë e shfrytëzimit të drejtpërdrejtë të rezervës. Aftësia e shtetit bizantin për të ndërhyrë me metoda rregulluese dhe praktike në ekonominë agrare ishte me shumë rëndësi, pasi parandalonte sjelljet arbitrare të pronarëve të mëdhenj të tokave. Si për shembull mund të përmendim fuqinë e shtetit bizantin për

---

37. P. Toubert, “La part du grand domaine dans le décollage économique de l’Occident (VIIIe–Xe siècles),” in *La croissance agricole du haut Moyen Age*, ed. Ch. Higounet (Auch, 1990), f. 53–86.

të administruar dhe caktimin e tokave<sup>38</sup>.

Në përgjithësi natyra kontribuese e shtetit bizantin nënkupton se zyrtarët e saj matnin sipërfaqen e fushave dhe të pemishteve, përshkruanin pronat apo hartonin një listë të qiramarrësve të tyre, përcaktonin dhe rregullonin periodikisht bazën e taksës së tokës. Me pak fjalë, punonjësi i shtetit u bë i njohur në shoqërinë rurale.

Marrja e të dhënave nga regjistrat fiskalë nëpërmjet kompjuterit na ka mundësuar të kuptojmë parimet dhe rregullat formale që ndiqeshin nga zyrtarët politikë. Më interesant është një përfundim i dytë: rilindja e shtetit, dhe në këtë mënyrë dominimi i tij kontribues, i dukshëm në Europë që në shekullin e 13-të, solli si pasojë krijimin e regjistrave të detajuar fiskalë, para së gjithash në komunat e mëdha italiane. Kadastrat e vjetra fiskale, si ajo e Orvietos e vitit 1292, janë analizuar me ndihmën e kompjuterit.

Një krahasim më i plotë i matjeve dhe regjistrimit të praktikave financiare bizantine me ato të komunave italiane në shekullin e 15-të është shumë interesant për të ardhmen. Format e ndërhyrjes së shtetit si kontribues nuk janë të limituara vetëm me marrjen e taksave. Është e qartë se shteti bizantin luajti një rol të rëndësishëm në jetën e fshatit. Mund të përmendim rolin e shtetit në përcaktimin e statusit juridik të kategorive të ndryshme të qiramarrësve, në lëvizjen e popullsisë rurale dhe transferimet e rëndësishme të pronës. Shteti krijoi gjithashtu praktikën e popullsisë për të përmbushur nevojat ushtarake apo rajonale dhe ka ndikuar në organizimin e strukturave rajonale ndërmjet trajtimit të kërkesës urbane.

Së fundi, historia bizantine rurale, që është shumë demaskuese nga pikëpamja e mendimit perëndimor, ka si veçanti bashkëjetesën e ndryshueshme apo të përhershme të dy strukturave në dukje të ndryshme: fshatit dhe pasurisë. Si një formë e zgjidhjes dhe organizimit të hapësirës së kultivuar dhe gjithashtu si një njësi sociale, fshati ishte struktura primare agrare<sup>39</sup>.

Pavarësisht sesa e pabarabartë dhe e diferencuar shoqërisht mund të ishte në brendësi, fshati ishte një komunitet. Bizanti kishte format karakteristike për shoqërinë fshatare, e pasur me konflikte të brendshme, por dhe me aftësinë e saj zbutjen këtyre konflikteve apo papajtueshmërive dhe për të krijuar zakone lokale. Deri në shekullin e 11-të, ndryshe nga Perëndimi, shteti ishte i angazhuar për mbrojtjen e fshatit. Gjithsesi, nga shekulli i 11-të e më vonë kjo strukturë, gjithmonë e pambrojtur, u bë e qartë se ishte gjithnjë e më shumë pre e pronarëve dhe lakmisë së

---

38. Ch. Wickham (1993). *Lachute de Rome n'aura pas lieu*, Le Moyen Age 99, f. 107–26.

39. A. Verhulst (1991), *The Decline of Slavery and the Economic Expansion of the Early Middle Ages*, Past and Present 133, f. 195–203.

aristokracisë. Kjo e fundit ka qenë mjaft e ndryshme nga aristokracia bashkëkohore e Perëndimit për shkak të lidhjeve të saj me shtetin. Deri në shekullin e 11-të struktura e pasurisë ishte drejtuar në menaxhimin ekonomik dhe strukturën sociale: ndarja në zonat e bonifikuara nga bujqësia, prania e kujdestarit të pronave etj. Gjithashtu prania e elementeve të fortifikimit për të mbrojtur qoftë dhe simbolikisht pasurinë dhe investimet (për shembull: në pemishte, mullinj, vreshta dhe ullinj), bëjnë pjesë të gjitha të ngjashmëritë<sup>40</sup>. Kështu, nuk ka ndonjë dallim thelbësor mes strukturës së pasurisë së Bizantit dhe asaj që gjendet lehtësisht në Perëndim të Mesdheut.

Pas themelimit nga shekulli i 11-të i një kulture të vërtetë të menaxhimit të pasurive dhe të kontabilitetit, jepet një tablo më e qartë e interesave të qiradhënësit. Dokumentacioni zbulon një shqetësim të ri: atë të riinvestimit të një pjese të të ardhurave të tokës në sektorin e bujqësisë, një formë e sjelljes ekonomike ende e panjohur në atë periudhë feudale.

Nga këto vëzhgime arrijmë në përfundimin<sup>41</sup> se për këdo në Europën Perëndimore që është i dhënë pas historisë krahasuese, mundësitë e ngritura nga historia agrare bizantine janë të pasura në përmbajtje dhe me potencial, por duhen mbajtur parasysh dy kushte: 1) të jemi të kujdesshëm në komentet e bëra mbi ngjashmëritë dhe dallimet; 2) të shqyrtohen realitetet rurale të Lindjes në dy perspektiva të ndryshme. Kushti i parë lejon të përshkruhen faktorët (pjesërisht dhe ata mjedisorë, teknikë, demografikë dhe socialë) që krijuan një agrosistem të sofistikuar dhe që në shumë aspekte është zhvilluar në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin ritëm në mesjetën perëndimore. I dyti na ndihmon të studiojmë faktorët politikë, institucionalë, socialë dhe kulturorë në Bizant. Këto dy perspektiva apo kushte duhet të jenë komplementare. Vetëm një ndërgjegjësim i duhur i këtij komplementariteti lejon një krahasim që ndjek parimet e shprehura nga Marc Bloch.

## 1.6. Shqipëria dhe Bizanti

Me ndarjen e Perandorisë Romake në Lindore dhe Perëndimore, Iliria përfshihet në atë të Lindjes. Roli i saj ishte mjaft i rëndësishëm për të ardhmen e Perandorisë, por dhe mjaft i vështirë, duke qenë se në kufijtë veriorë të Perandorisë, pra aty ku gjendet Iliria, kalonin të gjitha fiset barbare: hunët, gotët, sllavët, vizigotët, ostrogotët.

---

40. Y. The´Bert, eds (1989), *Les cadastres anciens des villes et leur traitement informatique*, Rome. f.14.

41. P. Toubert, "L'Italie rurale aux VIIIe-IXe sie`cles: Essai de typologie domaniale," in *I problem comuni dell'Europa nel secolo VIII* (Spoleto, 1973), 95-132 and 187-206.



Ilirët vazhdojnë të luajnë të njëjtin rol brenda Perandorisë së Lindjes, që u quajt Bizant. Si popull, si komb, shijojnë avantazhet dhe disavantazhet e qytetarëve të Perandorisë. Si njerëz u shërbejnë interesave të Bizantit, ata i dhanë kësaj Perandorie shumë gjeneralë, madje dhe perandorë.

Me krijimin e Perandorisë së re të Lindjes trevat iliro-shqiptare hynë në përbërje të kësaj Perandorie. Iliria ka luajtur një rol të rëndësishëm në emrin e kësaj Perandorie, duke i dhënë asaj një numër perandorësh dhe gjeneralësh të shquar, si Anastasi I i Durrësit apo Justiniani I nga Shkupi. Të dy luajtën një rol të madh në reformat dhe masat e zbatuara gjatë tranzicionit nga antikiteti në mesjetë. Gjithashtu ishte pozicioni gjeografik tepër i favorshëm i trevave ilire që i favorizoi ato në këndvështrimin e Perandorisë ndaj Ilirikut, duke i konsideruar trevat iliro-shqiptare një një komunikimi të Lindjes me Perëndimin dhe anasjelltas. Prania e porteve gjatë bregdetit adriatiko-jonian si dhe arteriet rrugore që fillonin prej tyre dhe zgjatëshin në thellësi të Gadishullit, duke krijuar lidhje me bregdetin dhe qendra të tilla të rëndësishme tregtare si Shkupi, Ohri, Kosturi, Selaniku, Kostandinopoja etj, i bënë trevat e Ilirisë shumë të vlerësuara nga Bizanti.

Nuk mund të lëmë pa përmendur rëndësinë e rrugës “Egnatia”, e cila luajti rolin kryesor në komunikimin midis provincave të Perandorisë në terrenin perëndim-lindje. Strategjia e Bizantit ishte t’i mbronte trojet e ilirëve. Një shembull historik kemi rrethimin me mure të trashë të qytetit të Durrësit nga Anastasi I.

Perandoria Bizantine bazat e saj mbështetëse të fuqishme në trevat iliro-shqiptare i shtrinte në Durrës, Shkodër, Tivar, Krujë, Lezhë, Dibër, Prizren, Shkup, Berat, Devoll, Kolonjë etj. Boshti i tretë i Perandorisë, krishterimi, gjeti një përhapje të madhe e të shpejtë në këto treva. Qytetet e Durrësit dhe ai i Shkodrës shërbyen si faktorë për përhapjen e shpejtë e të gjerë të krishterimit në katër provincat ilire: Prevalitania, Dardania, Epiri i Ri dhe Epiri i Vjetër. Këtë dukuri e provon ekzistenca e bazilikave të vjetra, që datojnë në shek. IV–V në Durrës, Shkodër, Lezhë, Mat, Apoloni, Butrint etj. Edhe pse u bënë shumë përpjekje për të eliminuar krishterimin, ai arriti të vendosej përfundimisht në Iliri dhe Kisha u organizua mbi bazën e provincave administrative të epokës së Dioklecianit. Në qendër të çdo province ndodhej kisha metropolitane, ku kishte selinë kryepeshkopi, ndërsa në katër qendrat kryesore shqiptare ndodheshin kryepeshkopatat. E veçanta ishte varësia e tyre nga papati romak dhe jo nga Patriarkana e Kostandinopojës. Më vonë vetëm pjesa veriore i qëndroi besnike papatit romak.

Një periudhë e gjatë dhe e lodhshme ishte marshimi i sllavëve drejt Ballkanit dhe Perandoria Bizantine arriti t'i mbronte trevat ilire falë organizimit të tyre në bashkësi kompakte, situatë kjo që u ndesh në Dalmaci dhe Maqedoni. Mbijetuan qytetet antike, qendrat dhe strukturat kishtare, edhe pse prania e pushtetit bizantin po vinte duke u dobësuar.

Dhjetëvjeçarët e fundit të Perandorisë Bizantine në Shqipëri, kryesisht në Shqipërinë e Jugut, treguan për një lidhje krejt formale me të, çka e treguan qartë dy faktorë: nga njëra anë, ushtria dhe administrata bizantine po uzurpohej për herë e më tepër nga vendasit dhe, nga ana tjetër, po zgjerohej vazhdimisht numri i zonave autonome, ku pushtetin real e ushtronin krerët dhe të zotët e vendit.

Historia e çdo kombi është një tablo e përzierjes së elementeve sociale, ekonomike, politike dhe ligjore. Gërshetimi i këtyre elementeve përkufizon ato që ne i quajmë “etapa historike”, të cilat hedhin dritë mbi ecurinë tonë në kohë, zhvillimin dhe përsosjen, risitë dhe gjurmët e së shkuarës. Çdo rend shoqëror ka nevojë për një kuadër ligjor për rregullimin e marrëdhënieve njerëzore, i cili kushtëzohet nga faktorë socialë, ekonomikë dhe politikë. Lindja dhe sundimi i një marrëdhënieje të caktuar ekonomike kërkon detyrimisht dhe përcaktimet ligjore. Këto përcaktime karakterizohen kryesisht nga elemente autoktone, por dhe nga elemente të huaja, që mbarten nga pushtimet në kohë të ndryshme.

Shqipëria, ky vend ballkanik, ka një histori të larmishme në gërshetimin e elementeve të huaja, që më së shumti janë trashëgimi të pushtimeve të ndryshme për dekada të tëra. Kuadri historik vazhdimisht ka analizuar faktorët, qëllimet, politikat e ekspansioneve të huaja, pa i kushtuar vëmendje të veçantë aspektit ligjor. Jemi njohur me politikat për zgjerim territori, për nënshtrim ekonomik, për përçarje kombëtare, për idetë e vasalitetit si shtyllë kryesore e çdo vendi pushtues, por nuk ka trajtime të posaçme për ekzistencën e kuadrit ligjor, mënyrën e lindjes dhe të zhvillimit të tij.

Studimi ynë i referohet një prej periudhave më brilante të historisë së njerëzimit: Perandorisë Bizantine, madhështore si në dimensionin kohor ashtu dhe hapësinor, përcjellëse e shumë vlerave historike e kulturore, por mbi të gjitha vatër e lindjes së një legjislacioni të kompletuar. Sistemet e së drejtës, të ligjeve që janë hartuar dhe kanë administruar jetën e një populli, janë burimi kryesor për të gjetur, zbuluar dhe përcaktuar llojin e sistemit politik, të drejtat e ligjëruara, të mbrojtura apo të mohuara, të kufizuara, të shkelura të shtetasve, të drejtat, detyrimet në fushën e tatimeve, taksave, pra me natyrë ekonomike, normat e së drejtës publike, që përcaktojnë dhe

pasqyrojnë organizimin dhe shkallën e qytetërimit të një shoqërie civile apo klanore. Perandoria Bizantine është perandoria më jetëgjatë në historinë e shoqërisë njerëzore, e cila përfshiu nën juridiksionin e saj pjesën më të madhe të territoreve të Ilirisë antike dhe më pas tërësisht ato arbërore. Nën këtë Perandori territoret dhe popullsia arbërore iu nënshtruan organizimit politik, ekonomik, administrativ dhe ligjor të diktuar prej këtij autoriteti bizantin. Pra, për nëntë shekuj mbi këto anë dominoi legjislacioni perandorak.

## **2. Reformat ligjore të Perandorisë Romake si burim të Bizantit të mëvonshëm**

Kodifikimi i së drejtës romake ishte baza juridike e njësuar e shtetit të centralizuar bizantin. Vepra më e madhe dhe më e qëndrueshme e epokës së Justinianit ishte, pa dyshim, kodifikimi i së drejtës romake<sup>42</sup>. E drejta romake, e karakterizuar nga një qartësi dhe thjeshtësi mendimi, me një gjuhë të pasur, kishte përcaktuar norma të detyrueshme sjelljeje, që shtriheshin në jetën politike dhe atë privatë dhe u drejtoheshin si shtetarëve, ashtu dhe individëve të thjeshtë. Me anë të këtyre normave rregulloheshin marrëdhëniet midis qytetarëve, marrëdhëniet në fushën e ekonomisë dhe ato të pronës. Ishte Justiniani ai që e ndërmoi këtë nisëm me rëndësi historike, kodifikimin e së drejtës romake, duke ia përshatur pushtetit të ri bizantin. Brenda një kohe të shkurtër u hartua një përmbledhje me të gjitha urdhëresat perandorake që nga koha e Adrianit, e cila u botua në vitin 529 me titullin “*Codex Justinianus*”. Ky variant u plotësua më shumë dhe çoi në daljen e tij më të plotë pas një periudhe pesëvjeçare. Përmbledhja e shkrimeve të juristëve të vjetër romak e titulluar “*Digesta*” së bashku me urdhëresat e perandorëve përbënin grupin e dytë të ligjeve në fuqi. Krahas “*Codex*”-it dhe “*Digesta*”-s u hartua “*Institutiones*”, e konceptuar si një manual për studimin e së drejtës. Të gjitha ligjet që dolën pas botimit të “*Codex*”-it u përmbledhën në një botim të vetëm me titullin “*Novellae*”, që u botua në gjuhën greke. Përshatja e së drejtës romake u shoqërua me përputhjen me normat e moralit të krishterë dhe me të drejtën zakonore të Lindjes helenistike. Ndikimi i krishterimit u vu re tek e drejta familjare, e cila u përfshi nga një frymë humanizmi. Zhvillimi i sistemit juridik bizantin u bë mbi të drejtën romake dhe referenca ligjore në çdo fushë ishte *Corpus juris civilis* apo *Codex*-i i Justinianit. Ndikimet e së drejtës romake sipas kodifikimit të Justinianit i gjejmë edhe sot në legjislacionin e vendeve të Europës. Karakteristikë e legjislacionit Justinian është theksimi i veçantë që i bëhej

---

42. P. Collinet *Etudes historiques sur le droit de Justinien, I, 1921.*

absolutizmit perandorak. “*Corpus juris civilis*” i dha një vulë juridike pushtetit autokratik, çka do të ndihet edhe më vonë. Perëndimi iu kthye së drejtës romake vetëm në shekullin e 12-të dhe nëpërmjet studimit të “*Corpus juris civilis*” të Justinianit u përpunuan konceptet politike dhe juridike. Duke filluar nga ky shekull e drejta romake, në formën që mori nëpërmjet kodifikimit Justinian, u bë një faktor bazë në zbulimin e së drejtës në gjithë Europën deri në ditët tona<sup>43</sup>.

## 2.1. Periudha e kodifikimit të ligjeve (867–886)

Bazili, si një sundimtar i pasionuar pas ligjeve, dëshironte të ripërtërinte të drejtën romake. Për të realizuar këtë ai përgatiti një përmbledhje të gjerë ligjesh të titulluar “*Purifikimi i ligjeve të vjetra*”. Kjo vepër mbeti e papërfunduar dhe ishte varianti i rishikuar i librave juridikë të Justinianit, i plotësuar me ligje të reja. Ajo i shërbeu më vonë Leonit VI për të botuar “*Bazilikat*” e tij.

Gjenden dy libra të vegjël juridikë, që shërbejnë si preambola të veprës së madhe:

- “*Procheiron*”, që mund ta quajmë manuali i dytë i ligjeve. Ky botim, që përmban normat më të rëndësishme e më të përdorshme të së drejtës civile dhe asaj publike e që i rendit ato në mënyrë sistematike në dyzet tituj, mban emrat e tre perandorëve: Bazilit, Konstandinit dhe Leonit VI. Duke pasur si qëllim një përdorim sa më efikas të tij, libri është shkruar me një gjuhë të thjeshtë juridike, duke u mbështetur kryesisht në materialin përmbledhës të “*Institutiones*”, pa u kushtuar vëmendje pjesëve të tjera të *Corpus juris civilis* të Justinianit. Ky botim mbështetet gjerësisht te libri tjetër juridik, “*Eklogeja*”, libri i famshëm i Leonit III. Ky libër pati një përhapje të gjerë në Bizant dhe ruajti vlerën e tij deri në rënien e Perandorisë. Pati përhapje të gjerë në Bullgari, Serbi dhe Rusi. Bazili shpresonte të risillte në jetë të drejtën romake dhe përpiquej në mënyrë aspak inteligjente të distancohej nga vepra e perandorit ikonoklast, që sipas tij ishte një “abrogim i ligjeve të mira”<sup>44</sup>. Në të vërtetë kjo vepër i detyrohet mjaft librit të vlefshëm e tepër popullor të Leonit III. “*Procheiron*” ndryshon nga kjo e fundit sidomos referuar së drejtës së trashëgimisë dhe së drejtës publike. Në fund të fundit, “*Procheiron*”-i i shërbente po atij qëllimi si “*Eklogeja*” e Leonit III, që gjithashtu ishte menduar si një libër ligjesh për përdorim të përditshëm nga gjykatësit.

---

43. G.Ostrogorsk, *Historia e Perandorisë Bizantine*, f. 60).

44. Procherion në Yepos, Jus, II 116.

• **“Eklogeja”**, libri i së drejtës i vitit 726 i perandorëve *Leon* dhe *Konstandin* zëvendësoi librat e Justinianit. Ky libër përbën një kthesë të madhe në historinë e kodifikimit juridik bizantin. Ai u mbështet mbi të drejtën romake në variantin e përpunuar të *“Corpus juris civilis”* të Justinianit, që ishte themeli i jurisprudencës bizantine. Ky libër është një përzgjedhje e normave më të rëndësishme të së drejtës private dhe penale që ishin në fuqi. Vend parësor në të zë e drejta familjare dhe e drejta e trashëgimisë, ndërsa e drejta e pronës është në plan të dytë. Ky libër u cilësua si “kodi i së drejtës” në duart e gjykatëseve gjatë punës së tyre të përditshme. Ka ndryshime të mëdha me të drejtën Justiniane, pasi u ndikua shumë nga e drejta kanonike dhe e drejta zakonore e Orientit. Ka ndryshime të mëdha në të drejtën familjare, p.sh.: martesë merr një mbrojtje të veçantë, kufizohet *patria potestas*, domethënë pushteti i burrit.

Në fushën penale futen për herë të parë ndëshkimet trupore, si: prerja e hundës, dorës, verbimi, djegia e flokëve, dënime këto që zëvendësuan dënimin me vdekje ose me gjobë të parashikuar më parë nga e drejta e Justinianit. Ndryshimet në ligje dhe në ndërgjegjen juridike bizantine nga koha e Justinianit lidhen me depërtimin e thellë të etikës kristiane dhe të zakoneve orientale. Parathënia e *“Eklogesë”* përmban një thënie të perandorit: “Luftë kundër korrupsionit të punonjëseve të drejtësisë, trajtim me rrogë i të gjithë gjykatësve.”. Sa më shumë i largohet së drejtës justiniane, aq më shumë *“Eklogeja”* i referohet së drejtës zakonore të zhvilluar në Bizant në shek. VII<sup>45</sup>. Ajo tregon ndryshimet që kishin ndodhur në ligjet dhe në ndërgjegjen juridike bizantine nga koha e Justinianit. Të tilla ndryshime i detyrohen pjesërisht depërtimit më të thellë të etikës kristiane dhe pjesërisht barbarizmit të zakoneve si rezultat i ndikimeve orientale.

Ky libër ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm tek e drejta bizantine, ndikim që ka lënë gjurmë në sistemet juridike të shteteve sllave. Përveç dy librave të sipërcituar rëndësi kanë patur dhe disa përmbledhje të tjera në rregullimin juridik të ushtrimit të pushtetit.

• **“Epanogoga”**, (884-886) libër përmbledhës i ligjeve i perandorëve *Bazil*, *Leon* dhe *Aleksandër* i vitit 879. Ka një përsëritje të trajtimeve që janë bërë te libri *“Procherion”*, por duke pasqyruar edhe ndryshime të rëndësishme në të. Në të drejtën familjare ka huazuar shumë nga *“Eklogeja”*<sup>46</sup>. Të rejtat që përmban ky libër kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrat e perandorit, patriarkut, si dy figurat më të rëndësishme sunduese të botës së krishterë. Trajton një

---

45. R.S Lopez, *Byzantine Law in the Seventh Century and its Reception by the Germans and the Arabs*, BYZ, 16 (1942–1943), 445 sgg.

46. Georg Ostrogorsky, *Historia e Perandorisë Bizantine*, f. 23.

marrëdhënie ideale midis dy pushteteve: *profanit* dhe *shpirtërorit* (gjë që nuk përkonte me realitetin e asaj kohe) në frymën e ideve që mbisundonin në rrethet e kishës ortodokse.

- **“Bazilika” (888-889)**. E drejta e Justinianit filloi të ripërpunohej nën kujdesin e Bazilit I dhe ky proces përfundoi me librin e titulluar “*Bazilika*” e Leonit VI. Leoni ishte sovran i përshpirtshëm, me interesa të mëdha kishtarë e teologjike, me talent të spikatur në letërsi, dhe kjo ishte arsyeja që ende kur ishte gjallë u nderua me titullin “sofos”, që do të thotë “i dituri”<sup>47</sup>.

Ligjet perandorake të Leonit të Ditur u përmbledhën në gjashtëdhjetë vëllime, në gjashtë prej të cilave janë përzgjedhur ligjet më të rëndësishme të Perandorisë Bizantine mesjetare.

“*Bazilikat*” janë jo vetëm një përmbledhje e së drejtës kanonike, por dhe e së drejtës civile e publike<sup>48</sup>, që e kanë burimin nga “*Codex Justinianus*” dhe nga “*Digesta*”, më pak nga “*Institutiones*”. Gjithashtu bazohen te “*Novellae*” e Justinianit I dhe te “*Novellae*” e Justinianit II dhe të Tiberit. Këto të fundit së bashku me “*Novellae*” e Justinianit I dhe II u përmbledhën në veprën e famshme të titulluar “*Novelat*”.

Juristet e kohës së Leonit VI nuk iu drejtuan burimeve latine, por shfrytëzuan variante e komente greke.

Në krahasim me “*Corpus juris civilis*” të Justinianit “*Bazilikat*” kishin avantazhin e madh se ishin shkruar në gjuhën greke, kështu që ishin mjaft të përdorshme.

Ndryshim tjetër mes tyre ishte se në “*Corpus juris civilis*” i njëjti objekt trajtohej në kapituj të ndryshëm, kurse te “*Bazilika*” ka një trajtim sistematik të elementeve. Kjo ishte dhe arsyeja kryesore që shumë shpejt “*Bazilika*” zëvendësoi tërësisht veprën e Justinianit dhe u bë baza e shkencës juridike për Bizantin mesjetar. Ky botim tepër i rëndësishëm u shoqërua edhe me komente dhe hartimin e një treguesi lëndor me titullin “*Tipukeitos*”, domethënë “çfarë dhe ku gjendet”. Vlera e këtij treguesi qëndron në faktin se na jep të dhëna mbi përmbajtjen e librave që nuk kanë mbërritur deri te ne<sup>49</sup>. Gjithashtu duhet theksuar se vlera e “*Bazilikës*” qëndron vetëm në aspektin juridik dhe jo në atë historik, pasi ka një vlerë të kufizuar si burime historike.

- **“*Novellae*”**, një përmbledhje prej trembëdhjetë shkrimesh të Leonit VI. Fillimisht ky botim mbante titullin “*Ratifikim e purifikim i ligjeve*”, titull që nxjerr në pah lidhjen e ngushtë midis

---

47. Krh .H.Gregoire BYZ 5(1929), 399 e në vijim.

48. Georg Ostrogorsky, *Historia e Perandorisë Bizantine*, f. 192.

49. E.Seidi, *Basilikenscholien im Tipukeitos*, BZ, 44 (1951).khr edhe F.Dolger dhe E.Seidi. *Beitrage und Berichtigungen yum Tipukeitos*, BZ, 39 (1939), 146 e në vijim.

veprës legislative të Leonit VI dhe asaj të atit të tij<sup>50</sup>. Ky botim trajton çështje të rëndësishme, që renditen pa një rregull të caktuar, dhe përmban revokime e ndryshime të ligjeve të vjetra si dhe vendime që u japin vlerën e ligjit normave të së drejtës zakonore. Dispozitat me përmbajtje thjesht kishtarë i drejtohen patrikut Stefan, gjithë të tjerat i drejtohen Stilian Zaucesit<sup>51</sup>.

Në periudhën që jetoi Stilian Zaucesit kjo vepër ishte tepër e fuqishme. Disa nga “*Novellae*”-te Leonit revokojnë të drejta të hershme të kurive qytetare dhe të Senatit<sup>52</sup>. Legjislacioni i Leonit VI përfaqëson përfundimin e një procesi të rëndësishëm historik, që e përqendron pushtetin në duart e perandorit dhe ua beson të gjitha çështjet shtetërore funksionarëve perandorakë. Perandori konsiderohet i zgjedhur nga Zoti dhe është nën mbrojtjen e pushtetit hyjnor, ai është kreu suprem i gjithë administratës perandorake, komandant suprem i ushtrisë, gjykatës supreme, legjislator i vetëm, mbrojtës i Kishës dhe garant i besimit ortodoks. Ai vendos për luftën dhe paqen, vendimi i tij është përfundimtar dhe i përvokueshëm. Ligjet e tij konsiderohen të frymëzuara nga Zoti, por, nga ana tjetër, ai duhet t’u përmbahet këtyre ligjeve, edhe pse mund të nxjerrë ligje të reja dhe të revokojë ato të vjetra<sup>53</sup>. Rendi kurial kishte degraduar prej kohësh dhe autoriteti administrativ e legjislativ i Senatit ekzistonte vetëm në letër. Por kjo nuk e ul rëndësinë e shuarjes së tij përfundimtare me dekret ligjor, pasi në secilën nga tri *novellae*-t ajo justifikohet me faktin se tashmë gjithë administrata e Perandorisë ishte në dorë të sovranit. Në ndryshim me ligjet e mëparshme perandorit nuk i njihet e drejta për të revokuar apo modifikuar vendimet e koncileve të Kishës.

Legjislacioni i Leonit VI nxori në pah forcimin e aristokracisë bizantine, një proces që më vonë do të minonte të gjitha strukturat shtetërore bizantine dhe do të trondiste absolutizmin perandorak. Aristokracia ishte ngritur kaq lart në kohën e Leonit VI, sa që rekomandonte hapur që detyra e strategut dhe ofiqet e larta t’u jepej personave të rangjeve të larta e të pasur<sup>54</sup>. Qeverisja e Leonit VI nuk ishte e vetëdijshme për rrezikun që mbarte ky fenomen dhe i mbështeti ambiciet e fisnikëve edhe në fushën e ekonomisë. “*Novellae*”-t parashikonin revokimin e dispozitave të vjetra që u ndalonin të mëdhenjve, funksionarëve të Kostandinopojës,

---

50. C.A.Spulber, *Les Nouvelles de Leon le Sage*, cit.81 e vijim.

51. Krahaso më në fund C.Krzisnik, *BZ*, 37 (1937) 486 e vijim.

52. P.Noaille dhe A.Dain, *Les Nouvelles de Leon VI le Sage ecc.cit.*182, 184, 270.

53. Ostrogorsky. G, *Historia e Perandorisë Bizantine*, f.194).

54. M.Mitard, *Le pouvoir imperial au temps de Leon VI Le Sage*, *Melanges Diehl*, I (1930), 215 e vijim.

të blinin prona dhe të merrnin trashëgimi dhe dhurata gjatë periudhës së ushtrimit të mandatit të tyre pa autorizimin e perandorit. Për funksionarët e provincave u kufizuan së tepërmi këto të drejta, mbetën në fuqi vetëm për strategët e themave<sup>55</sup>. Një *novellae* e mëvonshme parashikoi revokimin e së drejtës së parablerjes së fqinjëve, që pengonte tjetërsimin e pronave të fshatarëve latifondistë. Konkretisht, vetëm gjashtë muajt e parë fqinjët mund të kishin të drejtën e kthimit kundrejt pagesës së çmimit të blerjes<sup>56</sup>. Këto dispozita favorizonin fisnikërinë për t'u lehtësuar fshatarëve blerjen e tokave. Kjo dispozitë e vendosur nga Leoni VI u revokua më vonë nga një *novellae* e vitit 922 të Roman Lekapanit<sup>57</sup>. Ky i fundit bëri këtë parashikim: gjatë tjetërsimit të tokës nëpërmjet blerjes apo marrjes me qera caktoheshin pesë kategori, që kishin të drejtë blerjeje sipas një radhe të caktuar: 1) të afërmit bashkëpronarë; 2) bashkëpronarë të tjerë; 3) pronarë të parcelave që përfshihen në tokën që do të tjetërsohet; 4) pronarë tokash fqinje, që i paguajnë taksat së bashku; 5) pronarë të tjerë tokash fqinje. Vetëm pasi të përfundonin këto kategori toka mund t'u shitej të huajve<sup>58</sup>. Qëllimi i këtij sistemi ishte të mbronte pronën e vogël nga blerja prej të fuqishmëve dhe nga copëzimi i tepruar. Të fuqishmit nuk blinin dot dhe nuk merrnin dot me qera asnjë parcelë toke, me përjashtim të rasteve kur ata zotëronin prona në fshatin për të cilin bëhej fjalë, domethënë kur bënë pjesë në pesë kategoritë e përmendura më sipër. Gjithashtu nuk mund të merrnin dhurata nga të vobektit, përveç rasteve kur kishin lidhje familjare me ta.

Personat që shkelnin këto dispozita ligjore, ndiqeshin nga një sanksion: detyrimi të kthenin tokën pa asnjë shpërblim dhe pagimin njëkohësisht të një gjobe në favor të arkës së shtetit. Detyrimi i kthimit të pronës pa shpërblim kishte fuqi prapavepruese edhe për ato toka që ishin tjetërsuar tridhjetë vjetët e fundit, me kushtin që ky tjetërsim kishte rënë nën nivelin e nevojshëm për t'i siguruar pronarit stratiot pajisje ushtarake.

**Nomokanonet.** Ishin një përzierje normash perandorake (nomos) dhe rregullash kishtare me karakter të përgjithshëm (kanune), spikat si më i rëndësishmi ai i Fotit i shpallur në vitin 883.<sup>59</sup>

---

55. *Nov.84 Zepos , Jus, I, 152 e vijim.*

56. *Nov114Zepos , Jus.I, 186 e vijim.*

57. *Ibid,198 e vijim.Dolger, Reg 595.*

58. *Khr.Ostrogorsky, Steuergemeinde, 32 e vijim.*

<sup>59</sup>*A.Luarasi, Historia e Shtetit dhe e sw Drejtws nw Shqipwri, f.74.*



## 2.2. Ligjet e Konstandinit VII

Në vitin 947 u hartua nga patriku dhe kuestori Teofili<sup>60</sup> një ligj që urdhëronte kthimin e menjëhershëm e pa shpërblim të të gjitha pronave fshatare që të fuqishmit kishin blerë që nga fillimi i pushtetit autokrat të Konstandinit VII ose që do të blinin në të ardhmen. Edhe në rast shitjeje të pronës nga ana e të fuqishmeve kur kushtet e tjera plotësoheshin njëlloj nga kandidatë blerës, fshatarët duhej të kishin përparësi në të drejtën e blerjes. Por për blerjet më të hershme mbeteshin në fuqi dispozitat e vjetra, çka do të thoshte se detyrimi për të kthyer çmimin e blerjes në rastet e tjetërsimit të pronës shtrihej për gjithë periudhën deri në vitin 945, gjë që përbënte një lëshim të rëndësishëm për të fuqishmit.

Një tjetër ligji i Konstandinit VII, i hartuar nga patriku e kuestori Teodor Dekapoliti, u referohet pronave të ushtarëve<sup>61</sup>. Sipas këtij ligji, pronat e ushtarëve nga të cilat këta të fundit nxjerrin të ardhurat për familjet e tyre dhe për pajimet ushtarake nuk mund të tjetërsoheshin. Ndarja e tokave të ushtarëve gjatë kalimit të trashëgimisë lejohej vetëm me kushtin që trashëgimtarët të bashkonin forcat e tyre për të siguruar pajimet për shërbimin ushtarak. Duhej të kalonin njëzet vjet që një pronë që dikur kishte qenë e një ushtari të bëhej e parevokueshme.

Pronat e ushtarëve të blera në mënyrë të paligjshme duhej t'u hiqeshin blerësve pa asnjë shpërblim. E drejta për të kërkuar kthimin e pronës së ushtarit nuk i takonte vetëm ish-pronarit, por, sipas radhës së përparësive, kjo e drejtë duhej të përfshinte edhe të afërmit deri në shkallën e gjashtë, pastaj ata së bashku me ish-pronarët duhej të kujdeseshin për pajimet e nevojshme për shërbimin ushtarak bashkë me të, si dhe stratiotët më të varfër, që paguanin detyrimet bashkë me të, së fundi edhe fshatarët që i përkisnin së njëjtës bashkësi.

Në mars të vitit 962 Konstandini VII nxori një tjetër përmbledhje ligjesh (*novelae*), e cila përmbante shpjegime mbi dispozitat e mëparshme për pronat e tjetërsuara të stratiotëve dhe vendosi detyrimin që blerësit e ndershëm të kthenin pronën pa shpërblim, kurse të pandershmit duhej të paguanin edhe një gjobë<sup>62</sup>.

Ligji i Niqifor Fokës (perandor ushtarak) i vitit 967 përcakton heqjen e së drejtës së përparësisë të varfërve në blerje. Në rast tjetërsimi të pronave të të fuqishmëve u vendos parimi që të varfrit

---

60. Zepos, *Jus I*, 214 e vijim. Dolger, *Reg* 656.

61. *IBID* 222 e vijim Dolger *Reg* 673.

62. *IBID* 243 e vijim Dolger *Reg* 690.

mund të blinin vetëm nga të varfrit dhe të pasurit vetëm nga të pasurit<sup>63</sup>. Ai u përpoq të forconte e të ruante pronën e stratiotëve. Trefishimi i pronës së ushtarëve solli një ndryshim në përbërjen shoqërore të ushtrisë bizantine. Ky parashikim ligjor çoi në largimin nga politika e ndjekur deri atëherë, që mbështetej mbi pronën e vogël të të varfërve<sup>64</sup>. Ligji i vitit 964 i tij pati si qëllim kufizimin e zhvillimit të pronave kishtarë e të manastireve. Ky ligj përbënte një ndër pikat më të guximshme të legjislacionit bizantin.

Latifondi kishtar rritej vazhdimisht nga dhuratat, faljet e testamenteve nga besimtarë të të gjitha shtresave të popullsisë, por zhvillohej më ngadalë se ai laik. Tashmë duhej të merrte fund tjetërsimi i tokave në favor të manastireve, institucioneve kishtarë dhe personave me status kishtar. Megjithëse prona tokësore e institucioneve fetare u nënshtrohej detyrimeve shtetërore, këto detyrime ishin fare simbolike, pasi nuk barazoheshin me detyrimet që kishin pronat e të tjerëve jofetarë. Për shkak të natyrës fetare që e karakterizonte këtë perandor, ai ishte i prirur të rriste latifondet. Ky ligj nuk qëndroi gjatë në fuqi, edhe pse përputhej me puritanizmin fetar të perandorit.

### 2.3. Ligjet e Bazilit II

Perandori i Bizantit Bazili II, i cili iu përkushtua politikës agrare antiaristokratike, në vitin 996 nxori *novellae-n* e tij, si një shtojcë e legjislacionit të mëparshëm. Dispozita më e veçantë e kësaj pakete ligjore ishte parashikimi i heqjes së afatit 40-vjeçar të skadimit, pas të cilit, sipas ligjeve të dikurshme, humbte e drejta për të kërkuar kthimin e tokës së blerë në mënyrë të paligjshme<sup>65</sup>. Pra, ky perandor vendosi që të gjitha blerjet e bëra nga të pasurit prej të varfërve pas daljes së ligjit përkatës në kohën e Lekapenit duhej t'u ktheheshin të varfërve pa marrë parasysh asnjë afat skadimi dhe pa asnjë shpërblim nga ana e zotëruesve të mëparshëm. Në lidhje me arkën e shtetit kjo *novellae* kishte parashikuar se e drejta e shtetit për të konfiskuar kishte vlerë prapavepruese deri në kohën e Augustit.

Me këtë *novellae* Bazili II synonte të kufizonte shtrirjen e pronave tokësore të kishës në dëm të pronës së fshatarëve. Kuvendet e ngritura nëpër fshatra me kontributin e fshatarëve dhe që kishin

---

63. Zepos, *Jus, I, 253, e vijim Dolger Reg 712.*

64. Zepos, *Jus, I, 249 e vijim. Dolger, Reg. 699 Krh Charanis, Monastic Propertics, 56 e vijim.*

65. Zepos, *Jus, I, 262 e vijim. Dolger, Reg 783.*

një numër të vogël murgjish nuk do të konsideroheshin manastire, por vende lutjeje dhe do të ishin në varësi të bashkësive fshatare, duke u përjashtuar kështu nga detyrimet ndaj peshkopit. Kuvendet që kishin më tepër se tetë murgj do të ishin nën varësinë e peshkopit, por nuk kishin të drejtë të blinin toka të reja. Me këtë parashikim ligjor perandori Bazili II risillte në jetë një urdhëresë të hershme të stërgjyshit të tij, Lekapenit, por ai preferon të mos bëjë asnjë aluzion për ligjin akoma më radikal të Niqifor Fokës, i cili ishte revokuar nga Johan Cimisha<sup>66</sup>. Historia njeh dy emra që simbolizojnë epokën heroike të Bizantit: Heraklin dhe Bazilin II. I pari e hapi këtë epokë të lavdishme, ndërsa i dyti e mbylli.

### **3. Risitë e Perandorisë së Bizantit krahasuar me Perandorinë Romake**

Teodosi në çastet e fundit të jetës së tij e ndau Perandorinë mes dy djemve të tij, duke i dhënë djalit të madh, Arkadit, Lindjen, ndërsa djalit të vogël, Onorit, Perëndimin. Gjithashtu dioqeza e Maqedonisë iu dha Lindjes dhe u përfshi nën prefekturën ilirike me kryeqytet Selanikun. Nga viset ilirike i mbeti Perëndimit vetëm dioqeza kanonike, që njihej me emrin “Iliriku” (*Illyricum*)<sup>67</sup>. Kështu u shënuar një vijë kufitare mes Lindjes dhe Perëndimit, e cila me kalimin e kohës do të cilësohej qartazi si kufiri midis botës kulturore perëndimore, romane, dhe asaj lindore, bizantine.

Ndarja e bërë nga Teodosi nuk ishte diçka e re, por tepër e rëndësishme, pasi deri në rënien e Perandorisë romake të Perëndimit nuk flitej për dy perandori, por për dy pjesë të një perandorie të vetme, që qeverisej nga dy perandorë. Në aspektin ligjor u aplikua nxjerrja e dekreteve në emër të të dy perandorëve. Po të ndodhte që njëri prej tyre nxirrte një dekret dhe ia jepte tjetrit për shpallje, ky dekret automatikisht bëhej i detyrueshëm për t’u zbatuar nga e gjithë Perandoria. Në qoftë se një nga perandorët do të vdiste, tjetri kishte të drejtën për të zgjedhur trashëgimtarin e tij.

Pavarësisht këtyre parashikimeve, nuk ishte e mundur të mbahej e fortë lidhja mes dy perandorive, për shkak se jeta politike në Lindje e në Perëndim ndiqte dy drejtime të ndryshme. Gjatë sundimit të dy djemve të Teodosit lindi një rivalitet i ashpër midis mäkëmbësve që ndoqën

---

66. *Krh Dolger, Reg 772.*

67. Stein, *Geschichte*, I & E. Demougeot (1951), *De l’unité a la division de l’empire romain*, f. 410, Paris, 143 e në vijim.

njëri-tjetrin në qeverisjen e Lindjes në emër të Arkadit të pafuqishëm, nga njëra anë, dhe gjermanit të fuqishëm Stilikon, që qeverisi për më shumë se një dekadë në Perëndim në emër të djaloshit Onor, nga ana tjetër<sup>68</sup>.

Ndërsa Perëndimi në shekullin e 5-të u përfshi nga luftërat dhe gjendja paraqitej e pashpresë, në Lindje mbizotëronte një periudhë qetësie. Pikërisht në këtë periudhë u themelua Universiteti i Konstandinopojës, i cili u bë qendra kulturore më e rëndësishme e Perandorisë, ku jepnin mësim dhjetë gramatikanë grekë dhe dhjetë gramatikanë latinë, pesë oratorë grekë dhe tre oratorë latinë, një filozof dhe dy juristë.

Në këtë kohë doli në skenë botimi “*Codex Theodosianus*”, i cili solli një ndryshim rrënjësor në zhvillimin e sistemeve juridike të shtetit. Ky botim konsiston në një përmbledhje të të gjitha edikteve perandorake nga koha e Konstandinit e më pas. Rëndësia e tij qëndron në faktin se hodhi baza të reja më solide në administrimin e drejtësisë dhe shmangu mundësitë për të gabuar, që rridhnin nga mungesa e një përmbledhjeje zyrtare të ligjeve. “*Codex*”-i u shpërnda si në Perëndim, ashtu dhe në Lindje në emër të të dy perandorëve - Teodos II dhe Valentinian III. Edhe pse dalja e këtij botimi ishte një tentativë për të forcuar unitetin mes Lindjes dhe Perëndimit, realiteti tregoi se situata nuk ishte e tillë. Pas daljes së “*Codex*”-it në raste shumë të rralla perandorët e Lindjes (Bizantit) do t’u dërgonin atyre të Perëndimit(Romës) ediktet e tyre, ndërsa këta të fundit do të ndërprisnin përfundimisht dërgimin e edikteve të tyre perandorëve të Lindjes.

Një element tjetër që tregonte thellimin e ndarjes mes dy perandorive ishte gjuha. Në Perëndim përdorimi i gjuhës greke erdhi duke u zbehur, kurse në Lindje gjuha latine, edhe pse mbeti gjuhë zyrtare, po humbiste pozitat kundrejt gjuhës greke. Këtë e tregon edhe nga numri i profesorëve në Universitet: ata grekë ishin më shumë se latinët<sup>69</sup>.

## **KAPITULLI III**

### **Ligji agrar, gjeneza e tij, zhvillimi dhe karakteristikat**

#### **1. Gjeneza e ligjit agrar (*Nomos Georgikos*)**

---

68. E.Demougeot (1951), *De l'unité a la division de l'empire romain*, Paris, 93 e në vijim.

69. G.Bardy (1948), *La question des langues dans l'eglise ancienne*, I Paris.

Ligji për fshatarët është dokumenti më i rëndësishëm i shekullit të 7-të. Duke iu referuar titullit të tij konstatohet se ai përmban pjesë të marra nga një veper juridike e Justinianit. Por titulli i ligjit kërkon të zgjidhen çështja: a mund të konsiderohet ky ligj si një përzgjedhje me pjesë nga veprat juridike të Justinianit I, apo bëhet fjalë për pjesë të marra nga një libër juridik i Justinianit II, që nuk ka arritur deri te ne?

Studiuesi Zacharia në veprën e tij “*Geschichte des griechisch-römischen Rechts*” ka kërkuar të vërtetojë se ekziston një lidhje e ngushtë midis ligjit për fshatarët dhe “Eklogesë” së Leonit III dhe Konstandinit V dhe ka dashur t’ia atribuojë këtij të fundit autopsinë e kësaj vepre. Por studiues të tjerë të këtij ligji kanë theksuar se autori i tij ka qenë Justiniani II<sup>70</sup>.

Rezulton se nga të gjitha dorëshkrimet për *Nomos Georgikos* të njohura deri tani vetëm “Parisinus gr.1367” i shekullit të 12-të u referohet hapur veprave juridike të Justinianit I. Te ky dorëshkrim është cituar “*Digesta*” dhe “*Institutiones*”<sup>71</sup>. Por pavarësisht nëse është apo jo një veper zyrtare (libri i Justinianit I), nga i cili ai ka huazuar rregulla mbi jetën e fshatarëve, ishte patjetër një veper legjislative zyrtare e Justinianit II. Numri i madh i dorëshkrimeve të këtij ligji tregon qartë se ka pasur një përhapje të madhe jashtë kufijve të Perandorisë Bizantine.

Ligji agrar është shtylla kryesore e paketës ligjore që ka vepruar në trojet shqiptare. Së bashku me Ligjin Ushtarak dhe Ligjin Detar ishte një lloj plotësimi i Eklogesë.<sup>72</sup> Ky ligj fundamental ka një shtrirje kohore nga shekulli i 7-të deri në shekullin e 14-të dhe përbënë bazën ku Perandoria Bizantine mbështeti veprimtarinë e saj. Në qoftë se i referohemi titullit të tij, të krijohet përshtypja se kemi të bëjmë me një ligj që rregullon fushën e veprimtarisë bujqësisë, por në fakt ai përmban norma që rregullojnë tërë veprimtarinë administrative, financiare, fiskale, penale etj. të territoreve dhe popullsive që përfshiheshin në kufijtë e Bizantit dhe mes tyre ato arbërore. Ai ishte një përmbledhje dispozitash që rregullonin marrëdhëniet midis fshatarëve të vegjël që kishin pronat e tyre dhe që ishin të ngarkuar me detyrime ndaj shtetit.<sup>73</sup>

Kalimi i Shqipërisë nën sundimin e Bizantit në shekullin IV –rt u shoqërua me kodifikimin e legjislacionit në fushën e bujqësisë që ishte dega kryesore e ekonomisë së vendit .Në shekullin VIII-të u miratua ligji agrar , i cili gjatë periudhave të rëndësishme që diktoheshin nga zhvillimi

---

70. W.Ashburner (1910), *The Farmer’s Law*, f. 85-108.

71. Po aty, f. 85 e në vijim.

72 A.Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e sw Drejtws nw Shqipwri*, f.74

73 P.Haxhi, *Regjimi juridik i Tokws nw Shqipwri*, f.8.

politiko- shoqëror i perandorisë, pësoi ndryshime.<sup>74</sup> . Ligji agrar nga bashkëjetesa shumëshekullore me normat e kanuneve tona ka marrë nga traditat tona juridike, ashtu siç kanë marrë kanunet prej tij, duke lënë gjurmë në aspektin juridik të kohës në trojet shqiptare që iu nënshtruan sundimit të kësaj Perandorie. Sistemi agrar i trashëguar nga Roma, i bazuar në latifondet dhe në kolonatin, u përshtjellua nga vendosja e bujqve të rinj, sidomos të sllavëve. Krahas fshatarëve, ushtarëve dhe stratiotëve që nga fillimi i shek të 7-të u zhvillua një fshatarësi e lirë, që gjeti shprehjen e statusit të saj në ligjin agrar të Justinianit II. Mbizotëron mendimi se ky ligj është hartuar nga fundi i shekullit të 7-të ose fillimi i shekullit të 8-të, pra gjatë kohës kur ka pasur një dyndje të sllavëve në territoret europiane të Perandorisë Bizantine. Kjo shpjegon dhe faktin që gjenden shumë dispozita të tij që pasqyrojnë norma të së drejtës zakonore sllave. Sipas këtij ligji, pronësia ka karakter privat dhe shtrihet mbi arat, vreshtat etj., por ekziston edhe prona kolektive, për të cilën ligji parashikon ndarjen me lotari.

Dispozitat e ligjit agrar tregojnë se në kohën e veprimit të tij pronësia e përbashkët nuk ishte zhdukur përfundimisht. Kullotat, pyjet, ujërat, tokat e lëna djerr vazhdonin të ishin pronë e bashkësisë dhe administroheshin nga kjo. Bashkësia kishte një numër tokash të lira e të papunuara, që herë pas here ua ndante anëtarëve të bashkësisë, sipas nevojave, duke zbatuar sistemin e shortit. Një mbeturinë e kohës kur tokat ishin pasuri e përbashkët ishte edhe sistemi i “arave të hapura”, sipas të cilit me përfundimin e korrjeve bagëtitë mund të kullotnin lirisht në ngastrat e njërit apo tjetrit. Po ashtu arat e braktisura pas një afati të caktuar i ktheheshin përsëri bashkësisë, që mund t’i përdorte për të kompensuar anëtarët e bashkësisë që kishin nevojë për ngastra të reja shtesë ose që dëshironin ta ndërrojnë tokën që kishin. Gjithashtu bashkësia kujdesej për veprimtari me interes të përbashkët, si: për shfrytëzimin e ujërave; për pajtimin e barinjve që kullotnin tufat e fshatit dhe që i shoqëronin ato në shtegtimet nga kullotat verore në ato dimërore; për pajtimin e mjeshtërvë zejtarë, që kryenin punime për nevoja të bashkësisë dhe të natarëve të veçantë të saj. Nga dispozitat e ligjit kuptojmë se bashkësia fshatare ishte një formë organizimi shoqëror kalimtar, për të kaluar më pas në shoqërinë feudale. Ligji nxjerr në pah ekzistencën e personave që punonin tokat e të tjerëve kundrejt një të dhjetës së prodhimit ose u jepnin një rrogë të vogël.

---

<sup>74</sup> P.Haxhi , *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*, f.7.

Gjatë periudhës që Perandoria Bizantine u drejtua nga perandorë maqedonas, u përhapën “ngastrat ushtarake”, të cilat u shpërndaheshin bujqve me kusht që të kryenin shërbimin ushtarak. Sistemi i pronave ushtarake gjeti përhapje të gjerë në kohën e riorganizimit politiko-administrativ të Perandorisë Bizantine dhe të ndarjes së territorit të saj në provinca ushtarake të quajtura “tema”. Sistemi i temave, themeli ekonomik e shoqëror i të cilit ishte prona e vogël e bujkut-ushtar (stratioti), ishte shtylla kryesore e shtetit dhe e ushtrisë bizantine, ndaj perandorët bizantinë bënë të pamundurën për t’i ruajtur të paprekura ngastrat ushtarake nga sulmi i pronarëve të mëdhenj. Por tashmë kishte po përhapjes tendenca për zhdukjen e pronës së vogël, qoftë kjo e stratiotëve apo e anëtarëve të bashkësisë së fshatarëve, çka solli rrënimin ekonomik të Perandorisë dhe e çoi atë drejt shembjes.

## **2. Analizë juridike krahasuese e ligjit agrar me të drejtën zakonore shqiptare**

Ligji agrar përbën një paketë juridike që rregullon marrëdhëniet e pronësisë private, kryesisht si një reflektues i kushteve të fshatarësisë në të gjitha territoret e sunduara nga Perandoria Bizantine në shekujt VII–VIII. Dispozitat e tij nuk e përjashtojnë edhe ekzistencën e tokës në bashkësi, e cila mund të ndahej me lotari mes anëtarëve të saj, çka i jepte mundësi fshatarit të zgjidhte një tokë të barabartë me atë që ai punonte kur ishte pjesë e bashkësisë.

Për të përkrahur pronën e vogël që ishte burimi kryesor i të ardhurave të shtetit, ligji agrar parashikonte mundësitë e coptimit të sipërfaqeve të tokave të mëdha dhe dorëzimin e tyre bujqëve. Ligji nuk njihte institutin e mbrojtjes nga dinatët dhe varësinë e bashkësisë fshatare nga ana e tyre. Tatimi mbi tokën caktohej për të gjithë bashkësinë në tërësi në mënyrë të pandarë, duke qënë cdo pronar solidarisht përgjegjës për pagimin e tij. Në rast se ndonjë fshatar do të braktiste tokën, e linte të papunuar ose zhdukej, të tjerët përgjigjeshin solidarisht për tatimin. Sipas ligjit, familjet kishin të drejtë që arat e tyre t’i trashgonin, t’i shkëmbenin, t’ua jepnin të tjerëve me qera për t’i punuar. Përmbajtja e ligjit agrar tregon se bashkësia e dikurshme nga ana e strukturës juridike ruan ende elemente të strukturës së saj që përmbanin disa nene të ligjit.<sup>75</sup> Ligji nuk ka bërë një ndarje të dispozitave të veta sipas fushave përkatëse që ai rregullon,

---

<sup>75</sup> P. Haxhi, *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*, f.8.

përbëhet nga 85 nene, që do t'i marrim në analizë sipas natyrës juridike dhe fushës që i përkasin konkretisht.

Duke pasur parasysh zhvillimin ekonomik-shoqëror që ka sjellë ky ligj, duhet të theksojmë se bërthama më e rëndësishme e shoqërisë bizantine ishte organizimi ekonomik, bujqësia dhe blegtoaria, marrëdhëniet e pronës, detyrimet që rridhnin nga shkaktimi i dëmeve. Duke pasur në themel këto rregullime, ligji ka parashikuar dispozita të karakterit civil dhe penal. Janë marrë në mbrojtje marrëdhëniet e pronës, duke parashikuar disa vepra penale kundër pasurisë dhe masat ndëshkuese për kryerjen e tyre.

Në shekullin VII-VIII vendin e pronësisë së përbashkët mbi tokën, që deri atëherë e zinte pronësia sunduese, e zuri prona individuale e fshatarëve individualë, e fshatarëve të lirë, që përbëhej nga arat, vreshtat, pyjet, banesa e mullinjtë, si dhe bagëtitë e imta dhe të trasha. Tokat që dispononte privatisht çdo bujk ishin pjesë nga toka dikur e përbashkët. Kjo pronësi përforcohej me një varg dispozitash ligjore që parashikonin dënime të ndryshme për ata që do ta cënonin.<sup>76</sup>

Neni i parë i tij i referohet nocionit të kufijve midis pronave private dhe detyrimit për të mos i cenuar ato. Në të thuhet: *“Bujku që punon në arën e vet duhet të jetë i drejtë dhe të mos përvetësojë hullitë e fqinjit. Në qoftë se ndonjëri duke shkelur kufijtë përvetëson dhe zvogëlon pjesën e tokës që gjendet shumë afër tij, në qoftë se këtë e bën në lërimin e parë të tokës së lënë djerr, e humbet lërimin e saj; në qoftë se këtë shkelje e ka bërë në kohën e mbjelljes, bujku shkelës humbet farën, mbjelljen e saj dhe prodhimin.”*

Pra, kufiri konsiderohet i paprekshëm dhe i pandryshueshëm. Cenimi i tij konsiderohet shkelje dhe sanksioni përkatës është dëmi ekonomik që i vjen shkelësit për farën dhe prodhimin e marrë në tokë të huaj. Edhe Kanuni i Lekë Dukagjinit në kreun *“Prona dhe kufiri”* i ka kushtuar një rëndësi të madhe konceptit të kufirit të pronës, duke sanksionuar se *“kufiri ngulet një herë e përgjithmonë”*, parim që nënkupton rëndësinë që i jepte këtij Kanuni nocioni. Madje, neni 384 i Kanunit parashikonte si një dispozitë më vete dënimin për cenimin e kufijve dhe konkretisht: *“Për kufinin e luejtun i fajësumi pas faqes së zezë, i lanë gjobën katundit”*.

E drejta zakonore shqiptare ka ngjashmëri me parashikimin e kësaj situate në dy drejtime: së pari, ashtu si te ligji agrar i Perandorisë Bizantine sanksionohet paprekshmëria e kufirit të

---

<sup>76</sup> P.Haxhi, *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*, f.8.



pronës; së dyti, nuk aplikohet masë dënimi e karakterit fizik, si p.sh., prerje gjymtyrësh, por masa ndëshkimore ka natyrë civile.

Nenet 4, 5 dhe 6 të ligjit flasin për natyrën e një kontrate shkëmbimi, nëse do ta quanim të tillë, që lidhet mes dy bujqve me objekt shkëmbimin e pronave, arave. Kjo formë kontratë del qartë në nenin 3, ku thuhet: *“Në qoftë se dy bujq merren vesh midis tyre përpara dy ose tre dëshmitarëve për të shkëmbyer tokat dhe bien dakord, vendimi për shkëmbimin e tyre le të mbetet ligjor, i sigurt dhe i palëkundshëm.”*<sup>77</sup> Pra, kemi një marrëveshje dypalëshe të lidhur në prani të tre dëshmitarëve, formë kjo që sot zëvendësohet për efekt vlefshmërie e besueshmërie nga noteri, me përcaktime të qarta si siguria dhe palëkundshmëria. Kjo situatë juridike është parashikuar në Kanunin e Lekë Dukagjinit, në kreun VII të titulluar *“Toka për ndërrim”*. Në nenin 545, që i dedikohet tagrit për ndërrim toke, thuhet: *“Me ra në ujdi shpija, me shpi, me ndrru copa tokash jase tokë e shpi me shpinë e tokën e kushrinit, jase të shoqit, asht tagër kanunjë. Ndrrimi bahet me pleq.”*<sup>78</sup> Edhe këtu gjejmë të sanksionuar marrëveshjen dypalëshe, por me një ndryshim: kërkohet prania e pleqve dhe jo e dëshmitarëve për të lidhur marrëveshjen.

Neni 6 i ligjit parashikon rastin kur një bujk merr prodhimet e një toke të huaj pa dijeninë e pronarit të tokës. Në të thuhet se në një rast të tillë bujku duhet ta kthejë dyfish prodhimin. Një situatë të ngjashme gjejmë te Kanuni i Lekë Dukagjinit në kreun mbi bujqësinë dhe gjënë e gjallë. Kështu, neni 387 parashikon: *“Me pas një shpi nevojë për tokë ene me shkue e me u vendue në tokë të huaj, atë botë bahet bulku i tij, bahet gjysatar i të zot të tokës. Gjithçka që mbjell bulku në tokë të huaj do ta ndaj me të zonë.”*<sup>79</sup> Këtu përdoret termi “gjysatar”, të cilin e gjejmë edhe te Ligji agrar. Në nenet 12,13,14 dhe 15 është parashikuar mundësia e çdo bujku për të marrë një tokë nga një tjetër e ta punojë, por duhet ta ndajë prodhimin përgjysmë me pronarin e tokës.

Nenet 23, 24, 25, 26 dhe 27 të ligjit parashikojnë atë situatë juridike që në Kanunin e Lekë Dukagjinit quhet *“kontrata e qinosisë”*, konkretisht dhënia e bagëtive një personi tjetër për një kohë të caktuar, i cili detyrohej të kujdesej për to, ndërsa të ardhurat i ndanin sipas marrëveshjes. Neni 21 i ligjit thotë: *“Në qoftë se një bujk do të ndërtojë një shtëpi dhe do të mbjellë një vresht në një arë ose vend të huaj dhe pas një kohe vijnë të zotët e vendit, nuk lejohet që të shkatërrojnë shtëpinë dhe të shkulin vreshtat, por kanë të drejtë të marrin një vend të barabartë. Në qoftë se ai*

---

<sup>77</sup> Ligji Agrar, neni 3.

<sup>78</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 545.

<sup>79</sup> Po aty, neni 387.

*që ka ndërtuar dhe ka mbjellë në arën e huaj nuk pranon të japë vend të barabartë, i zoti i vendit ka të drejtë të shkulë vreshtin, kurse shtëpinë ta shkatërrojë.”<sup>80</sup>*

Në nenin 365 të Kanunit të Lekë Dukagjinit, në kreun “Fitimi i pronësisë”, në titullin “Të përdoruemtë e tokës në mungesë të zot” thuhet: *“Me dalë kush prej katundit tuj e lanë tokën djerrë, të zamit kanë tagër me e punue për vedi, ndryshe me lanë kujri kullotë për fis jase të fiseve përreth saj. Me ardhë dikur i zoti, toka i kthehet me kufijtë e parë. I zoti nuk ka tagër me lypë gja për bimën e tokës së vet.”<sup>81</sup>*

Nga analiza e tyre vërejmë pika të përbashkëta, si: moskthimi i të mbjellave në tokën e tij. Në kreun “Bujqësia dhe gjaja e gjallë” Kanuni i Lekë Dukagjinit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë qenit. Në një prej dispozitave, që titullohet “Detyrat e të huajt për qenin”, thuhet: *“Qeni i huaj nuk ngucet, nuk grabitet as nuk vritet. Kush nguc pa shkak qenin e huaj, pleqtë lypin arsy jase gjobën para katundit. E grabitja ene e vramja e qenit herët u çmote gjysë gjaku. Me Kanu të vonë çmohet 500 groshë.”* Kanuni sanksionon gjobë në rast të shkeljes së dispozitës së mësipërme, pasi e konsideronte këtë kafshë të rëndësishme në ekonominë e fshatarëve. Ngjashmëri me këtë situatë kemi në dispozitën nënen 4, 75, 76, të ligjit, në nenin 77 të tij thuhet: *“Në qoftë se dikush që ka një qen të fortë e nxit atë kundër qenve të dobët t’i kafshojë ata dhe ndodhë që ndonjë nga qentë sakatohet ose ngordh, ai detyrohet t’i paguajë dëmin të zotit dhe të rrihet me dymbëdhjetë kamxhikë.”<sup>82</sup>* Madje, në nenin 74 vendoset si rregull që ai që vret kafshën e huaj për çfarëdo arsyeje, duhet t’i paguajë gjobën të zotit të saj. Kemi një parandalim të shprehur qartë për vrasjen apo cenimin e jetës së kafshëve që kryenin shërbime të ndryshme në ekonominë bujqësore e blegtorale. Ka një ndryshim me Kanunin e Lekë Dukagjinit, që njeh vetëm dënimin me gjobë, kurse ligji e çon më tepër seksionin duke parashikuar edhe rrahje me kamxhikë.

Në nenin 23 të ligjit thuhet: *“Në qoftë se një lopar merr që në mëngjes nga një bujk një ka, e bashkon atë me kopenë dhe ndodh që kaun e ha ujku, le t’i tregojë të zotit të kaut kufomën dhe nuk do të dëmtohet.”<sup>83</sup>*

E gjejmë këtë situatë në nenin 575 të Kanunit të Lekë Dukagjinit në kreun “Kau me hu”, i cili titullohet *“Kur bahet dam kau me hu”*.<sup>84</sup>

---

<sup>80</sup> Ligji Agrar, neni 21

<sup>81</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 365

<sup>82</sup> Ligji Agrar, neni 77

<sup>83</sup> Po aty, neni 23.

Neni 44 i ligjit agrar parashikon: *“Në qoftë se ndonjëri gjen në pyll një ka, e ther atë dhe merr mishin e tij, t’i priten duart.”*<sup>85</sup>

Në kreun “Gjaja e gjetun” të Kanunit të Lekë Dukagjinit, në nenin 557 me titull “Tagër e detyrë për gjanë e gjallë”, thuhet: *“Me ndodh ene me gjet ndojë gja të gjallë jase mall udhës, malit, nën tokë e mbi tokë, tager ke me e marrë ene me e çue te shpija jote. Por detyrë ke mos me e mbajtë mfshetë gjanë e gjetme. Me e mbajtë të mfshet, bahesh me fjalë ene ndiqesh për cubni.”*<sup>86</sup>

Nga krahasimi i këtyre dy dispozitave kuptojmë se ligji agrar i Perandorisë Bizantine parashikon një sanksion penal të ashpër për përvetësimin e një sendi pa zot: prerjen e duarve. Kjo situatë parashikohet edhe në Kanunin e Lekë Dukagjinit, por kryerja e një veprimi të tillë nuk çon në ekzekutimin e sanksioneve të ashpra me dëmtime trupore fizike. Këtu kemi të parashikuar vetëm emërtimin që i jepej një personi që kryente një veprim Kanunit të Lekë Dukagjinit të tillë: “ndiqesh për cubni”, domethënë dënoj si hajdut. Dispozita e është më e zgjeruar, ajo paraqitet si një gërshetim i nocioneve civile me ato penale, konkretisht është parashikuar e drejta që ka personi që gjendet në një situatë të tillë, pra gjen një kafshë pa zot, e merr dhe e çon në banesën e tij. Deri këtu situata është më se legjitime dhe më pas vjen detyrimi që lind nga kjo situatë: të bësh me dije se çfarë ke gjetur. Ky parashikim prevalon të drejtën e pronarit legjitim, i cili mund të mos ketë dijeni për humbjen e pronës së tij. Bërja me dije e gjetjes së kësaj të fundit i jep atij të drejtën për të rimarrë përsëri sendin, pronën e tij.

## **2.1. Marrëdhëniet e pronësisë dhe detyrimet**

Në periudhën e Bizantit , dhe vecanërisht, nga shekulli X-të, u vendos një regjim juridik i fortë lidhur me shitblerjen e tokës. Njihej me ligj instituti i parapëlqimit në çështjet e shitblerjeve. Në radhë të parë parapëlqeheshin të afërmit që ishin bashkpronarë; së dyti ortakët që ishin të mpleksur njësoj si të parët, pastaj ata që ishin të përzier dhe nuk kishin as farefis as ortakë me atë që e shiste tokën. Pas këtyre , vinin të bashkjetuarit , dhe në fund ata që ishin komshij me një pjesë të pronës që shitej.

Instituti me rëndësi historike i së drejtës Bizantine që shërbeu si një nga rrugët për formimin e sistemit feudal bizantin ka qënë emfiteoza. Ky institut e ka zanafillën në qiramarrjet e pronave

---

<sup>84</sup> Kanuni I Lekë Dukagjinit, neni 575.

<sup>85</sup> Ligji Agrar, neni 44.

<sup>86</sup> Kanuni I Lekë Dukagjinit, neni 557.

agrare publike që fillimisht lidheshin prej një afati prej 5 vitesh. Më vonë shteti dhe pronarët e mëdhenj , për të siguruar shfrytëzimin e vazhdueshëm të tokave dhe për të mos patur sipërfaqe tokash të papunuara , përsërisnin kontratën duke u shndërruar kështu në marrëdhënie të përhershme juridike. Nga natyra e saj juridike , kjo kontratë nuk ishte as shitje as qiramarrje, por e drejtë tjetërsuese dhe e trashgueshme, në bazë të së cilës qiramarrësi kishte të drejtën e ushtrimit të plotë të attributeve të pronarit dhe merrte përsipër të gjitha barrat dhe rreziqet , ndërsa pronari gëzonte vetëm përfitimet.<sup>87</sup>

Kufizimet e pronës private janë një element tjetër për t'u analizuar. Këto kufizime shpreheshin në formën e barrëve ose servitute, siç i quajmë sot, domethënë e drejta e përdorimit të një pasurie të huaj për një qëllim të caktuar. Vendin kryesor e zinin servitutet reale, që shfaqeshin në disa forma, si p.sh.: të drejtën e kullotjes në tokat pronë private e gjejmë të sanksionuar në nenin 78 të ligjit agrar, në të cilin thuhet: *“Në qoftë se dikush ka korrur parcelën e tij dhe i fut bagëtitë në parcelat e pakorrura të komshinjve dhe u shkakton atyre dëm, të rrihet me tridhjetë kamxhikë e t'i paguajë dëmin të dëmtuarit.”*<sup>88</sup>

Pra, dispozita vendos një kufizim për shfrytëzimin e pronës private. Mosrespektimi i kësaj dispozite shoqërohet me shpërblimin e dëmit sipas konceptit të së drejtës civile dhe njëkohësisht me një sanksion penal: rrahje. Ky parashikim është aplikuar edhe në të drejtën tonë zakonore (shih kanunet).

Neni 79 i ligjit parashikon një tjetër situatë që i referohet kufizimit të shfrytëzimit të pronës private. Në të thuhet: *“Në qoftë se dikush vjel vreshtin e tij dhe fut bagëtitë në vreshtin e pamjelë të dikujt tjetër, të rrihet me tridhjetë kamxhikë e t'i paguajë dëmin të dëmtuarit.”*<sup>89</sup> Në këtë nen është marrë në mbrojtje prona private e njëkohësisht është sanksionuar e drejta e shfrytëzimit të një prone private duke u respektuar paraprakisht disa kushte, siç është vjelja e plotë e prodhimit bujqësor, si dhe aplikohet dënimi me rrahje për çdo shkelës krahas zhdëmtimi i dëmit.

Në nenin 84 gjejmë një ngjashmëri me të drejtën tonë zakonore: të drejtën e kalimit të ujit për vaditjen e tokave. Në këtë nen thuhet: *“Në qoftë se zotëruesit e arave nuk duan që uji të kalojë përmes arave të tyre, u njihet e drejta për këtë.”*<sup>90</sup> Në të drejtën tonë zakonore thuhet se *“e mira e përbashkët i paravihet dëmit të veçantë”* dhe *“për një shtëpi s'mund të lihet me u tha një*

<sup>87</sup> P.Haxhi, *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*, f.10.

<sup>88</sup> *Ligji Agrar, neni 78.*

<sup>89</sup> *Po aty, neni 79.*

<sup>90</sup> *Po aty, neni 84.*

katund<sup>91</sup>. Megjithatë, ka ndryshim mes tyre, pasi në të drejtën tonë i zoti i tokës duhej të lejonte kalimin e ujit.

Përveç normave të karakterit civil ligji agrar ka parashikuar edhe disa norma që marrin në mbrojtje pasurinë, pronën private dhe atë të bashkësisë. Në pjesën më të madhe të këtyre normave është parashikuar vepra penale e vjedhjes, si te neni 33, i cili parashikon: *“Në qoftë se një rojë pemësh frutore kapet duke vjedhur në vendin ku ruan, të privohet nga rroga e tij dhe të rrihet fort.”*<sup>91</sup> Pra, dispozita merr në mbrojtje pasurinë që buron nga pemëtaria si një pjesë e rëndësishme e ekonomisë familjare dhe asaj të bashkësisë. Sanksioni përkatës është ai fizik dhe ai ekonomik, pra privimi i marrjes së të ardhurave në të holla për punën që shkelësi do të bënte dhe ka abuzuar me atë. Ligji parashikon edhe një sanksion tjetër për këtë situatë në nenin 61, që thotë: *“Ata që hyjnë në vreshtat ose në plantacionet e manave të të tjerëve për të ngrënë, qofshin të pafajshëm. Në qoftë se hyjnë për të vjedhur, të zhvishen dhe të rrihen.”*<sup>92</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit ka parashikuar në një kre të veçantë, *“Mbrapër shembulltina kundër pasunisë”*, veprën penale të vjedhjes sipas objekteve të ndryshme. Një situatë të ngjashme me nenin e cituar më lartë të ligjit agrar e jep neni 718 i Kanunit të Lekë Dukagjinit, që titullohet *“Të thyemtë e shtegut të oborrit, të arrës, të veshtit”* në të thuhet: *“Bani kush ene i thej kuj shtegun e oborrit, të arës, të veshtit, të kopër shembulltit, të livadhit të xanë me gardh jase me pengesa të tjera, i ka gjobën dheut 500 groshë, të zot i ka punën për të ndreqmen e të thyemës. Me ndodhë i huaj ene me u ngatërrue në shtigje të xanëme, ka detyrë me i ba me dije të zot ene me i lypë të falun.”*<sup>93</sup> Dispozita parashikon dënimin me gjobë dhe dënim të karakterit fizik si ligji agrar.

Ligji agrar i ka kushtuar disa dispozita veprës penale të vjedhjes kundër gjësë së gjallë. Kështu, në nenin 41 thuhet: *“Në qoftë se dikush vjedh një ka ose një gomar dhe zbulohet, mbasi të rrihet, ta paguajë atë në dyfishin e punës së tij.”*<sup>94</sup> Ndërsa në nenin 42 thuhet: *“Në qoftë se dikush duke dashur të vjedhë një ka nga një kope bën që kopeja duke u shpërndarë të bëhet pre e bishave, të verbohet.”*<sup>95</sup>

Në nenin 46 thuhet: *“Në qoftë se një shërbëtor duke dashur të vjedhë natën nxjerr bagëtitë nga vatha dhe ato humbasin ose i hanë bishat, të ngulet në hu si drurës.”*<sup>96</sup> Ndërsa në nenin 47

---

<sup>91</sup>Ligji Agrar, neni 33.

<sup>92</sup>Po aty, neni 61.

<sup>93</sup>Kanuni I Lekë Dukagjinit, neni 718

<sup>94</sup>Ligji Agrar, neni 41.

<sup>95</sup>Po aty, neni 42.

<sup>96</sup>Po aty, neni 46.

thuhet: “Në qoftë se shërbëtori i dikuajt ka vjedhur shumë herë kafshë natën ose ka bërë shumë herë grabitje bagëtish, të gjobohet i zoti i tij për ato që kanë humbur, si njeri që është në dijeni se shërbëtori është shkaktar, kurse shërbëtori të ngulet në hu.”<sup>97</sup>

Të gjitha këto situata të ngjashme me objekt mbrojtjen e gjësë së gjallë nga vjedhja në Kanunin e Lekë Dukagjinit janë përmbledhur në një nen të vetëm, neni 719, me titullin “Vjedhja e gjasë së gjallë”, ku thuhet: “Me ba me vjedhë gjanë e huej në kullotë, vjedhësi i ka detyrë të zot dypërnjahren. Me u vjedhë gjaja në vathë, në t’banat jase në shpi, cubi i lanë të zot dypërnjahren ene dheut 500 groshë për shpi të thyeme.”<sup>98</sup>

Janë parashikuar dispozita për të mbrojtur veglat e bujqësisë nga krimi i vjedhjes, si neni 62 i ligjit, i cili thotë: “Ata që vjedhin parmendë, plor, zgjedhë ose vegla të tjera, të gjobiten sipas sasisë së ditëve, duke llogaritur që nga dita e kryerjes së vjedhjes nga 12 follë për çdo ditë.”<sup>99</sup>

Ndërsa neni 63 parashikon një tjetër mbrojtje të kësaj natyre: “Ata që djegien apo vjedhin një qerre të huaj, ta paguajnë në sasi të dyfishtë.”<sup>100</sup> Të njëjtën gjë parashikon për krimin e vjedhjes edhe neni 722, i titulluar “Vjedhja e veglave të bulkisë”, që thotë: “Bani e i vodh kush të zot veglat e bulkisë: parmendën, zhgjedhen jase ndoj vegël tjetër, cubi ka detyrë me i la të zot aq punëtorë sa i shkuen hups për me gjetë vjedhjen ene me ja prue veglat ke shpija.”<sup>101</sup>

Në të gjitha rastet në këto legjislacione vihet re forma e sanksionit, që është zhdëmtimi material. Te ligji agrar gjejmë dispozita që u referohen dëmtimeve të pronës private me anë të zjarrvënies, si neni 64, në të cilin thuhet: “Ata që vënë zjarr në lëmë ose në qipitë e grurit për hakmarrje kundrejt armiqve, le të digjen në zjarr.”<sup>102</sup> Sanksioni i parashikuar është i rëndë, si: dëmtim fizik, djegie në zjarr. Ndërsa te Kanuni i Lekë Dukagjinit çmimi i dëmit është parashikuar në pikën 7 të nenit 633: “Për mullar bari jase kashte të djegun: damin të zot me sanë jase kashte ene një pendë qe katundit.”<sup>103</sup> Nuk ka sanksion të rëndë si te ligji agrar, vetëm zhdëmtim material.

Në nenin 65 të ligjit thuhet: “Atyre që vënë zjarr në kasollen e barit ose të bujku, t’u priten duart.”<sup>104</sup> Ndërsa Kanuni i Lekë Dukagjinit në nenin 633/6 parashikon: “Për ksollë të djegun:

---

<sup>97</sup> Ligji Agrar, neni 47.

<sup>98</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 719.

<sup>99</sup> Ligji Agrar, neni 62.

<sup>100</sup> Po aty, neni 63.

<sup>101</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 722.

<sup>102</sup> Ligji Agrar, neni 64.

<sup>103</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 633.

<sup>104</sup> Ligji Agrar, neni 65.

*damin të zot ene nji ka katundit.*”<sup>105</sup> Analogji tjetër mes dy dispozitave të ligjit gjejmë ndërmjet nenit 66 dhe nenit 633/1, 2. Në nenin 66 thuhet: *“Atyre që shkatërrojnë shtëpi të huaja në mënyrë arbitrare ose prishin gardhet që të gardhojnë ose ndërtojnë të tilla në të vetat, t’u priten duart.”*<sup>106</sup>

Ndërsa në nenin 633/1,2: *“Për shtëpinë e thyeme dami është nji pendë qe ene 100 desh gjobë dheut për shtëpinë e djegun damin të zot, nji pend qe dheut.”*<sup>107</sup>

Në nenin 68 të ligjit Agrar thuhet: *“Ai që gjendet në hambar duke vjedhur grurë, të rrihet me kamxhik, herën e parë me 100 të rrahura dhe t’i paguajë dëmin të zotit. Në qoftë se do të kapet përsëri, të gjobitet në sasi të dyfishtë të asaj që ka vjedhur. Në qoftë se e përsërit dhe për të tretën herë, të verbohet.”*<sup>108</sup>

Neni 69 parashikon: *“Ai që vjedh natën verë nga qypi, nga kadja ose nga fuçia, t’i nënshtrohet të njëjtit dënim siç është shkruar në kapitullin e mësipërm.”*<sup>109</sup>

Te Kanuni i Lekë Dukagjinit këto parashikimi janë përmbledhur në nenin 716, “Vjedhja e rrethit të shpisë”, që thotë: *“Çdo përdhesë në oborr të shpisë jase rrethit të saj, me ba ene me u thye ka gjobën 500 groshë ene dypërnjahren për gjanë e hupme.”*<sup>110</sup>

Dispozitat e cituara më lartë tregojnë qartë ndikimin që ka patur ligji agrar i Bizantit tek kanunet e arbërisë mesjetare.

### **3. Marrëdhëniet e pronës në bashkësinë fshatare nën efektin e ligjit agrar**

Bashkësia fshatare në epokën bizantine përbënte qelizën kryesore të jetës së shoqërisë shqiptare. Kjo erdhi si pasojë e përqendrimit të ekonomisë në fshat, ku u vendos pjesa më e madhe e popullsisë. Ishte koha kur funksionet e qyteteve ishin reduktuar vetëm në funksione administrative, ushtarake e peshkopate, me ndonjë përjashtim të vogël si Durrësi. Organizimi administrativ kishtar bizantin njohu bashkimet krahinore, që përfshinin disa fshatra dhe përparësi nuk u jepej lidhjeve të gjakut si më parë. Organizimi dhe funksionimi i bashkësive fshatare në Perandorinë Bizantine në fazën e hershme, shek. VII–VIII, është pasqyruar në dokumentin

---

<sup>105</sup> Kanuni I Lekë Dukagjinit, neni 633/6.

<sup>106</sup> Ligji Agrar, neni 66.

<sup>107</sup> Kanuni I Lekë Dukagjinit, neni 633/1,2.

<sup>108</sup> Ligji Agrar, neni 68.

<sup>109</sup> Po aty, neni 69.

<sup>110</sup> Kanuni I Lekë Dukagjinit, neni 716.

juridik të asaj kohe, ligji agrar (*Nomos Georgikos*). Ligji kishte fuqi zbatuese mbi të gjitha territoret ballkanike të Perandorisë Bizantine, duke përfshirë këtu edhe trojet shqiptare. Ai përmbante shumë institucione dhe norma, të cilat u bënë pjesë e së drejtës dokesore shqiptare dhe u përcoll edhe në kohët e mëvonshme.

Nga përmbajtja e këtij ligji kuptohet ngjashmëria që hasim në të drejtën zakonore shqiptare fakt ky që tregon gjendjen e përafërt të marrëdhënieve ekonomike e shoqërore. Nga ky ligj del se në këtë kohë prona e përbashkët, kujria, ishte pakësuar aq shumë, sa ligji e përmend vetëm një herë, kurse prona private, bashtina, ishte forcuar dhe përmendet shumë herë në ligj.<sup>111</sup>

Fshatarët në kohën e daljes së ligjit zotëronin tokat e tyre arë, vreshta, që së bashku me bagëtinë dhe shtëpinë përbënin pasurinë kryesore vetjake të familjes fshatare. Madje, edhe pyjet u përkisnin individëve të veçantë. Këto lloj pronash mund të trashëgoheshin, të shkëmbeheshin, të pjesëtoheshin, të jepeshin me qira, të liheshin peng, madje edhe të shiteshin, por të gjitha këto veprime mund të bëheshin vetëm brenda bashkësisë.

Arbëria mesjetare na jep një tablo të fshatit si një njësi e përkufizuar në hapësirë dhe juridiksion. Njësitë më të pasura në banorë përbënin famulli e njësi kishtare më vete, nga ana tjetër qëndronin bashkësitë më të mëdha fshatare, të quajtura “universitar”, që përfaqësonin interesat e tyre si kolektiv para zotit të vendit. Banorët brenda një fshati kishin status juridik mjaft të ndryshëm.

Në këtë kohë ndërmjet anëtarëve të bashkësisë ishte bërë fiferencimi pasuror dhe dalloheshin këto shtresa: shtresa e parë përbëhej nga pjesëtarët e familjeve të pasura që si rregull e kishin prejardhjen nga aristokracia fisnore, quheshin të plotfuqishmit e fshatit.

Shtresa e dytë përbëhej nga ata që kishin ngastra toke nga fondi i përbashkët i bashkësisë. ”Ligji Agrar” i quan zotër të arave dhe shtresa e tretë përbëhej nga pjesëtarët ebashkësisë që ishin varfëruar dhe kishin humbur ngastrat e tokës, këta quheshin aporë.<sup>112</sup>

Në trajtimet juridike dokumentare i është kushtuar një rëndësi e madhe zonës së ultësirës shkodrane, pasi konsiderohej si zona më e madhe bujqësore e Arbërisë. Bërthama e çdo fshati përbëhej nga kisha, të cilat kudo që ndodheshin kishin ngjashmëri me njëra-tjetrën. Kadastra venedikase ka mangësi në paraqitjen e numrit të banorëve të asaj kohe, pasi janë regjistruar vetëm ata që njiheshin nga sundimtari i vendit. Nga ana tjetër, po t’i referohem një tjetër

---

<sup>111</sup> A.Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f.66.

<sup>112</sup> A.Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f.66



dokumenti të rëndësishëm siç është regjistri tatimor osman për Jugun e Arbërisë nga viti 1431, do të shohim se ky burim është i mangët, pasi nëpunësit osmanë nuk shkonin në zonat e largëta për shkak të trazirave, ndaj u janë referuar të tretëve për të bërë regjistrimet.

Juridiksioni i fshatrave dhe e drejta e tokës në Arbëri paraqitet si një tablo tepër komplekse. Karakterizohen nga tipari i mbishtresimit të marrëdhënieve të vjetra me ato të reja. Arsyeja e kësaj tabloje janë ekzistenca për një kohë të gjatë e elementeve të bashkësisë së vjetër bizantine të fshatit krahas sistemit të pronjës dhe të tokës paraspor deri në mesjetën e vonë. Prona mbi tokën ishte e ndarë midis shumë pronarëve: personat privatë, sundimtari i vendit, komuna qytetare, Kisha dhe bashkësitë fshatare. E veçantë paraqitej bashtina-prona e trashëgueshme private, e cila pavarësisht se ishte blerë apo dhuruar, duhej të figuronte në trashëgiminë e disa brezave brenda një familjeje. Sundimtari i vendit nuk kishte të drejtë të cenonte këtë pronë, vetëm nëse pronari i saj kishte kryer një tradhti të lartë. Kjo lloj prone nuk është regjistruar nga Venediku gjatë kohës së tij. Është e vështirë të gjenden burime të shkruara mbi gjendjen e kësaj prone, pasi duke qenë e karakterit privat nuk figuron në fondet shtetërore të asaj kohe të regjistruara. Sipas Saint-Gullain te Schmitt, *Actes Documents 2, 3*, zbulohen fakte se sipas disa dokumenteve origjinale që i përkisnin kancelarisë venedikase të Arbërisë, kanë qenë dy familje të fuqishme: Malonsi dhe Vulkata, që zotëronin prona të mëdha të trashëgueshme. Dokumenti 2 flet për një pronë që përbëhej nga pylli dhe tokë bujqësore në afërsi të fshatit Dardhë. Dokumenti 3 flet për ndarjen e trashëgimisë së pronës familjare të Vulkatëve. Këta pronarë nuk paguanin detyrime tatimore kundrejt shtetit dhe roli i administratës së Venedikut kufizohej në konfirmimin e marrëdhënieve ekzistuese të pronësisë. Pra, bashtina mbetej jashtë sistemit të pronjës dhe të kryetarëve të fshatit. Në krye të bashkësisë fshatare, që nuk i nënshtrohej pronjës, qëndronte kryetari i fshatit capo (një funksion i trashëgueshëm), i cili ishte mbledhës taksash, administrator, përfaqësonte zotin e vendit dhe kryente porositë e tij.

*Pronja* duhet kuptuar kështu: sundimtari (mbreti, dinastia e Balshajve, republikë e Venedikut) u jep tokë të shtetit, domethënë fusha, vreshta, ose edhe fshatra të tëra një ose disa personave, të cilët në shkëmbim duhet të mbledhin detyrimet dhe të sigurojnë shërbimin në luftë. *Pronja* ekzistonte gjithmonë në krahinë dhe te banorët e saj, ajo nuk zbatohet për një tokë djerre pa fshatarë. Banorët që jetonin në *pronja* kishin detyrimin t'i paguanin sundimtarit dhe pronjarit të holla. Pronjari në aspektin juridik nuk përfitonte ndonjë titull, por në sytë e fshatarëve konsiderohej i barabartë me një fisnikë. Me dhënien e pronjës sundimtari e humbiste ndikimin

politik dhe të ardhurat, dhe për këtë arsye kjo ishte një formë jo e pëlqyeshme për t'u zbatuar. Sundimtarët detyroheshin ta aplikonin këtë zgjidhje vetëm në rastin e mungesës së të hollave. Dokumentet historike japin një tablo të qartë për sistemin e aplikimit të pronjave në pjesën veriore të Arbërisë, kurse për Arbërinë e Mesme nuk ka të dhëna për këtë sistem pronash. Pronia ka patur karakter personal dhe përhapja e saj ka qënë e madhe në shekullin XII. Rëndësia dhe përhapja e saj shumë e madhe duket edhe në faktin se fjala “pronë” në gjuhën shqipe e ka origjinën pikërisht në këtë institutë të së drejtës bizantine.<sup>113</sup>

Në këtë periudhë shfaqet edhe një tjetër formë e aplikimit të së drejtës së pronës mbi tokën bujqësore: *paraspori*. Sipas Bozic-it, ky term nënkupton dhënien e tokës shtetërore personave privatë, ku toka duhet të punohet angari nga fshatarët e fshatit fqinj. Personi i favorizuar u jepte fshatarëve vetëm farën dhe ushqimin. Të gjitha punët e tjera, si mbjellje, korrje, shirje kryheshin nga fshatarët deri në transportimin e të korrave në depot e zotëruesve të parasporit. Shumë pronjarë zotëronin edhe toka paraspor. Pronarët e pronjave dhe ata të parasporeve kishin detyrimin të mbanin lidhje me autoritetet, për këtë arsye si në dokumentet venedikase, ashtu dhe në të tjera ka informacione për gjendjen e këtyre pronave. Ndryshe ndodh me bashtinat, pronat private, për të cilat ka një mangësi burimesh, pasi, duke mos pasur interes, autoritetet e asaj kohe i kanë zhdukur këto të dhëna.

Bujqësia ishte dega kryesore e ekonomisë dhe fshatarësia përbënte grupin e dytë themelorë të shoqërisë feudale. Një pjesë e madhe e të ardhurave të shtetit bizantin sigurohej nga taksat dhe tatimet e fshatarësisë së lirë prandaj u përpoqën që ti mbronin pronat e tyre me akte të posacme normative.<sup>114</sup>

#### **4. Krahasimi i ligjit agrar me të drejtën romake**

E drejta bizantine gjeti zbatim kryesisht në qytetet dhe në zonat fushore, të cilat kaluan nga pushtimi romak në atë bizantin. Gjatë sundimit romak në këto zona vepronte e drejta romake. Perandoria Bizantine e la në fuqi në tokat e sunduara prej saj në Shqipëri dhe jo vetëm kaq por sunduesit bizantinë morën masa për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj të drejte.<sup>115</sup> Themelet e një botë të civilizuar në aspektin legjislativë janë, pa dyshim, meritë e jashtëzakonshme e së

---

<sup>113</sup> A. Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f. 80.

<sup>114</sup> A. Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f. 71.

<sup>115</sup> A. Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f. 73.

drejtës romake. Impakti i saj i ka kaluar si kufijtë gjeografikë, ashtu dhe ata kohorë. Implementimi i sistemeve ligjore u bë duke pasur shtylla bazë parimet e së drejtës Romake. Pa asnjë hezitim ajo mund të quhet *ius commune* për pjesën më të madhe gjeografike të planetit. Madhështia e saj filloi njëkohësisht me madhësinë e Perandorisë Romake dhe u zbatua kudo që valëvitej flamuri i kësaj Perandorie. Ndarja e mëvonshme e Perandorisë dhe spostimi i qendrës nga Roma në Konstandinopjë bënë që të merrej si trashëgimi edhe e drejta romake për t'iu përshtatur Bizantit që po lindte. Edhe pse u bënë përpjekje për në këtë drejtim, e drejta e mëvonshme bizantine nuk pati ndikim të drejtpërdrejtë tek *ius commune* në Europën Perëndimore, ajo ka shërbyer vetëm për efekt studimi të së drejtës romake. Shkenca ligjore bizantine hyri në histori në saje të përpjekjeve e të Justinianit me të famshmin “*Corpus juris civilis*”. Përpjekjet serioze të tij avancuan akoma me krijimin e shkollave juridike në gjithë Perandorinë e Lindjes, ku u përpunua një kulturë e mirëfilltë ligjore. Këto shkolla kishin si qëllim kryesor të zotëronin shumë mirë kodifikimet e Justinianit. Meqenëse dominonte kultura dhe gjuha greke, u bënë përpjekje për të nxjerrë udhëzime praktike për të zbatuar lehtësisht kodet e tij. E tillë ishte “*Përmbledhja e ligjeve*”. Vdekja e Justinianit solli edhe shkatërrimin e shkencës ligjore, e cila vazhdoi deri në shekullin e 9-të, kur filloi të tregohet përsëri interes për kodet e Justinianit. Kjo periudhë shënoi kulmin e saj me hartimin e “Bazilikave”, të njohura ndryshe si “*librat perandorakë*”, të filluar nga perandori Bazili I dhe të përfunduar nga Leon i Urti. Në vetvete ky ishte një punim që solli kodifikimin e Justinianit në një formë më të re, më të sistemuar, duke eliminuar ligjet e vjetruara dhe duke e bërë më të thjeshtë në zbatim.

Duke e vlerësuar ligjin agrar si një pjesë të rëndësishme të legjislacionit bizantin dhe këtë të fundit si një trashëgimi të së drejtës romake, nga analiza krahasuese e tij me këtë të drejtë kemi vërejtur ngjashmëri në shumë koncepte dhe rregullime juridike. Ngjashmëritë janë kryesisht në fushën civile, ato që u referohen marrëdhënieve të pronësisë, detyrimet kontraktuale. Kështu, neni 1 i ligjit agrar parashikon: “*Bujku që punon arën e vet duhet të jetë i drejtë dhe të mos përvetësojë hullitë e fqinjit. Në qoftë se shkel kufijtë dhe përvetëson ose zvogëlon pjesën që gjendet shumë afër tij, në qoftë se këtë e bënë në lërimin e parë të tokës djerre, e humbet lërimin e saj; në qoftë se këtë shkelje e ka bërë në kohën e mbjelljes, bujku shkelës humbet farën edhe mbjelljen e parë si dhe prodhimin.*”<sup>116</sup> Ky nen ka sanksionuar parimin se toka është e shenjtë dhe nuk mund të preken kufijtë e saj. Ky është një parim që buron direkt nga e drejta romake. Sipas

---

<sup>116</sup> Ligji Agrar, neni 1.

saj, pronat fqinje me njëra-tjetrën duhej të kishin një hapësirë të lirë të llogaritur me këmbë (pesë këmbë = 152,4 cm), e cila për asnjë arsye nuk duhej të prekej. E drejta romake kishte rregulluar në mënyrë të hollësishme marrëdhëniet e fqinjësisë në toka për të eliminuar çdo lloj mosmarrëveshjeje mes tyre. Një nga këto rregulla ishte edhe përcaktimi për degët e zgjatura të pemës, situatë juridike kjo e parashikuar shprehimisht në nenin 31 të ligjit agrar, që thotë: *“Në qoftë se një pemë gjendet në një vend dhe ara e punuar apo parcela që gjendet pranë është kopër shembullte dhe mbulohet nga hija e pemës që është pranë, i zoti i saj t’i presë degët, në qoftë se nuk është kopër shembullte, të mos priten degët.”*<sup>117</sup>

E drejta romake i kushtonte rëndësi edhe kufizimit të prishjes së shtëpive, parashikim që në ligjin agrar shoqërohet me sanksion ndëshkimor të rëndë. Konkretisht neni 66 i ligjit parashikon: *“Atyre që shkatërrojnë shtëpi të huaja në mënyrë arbitrare ose prishin gardhet që të gardhojnë ose ndërtojnë të tilla në të vetat, t’u priten duart.”*<sup>118</sup>

E drejta romake parashikonte se, nëse një pronar i një ngastre toke pësonte një dëm si pasojë e një ndërtimi në një tokë ngjitur, ndërhynte pretori për të ndaluar punimin e ri. Në ligjin agrar për këtë thuhet *“Në qoftë se një bujk ndërton një shtëpi dhe mbjellë një vresht në një arë ose vend të huaj dhe pas një kohe vijnë të zotët e vendit, nuk lejohen që ata të shkatërrojnë shtëpinë dhe të shkulin vreshtat, por kanë të drejtë të marrin një vend të barabartë. Në qoftë se bujku që ka ndërtuar dhe ka mbjellë në arën e huaj nuk pranon që të japë vend të barabartë, i zoti i vendit ka të drejtë të shkullë vreshtin dhe shtëpinë ta shkatërrojë.”*

E drejta romake parashikonte rregulla të qarta ndaj atyre personave që në mënyrë të fshehtë ose forcërisht bënin punime në pronën e dikujt tjetër, duke i shkaktuar këtij të fundit një dëm. Me punime në tokën e huaj kuptohej prerja e pemëve, plugimi, gërmimi, prishja e ndërtimeve të vjetra etj. Për këtë në nenin 2 të ligjit agrar është parashikuar: *“Në qoftë se një bujk lëron tokën djerre dhe e mbjellë pa njoftuar të zotin e saj, të mos marrë as shpërblimin për lërimin, as prodhimin nga të mbjellat dhe as farën që harxhoi.”*<sup>119</sup> Pra, jemi para së njëjtës situatë juridike që ka parashikuar edhe e drejta romake: punimi i një toke të huaj, plugimi ose mbjellja, dhe pasoja është që personi që kryen këtë veprim jo vetën nuk do të marrë asnjë përfitim, por edhe harxhin nuk do ta marrë. Gjithashtu neni 9 i ligjit parashikon: *“Në qoftë se një mortitë (qiramarrës) korr dhe mban duajt e prodhimit pa dijeninë e të zotit të tokës, të privohet si hajdut*

---

<sup>117</sup> Po aty, neni 31.

<sup>118</sup> Po aty, neni 66.

<sup>119</sup> Ligji Agrar, neni 2.

*nga i gjithë prodhimi i tij.*<sup>120</sup> Pra, kemi përsëri cenim të tokës së pronarit nga veprime apo punime pa dijeninë e tij. Një parashikim tjetër interesant, por që nuk ka pasoja të dëmshme, është ai i nenit 17 të ligjit, që thotë: *“Në qoftë se një bujk punon një tokë të pyllëzuar të një bujku tjetër, të përfitojë tre vjet prodhimin e saj dhe arën t’ia kthejë prapë të zotit të saj.”*<sup>121</sup> Ndoshta legjislatori nuk ka parashikuar dënime në këtë rast, pasi jemi para shfrytëzimit të një toke të pyllëzuar dhe jo bujqësore, pra nuk i është shkaktuar ndonjë dëm pronarit të tokës. Ndryshe paraqitet situata në nenin 20 të ligjit, që parashikon: *“Ai që pret pyllin e huaj pa dijeninë e të zotit të tij dhe e punon a e mbjellë tokën, të mos marrë asgjë nga prodhimi.”*<sup>122</sup> Ndryshe nga neni 17, neni 20 ka sanksion, pasi personi i huaji e ka dëmtuar pronën private të dikujt me qëllimin e vetëm për të kryer punime në të.

Kufizime në lidhje me pronën private e drejta romake kishte parashikuar edhe të atij llojit që kryheshin nga vetë pronarët nëpërmjet kontratave apo krijimit të servituteve të ndryshme apo uzukfrukteve. Këto lloj marrëveshjesh i gjejmë të parashikuara në nenet 11, 12, 13, 14 dhe 15 të ligjit.

Konkretisht në nenin 11 thuhet: *“Në qoftë se dikush do të marrë tokë nga një bujk i varfëruar dhe do të merret vesh vetëm për të shfrytëzuar tokën e papunuar dhe për të ndarë të korrat, le t’i qëndrojnë marrëveshjes.”*<sup>123</sup>

Ligji agrar në nenin 84 parashikon edhe servitutin për kalimin e ujit. Në të thuhet: *“Në qoftë se të zotët e arave nuk duan që uji të kalojë përmes arave të tyre, le të kenë të drejtë për këtë.”*<sup>124</sup>

Në të drejtën romake kjo e drejtë njihet me emrin *“aquae ductus”*, që do të thotë *“e drejta për të bërë kanalizime uji përmes tokës së dikujt”* dhe klasifikohet si servituti rural. Gjithashtu ligji përmban të trashëguar nga e drejta romake edhe uzufruktin, që është e drejta e përdorimit të pronës së tjetrit dhe marrja e prodhimit të saj pa e cenuar tokën si pasuri. Për shembull, në nenin 67 është parashikuar e drejta për të marrë me fajde pronën e dikujt tjetër dhe për të marrë prodhimin e saj. Edhe neni 16 ka parashikuar të drejtën për të marrë përsipër mbjelljen e një vreshti ose are, pasi ka bërë paraprakisht një marrëveshje me pronarin e tokës. Ligji ka futur dhe konceptin e gjysmatarit, domethënë një person punon arën e dikujt tjetër dhe prodhimin e ndanë përgjysmë me pronarin e tokës.

---

<sup>120</sup> Po aty, neni 9.

<sup>121</sup> Po aty, neni 17.

<sup>122</sup> Po aty, neni 20.

<sup>123</sup> Ligji Agrar, neni 11.

<sup>124</sup> Po aty, neni 84.

Krahasimi do të bëhet edhe për deliktet e kryera ndaj subjekteve të ndryshme<sup>125</sup>. Ky botim flet për kryerjen e veprës penal të vrasjes ndaj skllëvërve dhe ndaj kafshëve, ku përfshiheshin delet, dhitë, kuajt, gjedhët, derrat. Për këtë vepër penale në të drejtën romake ishte parashikuar dëmshpërblimi në të holla i barabartë me vlerën më të madhe që ka arritur prona në vitin paraardhës. Sanksioni këtu është i njëjtë si te ligji agrar, pra kemi dëmshpërblim të dëmit, por ndryshon masa që duhet të shpërblehet, për shembull në nenin 54 thuhet: *“Në qoftë se dikush mbyll një derr ose një qen dhe e vret, ta shpërblejë në vlerë të dyfishtë.”*<sup>126</sup>

Tek e drejta romake gjejmë dispozita që parashikojnë veprën penale të shkatërrimit të pronës me anë të djegies, thyerjes apo prishjes së saj, vepër kjo që parashikohet edhe në ligjin agrar: *“Nëse dikush i bën dëm dikujt tjetër duke i djegur, duke i thyer ose prishur pronën padrejtësisht, të dënohet duke paguar pronarin me cilindo vlerë që do të provohet se vlen në tridhjetëditëshin që do të pasojë.”*<sup>127</sup> Pra, ka parashikuar pronën në përgjithësi pa e specifikuar atë, detaj ky që gjendet në dispozita të ndryshme të ligjit agrar, si në nenet e mëposhtme:

Neni 57: *“Ai që e djeg malin e huaj ose pret dru në pyllin e huaj dënohet me dyfishin.”*<sup>128</sup>

Neni 58: *“Ai që djeg gardhin e vreshtit, të rrihet, t’i damkoset dora, por edhe të paguajë dyfish dëmin.”*<sup>129</sup>

Neni 59: *“Atij që pret hardhitë e huaja në prodhim ose i shkul, t’i priten duart dhe të gjobitet.”*<sup>130</sup>

Neni 64: *“Ata që vënë zjarr në lëmin ose në kavaletën e grurit për hakmarrje kundrejt armiqve të tyre, le të digjen në zjarr.”*<sup>131</sup>

Neni 65: *“Atyre që vënë zjarr në kasollen e bariut ose të bujkut t’u priten duart.”*<sup>132</sup>

Neni 66: *“Atyre që shkatërrojnë shtëpi të huaja në mënyrë arbitrare ose prishin gardhet që të gardhojnë ose ndërtojnë në të vetat, t’u priten duart.”*<sup>133</sup>

Ligji agrar ka parashikuar sanksione të rënda, si për shembull dëmtime trupore, që aplikoheshin krahas shpërblimit të dëmit në të holla.

---

<sup>125</sup> Gaius, Provincial Edict, book 7.

<sup>126</sup> Ligji Agrar, neni 54.

<sup>127</sup> Ulpian Edict, book, 18.

<sup>128</sup> Ligji Agrar, neni 57.

<sup>129</sup> Po aty, neni 58.

<sup>130</sup> Po aty, neni 59.

<sup>131</sup> Po aty, neni 64.

<sup>132</sup> Po aty, neni 65.

<sup>133</sup> Po aty, neni 66.

Një vepër penale shumë e njohur është vjedhja, sanksionet për të cilën janë parashikuar në disa dispozita të ligjit agrar. Për shembull, në nenin 62 thuhet: *“Ata që vjedhin parmendë, plor, zgjedhë e të tjera, të gjobiten me 12 follë në ditë duke llogaritur nga dita e kryerjes së vjedhjes.”*<sup>134</sup> Ndërsa në nenin 68: *“Ai që gjendet në hambar duke vjedhur grurë të rrihet me kamxhik, herën e parë me 100 të harruara dhe t’i paguajë dëmin të zotit. Në qoftë se do të kapet përsëri, të gjobitet në sasi të dyfishtë të asaj që ka vjedhur.”*<sup>135</sup>

## **KAPITULLI IV**

### **Reflektimi i legjislacionit bizantin në të drejtën dokesore shqiptare**

#### **1. Nocioni i së drejtës zakonore, lindja e saj**

Referuar pozicionit gjeografik, Shqipëria, edhe pse e izoluar, ka qenë gjithmonë në udhëkryqin e perandorive dhe të qytetërimeve. Në lashtësi për shekuj me radhë ajo është gjendur në kufirin politik, ushtarak dhe kulturor ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, në fillim midis Perandorisë Romake dhe qytetërimit grek e më pas, në mesjetë, midis Italisë katolike dhe Perandorisë së Poshtme ortodokse. Më tej deri në pushtimin e plotë nga Turqit ajo gjendej në frontin midis Europës kristiane dhe Lindjen islamike.

Historia e çdo kombi është një tablo e përzierjes së elementeve sociale, ekonomike, politike dhe ligjore. Gërshetimi i këtyre elementeve përkufizon ato që ne i quajmë “etapa historike”, të cilat hedhin dritë mbi ecurinë tonë në kohë, zhvillimin dhe përsosjen, risitë dhe gjurmët e së shkuarës. Çdo rend shoqëror për rregullimin e marrëdhënieve njerëzore ka nevojë për një kuadër ligjor, i cili kushtëzohet nga faktorët socialë, ekonomikë dhe politikë. Lindja dhe sundimi i një marrëdhënie të caktuar ekonomike kërkon detyrimisht edhe përcaktimet ligjore. Këto përcaktime karakterizohen kryesisht nga elemente autoktone, por dhe nga elemente të huaja, që mbarten nga pushtimet në kohë të ndryshme.

Shqipëria ndër elementet e saj të rëndësishme të trashëgimisë kulturore ruan edhe të drejtën zakonore, një krijim i vetë popullit në shekuj. Nuk ka autorësi të veçantë kjo vepër

---

<sup>134</sup> *Po aty, neni 62.*

<sup>135</sup> *Ligji Agrar, neni 68.*

mbarëpopullore, ajo përfaqëson një tablo në të cilën marrin pjesë të gjitha ngjyrat krahinore, duke u zbehur e duke u forcuar nga faktorë socialë, ekonomikë dhe politikë. Krijimi i saj ishte një domosdoshmëri njerëzore, buroi nga vetë shpirti i popullit, që kishte si qëllim unikal ruajtjen e identitetit të kombit. Ky ishte një mision i vështirë, me një shtrirje kohore shekullore, që u përmbush me sukses nga mençuria e vetë kombit, që e trashëgoi atë brez pas brezi. Të aplikonte, të respektonte dhe të riprodhonte normat zakonore për shqiptarin do të thoshte të respektonte shtetin, edhe pse ai nuk ekzistonte në formën juridike që duhej. Termi “*e drejtë zakonore*” shpeshherë njësohet me termin “*e drejtë kanunore*”, duke e gjetur prejardhjen e termit “kanun” në traditën greko-bizantine. Konkretisht termi “nomokanon” kuptohej si normat juridike fetare që nxirrnin perandorët bizantinë. Më vonë gjuha turke e shndërroi në “kanunname”, domethënë norma juridike që nxirrte sulltani. Po t’i qëndrojmë strikt kuptimit, fillimisht vetë fjala “kanun” kishte kuptimin e një norme të vetme, më vonë me këtë term u kuptua një tërësi normash apo *corpus juris* i pashkruar, që i përkiste popullit.

Analiza e plotë e kësaj të drejte do të realizohet vetëm duke marrë në konsideratë kushtet ekonomike, shoqërore dhe politike të krahinave ku kjo e drejtë ka vepruar. Shumë dukuri që i referohen historisë dhe së drejtës dalin në pah nga analiza e normave juridike të së drejtës zakonore, të ndërvarura këto nga zhvillimi ekonomik-shoqëror i krahinave përkatëse. Duke qenë një e drejtë që ka lindur në një kohë të caktuar të zhvillimit historik dhe pasqyron kushtet materiale të jetës së njerëzve, ajo ecën përkrah zhvillimit të nocionit të pronës, duke dhënë vazhdimisht fakte për diferencimin e qartë e në proces të shoqërisë së kohës nga pikëpamja ekonomike. Te normat e kësaj të drejte gjejmë të pasqyruar periudhën e kalimit nga rendi patriarkal fisnor në atë patriarkal feudal, duke ruajtur elemente edhe të rendit të ri dhe atij të vjetër. Edhe pse kjo e drejtë është përndjekur nga faktori i huaj dhe njëkohësisht nga ndryshimet lokale, ajo karakterizohet nga tipare të përbashkëta, duke dhënë në këtë mënyrë një provë të pakontestueshme për tiparin e saj kombëtar dhe karakterin mbarëshqiptar.

Origjina e së drejtës zakonore shqiptare daton që nga koha e ilirëve. Ky fakt del qartë nga institutet juridike që ajo përmban, të cilat i përkasin saj periudhe të lashtë. Si një formë e së drejtës që ka vepruar në mungesë të shtetit, ajo ka treguar se ia ka arritur qëllimit për vetëqeverisje dhe me daljen e shtetit në skenën historike ajo i është bashkuar të drejtës shtetërore, ka bashkëjetuar me atë në simbiozë, një pjesë e saj u bë element përbërës i së drejtës shtetërore, ndërsa pjesa tjetër vazhdoi të vepronte në mënyrë të pavarur.



Periudha të ndryshme të sundimit të huaj kanë treguar forma të ndryshme të veprimit të kësaj të drejte, një veprim me një intensitet të fuqishëm në kohën e pushtimit osman, si një thirrje për mbijetesë të trevave shqiptare me rilindjen e formave të lashta të organizimit fisnor. E veçanta e saj qëndron në faktin se tek ajo gjejmë të pasqyruar të gjitha etapat historike që kanë shoqëruar vendin tonë që nga lindja e saj e deri në kohën kur ajo u dobësua në zbatim (shek. i 20-të).

Analistë të ndryshëm apo historianë e juristë në shkrimet e tyre për këtë drejtë shpesh kanë përdorur termin “kushtetuta shqiptare”. A mundet historia e shtetit të së drejtës t’ia atribuojë këtë term së drejtës zakonore shqiptare? Pa dyshim që kjo e drejtë është një sistem i plotë juridik, ku përfshihen të gjitha degët e së drejtës, norma civile, penale, familjare, procedurale, që shtrihen në rregullimin e të gjitha marrëdhënieve ekonomike e shoqërore të kohëve të ndryshme. Pra, ajo përbënte një *corpus juris* që kishte parashikuar rregullimin e çdo situatë që buronte nga zhvillimi i marrëdhënieve mes njerëzve të shoqërisë që ajo i përkiste. Në analizën që do t’u kushtojmë burimeve të kësaj të drejte, si statutet apo kanunet në zona të ndryshme të Shqipërisë, do të shohim se si janë përcaktuar juridikisht normat e karakterit civil, që kryesisht shtriheshin në rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë, duke parashikuar çdo formë të tjetërsimit të saj. Nga ana tjetër, kemi norma të karakterit penal, që mund t’i ndajmë në norma të pjesës së përgjithshme dhe ato të pjesës së posaçme.

Është parashikuar koncepti i veprës penale, që i paraprin mbrojtjes së marrëdhënieve shoqërore; është parashikuar faji në dy format e tij: me dashje dhe nga pakujdesia; bashkëpunimi si koncept, përgatitja dhe tentative. E veçantë është parashikimi i dënimit, çka shpreh qartë karakterin klasor të së drejtës zakonore shqiptare. E veçantë është mënyra se si do të aplikoheshin këto norma, meqenëse mungonte forca shtrënguese e shtetit. Kjo e drejtë kishte gjetur format e saj shtrënguese të zbatimit, të cilat ishin forma kolektive, si p.sh.: kuvendet, gjyqi i pleqve, forca e opinionit publik apo individual dhe gjakmarrja. Në pjesën e posaçme janë trajtuar shumë lloje krimesh kundër personit, si: vrasja, plagosja, fyerja, rrahja etj. Këtu vihet re se parashikimi i llojeve të veprave penale është ndikuar nga e drejta kanonike, meqenëse ajo luante një rol të rëndësishëm në shoqërinë mesjetare e feudale. Duhet pranuar se e drejta kanonike ka ushtruar vazhdimisht presion mbi të drejtën zakonore shqiptare, por nuk arriti asnjëherë të shkrihej me të. Me interes është parashikimi në kanune i veprave penale që drejtohen kundër pronës private, si vjedhja, shkatërrimi i pasurisë së tjetrit etj. Kanunet në parashikimin e tyre kanë pasur parasysh diferencimin ekonomik e shoqëror të zonave të ndryshme, pra nëse ishin zona malore apo

fushore, pasi në malësi ruhej për një kohë të gjatë prona e përbashkët mbi tokën, kurse në zonat e ulëta u zhvillua ajo private. Kjo tregon edhe një herë se e drejta zakonore karakterizohej nga diversiteti, pasi kanunet e ndryshme kanë pasqyruar veçori lokale, çka e bënin këtë të drejtë tepër të larmishme.

Në të gjitha burimet e së drejtës zakonore shqiptare të bie në sy ekzistenca e parimeve themelore mbi të cilat janë mbështetur të gjitha normat kanunore të çdo krahine shqiptare, tipar ky i unitetit të saj. Ndër parimet themelore që gjejmë është ai i *besës* ose *fjalës së dhënë*, e cila zbatohet për gjithë popullsinë dhe kishte rëndësinë e një institucioni juridik për njerëzit (parashikohej lloji i besës, rastet kur jepej besa, kujt i jepej ajo), ndaj dhe përgjegjësia për shkeljen e saj ishte një nga më të rëndat sipas kanunit.

Një parim tjetër ishte *nderi vetjak*, i përcaktuar sipas kanunit në dy forma: *vetjak* dhe *shoqëror*. Mund të themi se lindjen e këtij parimi e kërkoi vetë shoqëria shqiptare: një shoqëri e mbyllur, me një krenari të lartë.

Kemi parimin e *barazisë së njerëzve nga gjaku*, sipas të cilit të gjithë njerëzit trajtoheshin nga normat kanunore si të barabartë. Është një parim që tregon origjinën e hershme të normave tona kanunore, pasi barazia para ligjit lidhet me të drejtat e njeriut. Parimi i *mikpritjes*, i pranishëm tek të gjitha kanunet, tregon se miku kishte një vend të rëndësishëm në kanun, ai respektohej në një mënyrë që nuk mund të gjendej në asnjë vend tjetër ballkanik, një figurë gati e shenjtë.

Nga studimi i kësaj të drejte lind pyetja: si duhet të trajtohet sistemi juridik shqiptar në fillimet e tij, si e drejtë zakonore shqiptare, apo si e drejtë kanunore? Referuar autorëve të huaj që janë marrë me studimin e saj, flitet për doke dhe zakone juridike shqiptare.

Në rastin kur e drejta trajtohet si një grumbull dokesh e zakonesh, kthehet në lëndë shqyrtimi etnografik, ndërsa si një e drejtë zakonore apo kanunore kryesisht është marrë historiografia dhe mund të themi se në mënyrë sipërfaqësore ajo është trajtuar nga lënda e së drejtës. Ka pasur ide se trajtimi i së drejtës thjesht si e drejtë zakonore është bërë vetëm për shkak se nuk gjendet e shkruar, mendime këto që nuk kanë bazë logjike, po t'i referohemi faktit se këto marrin atributet e ligjeve<sup>136</sup>. Përcaktimi i së drejtës si një e tillë është çështje interpretimi dhe këndvështrimi subjektiv, pasi:

---

<sup>136</sup>. *Dokumentet e Hamurabit në Babiloni, të Manusë në Indi, të Drakonit në Greqi, të 12 tabelave në Romë.*

*Së pari.* Karakteristikë e ligjeve të shkruara të lashtësisë, madje edhe në kohët e mëvonshme, është burimi prej nga dalin, që do të thotë se janë ligje të diktuar nga lloji i organizimit shoqëror. Ato janë ligje sundimtarësh dhe, si të tilla, detyrimisht duhet të shkruhen për efekt të njohjes dhe zbatimit nga nënshtetasit e tyre. Ndërsa ligjet që burojnë nga vetë shoqëria e organizuar në mënyrë demokratike, konceptohen si vetëdija juridike e saj.

*Së dyti.* Zbulimet e fundit kanë treguar se e drejta shqiptare nuk mund të thuhet se ka qenë e pashkruar. Prova më e qartë për këtë është dalja në dritë e statuteve të qyteteve shqiptare, që çon në konkluzionin se nuk ka mundësi që ai mendim i thellë juridik që shprehet në normat zakonore të malësive të mos jetë shkruar dikur e diku. Mosgjetyja e deritanishme nuk parathotë medoemos mosekzistencën e tyre.

Vlen të përmendet fakti se sot të drejta të tilla si ajo romake, bizantine, osmane apo sllave studiohen pa cilësorin “zakonor”. Ndryshe paraqitet situata tek e drejta shqiptare; ajo bën përjashtim, dhe ky fakt ndikon jo pozitivisht tek ajo, pasi e ul në nivelin studimor, sepse nuk pranohet si sistem. Shqyrtimi dhe analiza e së drejtës shqiptare duhet të bëhet duke e krahasuar me të drejtat e tjera, por duke eliminuar ndërkohë qëndrimin anatemues të penaliteteve të saj, të cilat duhen parë si elemente integrale brenda sistemit juridik dhe jo si përfaqësim apo mishërim të tij. Në anën formale me vend mund të ngriheshin argumentet se e drejta shqiptare nuk ka një kohë të përcaktuar krijimi, nuk njihen përpiluesit e saj, i mungon kohezioni dhe sistematika juridike, ka një juridiksion të kufizuar dhe se pasqyrohet e shkruar dhe e paplotë vetëm në shek e 20-të nën emërtesën “Kanuni i Lekë Dukagjinit”<sup>137</sup>. Mbi kohën e krijimit ka pasur shumë hipoteza për vetë faktin se kjo e drejtë nuk i atribuohet ndonjë emri sundimtari të përcaktuar në kohë veprimi. Ndërkaq vetë mungesa e një studimi të thellë të karakterit të kësaj të drejte, të frymës që e përshkon, elementeve përkues në kohë të caktuara organizimi shoqëror apo piketash historike, nuk e mundëson përafrimin e saj me ndonjë kohë krijimi. Megjithatë, ky konstatim nuk e zhvesh atë nga natyra e një sistemi juridik. Përmes deduksionesh arrijmë në konkluzionin se krijimi i saj daton në lashtësi, duke pasur parasysh këtu edhe faktin se elementet tiparizuese që pasqyrohen dhe vijnë organikisht në të deri në ditët tona i gjejmë në burime tepër të hershme historike, për shembull në dokumentin epigrafik që flet për lidhjen e molosëve, tek Apiani, kur rrëfen për marrëdhëniet e Teutës me Romën. Nga krahasimi i kësaj të drejte me atë gjermanike,

---

137. Kasteleti Xh, *Normat e se drejtës zakonore shqiptare*. f.12-13.

kuptohet se zanafilla e së drejtës shqiptare daton së paku në kohët para shekullit të katërt të erës sonë<sup>138</sup>.

Fakti që së drejtës shqiptare të hershme i ka munguar sistematika, nuk i heq thelbin, por dëshmon vetëm për kushtet dhe rrethanat në të cilat ajo është përcjellë deri në ditët tona nën ndikimin e shumë faktorëve historikë e natyrorë. Nga të dhënat e deritanishme përpjekjet për një kodifikim të saj shkojnë në gjysmën e dytë të shekullit të 19-të me projektin e ligjit turk mbi kodifikimin e së drejtës zakonore shqiptare, pa folur këtu për lëndën që kanë sjellë albanologë të ndryshëm edhe më herët, pa pretendimin për një kodifikim. Në vitet 1913–1929 at Shtjefën Gjeçovi mbodhi dhe botoi normat e Kanunit të Lekë Dukagjinit, por nuk e përfundoi këtë iniciativë me rëndësi historike, pasi u vra nga serbët. Vepra e tij u botuar në vitin 1933. Në parathënien e at Fishtës për botimin e përmbledhjes së Gjeçovit flitet për rëndësinë e folklorit dhe të mbledhjes se dokeve<sup>139</sup>.

## 2. Gjurmet e ligjit bizantin në kanunet dhe statutet e qyteteve shqiptare

Për shkak të sundimit shumëshekullor romako-bizantin , në Arbëri veproi për një kohë të gjatë e drejta bizantine, një e drejtë romake e përpunuar në kohën e perandorit Justinian, e përshtatur sipas kushteve të reja të feudalizmit .Krahas kësaj , gjatë gjithë periudhës së sundimit bizantin, veproi fuqishëm , sidomos në zonat malore, e drejta zakonore vendase.<sup>140</sup>

Në trojet feudale bizantine , në Shqipëri ka qënë në fuqi një e drejtë zakonore, një e drejtë popullore me tipare arkaike interesante , që nuk i njehte e drejta bizantine ose që ishte në kundërshtim me të.<sup>141</sup>

Pas shkëputjes nga Perandoria Bizantine klasa feudale arbëreshe nuk e pa të nevojshme krijimin e një të drejte të re, por pranoi të drejtën bizantine dhe e përdori atë për interesat e saj.Kështu shteti feudal i Arbërisë , duke qënë i njëjtë një thelb me Perandorinë e Bizantit, u mjaftua me sanksionimin e normave juridike të së drejtës bizantine, të njohura e të zbuluara gjerësisht deri atëherë në botën ballkanike.<sup>142</sup>

---

138. G.Castelleti.*Çonsuetudin, vep. cit. f. 153–160.*

139. Sh. Gjecovi, *Kanuni i Lekë Dukagjinit, Tiranë, 1993, f. 5.*

<sup>140</sup> A.Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, f.109.*

<sup>141</sup> A.Buda. *Vendi i Shqipërisë në Historinë Evropiane të shek.VIII-XVIII, Rev.Studimet Historike, Nr.1/1967;fq.7*

<sup>142</sup> A.Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri, f.110.*

E drejta Bizantine e pranuar dhe e sanksionuar vazhdoi të vepronte gjerësisht në Arbëri në rregullimin e marrëdhënieve juridike jo vetëm në Principatën e Arbërisë (shek XII-XIII), por edhe më vonë, deri në shek. XV. Megjithatë e drejta bizantine shërbeu për një kohë të gjatë si lëndë e parë për krijimin e së drejtës pozitive në Arbëri, me kalimin e kohës largimi nga parimet e saj filloi të bëhej gjithmonë e më i dukshëm. Një largim i tillë nga parimet tradicionale të së drejtës lindore bizantine apo perëndimore romake si dhe një ndikim të fuqishëm të së drejtës zakonore vendase mbi të drejtën pozitive e shohim në principatat feudale shqiptare të shek.XIV-XV.<sup>143</sup>

Arbëria mesjetare karakterizohej nga dy lloje qytetesh: ato dalmate dhe ato bizantine, që pasqyrojnë një zhvillim të ndryshëm të botës latine dhe asaj greke pas shpërbërjes së Perandorisë Romake. Një histori kushtetuese, dëshmi e vërtetë e këtij ndikimi të dyfishtë, paraqet Durrësi, si një vend kufi midis këtyre dy botëve të ndryshme. Qytetet arbërore bizantine karakterizoheshin nga një autonomi e pjesshme, me autoritete vendase mbi bazën e një sistemi juridik pjesërisht vetjak.

Arbëria Jugore dhe ajo e Mesme, përfshirë këtu Krujën dhe Durrësin, karakterizoheshin nga tipi qytetar bizantin, i cili karakterizohej nga mungesa e një kushtetute qytetare (statutet) dhe e autoriteteve komunale vetjake, nga mungesa e një statuti të veçantë brendapërbrenda shtetit bizantin, madje edhe të një shtrese të lartë, e cila në aspektin juridik përbente këshillin. Qyteti bizantin nuk ka një organizim si komunë dhe të gjithë banorët e tij, sipas kodit zakonor romak, janë të barabartë para gjykatave, pavarësisht shtresës që i përkisnin. Qyteti bizantin shërbente si rezidencë e një mëkëmbësi të emëruar nga zoti i vendit, i cili quhej *kefale*<sup>144</sup>. Roli i tij ishte kufizimi i çdo lloj vetadministrimi. Mungesa e autonomisë qytetare çoi në lulëzimin e kishave, përfaqësuesit e të cilave arritën një pozicion të rëndësishëm si ndërmjetës midis popullsisë dhe pushtetit laik.

Krejt ndryshe paraqitet situata në qytetet dalmate. Në këto qytete ekzistonte një kushtetutë qytetare e zhvilluar, e cila parashikonte bashkëveprimin në kuadrin e një komune qytetare (*civitas*) midis priorit si përfaqësues i pushtetit dhe ipeshkvit si figurë e Kishës.

Statutet ishin akte normative që rregullonin jetën e brendshme të qyteteve shqiptare në mesjetë dhe burimi kryesor i së drejtës së tyre. Krijimi i statuteve si kushtetuta qytetare është realizuar

---

<sup>143</sup> A.Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f.111.

<sup>144</sup>. AD II 292;391.

nëpërmjet një procesi gradual e të vazhdueshëm. Si fillim, për krijimin e statuteve shërbyen krisovulat e perandorëve bizantinë, të konfirmuara më vonë nga mbretërit anzhuinë. Ata i pajisën qytetet dhe qytetarët e Arbërisë me privilegje dhe me imunitete të caktuara për tu tërhequr në politikën e tyre centraliste. Këto privilegje krijuan një farë tradite në rregullimin e marrëdhënieve juridike, e cila, me kalimin e kohës, u konsolidua edhe gjatë shek. XIV e bënte përpjekje për kodifikimin e saj në formën e statuteve. Në krijimin e statuteve ka ndikuar e drejta bizantine, e cila shërbente si model për zgjidhjen e problemeve juridike.<sup>145</sup>

Qytetarët gëzonin të drejta të plota dhe liri vetjake dhe organizoheshin në asamble. Veriu i Arbërisë, që në vitin 1200 ndodhej nën sundimin e mbretërisë serbe, nuk u prek në zhvillimin e vet drejt komunave me kushtetutë të kristalizuar, me këshilla dhe autoritete.

Komuna përbëhej nga banorë me të drejta të plota qytetarie. Për shembull, përfshirja në të drejtën qytetare në Shkodër ishte shumë e lehtë, ftoheshin nënshtetas të mbretit serb, fisnikë si dhe njerëz të zakonshëm, të cilët bëheshin qytetarë të *franco et libero*<sup>146</sup>. Krahas qytetarëve me të drejta të plota në komuna jetonin edhe banorët e rrethinave pa të drejta politike. Juridiksioni në qytete zbatohet nga gjykatësit sipas së drejtës zakonore lokale dhe nga shekulli i 13-të u përcaktuan me shkrim në statute sipas shembullit italian dhe në ndikimin e noterëve italianë parimet themelore juridike të trashëguara gojarisht si dhe të drejtat dhe detyrat e komunave qytetare kundrejt shtetit territorial<sup>147</sup>. Qytetet relativisht të varfra në Arbërinë e Veriut në shekullin e 13-të ishin më pak të hapura ndaj ndikimit italian sesa komunat e Dalmacisë, ku nuk vepronin në mënyrë të tërthortë as Bizanti dhe as Serbia. Forcimi i *tregtisë venedikase dhe kryesisht asaj raguziane dhe shfaqja e noterëve italianë*<sup>148</sup> në shekullin e 14-të e nxiti depërtimin e ideve të reja kushtetuese edhe në Arbërinë Veriore. Nga statutet dalmate ishte kodi i Raguzës ai që ushtronte një ndikim të fortë mbi Arbërinë, për shkak të veprimtarisë tregtare të raguzianëve në Ballkan. Edhe kodi ligjor i carit serb Dushan, Zakoniku, ushtroi ndikim e vet<sup>149</sup>.

Pra, lindja e statuteve të Arbërisë Veriore përshkoi një proces të gjatë, që u ndikua nga zhvillimet italiane, nga lidhja me të drejtën bizantine dhe nga ndikimi i shtetit kufitar: mbretëria serbe.

---

<sup>145</sup> A. Luarasi, *Historia e Shtetit dhe e së Drejtës në Shqipëri*, f.143.

<sup>146</sup> Valentini, *Statuto 12-13*.

<sup>147</sup> Valentini, *Statuto 5*.

<sup>148</sup> Sufflay, *Stadte 78 v*.

<sup>149</sup> A. D'Emila (1947–1949), *Lezioni Di Diritto Bizantino*, Rome, Tradita shume shkrimore Universitare.

E drejta dokesore shqiptare me veçoritë krahinore, e ndarë në të folme dhe në dialekte, na paraqitet në shumë pamje. Ajo përbëhet nga një skelet i fortë normash me burim tepër të lashtë vendas, por ka edhe ndikime nga jashtë, nga kodet e ndryshme greko-bizantine, romane, Sheriati, nga zakonet e vendeve të ndryshme, që sunduan në trevat tona për shekuj me radhë. Ndikimet e huaja kanë lënë gjurmë jo të barabarta në treva të ndryshme. Kjo vihet re në faktin që për situata të njëjta kanune të trevave të ndryshme parashikojnë pasoja të ndryshme. Këto kundërshti për të njëjtat dukuri e për elemente të veçanta shpjegohen nga tri arsye: së pari, forma shumë arkaike e normave e formave të evoluara; së dyti, normat vendase që bien në kundërshtim me disa norma të hyra nga jashtë; së treti, krahas një shtrese unitare mbaretnike ka dhe veçori të caktuara krahinore, që kushtëzohen nga veçoritë gjeografike, klimatike, burime ekonomike si më të hapura e më të mbyllura drejt qendrës.

Një nga veçoritë e qyteteve shqiptare është se ato nuk e pranonin statutin e bujkrobërisë. Gjithashtu si element garancie për jetën dhe lirinë personale shikohej prona. Këto dy elemente kanë ekzistuar dhe janë garantuar në mënyrë të veçantë nga e drejta tradicionale në Shqipëri<sup>150</sup>.

### **3. Analizë krahasuese e Statutit të Shkodrës si burim i së drejtës zakonore me ligjin bizantin**

Dokumente të ndryshme historike flisnin në mënyrë fragmentare për ekzistencën e statuteve arbërore, duke përmendur të drejta të shkruara për Tivarin më 1369, për Ulqinin më 1376, për Durrësin më 1392, për Drishtin më 1397, që rezultojnë të humbura. Do të ishte katalogu mbi fondin “Albanika” të muzeut “Correr” në Venecie që do të zbulonte ekzistencën e Statutit të Shkodrës, i cili konsiderohet si dokumenti më i lashtë ligjvënës i hartuar në territorin shqiptar. Statuti i Shkodrës hedh dritë për herë të parë mbi qytetërimet shumëshekullore të gërshetuara me përvojat e ndikimeve dhe bashkëjetesës në simbiozë me perandori të mëdha si Bizanti apo Venediku.

Për të konkluduar për kohën e saktë kur është shkruar Statuti i referohemi faktit që në përmendet kurorëzimi i carit serb Dushan në vitin 1346. Kjo tregon se Statuti daton para kësaj ngjarjeje. Duke e çuar analizën më tutje, konkludojmë se Zakoniku, kodi ligjor i carit Dushan, daton më vonë se Statuti i Shkodrës. Pavarësia e tekstit shkodran nga legjislacioni i përgjithshëm i Stefan

---

<sup>150</sup> Valentino. G, *Studime dhe tekste juridike*, fq.31.

Dushanit nuk do të thotë se janë anashkaluar përvojat e tjera normative. Zakoniku ka një ndikim te Statuti i Shkodrës, kurse ky i fundit mendohet ta ketë pikënisjen nga Statuti i Kotorrit, i cili daton më herët.

Statuti përbëhet nga 278 kapituj dhe dallohet për një rregull në hartimin e tij, gjë që e dallon nga Statuti i Kotorrit. Kapitujt parë flasin për të drejtën shtetërore, duke rregulluar marrëdhëniet me mbretin serb si zot i vendit, pastaj vijojnë dispozitat për ndërtimin e shtëpisë, pronën dhe qiranë e shtëpive, mbajtjen e mullinjve dhe tavernave. Më pas flitet për përcaktimin e punëve në ara, në vreshta dhe në pemëtore. Në një kapitull më vete flitet për marrëdhëniet e punës, për mënyrën e pagesës, kurse kushtetuta e mirëfilltë e qytetit bashkë me asamblenë popullore, këshillin, gjykatësit, zyrat e ndryshme funksionale, detyrimin ushtarak janë parashikuar në kapitujt 88–109. Menjëherë pas tyre vijonë dispozitat me karakter procedural, që flasin për gjykatësit dhe procedurat e tyre të gjykimit të çështjeve, si për shembull mënyra se si merret një dëshmi<sup>151</sup>.

Me mjaft interes janë kapitujt mbi të drejtën civile (kapitujt 156–159 dhe ata mbi të drejtën penale (kapitujt 200–276), që i trajtojnë në mënyrë të hollësishme këto fusha. E drejta e detyrimeve është parashikuar në kapitullin mbi pronësinë e shtëpive dhe trojeve. Gjatë periudhës venedikase këtij Statuti iu bë një redaktim gjuhësor, kapitujt kanë një trajtë venedikase, ndërsa përmbajtja e tij atë dalmate. Ai është një monument i përcaktimeve ligjore dhe i gjuhës në Arbërinë e Veriut në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 14-të. Ky dokument nuk mund të përcaktohet si një krijim origjinal i qytetarisë shkodrane, i gjuhës romane, për më tepër si krijim i botës dalmate të ndikuar nga Italia. Shkodra përfaqësonte një nga hallkat më jugore të zinxhirit të komunave dalmate, me parime të ngjashme ligjore dhe me orientim kryesor nga Italia. Edhe pse jemi para fenomenit të solidaritetit adriatik, shkodranët nuk e humbën lidhjen me realitetin e tyre juridik, me përkatësinë në mbretërinë serbe<sup>152</sup>.

Duhet theksuar se në këtë kohë Shkodra gëzonte një autonomi shumë të zgjeruar në fushën juridike, por gjithmonë duke mos anashkaluar kompetencat ligjore të mbretit serb, të cilat më vonë nga verbale u shkruan në Zakonik. Mbreti u kishte njohur komunave kompetenca të gjera në fushën gjyqësore, gjykatësit kishin një juridiksion të zgjeruar mbi qytetarët, banorët sllavë e arbër etnik të krahinave përreth dhe të huaj. Katër elemente përjashtoheshin nga kompetencat e

---

151. Fr. Brandileone (1897), *Il Diritto Bizantinico nell'Italia Meridionale dal VIII secolo al XII secolo*, Napoli, Jovene.

152. H.G. Beck (1981), *Nomos, Kanonund staatrason in Byzanz*, Vjenë.



tyre: tradhtia, vrasja, e drejta mbi shërbëtorët dhe mbi kuajt. Të gjitha këto ishin në kompetencë të plotë të mbretërisë serbe.

Në rastin e vrasjeve parashikohej një procedurë që nuk ishte e disfavorshme për shkodranët. Konkretisht parashikohej që një qytetar shkodran nuk duhej të paraqitej para gjykatës mbretërore, në rast se bëheshin bashkë 12 betarë<sup>153</sup>. Parashikimi i betarëve si institucion ishte mjaft i përhapur në Europën mesjetare. Vepra penale e tradhtisë konsiderohej mjaft e rëndë si ndaj mbretit, ashtu dhe ndaj komunës dhe dënimi i saj ishte pagimi i një gjobe shumë të rëndë. Në rastet e tjera mbreti respektonte të drejtën zakonore të vendasve. Ky parashikim i dispozitës penale tregon qartë se nuk shihej si formë ndëshkimi fizik ndaj njeriut në kryerjen e këtyre veprave penale, por aplikohej një ndëshkim financiar. Kjo flet për një ndryshim të madh në parashikimin e gjakmarrjes sipas ligjeve tona zakonore.

Vlen të përmendet mënyra se si mbrohet figura e gruas nga abuzimet dhe nga dhuna, përfshirë edhe atë verbale. Ajo është e lirë të hartojë një testament, ka të drejtë të jap dëshmi, mbrohet nga pretendimet e paligjshme të bashkëshortit. Të gjitha këto elemente të sjella nga ky Statut tregojnë haptazi një mentalitet ndryshe në qëndrimin ndaj gruas, larg atij personaliteti të paqenë juridik të gruas në kanune<sup>154</sup>.

Në Statut normat penale janë vendosur në pjesën e përgjithshme dhe në atë të veçantë dhe rregullojnë shumë fusha. Në pjesën e përgjithshme gjejmë të trajtuara nocione si: mosnjohja e ligjit, përgjegjësia penale, faji, mbrojtja e ligjshme etj. Në pjesën e veçantë janë parashikuar veprat penale kundër personit, si: vrasja, plagosja, vepra penale kundër pronës dhe fushën ekonomike, krimet doganore, falsifikimet, korrupsioni etj.

Statuti i Shkodrës përbën dokumentin e parë të shkruar mbi normën penale shqiptare. Ai është një provë e pakontestueshme e ndikimit të traditës juridike venedikase në zhvillimin e së drejtës penale shqiptare nga e drejta romake deri te Kodi Penal shqiptar<sup>155</sup>.

Edhe pse vihet re një ndikim shumë i madh i juridiksionit dalmat dhe atij bizantin, në Statut nuk mungojnë gjurmët e disa zakoneve tipike ligjore serbe. Statuti parashikonte gjobën për shlyerjen e gjakut, të cilën e paguante një keqbërës në rastin e vrasjes me paramendim, dispozitë kjo që ka ngjasime me të drejtën zakonore shqiptare. Statuti i Shkodrës në zhvillimin e mëtejshëm të tij

---

153. Ms Correr 295 31 v.

154. J. Maridhakis. (1992), *Jurisdiksioni qytetar, brenda Rejave te mbreterve bizantin*. Athine.

155. Fr. Brandileone (1897), *Il Diritto Bizantinno nell Italia Meridionale dal VIII secolo al XII secolo*, Napoli, Jovene.

karakterizohet nga një numër i vogël amendamentesh. Gjashtë shtojca dhe pesë dispozita të periudhës venedikase. Këto shtojca u referohen çështjeve administrative, si: tarifatat e akteve të kancelarisë, rroga për personat e ngarkuar me kontrollin e ngarkesave detare të kripës, taksat e kancelarisë lidhur me çdo akt penal, përçindja që u takon prokurorëve dhe avokatëve në çështjet civile etj. Statuti shërben për të krijuar një ide mbi zhvillimin në nivel kushtetues të qyteteve të Arbërisë së Veriut. Përmbajtja e tij flet për funksionimin e jetës qytetare, marrëdhëniet me mbretin serb, që në Shkodër përfaqësohej nga një kont, i cili duhej të respektonte vetadministrimin e komunës. Emërimi i fisnikëve vendas si mëkëmbës të mbretit tregon një përfaqësim formal të pushtetit qendror në komunën qytetare.

Sipas Statutit, gjithë jeta e Arbërisë së Veriut përcaktohej nga tri elemente: komuna, ipeshkvi dhe zoti i vendit. Kushtetuta komunale gjendet në të gjitha trevat e Arbërisë së Veriut në gjysmën e dytë të shekullit të 14-të dhe karakterizohet nga asambleja e qytetarëve të lirë me të drejta të plota politike. Ajo kishte tendencë për të shkuar drejt një diferencimi shoqëror në fisnikë dhe *populares*. Kjo frymë u bë tepër e dukshme në pjesën veriore dhe jo në atë jugore, ku ende ishte fryma bizantine<sup>156</sup>.

Le të marrim në analizë disa prej neneve ku spikat ngjashmëria dhe ndikimi i ligjit bizantin. Neni 1 i ligjit agrar i referohet pronës private dhe konkretisht respektimit rigoroz të kufijve të pronës midis pronarëve, cenimi i të cilit penalizohej me shpërblim demi apo me humbje të të ardhurave materiale. Në të thuhet: *“Bujku që punon në arën e vet duhet të jetë i drejtë dhe të mos përvetësojë hullitë e fqinjit. Në qoftë se ndonjëri duke shkelur kufijtë përvetëson dhe zvogëlon pjesën e tokës që gjendet shumë afër tij, në qoftë se këtë e bën në lërimin e parë të tokës djerre, e humbet lërimin e saj; në qoftë se këtë shkelje e ka bërë në kohën e mbjelljes, bujku shkelës humbet farën, mbjelljen e saj dhe prodhimin.”*

Statuti e ka parashikuar këtë në nenin 210 mbi zaptimin e tokës: *“Kur dikush i ha fqinjët në vreshtë, arë ose kopër shembulltie, duke zhvendosur shënjat ose duke zhvendosur dherat nga ana e tij, detyrohet të paguajë tre hyperperë, që ndahen midis Kontit dhe të dëmtuarit. Këtij i paguhet dhe dëmi.”*

Ligji agrar i ka kushtuar disa nene aplikimit të nocionit të gjysmatarit, në ndryshim nga Statuti, i cili e ka përmendur këtë koncept vetëm në nenin 34 të tij, *“Mbi punimin e vreshtës në*

---

156. D. Gini (1989), *“Përshkrimi i historisë së juridiksionit parabizantin”*, Athinë, 1966. K. Picakis, *“Jeta e përditshme në Bizant”*, Athinë.

gjysmatari”, ku thuhet: “Nëse dikush pranon të punojë një vresht në gjysmatari, ai është i detyruar t’i bëjë të gjitha shërbimet e duhura vreshtës. Vjela e rrushit duhet të bëhet në prani të pronarit. Nëse punëtori nuk ia bën si duhet shërbimin vreshtës, atij nuk i quhet fare puna që ka bërë dhe detyrohet të paguajë pjesën e tij duke marrë për bazë prodhimin e realizuar me punën e bërë mirë nga fqinjët e tij. T’i zihet besë atij që punon nga 12 denar e sipër.”<sup>157</sup>”

Sipas këtij neni, Statuti e ka njohur konceptin e gjysmatarit vetëm për sa i përket punës në vreshta, ndërsa te ligji agrar ky koncept është më i gjerë dhe është trajtuar në nenin 12, 13, 14 dhe 15 të tij. Konkretisht neni 12 i referohet marrjes së një vreshti nga një bujk për ta punuar kundrejt ndarjes përgjysmë të prodhimit, i cili ka detyrimin njësoj si te Statuti për t’i bërë të gjitha shërbimet e duhura vreshtit, në rast të kundërt punëtori privohet nga marrja e prodhimit. Ja çfarë thuhet në këtë nen: “Në qoftë se një bujk do të marrë prej ndonjë bujku të varfëruar vresht për ta punuar përgjysmë dhe nuk do ta krasisë atë siç duhet, nuk do të prashitë e nuk do ta rrethojë me gardh, të mos marrë asgjë nga prodhimi.”<sup>158</sup> Po të shohim nenin 13 të ligjit agrar, koncepti i gjysmatarit është përdorur për punimin e tokës, për mbjelljen e saj me kusht që prodhimi i marrë të ndahet me pronarin e tokës. Ky nen kërkon që bujku ta marrë seriozisht punën e tij si gjysmatar, përndryshe nuk do të përfitojë nga prodhimi i tokës. Saktësisht në ligj thuhet: “Në qoftë se një bujk duke marrë tokë për ta mbjellë përgjysmë, nuk do të punojë kur është koha, por do të hedhë farën në sipërfaqe, le të mos marrë asgjë prej prodhimit, sepse duke gënjyer u tall me të zotin e tokës.”<sup>159</sup> Pra, kemi të bëjmë me një penalizim që i referohet privimit nga marrja e prodhimit.

#### **4. Analizë krahasuese e Kanunit të Skënderbeut si burim i së drejtës zakonore me ligjin bizantin**

Meritat e nxjerrjes në dritë për herë të parë të këtij dokumenti të lashtë i takojnë albanologut austriak J. Hahni, i cili u ka kushtuar dy botime studimeve të veta rreth të drejtës kanonore shqiptare. Vepra e tij e parë, e cila është botuar në vitin 1853, titullohet “Albanesische Studien” dhe flet për ekzistencën e një kanuni popullor në trevat veriore shqiptare me emrin “Kanuni i Lekë Dukagjinit”. Në veprën e tij të dytë, shkruar 14 vjet më vonë (në vitin 1867), ai vinte në

---

157. Sp. Troianos (1991), *Ligji Nomos und Kanon in Byzanz*, Kanon 10.

<sup>158</sup> *Ligji Agrar, neni 12.*

<sup>159</sup> *Po aty, neni 13.*

dukje se gjatë udhëtimit të tij në viset e Drinit kishte mësuar për ekzistencën e një tjetër kanuni popullor, i cili zbatohet në krahinat e Matit dhe të Dibrës dhe njihet si “Kanuni i Skënderbeut”<sup>160</sup>. Gjatë studimit të këtyre dy kanuneve shqiptare J. Hahni arriti në përfundimin se ekzistonin ndryshime të mëdha mes tyre. Por albanologu i shquar e shtriu më tej studimin e tij. Në krahasimin e dy kanuneve shqiptare me kanunin e gjermanëve të vjetër ai zbuloi shumë ngjashmëri midis tyre.

Historia shqiptare ka treguar se vëmendje i është kushtuar vetëm Kanunit të Lekë Dukagjinit, duke e konsideruar atë si të vetmin përfaqësues të së drejtës kanunore shqiptare. Ky trajtim i pabarabartë i dy kanuneve ka bërë që studiues të ndryshëm ta konsiderojnë Kanunin e Skënderbeut si emër të dytë të Kanunit të Lekë Dukagjinit, si për shembull studiuesi Italian S. Villari. Rreth viteve 50 janë bërë studimet e para albanologjike për të hedhur dritë mbi këtë kanun shqiptar. Studimet në këtë fushë treguan qartazi se e drejta e pashkruar ka lindur si përshtatje me kushtet shoqërore shqiptare dhe jo nga një imponim i jashtëm, gjithashtu ajo është një *corpus juridik* i krijuar ndër shekuj nga populli dhe jo një produkt i një individi të vetëm.

Kanuni i Skënderbeut do të konsiderohet një *corpus juris* që zbatohet në të gjitha trevat e sunduara nga Kastriotët, konkretisht krahinat Dibër, Mat, Krujë, Kurbin, Bendë, Martanesh. Që të flasim për të drejtën kanunore si institut juridik, duhet t’i hedhim sytë në periudhën e parahistorisë, kur lindja e pronës private e kërkoi një rregullim të tillë në gjirin e bashkësisë primitive. Kjo e drejtë vazhdoi ekzistencën e saj derisa faktorët e huaj shfrytëzues vendosën ta zëvendësonin atë me institutet juridike shtetërore. Të drejtën kanunore e gjejmë edhe në mesjetë, kryesisht në bashkësitë krahinore që nuk iu nënshtruan administratës shtetërore feudale. Koha tregoi se kjo e drejtë i rezistoi edhe pushtimit otoman, duke eliminuar zbatimin e instituteve juridike turke në këto vise, madje aplikimi i saj erdhi edhe në shekullin e 20-të në disa vise shqiptare. Rëndësia e së drejtës kanunore arrin dhe merr tipare kombëtare, për arsye se ajo ishte një shprehje e autonomisë lokale në trevat ku zbatohet, dhe në këtë mënyrë ajo ruajti ekzistencën e kombit nga asimilimi i të huajve. Nga analiza e së drejtës kanunore del në pah funksioni i saj i dyfishtë: së pari, ajo mbron unitetin moral midis anëtarëve të bashkësisë krahinore, që ishte i domosdoshëm për t’i bërë ballë presionit të huaj; së dyti, ajo ligjëronte interesat e krerëve që po pasuroheshin në gjirin e saj, një proces ky që po çonte drejt shpërbërjes së bashkësisë krahinore. Të dyja këto funksione kishin natyrë kontradiktore, pasi nga njëra anë kemi normat pozitive, që

---

160. J.G.Hahn, *Reise durch die Gebiete des drin und Ęardar, Ęien* 1967. f.21.

tentojnë të ritin solidaritetin shoqëror mes anëtarëve të bashkësisë, nga ana tjetër kemi normat negative, që favorizojnë pabarazinë shoqërore mes anëtarëve të saj.

Për të bërë një analizë sa më reale të së drejtës kanunore duhet që institutet e saj të shqyrtohen e të vlerësohen në raport me kushtet konkrete historike dhe aplikimin e tyre në terren. Gjatë studimit analitik të kanunit të Skënderbeut pyetja e parë që lind dhe kërkon një përgjigje është: a duhet konsideruar kodifikues Skënderbeu, meqenëse kanuni mban emrin e tij? Cili ishte roli konkret i tij në hartimin e këtij *corpus juris*-i?

Fillimisht sjellim në vëmendje faktin se e drejta kanunore është një produkt shekullor i trashëguar brez pas brezi, i ruajtur me fanatizëm nga bashkësitë krahinore të Shqipërisë mesjetare, më saktë në krahinat e Kastriotëve. Zëvendësimi i saj nga një përmbledhje e re kanunore, në rastin konkret nga Kanuni i Skënderbeut, mund të realizohej vetëm nga një ndryshim i madh politik, konkretisht nga krijimi i një shteti të centralizuar. Nëse do të realizohej kjo, do të kishim funksionimin e një aparati administrativ në të gjitha viset malore, që do të realizonte funksionet e veta nëpërmjet instituteve juridike që do t'u imponoheshin bashkësive patriarkale. Por faktet historike kanë treguar një situatë tjetër nga ajo që parashtruam më lart. Gjergj Kastrioti veproi në këto krahina vetëm me anë të së drejtës së pashkruar, duke mundësuar vetëm ndryshime fragmentare, të cilat nuk preknin thelbin e së drejtës kanunore. Rrjedhimisht nuk kemi një kod të hartuar nga vetë Skënderbeu, por disa norma të veçanta kanunore të formuluar prej tij dhe të përfshira në të drejtën e pashkruar që aplikoheshin në Shqipërinë e Mesme në shek e 15-të. Nga ana tjetër, nuk mund të pranohet përfundimi se ky Kanun është pasqyrë e së drejtës së pashkruar që ka qenë në fuqi në krahinat malore gjatë sundimit të Skënderbeut, pasi e drejta kanunore gëzon një dialektik të shumëllojshme, ndërsa e drejta e pashkruar nuk mund të jetë statike. E drejta kanunore vazhdimisht ka qenë nën presionin e ndikimit të faktorit të huaj: atij romak, bizantin, venedikas dhe turk. Ky ndikim solli shfuqizimin dhe ndryshimin e shumë instituteve politike, juridike, u vendosën institute të reja për herë të parë, si për shembull: instituti i bajraktarit në trevat e Dukagjinit, Dera e Gjonmarkajve në Mirditë, pozita e hoxhës në Gollobordë, roli i teqesë në Martanesh etj. Këto institute nuk mund të konsiderohen si pjesë përbërëse të Kanunit të Skënderbeut.

Po të marrim në analizë ndryshimet e instituteve të së drejtës së pashkruar në periudhën para pushtimit osman, vëmë re se transformimi i tyre nuk u bë në mënyrë të barabartë në të gjitha krahinat shqiptare. Kjo ndodhi si pasojë e shumë faktorëve për shkak të zhvillimit jo të barabartë

të marrëdhënieve feudale dhe të rezultateve jo të njëllojta të rezistencës së malësorëve. Institute të tilla, si për shembull: instituti i kefalisë, u zhduk në Mat dhe mbijetoi në Dibër, vojvoda u krijua në Bendë dhe rezistoi në Dukagjin. Do të ishte më e drejtë të flitej për kanune të veçanta krahinore të periudhës së fundit të sundimit otoman, apo siç i quajnë vetë malësorët, një zakon i Dibrës, i Matit, i Kurbinit Bendës etj., por jo të njëjtësuar me një emër: *Kanuni i Skënderbeut*. Emërtimi i njëjtë i këtyre zakoneve do të çonte në një tablo jo reale të së drejtës kanunore në këto zona për shkak të veçorive karakteristike të tyre.

Për të kuptuar se pse tradita popullore e ka quajtur Skënderbeun ligjvënës, gjë që nuk vërtetohet nga burimet historike, duhet t'i referohemi kuptimit dhe origjinës së termit “kanun”. Ky term rrjedh nga gjuha bizantine dhe ka kuptimin “një normë që dikton rrugën e të vepruarit drejt”. Pra, me “kanun” kuptohej një normë juridike dhe jo një korpus normash, që quhej “kod” nga bizantinët, apo “sindagma”, apo “kanun-name” (përmbledhje e kanuneve). Pra, në trajtimet që bëhen sot kur përmendet Kanuni, i referohen atij si një korpus normash dhe jo si një normë e vetme, duke iu larguar kështu origjinalitetit të tij. Por malësorët e kanë ruajtur origjinalitetin e këtij termi kur shprehen, për shembull: *“Skënderbeu vuri kanun, se gjaku nuk ngel për faj.”*. Sipas këtij trajtimi, tek e drejta e pashkruar, e cila u përket trevave të Kastriotëve, vetëm disa prej tyre mund të jenë kanune të mirëfillta të Skënderbeut.

Sipas praktikës legislative të bashkësive malësore, sa herë që ndihej nevoja për një normë kanunore ose sa herë që një normë e vjetër nuk pajtohej me rrethanat e reja historike, hynin në skenë të ashtuquajturit pleq të kanunit. Procedura e zëvendësimit të një norme të vjetër me një normë të re kanunore kryej nga organi më i lartë i shoqërisë malësore, që ishte kuvendi i bashkësisë, i cili ishte i lidhur ngushtë me veprimin e së drejtës kanunore. Zakonisht pranimi i një norme të re shoqërohej me emrin e personit që e formulonte, por tradita popullore si të tillë ka ruajtur vetëm emrin e Skënderbeun. Koha solli ndryshime të normave të Skënderbeut, diku i transformoi ato e diku i zhduku, por është e vërtetë se në malësinë e Dibrës ato kanë ekzistuar edhe në shekullin e 19-të. Ky fakt vjen si dëshmi e konsullit rus M. Hitrov, i cili vizitoi trevën dibrane dhe në vitin 1864 i shkroi një relacion drejtorit të departamentit aziatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Ruse. Në këtë dokument ai shprehej se në këto zona vepronte ende një kanun i lashtë, i trashëguar gojarisht brez pas brezi, që i atribuohet prijësit të lavdishëm

shqiptar Gjergj Kastriotit, i cili njihet me emrin “Kanuni i Skënderbeut”<sup>161</sup>. Mundësia e vetme për të arritur në një përfundim të saktë mbi këto norma që i atribuohen Skënderbeut është nënshtrimi i tyre analizës historike për të parë nëse ato pajtohen me strukturën shoqërore që sundonte në këto vise në shek e 15-të. Deri në ditët e sotme njihen gjashtë norma kanunore që lidhen me emrin e Skënderbeut dhe analiza e tyre do të bëhet duke iu referuar strukturës shoqërore të malësisë së Dibrës, meqenëse në këtë krahinë ato kanë vepruar më gjatë krahasuar me trevat e tjera të Kastriotëve. Analiza do të shtrihet kryesisht në zhvillimin shoqëror që ka pësuar malësia dibrane në pjesën që i përket ultësirës bujqësore, apo siç njihet ndryshe, Fusha e Dibrës. Për shkak të kushteve të favorshme ekonomike kjo ultësirë ka pasur një zhvillim ekonomik shoqëror më të shpejtë se malësia, edhe pse për gati 2000 vjet ka qenë nën zgjedhën e të huajve. Faktori i huaj është përpjekur të zbatojë legjislacionin e vet në këto treva. Tjetër faktor gjejmë në malësinë e thellë, jo të zhvilluar ekonomikisht, por një komunitet i lirë, që nuk iu nënshtrua faktorit të huaj.

Duke iu referuar organizimit shoqëror në malësinë dibrane, gjejmë si njësi bazë të saj shtëpinë me karakter patriarkal, e cila në marrëdhëniet me fshatin përfaqësohej nga kryefamiljari. Si njësi shoqërore dhe ekonomike nuk ishte lagjia, por fshati, sepse prona e përbashkët, e quajtur “kuiria”, nuk i takonte lagjes, por mbarë fshatit. Karakteristikë e fshatit dibran ishte ekzistenca e një bashkësie territoriale dhe jo fisnore. Pra, bashkësia fisnore nga dokumentet e periudhës osmane nuk ka qenë e njohur në Dibër. Provë e këtij fakti janë mbiemrat e ndryshëm që mbanin familjet e të njëjtit fshat.

Bashkësia fshatare, me gjithë lidhjet e brendshme dhe shoqërore që mund të kishte, nuk ishte në gjendje të mbronte në mënyrë të veçantë vetveten nga presioni i jashtëm dhe ai feudal. Për të përballuar presionin e huaj dibranët gjetën këtë mënyrë: shumë fshatra fqinje krijuan lidhje të ngushta, duke formuar kështu një bashkësi territoriale më të madhe se bashkësia fshatare, pra një bashkësi krahinore. Rezulton se në periudhën e fundit të sundimit osman malësia dibrane kishte nëntë bashkësi krahinore ose, siç i quajtën dibranët, “*nandë male*”. Një bashkësi krahinore nuk kishte prona “kuiri” si fshati, prandaj paraqitej si një lidhje federative, ndërsa fshati si një bashkësi krahinore me karakter politik dhe ushtarak.

---

161. M.Hitrov, *Relacion drejtuar nga Manastiri më 6 gusht 1864 drejtorit të departamentit aziatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Perandorisë Ruse (origjinali në Arkivin e Shtetit në Leningrad, sipas fotokopjes se origjinalit dhe përkthimit në shqip, që ndodhet në Arkivin e Institutit të Historisë, Tiranë)*.

Një organizim të tillë e gjejmë edhe në treva të tjera shqiptare, si për shembull, *mali* i Hotit në viset veriore apo *mali* i Benës në trojet e Kastriotëve. Përveç lidhjeve politike dhe ushtarake një bashkësi krahinore, apo *mali*, karakterizohej edhe nga *bashkësia juridike*, sepse çdo normë e re kanunore që dilte shtrihej në gjithë territorin e tij. Karakteri detyrues i këtyre normave vinte pasi miratoheshin nga *kuvendi i bashkësisë krahinore*. Rritja e presionit të faktorit të jashtëm solli forcimin e lidhjeve midis bashkësive krahinore, që çoi në lindjen e *bashkimeve të maleve* si bashkësi ndërkrahinore, politike, ushtarake dhe zakonore të së drejtës.

Ndarja e trevës dibrane në shekullin e 13-të në dy pjesë: Dibra e Sipërme dhe Dibra e Poshtme, tregon formimin me kohë në këtë trevë të dy bashkësive ndërkrahinore. Përpara pushtimit osman të dyja këto bashkësi ndodheshin nën pushtetin e dy familjeve feudale të njohura: Dibra e Sipërme nën sundimin e Gropajve nga fshati Gropë, ndërsa Dibra Poshtme nën pushtimin e Kastriotëve nga fshati Kastriot, që ndodhet pranë Peshkopisë. Presioni otoman e ndihmoi Gjon Kastriotin t'i shkrinte *malet* e Dibrës, Matit dhe Kurbinit në një bashkësi më të gjerë krahinore. Në vitet '40 të shekullit të 15-të, në mbështetje të luftës së udhëhequr nga Skënderbet, të gjitha *malet* e Shqipërisë së Mesme së bashku me viset fushore hynë në një bashkësi politike kombëtare: në shtetin e pavarur shqiptar. Për të gjitha malet që u përfshinë në këtë shtet u krijua terreni për një bashkësi juridike në fushën e së drejtës zakonore.

Normat kanunore që dolën gjatë ekzistencës së kësaj bashkësie kombëtare, si norma të diktuar nga nevoja e luftës dhe që bartnin autoritetin e lartë të Skënderbeut, u bënë në detyrueshme për të gjitha *malet* që përfshiheshin në këtë bashkësi. Pas shkatërrimit të shtetit shqiptar nga osmanët për viset e Shqipërisë së Mesme u shkatërrua terreni për norma kanunore të përbashkëta. Vendi u kthye në gjendjen e mëparshme, bashkësia kombëtare ua la vendin bashkësive krahinore të shkëputura nga njëra-tjetra. Pushtimi otoman i shekullit të 15-të i gjeti viset e Dibrës me një diferencim shoqëror të brendshëm dhe vetëqeverisje të bashkësive krahinore mjaft të kufizuara nga pushteti i familjeve Gropa dhe Kastrioti. Dy ishin figurat kryesore që qeverisnin institutet e vetëqeverisjes me anë të së drejtës kanunore: plaku, ruajtësi i normave kanunore, dhe kefali, i cili drejtonte ushtrinë e bashkësisë. Për të zëvendësuar prijësit ushtarakë dhe kefalitë e *maleve* Skënderbeu u detyrua të ndryshonte normën për trashëgiminë e funksionit, sipas së cilës në krye të shoqërisë dhe të trupave ushtarake mund të viheshin vetëm fisnikët. Skënderbeu e riformuloi normën juridike kështu: “*Si i mejri dhe i kejqi janë nja për nja, se përej të mejrit del ene i kejqi e*



*prej të keqjit del edhe i mejri.*”<sup>162</sup>Sipas kësaj norme, posti i kreut të bashkësisë nuk mund të ishte i trashëgueshëm, ai duhej të zgjidhej periodikisht nga asambleja e malësorëve.

Kjo normë gjeti një përdorim edhe në gjirin e bashkësisë familjare. Me vdekjen e kryefamiljarit apo në rastin e paaftësisë së tij drejtimin e familjes e merrte personi i saj më i dashur. Këtë parim të barazisë midis anëtarëve të familjes e gjejmë edhe në dy norma të tjera, që tradita dibrane ia adreson përsëri Skënderbeut. Njëra kufizonte pushtetin absolut të kryefamiljarit, i cili kishte të drejtën të përjashtonte nga prona e familjes cilindo nga pjesëtarët e saj. Në kundërshtim me këtë normë, Skënderbeu sanksionoi: *“Fëmija qysh se len e ka tenin (pjesën) nja për nja me të madhin.”*<sup>163</sup> Norma tjetër kundërshtonte parashikimin e mëparshëm, sipas të cilit burri kishte të drejtë ta ndante gruan pa i dhënë asnjë lloj prone brenda familjes ku ishte martuar. Skënderbeu bëri këtë ndryshim: *“Gruaja munet me u nda pa hise vetëm për bracallëk (vjedhje) e për punë të panershme, për ndrishe gruaja merr xhinsën e tokës së burrit dhe pjesën e gjas se ene ajo ka mundin e vet për plang të shpajs.”*<sup>164</sup>

Norma kanunore *“si i mejri dhe i keqji janë nja për nja”* gjeti zbatim edhe në institutin e gjakmarrjes. Kjo normë ndryshoi parashikimin e mëparshëm, sipas të cilit gjaku i një të miri duhej të shpaguej me gjakun e dy të këqijve. Ky parashikim i kishte rrënjët te parimi anakronik i trashëguar nga e drejta kanunore fisnore se gjaku shkon për gjak. Ky parashikim e legjitimonte palën e viktimës të gjakmerrej ndaj çdo anëtari të fafesisit të gjakësit. Në këto kushte, meshkujt madhorë që ekspozoheshin përballë rrezikut të gjakmarrjes ishin të detyruar të mbylleshin në shtëpitë e tyre. Një situatë e tillë ndikonte negativisht jo vetëm në prodhimtari, por dhe i përçante malësorët, çka binte në kundërshtim me interesin e vendit për t’u rimëkëmbur ekonomikisht dhe për t’u forcuar politikisht. Kjo ishte arsyeja që Skënderbeu ndërhyri për ta kufizuar rrezin e gjakmarrjes. Me cilësinë e plakut të kanunit ai operoi nëpërmjet së drejtës së pashkruar, duke shpallur dy norma të reja kanunore, nga të cilat njëra pakësonte rastet e hakmarrjes dhe tjetra ngushtonte rrethin e viktimave. Të dyja këto norma tregojnë një ndryshim thelbësor të Kanunit të Skënderbeut me Kanunin e Lekë Dukagjinit. Sipas këtij të fundit, *“gjaku mbetet për faj”*, domethënë vrasja e fajtorit nuk konsiderohej si shpagim i fajit, por hapte serinë e gjakmarrjes së vazhdueshme dhe të trashëgueshme. Skënderbeu iu kundërvu kësaj norme, duke lënë në Kanun

---

<sup>162</sup> . Q. Haxhihasani (1953), *Tregim i mbledhur në fshatin Brest të Dibrës*, f. 30.

<sup>163</sup> Q. Haxhihasani (1953), *Tregim i mbledhur në fshatin Brest të Dibrës*, f. 34.

<sup>164</sup> Po aty, f.43.

“*gjaku nuk ngel për faj*”, që do të thoshte: në rast se faji shpaguhej me vrasje, kjo vrasje nuk mund të bëhej objekt i gjakmarrjes. Edhe norma tjetër ndryshoi rregullin e vjetër kanunor. Në Kuvendin e Dheut në Lurë Lekë Dukagjini mbrojti parimin kanunor “*gjaku shkon për fis*”, ndërsa Skënderbeu paraqiti dhe mbrojti parimin “*gjaku shkon për gisht*”. Nga interpretimi i këtij parimi rezulton se hakmarrja duhej të rëndonte vetëm ndaj personit që kishte kryer vrasjen dhe jo ndaj farefisit të tij.

Një problem shumë i madh i Skënderbeut ishte dëmtimi i rëndë i ekonomisë nga sulmet e vazhdueshme dhe ekspeditat luftarake të osmanëve. Kur përfundonte një sulm i reparteve turke, detyrë e parë ishte rindërtimi i shtëpive dhe përtëritja e të mbjellave. Vlen të theksohet se në këtë zonë peshë kryesore në ekonomi kishte ulliri. Me këtë pasuri ka lidhje dhe norma e gjashtë e Skënderbeut, e cila trajtohet në mënyrë të veçantë. Kjo traditë ka ekzistuar në zonën ku kishte ullinj, kryesisht në zonën e Krujës. Sipas traditës krutane, Skënderbeu dha urdhër që, kur lindte një djalë, prindërit e tij duhej të mbillnin 20 rrënjë ullinj dhe të kujdeseshin për to derisa ai të martohej, përndryshe askush nuk duhej t’i jepte atij vajzë për nuse. Në variantin e krutan kjo normë ruhet e formuluar afërsisht kështu: “*Pa nijzet rranjë ullinj të ngulme për djalin, nuk bahet martesë e tij.*” Pra, nuk kemi të bëjmë me një porosi të thjeshtë, por me një normë kanunore, e cila ka një detyrim shoqëror për t’u zbatuar.

Shohim se normat kanunore të Skënderbeut shënuan një hap përpara në lidhje me parimet e lashta të së drejtës së pashkruar, që sundonte ende në shekullin e 15-të. Karakteri i tyre progresiv dhe figura madhështore e Skënderbeut janë dy faktorë që shpjegojnë pse emri i tij iu vesh mbarë së drejtës kanunore që sundonte në Shqipërinë e Mesme. Gjithsesi, normat kanunore të Skënderbeut nuk qenë reforma radikale. Edhe pse ai përpoq të sillte një frymë të re në marrëdhëniet mes malësorëve, këto norma nuk arritën të zhduknin fenomenin e gjakmarrjes, ashtu sikurse nuk e ndryshuan dot pozitën e gruas nga skllavëria e burrit. Këtu kujtojmë se sa progresive ishin normat e Statutit të Shkodrës në mbrojtjen e figurës së gruas, një parashikim ky ligjor që sfidonte shoqërinë arbërore mesjetare.

Vendosja e marrëdhënieve feudale në viset malore solli rivendosjen e trashëgueshme të pozitës së krerëve të malësorëve, u zgjerua rrethi i gjakmarrjes, gruaja e humbi të drejtën e saj mbi pronën. Me krijimin e shtetit shqiptar të pavarur, funksioni i bashkësisë krahinore mori fund, po kështu duhej të përfundonte edhe funksioni i së drejtës kanunore, por ndodhi e kundërta. Këto

norma i mbijetuan kohës për shumë arsye, një prej tyre ishte tradita e tyre shumëshekullore nga përkrahja që iu dha prej krerëve të feudalizuar dhe nga elementë të tjerë.

Interesant është dhe flamuri, një element i veçantë dhe shumë domethënës në aspektin fisnor dhe ushtarak të zakoneve juridike shqiptare. Në Shqipëri figura e shqiponjës dykrenore si simbol pushteti gjatë mesjetës është përdorur nga shumë familje sundimtare shqiptare, si Kastriotët, Muzakajt, Topiajt etj. Përdorimi i figurës së shqiponjës dykrenore si simbol dëshmon se pinjollët e këtyre familjeve kanë qenë funksionarë të lartë të Perandorisë Bizantine.

Për të dëshmuar nëpërmjet simboleve shtetërore se ishte në krye të një shteti të pavarur, Skënderbeu ndërthuri simbolin bizantin (shqiponjën dykrenore) të trashëguar prej familjes së tij me simbole që mbështeteshin në traditën vendase dhe shprehnin sovranitetin e tij. Si simbol kryesor vendor ai ka përdorur diellin, duke e paraqitur në trajtën e një ylli me tetë dhe me gjashtë cepa<sup>165</sup>. Skënderbeu ka pasur simbol shtetëror edhe vulën me shqiponjë, e cila është përdorur për herë të parë në mesin e viteve '50 të shekullit të 15-të. Rezulton se në të njëjtën kohë me përdorimin e kësaj vule është përdorur edhe flamuri me fushën e kuqe dhe me shqiponjën dykrenore në mes, të cilën e ka pasur Perandoria Bizantine.

## **5. Analizë krahasuese e Kanunit të Lekë Dukagjinit si burim i së drejtës zakonore me ligjin bizantin**

Jeta shoqërore dhe juridike e popullatave banuese në rajonet malore të Shqipërisë së Sipërme, që shtrihen në veri të lumit Mat, deri pak vjet më parë ishte rregulluar dhe drejtuar nga norma zakonore karakteristike, prej të cilave edhe në ditët e sotme gjejmë gjurmë të ndjeshme. Malësorët edhe sot e kësaj dite e njohin tërësinë e këtyre normave zakonore nën emrin e Kanunit të Lekë Dukagjinit, titull i cili ka marrë vulën tashmë nga një përdorim që tradita dhe kronikat thonë se është shekullor.

Me përjashtim të përmbledhjes në revistën “*Hylli i Dritës*” vitet 1912, 1914 dhe 1921–1922 nga at Gjeçovi dhe të disa studimeve të priftërinjve shqiptarë, një bibliografi e thelluar dhe analitike mbi argumentin në fjalë nuk ekziston. Studimi dhe analiza e këtij Kanuni pa dyshim që paraqet

---

165. Biçoku K, *Kastriotët në Dardani*, f. 118.

një rëndësi shumë të madhe, pasi, duke qenë se normat zakonore të tij janë një shprehje e brendshme e vetëdijes popullore, që më parë i ka krijuar dhe më pas i ka jetësuar duke i ushtruar ato, njohja e tyre ndihmon në kuptimin e vlerave psikologjike të popullatave malësore, që nuk e prekën nga pushtimi osman.

Perandoria osmane gjatë sundimit të saj në trevat shqiptare nuk arriti të vendoste një administratë të rregullt në malësitë e Shqipërisë së Veriut, kalimet e sunduesve ishin fragmentare dhe këto male konsideroheshin si treva kryengritëse. Asnjëherë faktori i huaj nuk i reshti përpjekjet për të minimizuar sa më shumë fushën e zbatimit të së drejtës dokesore, por pa ndonjë sukses të madh. Ka një rëndësi të madhe ruajtja e së drejtës zakonore, pasi ajo siguroi ruajtjen e individualitetit të kombit tonë. Normat e Kanunit kanë karakter origjinal, ato iu përshtatën rrethanave ekonomike shoqërore dhe historike të vendit, por nuk përjashtohet edhe ndikimi i faktorit të huaj.

Tradita popullore, e mbledhur dhe e përcjellë edhe nga studiuesit e çështjes shqiptare, ka pohuar se Kanuni duhet të ketë qenë vepër e princit Aleksandër Dukagjini, që ka jetuar në shekullin e 15-të, i cili do t'i ketë krijuar këto norma ose së paku ka bërë kodifikimin e tyre, duke i mbledhur mes nënshtetasve të tij për t'i përmbledhur në një korpus të vetëm. Duke menduar se emri “Lekë” mund të jetë shkurtim i emrit “Aleksandër”, disa studiues e lidhin Kanunin me emrin e Aleksandërit të Madh. Për ta mbështetur mendimin e tyre ata argumentojnë se, nëse normat e Kanunit u pranuan nga turqit, kjo erdhi pasi këto norma kishin atë karakter të përgjithshëm që vetëm një qytetërim si ai i Aleksandrit të Madh mund t'i nguliste në kujtesë<sup>166</sup>. Një hipotezë të tillë e përjashton mbiemri “Dukagjini”, pra bëhet fjalë për Aleksandër Dukagjinin dhe jo për Aleksandrin e Madh. Nga ana tjetër, turqit nuk e pranuan Kanunin edhe për jetën e tyre shoqërore juridike, siç pretendohet nga studiuesit e hipotezës së mësipërme. Ata lejuan vetëm përdorimin e tij nga malësorët duke qenë të bindur se, për t'i mbajtur ata të nënshtruar, ishte e nevojshme t'i linin të jetonin sipas zakoneve të tyre shoqërore dhe juridike.

Për të kuptuar origjinën, zhvillimin e tij dhe karakteristikat e Kanunit pikësëpari duhet të bëjmë periodizimin dhe shtresëzimin e normave kanunore. Studimi i normave kanunore nuk mund të bëhet i shkëputur nga konteksti i etnokulturës në tërësi në *malet* shqiptare. E drejta dokesore shqiptare, me tërë shfaqjet e saj, është një det i pafund. Ka shumë vende dhe kushte të ndryshme me norma dokesore në funksione të ndryshme lidhur me nevojat praktike. Ajo është në evolucion

---

166. *Albanische Forschungen nga Thaloci.*

të përhershëm e me larmi ngjyrash. Këtë e vërteton edhe shprehja e lashtë “*tym për shtëpi e doke për katund*”. Çdo fshat ka diçka të veçantë në normat dhe në rregullat e detyrueshme të bashkëjetesës, por kjo mund të thuhet edhe për një krahinë të caktuar ose për dy a tri krahina të marra së bashku.

Normat kanunore kanë filluar të shfaqen që në shekullin e 12-të në shkrimet e udhëtarëve e të misionarëve të huaj dhe të fisnikëve arbëresh. Ky Kanun është i përbërë nga shumë norma juridike dokesore me karakter moral dhe religjioz, si dukuri të lashta vendase, përpunuar ndër shekuj, si shprehje e atij kohezioni psikologjik krahinor, ndërkrahinor e mbaretnik, si një lidhje e brendshme sociale me rrënjë prehistorike. Besa, betimi, kufiri me 12 dëshmitarë, borxhi i huaj për atë që vdes, beja e vërtetimit në dhe të varrit, rregullat e mikpritjes, të trimërisë e të gjakmarrjes e me radhë kishin natyrë juridike, e ndërkohë, në një të shprehur të qartë në praktika të shekullit të 20-të, natyrë morale e religjioze, tipare krejt të dallueshme nga të gjithë. Ky Kanun në Mirditë është zbatuar dhe ka evoluar në një mënyrë disi të veçantë në rrethana të një autonomie të theksuar: një vend i rrethuar nga malet në mes të krahinave të Shqipërisë së Sipërme. Mirdita ka pasur elemente të një principatë dhe e tillë është quajtur nga të huajt. Ajo ka qenë e organizuar si një bashkësi fshatare krahinore e vetëqeverisur sipas dokeve të vjetra vendase, me një të drejtë dokesore që zbatohet me shumë saktësi. Dera e Kapedanëve të Oroshit ka qenë organi më i lartë i drejtësisë së kësaj zone dhe përforsimi i funksionit të saj vinte edhe nga funksionet shtetërore që ka pasur nga koha në kohë. Përmes Derës së Kapedanëve, që përbënte simbolin e unitetit krahinor, shkriheshin në një njëjtësi organizimi në bazë të Kanunit dhe ndërkohë në ligjet shtetërore të çdo kohe, sidomos të shtetit turk. Një tjetër element që ka ndikuar në unitetin e kësaj krahine ka qenë edhe Abacia e Oroshit, e cila në bashkëveprim me derën e Gjonmarkajve ka ruajtur ekuilibrin social në vetëqeverisjen dokesore të Mirditës. Hierarkia e bashkësisë krahinore përbëhet edhe nga bajraktarët, pleqtë e vendit, që kishin funksione të qarta vetëqeverisëse sipas normave të së drejtës dokesore. Lidhjet e vazhdueshme mes zonave të ndryshme dhe zbatimi i së njëjtës të drejtë dokesore ka bërë që Mirdita të jetë një krahinë e madhe etnologjike me tipare dalluese nga krahina e tjera. Mirdita është krahina më tipike për ruajtjen dhe funksionimin më të plotë të së drejtës dokesore deri në vitet '30 të shekullit të 20-të. Kanuni i Maleve ishte baza juridike, politike e praktike për ruajtjen e autonomisë në bashkësitë e lira krahinore malore në kushtet e sundimit otoman. Kjo ka bërë që institucione të veçanta, në përshtatje me rrethana të caktuara historike, jo vetëm të ruheshin, por

edhe të plotësoheshin në përshtatje me këto rrethana, që ishin në zhvillim, si përgjigje e zhvillimeve të brendshme shoqërore dhe ekonomike krahinore, ndërkrahinore dhe kombëtare. Variantet kanunore, edhe pse me karakteristika të veçanta nga njëra krahinë në tjetrën, te parimet themelore dhe institucionet kryesore kanunore kanë plotësisht skeletin e përbashkët të së drejtës dokesore shqiptare.

Kanuni i Lekë Dukagjinit ka dallime në zona të ndryshme ku ai zbatohet. Për shembull, ndryshe nga Puka dhe Luma, Mirdita trashëgonte të drejtën e plakut të katundit, që hynte në “krerët e dheut”. Kështu, funksiononte figura e “plakut të dheut”, plak bajraktari, i cili deri nga mesi i shekullit të 19-të ishte i pari në “krerët e dheut”, kur filloi të rritej roli i bajrakut dhe në kohë paqe, si rezultat i pjesëmarrjes në luftëra, të cilat sa vinin shpeshtoheshin.

Abacia e Oroshit ushtroi ndikim të rëndësishëm në jetën familjare, shoqërore dhe politike deri në vendimmarrje në kuvende e besëlidhje mbarëkrahinore e më gjerë. Pajtimi i dheut, pajtimi i mbarëkrahinor i gjaqeve në krye të shtatë vjetve, ka qenë më i organizuar dhe më i drejtuar nëpërmjet krerëve në bashkëpunim me kapëdanin, me pleq e stërpleq në bajrak e katund. Ky është dallimi më i dukshëm në variantin e së drejtës dokesore (kanunore), në të cilat kanë gjetur zgjidhje problemet familjare, shoqërore, ekonomike, organizative, fetare e politike nga shekulli në shekull nëpërmjet zgjidhjeve origjinale me një zgjuarsia e filozofi popullore të përkryer.

Nëse do të pranohet se këto norma kanë qenë thjesht ligjet që janë diktuar nga një zotëri si Aleksandër Dukagjini apo nga një grup krerësh, do të na duhej t’u mohojmë tërësisht atyre atë karakter normash zakonore që tek ato shfaqet mjaft qartë, në mos tjetër veç për faktin se ato u ruajtën edhe kur turqit kishin diktuar pak a shumë në mënyrë të tërthortë sundimin e tyre. Jetëgjatësia e këtyre normave u bë e mundur pikërisht për faktin se bëhej fjalë për norma zakonore, domethënë norma të rrënjësura thellë në vetëdijen popullore, qoftë sepse gjykohehin të përshtatshme për të përmbushur kërkesat juridike shoqërore, qoftë sepse, të përthithura nëpërmjet përsëritjes së pareshtur prej tiparit shpirtëror të bashkanëtarëve, ato u përcollën prej brezit në brez bashkë me traditat më të shtrenjta. Dhe në këtë mënyrë, prej një karakteri detyrues juridik, që buron nga vetëdija e popullit, ky arriti t’i ruajë deri në ditët tona, edhe në mungesë të një pushteti të fortë, që ta detyronte t’u përmbahej atyre. Nëse do të kishin qenë ligje të krijuara nga Lekë Dukagjini apo nga bashkëkohësit e tij, turqit, që zotëronin viset arbërore në kohën e Lekë Dukagjinit, nuk do ta kishin të vështirë të çrrënjosnin atë që, duke lindur pothuaj në të njëjtën kohë me dyndjen e tyre, nuk do të kishte as fuqinë e traditës që ta ndihmonte.

Përkundrazi, ata nuk e bënë asnjëherë këtë, madje në hapësirën e pesë shekujve vulosën rëndësinë e këtyre zakoneve, duke u orvatur të bëjnë një kodifikim të tyre.

Kanuni i Lekë Dukagjini përbëhet nga tri pjesë. Pjesa e parë i referohet organizimit familjar e shoqëror, pjesa e dytë organizimit ekonomik dhe pjesa e tretë së drejtës ndëshkimore. Krahasuar me botimin e parë të Kanunit të Lekë Dukagjinit nga Gjeçovi, ka një ndryshim në tri aspekte: 1) botimi i parë ka paraqitur si norma kanunore edhe mjaft rregulla fetare, të cilat nuk njiheshin e nuk zbatoheshin në Kanun, por që ishin imponuar nga Kisha për t'u zbatuar, ishin rezultat i ndikimeve të së drejtës kanonike; 2) janë parashikuar si norma kanunore edhe disa aspekte të ligjeve turke, të cilat pushtuesit synonin t'u impononin malësorëve; 3) janë përgjithësuar, njësuar e paraqitur si të mbarë kombit shqiptar disa norma që jo vetëm nuk ishin të tilla, por edhe në malësi, madje edhe në bajraqe të ndryshme, kishin dallime.

Lind pyetja: a mund të përmbliidhen të gjitha këto norma dokesore në Kanuni i Lekë Dukagjinit? Po të shohim të dhënat dokumentare, burime të ndryshme historike dalin në përfundimin se kjo përmbledhje e së drejtës dokesore duhet të emërtohej “Kanuni i Maleve”, pasi *mali* në kuptimin shoqëror administrativ ka qenë njësi themelore e vetëqeverisjes dokesore të malësorëve, të trevës ku është në fuqi ajo tërësi normash e së drejtës dokesore. Në traditën popullore thuhej “Kanuni i Maleve” ose “Kanuni i Lekës”. Nga ana tjetër, një argument i fortë, që bie në kundërshtim me titullin “Kanuni i Lekë Dukagjinit”, është dhe prania në Kanun e numri të madh normash që kanë ekzistuar para se të dilte si figurë Lekë Dukagjini. Ky i fundit mund të ketë ndikuar në lindjen e disa normave kanunore, por jo të konsiderohet si autori i një *corps juris*-i të një bashkësie krahinore, e cila për shekuj me radhë ka lindur, zhvilluar dhe ruajtur me fanatizëm zakonet e veta të pashkruara, duke rregulluar jetën e malësorëve në çdo drejtim, si një formë vetadministrimi tepër origjinale.

Engjëll Komneni, një figurë që i përket shekullit të 16-të, pas Aleksandër Dukagjinit, në gjenealogjinë e tij mbi princat shqiptarë e përmend Dukagjinin dhe jep të dhëna të sakta për jetën e tij, por vlen të theksohet se ai nuk ka përmendur asnjë vepër ligjvënëse të tij.

Vlen të theksohet gjithashtu se tradita popullore ka pasur tendencën për ta lidhur emrin e Aleksandër Dukagjinit me bashkësinë e normave zakonore, por ky konstatim mund të pranohet vetëm nëse do të pohonim se nuk është qëllimi t'i atribuohet Lekë Dukagjinit roli i posaçëm i ligjvënësit apo kodifikuesit. Me zbatimin praktik që u bëri i normave zakonore të vendit të tij, Lekë Dukagjini mund të konsiderohet një rivlerësues i tyre.

Me interes paraqitet konstatimi i Antonio Baldacit në veprën “Albania” për prejardhjen e familjes së Dukagjinasve, prejardhje kjo gjermanike. Sipas tij, duka Gjon ka ardhur në Shqipëri në shekullin e 12-të, pra me pushtimin norman, dhe u bë trangu i zanafillës për familjen Dukagjini, e cila shumë shpejt e shtriu sundimin e saj në territorin që përfshihet mes bregut të majtë të Drinit, burimeve të Fanit dhe territorit përreth Lezhës.

Lekë Dukagjini lindi rreth vitit 1410, një prej shokëve më besnik të Skënderbeut në luftën e udhëhequr prej tij ndaj Turqisë dhe është një nga trashëgimtarët e veprës së Kastriotëve, anëtar i shquar i familjes së Dukagjinasve. Historianët thotë se ai i qëndroi pranë Skënderbeu në çastet e fundit të jetës para se të vdiste në Lezhë në vitin 1467 dhe ishte i pari që njoftoi krerët shqiptarë të mbledhur në sheshin e Lezhës për vdekjen e tij. Ka vdekur në vitin 1477, i vrarë nga turqit gjatë rrethimit të Krujës. Me vdekjen e tij përfundon lufta e shqiptarëve kundër Mehmetit II. Në këtë periudhë, nisur nga pushtimi otoman, ishte shumë e nevojshme të zbatoheshin në mënyrë të rreptë normat zakonore. Qëllimi kryesor i forcimit të tyre ishte arritja e drejtpeshimit mes grupeve, kusht i domosdoshëm për luftën dhe për mbrojtjen. Kjo shpjegon dhe iniciativën e Lekë Dukagjinit, në cilësinë e gjykatësit që shoqëronte pozitën e tij të princit, për të mundësuar rivlerësimin dhe forcimin e normave zakonore.

Tradita nuk vonoi atëherë të tjetërsojë prurjen e njëmendtë të veprës së Aleksandër Dukagjinit dhe duke ngatërruar zbatimin e normave zakonore me krijimin e tyre, ia atribuoi drejtpërdrejt Aleksandër Dukagjinit. Të paraqitura si vepër e tij, prej famës që gëzonte për shkak të trimërisë së tij, ato në mënyrë të pashmangshme fitonin një peshë dhe një karakter detyrues më të madh. Kjo shpjegon arsyen pse Lekë Dukagjini nuk paraqitet jo vetëm si gjykatësi i urtë, i drejtë dhe njohës i thellë i shpirtit të popullit të tij dhe i ligjeve zakonore, por u paraqitet brezave pasardhës si kodifikuesi i tyre, aq sa populli i përcjellë brez pas brezi normat zakonore nën emrin “Kanuni i Lekë Dukagjinit”.

Po të analizojmë përmbledhjen e Gjeçovit, nuk flitet për rend apo për formacion fisnor të blegtorëve, as nga teksti nuk nënkuptohet një gjë e tillë. Nga një vështrim i përgjithshëm i normave të cituara në të, del se në rreth 140 paragrafë flitet për katundin e flamurin si bashkësi territoriale në kuptimin e organizimit administrative e dokesor, pra politik, në lidhje me territorin e pronën private dhe në asnjë paragraf nuk bëhet fjalë për fisin si organizëm shoqëror. Në Kanunin e Lekë Dukagjinit flitet shumë për pronën private, për tokën, për trojet e zëna. “Shtëpia



ka plëng, truall dhe pronat e veta”, - kështu thuhet në të<sup>167</sup>. Në Kanun flitet me hollësi edhe për kufijtë (paragrafët 238–265).

Për sa u përket ndëshkimeve në paragrafin 1196 thuhet: “*Shtëpia i digjet, pemët i priten, kopër shembullti e vreshta i sodumen, toka i lihet djerrë.*” Pra, bëhet fjalë për banorët që merren me bujqësi, me shtëpi të ngulur. Po të ishin blegtorë, dënimi do të ishte dëmtimi i tufës, gjë që nuk përmendet në Kanun. Një vend të veçantë zënë dënimet që jepnin kuvendet sipas Kanunit të Maleve, të cilat nuk ishin vetëm me gjobë, por edhe dënim me vdekje, dënim me djegie e rrënim të gjithë pasurisë. Këtu gjobat ndaheshin për shtëpi. Ky Kanun njihte edhe pengun, i cili i lëshuar në Kanun nuk kishte rëndësi si vlerë materiale, çfarëdo të ishte, por vetëm si pranim nga ana e ndërgjyqësit për t’iu nënshtruar gjykimit në Kanun e asgjë më tepër. Parimi “*plak mbi plak, gjyq mbi gjyq e be mbi be kanunaja nuk ban*” duhet kuptuar jo si parim i pagabueshmërisë së pleqve, se ata me dashje ose pa dashje edhe mund të gabonin, por si pranim i ndërgjyqësve, se çështja është zgjidhur drejt në Kanun, si pëlqim i zgjidhjes. Kanuni njihej mjaft mirë si nga pleqtë, ashtu dhe nga ndërgjyqësit, të cilët ndihmoheshin nga disa këshilltarë të quajtur çekicë. Këta ndihmonin për të kuptuar ecurinë e gjykimit. Veç kësaj palët donin që çështja të zgjidhej shpejt, ndërsa pleqtë kërkonin të fitonin garanci morale sipas interesit të tyre. Gjatë gjykimit, po të mos i pëlqente njërës palë, vendimi mund të shtonte sa të donte numrin e pleqve. Në rast se zgjidhja pranohej menjëherë, domethënë sipas Kanunit, të pihej kafja e të laheshin opingat, çështja konsiderohej e mbyllur dhe ajo nuk mund të gërmohej më, veç me pushkë, duke e çuar gjakun te dera. Pranimi i zgjidhjes, fjala e dhënë nuk bëhej dy. Në këtë prizëm duhet kuptuar përmbajtja e paragrafit 1002. Studimi i të gjitha degëve të së drejtës dokesore duhet bërë në kuadrin e përgjithshëm ekonomiko-shoqëror.

Në dispozitat me karakter penal të bie në sy kreu “*Mbrashtina kundër jetës dhe shëndetit*”, ku është parashikuar vepra penale e vrasjes në familje. Për anëtarë të veçantë të familjes është parashikuar dispozitë më vete, si: vrasja e fëmijës, vrasja e prindërve, vrasja e vëllait, vrasja e motrës, vrasja e gruas, e burrit, e kunatës. Nga sa më sipër. arrijmë në përfundimin se i është kushtuar një rëndësi e madhe mbrojtjes së jetës së anëtarëve të familjes, duke pasur parasysh rëndësinë e madhe që zinte familja në bashkësitë krahinore të asaj kohe. Parashikimi i kësaj vepre penale sipas subjekteve të veçanta ka dashur t’i marrë këto subjekte në mbrojtje të

---

167. Kanuni Lekë Dukagjinit, Paragrafi 213-230.

posaçme për të rritur solidaritetin në bashkësi, që ishte një element shumë i nevojshëm për vazhdimësinë e jetës në *male*.

### 5.1. Ndikimi i ligjit agrar te Kanuni i Lekë Dukagjinit

Ligji agrar ka ndikuar në aspekte të veçanta te Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe nga vështrimi krahasues me të gjejmë parashikime gati të njëjta të situatave të ndryshme ligjore. Gjithmonë krahasimi do të bëhet mes dispozitave që mbrojnë të drejtën e pronës. Kështu, neni 23 i ligjit agrar parashikon: *“Në qoftë se një lopar merr që në mëngjes nga një bujk një ka, e bashkon atë me kopenë dhe ndodh që kaun e ha ujku, le t’i tregojë të zotit të kaut kufomën dhe nuk do të dëmtohet.”*<sup>168</sup>

Këtë dispozitë e gjejmë të parashikuar në paragrafin 148 të Kanunit të Lekë Dukagjinit, ku thuhet: *“Po thej qafën a u kafshue prej bishës ndo’i berr, bariu a’ në detyrë me ia çue shejin të zotit e tjetër detyrë si ka.”*<sup>169</sup> Gjithashtu ngjashmëri me parashikimin ligjor të mësipërm të ligjit agrar kemi edhe në paragrafin 195 të Kanunit të Lekë Dukagjinit, në të cilin thuhet: *“Po e kaptoi kan bisha a e xu gjarpni në male bulku e gjet cofët, do t’ia çojë të zotit lkurën a ndoi shenjë tjetër.”*<sup>170</sup> Këto dispozita parashikojnë përjashtimin nga detyrimi i pagimit të dëmit të shkaktuar pronarit të një sendi.

Neni 24 i ligjit agrar parashikon: *“Në qoftë se një lopar merr një ka të cilin e humbet dhe nuk vë në dijeni brenda ditës të zotit se kaun e ka parë deri në këtë vend dhe më pas s’di ç’u bë, është fajtor; në qoftë se e njofton, është i pafajshëm.”*<sup>171</sup>

Të njëjtin rregullim gjejmë edhe në paragrafi 149 të Kanunit të Lekë Dukagjinit, që thotë: *“Po ia vodh kush ndon’ i berr bariut, detyra e këtij është me e ba me dije të zo’n e tufës, tuj ia kallxue vendin e kohën se ku e kur u vodh, tjetër detyrë s’i ka.”*<sup>172</sup>

Një tjetër situatë e parashikon edhe neni 25 i ligjit agrar, që thotë: *“Në qoftë se një lopar merr një ka që në mëngjes nga një bujk dhe largohet, ndërsa kau, duke u ndarë nga kopeja e qeve dhe*

---

<sup>168</sup> Ligji Agrar, neni 23.

<sup>169</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 148.

<sup>170</sup> Po aty, neni 195.

<sup>171</sup> Ligji Agrar, neni 24.

<sup>172</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 149.

*duke u larguar në ara ose vreshta bën dëm, lopari të mos privohet nga rroga e tij, kurse dëmin ta paguajë.”*

Për një raste analoge paragrafi 145 i Kanunit të Lekë Dukagjinit parashikon: *“Po i bani dam kuej bariu me gja , i zoti i tufës e lan e jo bariu.”*

Ngjashmëri ndërmjet ligjit agrar dhe Kanunit të Lekë Dukagjinit gjejmë edhe për situata të tjera. Kështu, neni 28 të ligjit agrar parashikon: *“Në qoftë se një lopar betohet për humbjen e një kau ose plagosjen, ose verbimin e tij dhe pastaj vërtetohet në mënyrë të besueshme se nuk është betuar sinqerisht, t’i pritet gjuha dhe t’i paguajë zhdëmtimin të zotit të kaut.”* Ndërsa Kanuni i Lekë Dukagjinit në paragrafin 147 për të njëjtën situatë parashikon: *“Po i treti bariut ndo’i berr pa shej e pa dukë, i zotoi i tufës ka tagër me e çue bariun deri në be, po i u la me be, si ka tjetër detyrë.”* Gjithashtu gjejmë edhe një tjetër parashikim për situatë të ngjashme në paragrafin 196 të Kanunit të Lekë Dukagjinit: *“Po hupi kau pa shej e pa dukë, bulku do t’i ligjohet të zot’ me be se nuk ka gjaht në dam të bkaut.”<sup>173</sup>*

Një rast tjetër paraqet neni 31 i ligjit agrar, që thotë: *“Në qoftë se një pemë gjendet në një vend dhe ara e punuar apo parcela që gjendet pranë është kopër shembullt dhe mbulohet nga hija e pemës që është pranë, i zoti i saj t’i presë degët, në qoftë se nuk është kopër shembullt, të mos priten degët.”<sup>174</sup>*

Kanuni i Lekë Dukagjinit për të njëjtën situatë parashikon: *“Landa a pema që i ban dam arës së huaj me hije a do ta zhgulë i zoti, a do t’ia lajë damin e përveçëm të zot’ t’ arës.”* Këto parashikimi rregullojnë situatat që krijohen në dy prona private që janë afër njëra-tjetrës për të respektuar ushtrimin dhe gëzimin e së drejtës së pronësisë mbi këto prona.

Në nenin 38 ligji agrar parashikon një rast tjetër, konkretisht: *“Në qoftë se ndokush gjen një ka në vresht, në arë ose në ndonjë vend tjetër duke bërë dëm dhe nuk ia dorëzon atë të zotit të vet me synim që të kërkojë zhdëmtimin për tërë humbjen e prodhimit, por e ther ose e plagos atë, le të japë ka në vend të kaut, gomar në vend të gomarit ose dele në vend të deles.”<sup>175</sup>*

Për të njëjtën situatë Kanuni i Lekë Dukagjinit në paragrafin 743 parashikon: *“Po vrau kush në dam kan, lopën, kalin, mushkun, gomarin, dhin, delen, lan gjan.”<sup>176</sup>*

---

<sup>173</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 196.

<sup>174</sup> Ligji Agrar, neni 31.

<sup>175</sup> Po aty, neni 38.

<sup>176</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 743.

Neni 55 i ligjit agrar parashikon: “Në qoftë se dikush i vret një qen që ruan kopenë, nuk e denoncon dhe bishat bëjnë sulm në vathë dhe pastaj zbulohet vrasësi i qenit, të paguajë gjithë kopenë e dhenve së bashku me vlerën e qenit.”<sup>177</sup>

Për të njëjtën situatë Kanuni i Lekë Dukagjinit në paragrafin 182 parashikon: “Po vrau kush qenin në stel të vet, i ka 500 groshë të zot’ t të qenit.”<sup>178</sup>

## 5.2 Gjurmë të së drejtës gjermanike në Kanunin e Lekë Dukagjinit

Kanuni përmend si institucion djelmënë, që përbëhej prej të rinjve më të mirë të fiseve, të cilët kryenin funksionin e truprojës së kapedanit në paqe dhe në luftë. Ky institucion gjen ngjashmërinë tek e drejta gjermanike me emërtimin “Komiteti”, që më vonë nga Kuvendi i Përgjithshëm u quajt “Vegjelia”<sup>179</sup>. Të gjitha ngjashmëritë e përmendura më lart tregojnë qartë bashkëjetesën e dy paketave ligjore, që nëpërmjet parashikimeve të tyre kanë përcjellë realitetin e kohës kur trevat shqiptare kishin filluar të administroinin pjesërisht vendin e tyre.

## 6. Kanuni i Labërisë, vështrim krahasues me normat bizantine

E drejta zakonore shqiptare shtrihej jo vetëm në krahinat autonome, si Malësia e Shkodrës, Mirditës etj., por edhe në zona të tjera malore të banuara, si në Elbasan, Tiranë, Berat, Mallakastër, Vlorë, Çamëri, Korçë etj. Ajo kishte fuqi ligjore mbi popullatën, pa dallim feje apo diferencimi shoqëror. Si pjesë përbërëse, si një aortë e rëndësishme e kanunit mbarëshqiptar është edhe Kanuni i Labërisë.

Trevat e Shqipërisë së Jugut për shekuj me radhë i kanë rregulluar marrëdhëniet mes popullatave malore të Labërisë, Toskërisë dhe Çamërisë me anë të një *corpus juris*-i zakonor që mbante emra të ndryshëm në zona të ndryshme. Për shembull, nga Korça deri në Përmet quhej “Kanuni i Adetit”, në Çamëri e quanin shkurt “Adeti”, kurse në zonën e Labërisë, duke përfshirë Vlorën, Himarën, Kurveleshin, e quanin “Kanuni i Papa Zhulit” ose “Kanuni i Idriz Sullit”<sup>180</sup>.

---

<sup>177</sup> Ligji Agrar, neni 55.

<sup>178</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, neni 182.

<sup>179</sup> Taciti, *Gjermania*, kreu 13 dhe 14.

<sup>180</sup> “Shejzat”, Romë 1957, nr 23, f. 56–61.

Këtë pjesë tepër të rëndësishme të identitetit shqiptar, të drejtën e tyre zakonore, shqiptarët janë përpjekur në shekuj, pushtim pas pushtimi, ta ruajnë të gjallë e ta përcjellin brez pas brezi. Dëshmi e këtyre përpjekjeve janë edhe afirmimet që kanë bërë studiues të huaj në këtë drejtim. Një prej tyre mbetet, pa dyshim, Edit Durhami, e cila në veprën “Brenge e Ballkanit” është shprehur: “*Perandoritë e tjera erdhën e ikën, por ato kaluan mbi shpinën e shqiptarit si uji mbi shpinën e rosës [...] dhe ai ruajti zakonet dhe identitetin e tij*<sup>181</sup>.”

Kanë qenë të shumtë studiuesit e huaj që i kanë kushtuar rëndësi studimit të së drejtës zakonore në Shqipëri, duke e krahasuar atë me zakonet e vendeve fqinje. Përmendim këtu studiuesin japonez prof. Kazuiko Jamamoto, i cili ka bërë hulumtime të posaçme për problemet e etikës së Kodit Zakonor (Kanunit) shqiptar në planin krahasues. Ai thotë: “*Edhe struktura etike e shoqërisë homerike, e përbërë nga besa, nderi, miku, gjaku, buka dhe hakmarrja, duket se i përket kategorisë etike të një shoqërie pa autoritet shtetëror, përfaqësuar më së miri nga struktura e Kanunit*”<sup>182</sup>.

Kjo strukturë etike për të cilën flet studiuesi japonez përfaqësimin më të mirë e gjen në Kanunin e Labërisë për shkak të territorit gjeografik të Jugut shqiptar dhe marrëdhënieve të mira me shoqërinë helene, duke sjellë shkëmbim kulturash e zakonesh mes dy vendeve.

Ekzistenca e kanunit tregon qartë se në një shoqëri ku mungon autoriteti shtetëror, ky sistem vlerash ushtron dhe kontrollon ekuilibrin e shoqërisë, vetë sensin e drejtësisë, tregon se çfarë është e mirë dhe çfarë nuk duhet të bëhet. Në Kanunin e Labërisë janë parashikuar në unitet etika si një sistem vlerash, nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, parimet themelore juridike të mbrojtjes së nderit, burrërisë, fisnikërisë, besës, bujarisë, të gjakut dhe lirisë, ashtu siç pasqyrohen në të drejtën zakonore në kanunet e trevave të tjera. Këto parime mundësuan eliminimin e anarkisë. Ato janë zbatuar me fanatizëm nga kjo trevë pa forcën e shtetit, por me një autoritet tepër të madh. Respektimi i këtyre normave lidhej ngushtë me vetëqeverisjen e këtyre bashkësive dhe të pjesëtarëve të tyre, kurse mosrespektimi vinte në rrezik jetën kolektive të bashkësisë e të individëve. Këto rrethana kanë bërë që bashkësitë dhe organizmat e vetëqeverisjes vendore të reagonin ashpër ndaj të gjitha sjelljeve me rrezikshmëri shoqërore, me qëllim ruajtjen e unitetit të

---

181. “*Brenge e Ballkanit*”, 1991, f.104.

182. *The etical structure of Kanun and cultural implications, 2005, SHBA.*

bashkësisë dhe mbrojtjen e individit. Natyrisht, format dhe mënyrat e reagimit kanë ndryshuar gjatë zhvillimit historik të shoqërisë labe që nga bojkotimi, dëbimi e deri te vrasja e fajtorit.

Në kushtet kur nuk kishte shtet shqiptar të pavarur, nuk kishte kushtetutë e ligje të tij, Kanuni luante rolin e kushtetutës në rregullimin e marrëdhënieve juridike të popullsisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore, përfshirë edhe Labërinë. Edhe në shoqërinë e sotme labe ndeshen dukuri të Kanunit, sidomos në marrëdhëniet familjare e martesore, në marrëdhëniet civile dhe kontraktore, që i referohen mirëbesimit dhe lidhen në formë verbale, madje edhe në fushën penale, por duke e përjashtuar fenomenin e gjakmarrjes.

Kushtet historike nëpër të cilat ka kaluar Shqipëria, si dhe zhvillimi ekonomiko-shoqëror kanë qenë përcaktues që mjaft zakone të ktheheshin në norma të së drejtës zakonore, duke u bërë pjesë e sistemit të së drejtës. Pra, zakonet konsiderohen burimi kryesor i së drejtës zakonore dhe pas tij kemi vendimet e Kuvendit të Burrave, besëlidhjet e ndryshme, ndarjen e kufijve të tokave apo maleve etj. Të gjithë anëtarët e bashkësisë duhej të vepronin në përputhje me këto norma, nuk u lejohej vetëgjyqësia.

Rëndësia më e madhe qëndron në përpjekjet maksimale që ka bërë populli shqiptar për të minimizuar ndikimin e faktorit të huaj në të drejtën zakonore. Burimet historike kanë treguar se Perandoria Bizantine apo ajo Romake për shkak të kësaj qëndrese qenë e detyruar t'u njëhte bashkësive të ndryshme etnike format patriarkale të ekzistencës së tyre kombëtare si dhe normat e së drejtës zakonore për vetëqeverisjen vendore. E drejta zakonore shqiptare ka bashkëjetuar në simbiozë me të drejtën romake, bizantine, me Sheriatin e Perandorë Osmane, me të drejtën kishtarë, kështu që nuk mund të anashkalohen ndikimet e tyre tek ajo. Konkretisht do të ishte e drejta bizantine ajo që solli si formë të re dënimi implementimin në normat e kanunit të llojit të dënimit me prerje gjymtyrësh, të hundës, veshit etj. Origjinaliteti i normave kanunore u ruajt, dhe kjo lidhet edhe me origjinën tepër të lashtë të tyre, që nga Iliria. Sipas botimit “*E drejta zakonore Shqiptare*”<sup>183</sup>, e drejta zakonore e shqiptarëve të Jugut lidhet me emrin e Pirros, mbretit të Epirit. Këtë e mbështet edhe Shtjefën Gjeçovi, i cili në një studim të tij shprehet se rrethinat e Gjirokastër kanë shprehjen “me ba kuvend sipas Kanunit të Pirrit”.

Kanuni i Labërisë ka marrë emrin e Papa Zhulit, prift nga Zhulati, për të cilin thuhet se ka qenë edhe prijës i Kurveleshit, i njohur nga normanët gjatë pushtimit të tyre. Figura e Papa Zhulit i

---

183. *E drejta zakonore Shqiptare*, Botim i vitit 1989, f. 128.

takon kohës së Bizantit, çka dëshmon se gjurmët e Kanunit të Labërisë gjenden qysh atëherë dhe kanë vepruar në praktikë krahas monokanunit bizantin.

Është interesant fakti se kjo gojëdhënë për Papa Zhulin në Labëri ka shumë ngjashmëri me atë në malësinë e Veriut, që ia atribuon Kanunin mesjetar Lekë Dukagjinit, apo Kanuni i Skënderbeut, edhe pse nuk ka dokumente arkivore.

Edhe sipas analizës së mëparshme as Lekë Dukagjinit, as Skënderbeu dhe as Papa Zhuli nuk kanë qenë dhe nuk mund të jenë krijuesit dhe kodifikuesit e kanuneve respektive përderisa normat e kanuneve kanë origjinë shumë herët, por në rastin më të mirë ata mund të kenë bërë ndonjë ndryshim të normave të vjetra për zëvendësimin me norma të reja në përshtatje me kërkesat e kohës, ose kanë ushtruar autoritetin e tyre për zbatimin e këtyre normave.

Ndër risitë e Kanunit të Labërisë përmendim zgjerimin e pronës private në dëm të asaj të përbashkët, tendencën për të mbrojtur të drejtat e njeriut, në veçanti të gruas. Për herë të parë gruas iu njoh e drejta të punonte jashtë ambientit të shtëpisë bashkë me burrat, një risi kjo në kohën kur gratë rrinin të mbyllura dhe mbuloheshin me përçe. Një normë tjetër që mbronte figurën e gruas ishte edhe ndarja e saj pa sjellë si pasojë vrasjen. U ndryshua parashikimi i huazuar nga e drejta bizantine, dënimi i hajdutit me prerje të dorës nuk do të aplikohet më, ai u zëvendësua nga pagimi i zhdëmtimit të vlerës së mallit të vjedhur me njëfishin kur malli vidhej jashtë shtëpisë dhe me dyfishin ose pesëfishin kur ai vidhej brenda banesës. Pra, kemi zëvendësimin e një dënimi penal të rëndë: prerjen e gjymtyrëve, me aplikimin e një norme me karakter civil: zhdëmtimin e dëmit. Kjo flet për emancipimin e shoqërisë shqiptare dhe çlirimin e saj nga format e vjetra feudale. Një përpjekje të madhe ka bërë Kuvendi i Burrave në këto treva për të hequr gjakmarrjen si fenomen që vepronte për mbrojtjen e jetës, pasi nuk kishte autoritet shtetëror që të merrte në mbrojtje këtë të drejtë themelore, pra funksiononte si element vetëmbrojtës.

Në pjesën më të madhe Kanuni përmban norma të së drejtës zakonore të shekujve XVIII–XX, pa përjashtuar edhe norma më të hershme. Trajtimi i organizimit tokësor e shoqëror para krijimit të shtetit të pavarur shqiptar në njësitë e vetëqeverisjes vendore përbën një drejtim të rëndësishëm për të kuptuar e shpjeguar se bashkësia labe nuk ishte tribu fisesh nomade apo të mbyllura e të izoluara, por jetonte në një njësi tokësore me kufij e ndarje administrative të përcaktuara sipas traditës dhe ndikimeve të trashëguara nga Perandoria Romake, Perandoria Bizantine dhe ajo Osmane, konkretisht mëhalla, fshati, krahina. Mbi këtë bazë ndërtohej edhe struktura e

organizmave të vetëqeverisjes vendore, që nga plaku i fisit deri te Kuvendi i Burrave, me gjurmë të demokracisë gjinore dhe elemente të organizimit shtetëror nga ilirët deri te pashallëku i Janinës i Ali Pashë Tepelenës.

Rendi shoqëror, vëllazëria, fafësi, familja, brezat, gjinia, marrëdhëniet familjare e martesore në Kanun pasqyrojnë evoluimin nga bashkësia gjinore te rendi patriarkal në familje, me ndikime nga e drejta romake për *patërfamiljas* dhe me prirje zhvillimi gradual drejt njëfarë emancipimi në marrëdhëniet familjare. Shtylla kryesore qëndronte te martesa *monogame* e *egzogame* dhe pabarazia mes burrit dhe gruas si rezultat i ndikimit të madh të Sheriatit.

Rendi ekonomik është një pjesë e rëndësishme e Kanunit të Labërisë, i cili përfaqëson fushën civile të parashikuar dhe të rregulluar nga ky Kanun. Një vend i veçantë u është kushtuar normave kanunore që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile mbi pronën, kryesisht atë private, detyrimet kontraktore dhe trashëgiminë. Nga ana tjetër, kemi fushën penale me normat përkatëse, që parashikojnë veprat penale dhe dënimet për secilën prej tyre. Normat penale kanë parashikuar krimet dhe kundërvajtjet penale. Në rast se do ta krahasojmë këtë Kanun me Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe atë të Skënderbeut, do të konstatojmë mjaft dallime dhe ngjashmëri mes tyre.

Dallimi i parë konsiston në datimin e secilit prej tyre. Kanuni i Labërisë, sipas burimeve popullore, daton në shekullin e 11-të ,kurse dy të tjerët në shekullin e 15-të. Ndryshim tjetër ka të bëjë me territorin ku këto kanune kanë vepruar. Kanuni i Labërisë i përket Shqipërisë Jugperëndimore, kurse dy të tjerët malësisë së Veriut. Ngjashmëria midis tyre ka të bëjë me etikën, sistemin e vlerave të larta morale që përcjellin, parimet kryesore juridike të së drejtës zakonore shqiptare, që i mbijetoi faktorit të huaj në shekuj. Mënyra e organizimit të brendshëm shoqëror është e njëjtë tek të tria kanunet, pasi ajo mbështete te lidhjet fafëfisnore në vëllazëritë e mëdha e të vogla, në institucionin e pleqve e të kuvendeve të burrave, si organizma të vetëqeverisjes vendore, në rregullimin e marrëdhënieve të pronësisë, të trashëgimisë, të detyrimeve e deri te rregullat e hetimit e të gjykimit të çështjeve.

Kanuni i Labërisë rregullonte marrëdhëniet juridike ndërmjet çifligarëve, marrëdhëniet civile e kontraktore të pronarëve të tokave e të bujqve, të agallarëve, të pronarëve të kopeve të bagëtive e të çobanëve, që e dallojnë dukshëm Kanunin e Labërisë nga Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe ai i Skënderbeut në Veri të Shqipërisë. Dallime të rëndësishme vërehen në marrëdhëniet familjare e martesore. Fiset dhe familjet e mëdha patriarkale në Labëri që nga gjysma e dytë e shekullit të



18-të dhe fillimi i shekullit të 19-të ishin drejt shpërbërjes së plotë, për t'ua lënë vendin vëllazërive, familjeve të mesme e të vogla, të ndara nga trangu prindëror, me ekonomi më vete, të vogël apo të mesme. Tradita gojore dëshmon se familja labe në pjesën më të madhe përbëhej nga 10 deri 20 veta, maksimumi deri në 30 veta, ndryshe nga zonat e Veriut, ku vepronte Kanuni i Lekë Dukagjinit dhe i Skënderbeut. Në këto të fundit familja arrinte deri në 100 veta. Zakonet e tjera ishin skllavëruese për gruan. Ato nuk i njihnin asaj të drejta në krahasim me burrin, veçse i mbronin nderin asaj. Një dallim tjetër mes Kanunit të Labërisë dhe dy kanuneve të tjera ka të bëjë me organizimin e vetëqeverisjes vendore. Në këtë Kanun nuk njihet pozita dhe privilegjet e Derës së Gjonmarkajve si të Kanuni i Lekës, nuk njihet instituti i bajraktarit, i krerëve të fiseve, por pranohet roli i kuvendeve, i pleqve, i parisë së vendit, i vegjëlisë, i gjyqit të pleqve. Marrëdhëniet tregtare me vende si Greqia, Italia bënë të mundur përparimin e normave të Kanunit të Labërisë. Ky Kanun është ndërtuar mbi bazën e normave të së drejtës zakonore në unitet me anën etiko-morale të tyre. Nuk përjashtohen edhe doke apo zakone që kanë lidhje më organike me normat e së drejtës zakonore. Kjo shpjegon faktin se Kanuni paraqitet i kodifikuar me kërkesat e teknikës ligjore në formën e një kodi zakonor, duke ruajtur me besnikëri përmbajtjen e normave të trashëguara, të sistemuara sipas objektit të marrëdhënieve juridike që rregullohen.

Kanuni përbëhet nga 883 nene, ku janë parashikuar parime të përgjithshme si: liria, barazia, besa, nderi, organizimi territorial e shoqëror në njësitë vetëqeverisëse, rendi ekonomik, prona, barra mbi pronat e paluajtshme (servitutet), detyrimet dhe kontratat. Kemi një kre më vete për fajin dhe dënimet, llojet e veprave penale kundër personit, pasurisë etj., më tej vazhdohet me analizën për pjesën e rendit ekonomik krahasuar me dispozitat ekonomike.

## **7. Analizë krahasuese e Statutit të Durrësit si burim i së drejtës zakonore me ligjin bizantin**

Që të kuptosh botën e Arbërisë, pikësëpari duhet të kuptosh mënyrën se si funksiononte qyteti, pasi në Arbërinë e Veriut dhe atë të Jugut kemi një numër të madh qytetesh, ndërsa në Arbërinë e Mesme qyteti më i madh ishte Durrësi. Ky qytet kishte një epërsi të dukshme në krahasim me

qytetet e Veriut, dhe këtë epërsi ia mundësonte vendosja gjeografike. Asnjë nga qytetet e Arbërisë së Veriut nuk e konkurroi Durrësin deri në shekullin e 15-të në aspektin politik, ekonomik dhe kulturor. Ndryshimi që bënte diferencën e këtij qyteti ishte përqendrimi në një i të gjitha funksioneve qendrore, politike, ekonomike, të qarkullimit, kulturore dhe kishtarë. Durrësi u pajis me një mbrojtje trefishe muresh me kulla, që sigurohej në ngushticën veriore me një ledh prej tullash dy metra të trashë<sup>184</sup>.

Gjurmët e Bizantit vazhdonin të jetonin në zonën e përzier fetare të Durrësit, kurse Arbëria e Veriut ishte nën ndikimin e Italisë. Kufiri mes dy botëve, asaj latine dhe asaj greke, në Arbërinë mesjetare gjendej pikërisht në qytetin e Durrësit, i cili ka një histori kushtetuese, dëshmi e vërtetë e këtij ndikimi të dyfishtë. Ndikimi bizantin në qytetari mbizotëroi në Jug të Arbërisë dhe arriti deri në Durrës, pa mundur të shtrihej në Veri, ku spikat ndikimi serb.

Qytetet bizantine të Arbërisë karakterizoheshin nga mungesa e një kushtetute qytetare (statut) dhe e autoriteteve komunale vetjake të ngulitura në to. Qyteti bizantin nuk organizohej në komuna. Banorët e tij, sipas kodit zakonor romak, pavarësisht nga shtresëzimi, ishin të barabartë para gjykatave. Privilegjet klasore që dallonin në qytetet dalmate nuk ishin pjesë e një të drejte të shkruar. Statuti i Durrësit, ashtu si dhe statutet e qyteteve të tjera, deri vonë njihej vetëm nga fragmente dokumentesh, ku për Durrësin flitet se ka pasur një kushtetutë të tillë në vitin 1392. Deri më sot nuk është bërë ndonjë përpjekje për t'i rindërtuar këto statute, ashtu siç ka ndodhur me Ulqinin dhe Tivarin. Për statutet e këtyre dy qyteteve u bë përpjekje që të rindërtoheshin duke u mbështetur në lutjet e komunave drejtuar Venedikut në shekullin e 15-të<sup>185</sup>. Si tekste krahasimi u morën statutet e vendeve të afërta me Arbërinë: Kotori (nga fillimi i shekullit të 14-të) dhe Budva (1349–1351)<sup>186</sup>. E drejta zakonore u bë pjesë e statuteve, fenomen që arriti deri në Durrës, por jo në Jug, ku mbizotëronte fryma bizantine. Policia në Durrës drejtohej nga një *magister iuratus*, që zgjidhej nga qytetarët<sup>187</sup>.

Në Durrës mbijetesën e *universitas* në formën e vet të mirëfilltë si asamble popullore pa këshilla të veçantë. Dera e Topijave pengoi krijimin e një qyteti të modelit arbëror verior-dalmat dhe nuk u bë asnjëherë komunë e vërtetë<sup>188</sup>.

---

184. Sufflay *Stadte* 19, Praschniker-Schober 46, Saradi 104 v dhe 116.

185. Pertusi, Dulcigno, Për Tivarin 218, shënimi 21, Valentini Amministrazione 880v, shënimi 6.

186. D.Lopčić (1992), *Srednjovekovni statut Budve*. *Archiv za pravne i društvene nauke*. f. 12, 28, 231.

187. AAVII f. 150.

188. Ducellier, Façade f. 519-520.

Sipas Statutit, faktor pushteti në jetën qytetare ishin asambleja popullore, fisnikët dhe popularët, Kisha, por dhe noterët. Statuti, si shprehje e paraqitjes me shkrim të kushtetutave qytetare dhe jetës juridike, kishte parashikuar se për çdo veprim ligjor duhej të përpilohej një dokument nga noteri. Pra, noteri, i cili shpesh kryente edhe punën e mësuesit të shkollës<sup>189</sup>, ishte shumë i lidhur me jetën ekonomike, shoqërore dhe politike të komunës. Durrësi, si një nga qytetet më të mëdha, kishte disa noterë të njohur zyrtarisht (*notaries publicius*), të cilët nuk ishin nëpunës të komunës<sup>190</sup>.

Deri në vitin 1400 noteria në Durrës përdorte si gjuhë zyrtare greqishten, më vonë filloi të ndihej ndikimi i gjuhës serbe të kancelarisë. Pas vitit 1434 kjo u bë gjuha e vetme e shkrimit. Në Durrës takoheshin sferat e greqishtes bizantine e të serbishtes mesjetare me latinishten, e cila mbisundonte në qytetet bregdetare dhe pjesërisht edhe në Shkodër. Në Durrës kishte dy lloj noterësh: latinë dhe grekë dhe klientela e tyre nuk ishte e ndarë sipas besimeve.

Venediku i ka konfirmuar që në vitin 1392 statutet e qytetit-port, por nga frika e Topijave dorëshkrimi i Statutit të Durrësit arriti të fshihej dhe u zbulua më vonë në manastirin françeskan të qytetit. Për shkak të kësaj Senati, që funksiononte në këtë qytet, hamendësoi se qytetarët nuk do ta futnin sërish Statutin në fuqi kur e drejta venedikase të kishte zëvendësuar statutet durrsake të vitit 1398. Këshillimi që u bë për këtë arsye me *boni bomines* u hoq zvarrë për disa vjet. Me sa kuptohet, qytetaria kërkoi ruajtjen e juridiksionit të deriatëhershëm dhe në vitin 1401 dërgoi pjesë të Statutit në Venedik që të miratoheshin nga Senati. Republika e Shën Markut e pranoi këtë vendim dhe pas lutjeve të komunës e konfirmoi qartazi të drejtën zakonore qytetare të vitit 1423<sup>191</sup>.

Duke iu referua statuteve durrsake, konstatojmë se edhe në vitin 1440 mbrojtën kërkesat e tyre ndaj Sinjorisë<sup>192</sup>.

Durrësi nuk reshti kurrë së mbrojturi kushtetutat e tij kundër njëjtësimin të administratës së Arbërisë Venedikase, që bëhej pa u ndier. Në marrëveshjet përkatëse të dorëzimit Venediku duhej të zotohej shprehimisht se do t'i respektonte statutet, po kur ndodhi si në Ulqin në vitin 1412, që nuk gjendej më dorëshkrimi i Statutit, shqetësimi ishte shumë i madh<sup>193</sup>.

---

189. AAV III 1178)

190. AAV III 721 për vitin 1398.

191. Valentini, Appunti 218 v, Malltezi Qytetet 201 vv.)

192. AAV XVII 3938 bis.

193. Valentini, Appunti 219vv.

Lufta e qyteteve për të mbrojtur statutet e tyre u dobësua nga shekulli i 15-të, për shkak se ishte keqësuar gjendja politike e komunave kundrejt Venedikut. Përparimi osman i shtyu qytetet në anën e Venedikut, të cilit i duhej të bashkonte përpjekjet mbrojtëse duke u mbështetur mbi burimet vendase.

Nga shekulli i 8-të në Durrës filloi të dobësohej autoriteti juridik i Bizantit. Nën ndikimin e Perëndimit, kryesisht të normanëve dhe anzhuinëve, pas shekullit të 12-të filluan të krijoheshin formacionet e reja shtetërore dhe fusha e jurisprudencës dominohej nga shkollat e Bolonjës dhe të Padovës. Në shekullin e 14-të, kur mbizotëroi ndikimi nivelues i Venedikut, vazhdonte të ishte e drejta bizantine në zbatim, por tashmë ajo paraqitej e modifikuar nga elementi juridik i ardhur nga Italia. Pas marrjes së Durrësit nga Venecia, u konfirmua se do të ruheshin statutet lokale dhe zakonet e mëparshme. Venecia kërkesave të shumta që i vinin për këtë problem iu përgjigjej se *“në këtë rast jemi të prirur të besojmë traditat, sinonim i statuteve ose ligjit zakonor të gfarëdo lloji...”*<sup>194</sup>

## KAPITULLI V

### **Venediku, ndikimi i tij si një faktor i huaj, gërshetimi i tij me pushtimin bizantin në trevat shqiptare**

#### **1. Vendosja e regjimit venedikas në trevat shqiptare**

Furia osmane paraqiti si zgjidhje emergjente para fuqive të mëdha të asaj kohe (Mbretëria Hungareze, Republika e Venedikut etj.) të merrnin masa kundër ndryshimeve tepër shqetësuese të situatës politike në Europën Juglindore. Ndërhyrja e pushtetit venedikas në Arbëri dhe Greqi rreth viteve 1400 nuk erdhi si rezultat i ndonjë marrëveshje me fuqitë e tjera, por i parapriu kërcënimit të interesave të saj në Lindje. Me interes është fakti historik që sundimtarët vendas të

---

194. Valentini G. *Studime dhe tekste juridike*, f.31.

Arbërisë e thirrën Venedikun në ndihmë kundër osmanëve, ftesë kjo që Sinjoria iu përgjigj pas shumë vjetve hezitim. Në pikëpamje të parë duket se kemi të bëjmë me një angazhim thjesht në planin mbrojtës, më konkretisht sigurimi i rrugëve detare adriatike dhe paqëtimi i viseve bregdetare arbërore. Porti i Durrësit në vitin 1392 u bë protektorat venedikas, duke konsideruar si një gur themeli për një provincë të re në brigjet arbërore Arbërinë venedikase, e cila së shpejti do të përfshinte treva të gjera të Arbërisë Veriore dhe Malit të Zi të sotëm. Venediku nuk e kishte ngritur shtetin e tij përtej detit për të nxitur zhvillim ekonomik të këtyre trevave apo për t'u siguruar atyre një administratë të qëndrueshme. Politika e Venedikut kishte si synim zgjerimin e hapësirave mesdhetare lindore për të dominuar tregjet e Detit të Zi, pra kërkonte të siguronte një urë lidhëse për kalimin e mallrave nga tregjet e Orientit për në Europë, për këtë qëllim Adriatiku konsiderohej arteria kryesore e lundrimit detar venedikas. Si fuqi e natyrshme mbrojtëse e Ballkanit Perëndimor ofrohej tani Venediku, i cili kishte qenë i përfaqësuar prej kohësh në Arbëri me konsujt dhe tregtarët e tij<sup>195</sup>.

Në atë periudhë Arbëria ishte një nga vendet ballkanike në konflikt, në të cilin shtetet perëndimore kërkonin të ndalnin revanshin otoman. Por ky impenjim nuk kishte kufizim në kohë, për këtë arsye Venediku vendosi një administrim të qëndrueshëm të qyteteve bregdetare arbërore. Ai nuk gjeti një shoqëri të prapambetur në këto troje, por një organizim komunar, një fisnikëri të pasur province, bashkësi të mëdha fshatare, dyer të fuqishme të princave. Legjenda venedikase filloi në vitin 1396 me udhëtimin e disa fisnikëve venedikas drejt Shkodrës dhe përfundoi me një tablo tronditëse: qytetarët shkodranë, që u mbijetuan rrethimeve osmane në vitin 1479, u larguan nga Rozafa e iu drejtuan bregut për tek anijet venedikase dhe u larguan drejt tokës italiane. Për gati 80 vjet Venediku shërbeu si një pengesë për trupat otomane në trevat shqiptare. Vetëm marrëdhëniet ekonomike me Venedikun dhe Raguzën mundësuan futjen në Arbëri të mjeteve financiare dhe të armatimeve në këmbim të prodhimeve bujqësore. Gjithashtu vetëm mbështetja ushtarake e Venedikut arriti ta shpëtonte Arbërinë për një kohë relativisht të gjatë. Lind pyetja: si i mbrojtën banorët e provincës venedikase trashëgiminë e tyre juridike, sociale ekonomike dhe fetare përballë përpjekjeve të Venedikut për njëjtësim? Sa venedikase u bë Arbëria?

Në pikëpamje ekonomike Arbëria shfaqte shumë pak interes për Venedikun, me rëndësi ishin vetëm portet arbërore, që natyrisht prapë nuk mund të krahasoheshin me Korfuzin me më shumë

---

195. Nicol, *Despotatë 160 vv'Antonovic 163v*.

vlerë. Dorëheqja nga Vlora në vitin 1386 nuk kishte ndodhur nga kujdesi ndaj Muratit, por për shkak të skelës së keqe të qytetit. Kur Republika e Shën Markut filloi të shfaqej gjithmonë e më fort mes viteve 1386–1394 në hapësirën arbërore e së fundi mori edhe sundimin mbi Durrësin dhe Shkodrën, ajo vepronte e shtyrë nga zhvillimet e përshpejtuara politike dhe jo si forcë nxitëse që kërkonte me çdo kusht t'i ngushtonte sundimtarët territorialë arbërore e të vinte aty mëkëmbësit e vet. Askund venedikasit nuk u shtynë brenda tokës, ata mjaftoheshin gjithmonë me kështjella të forta portesh, të cilat plotësonin sistemin e bazave detare dhe mund të mbroheshin lehtë nga deti<sup>196</sup>.

Në pikëpamje të parë Venediku pati miratimin e popullatës vendase, pasi nuk preku rrethanat juridike e sociale jashtë qyteteve, vazhdoi të ekzistonte sistemi bizantin i pronjave dhe i komunave fshatare, vetëqeverisja e fiseve edhe pas disa përpjekjeve venedikase për centralizimin e tyre. Sundimi real i venedikasve u kufizua në territoret qytetare, të cilat shërbenin njëkohësisht si kryeqendra të qarqeve. Kjo është dhe arsyeja që gjatë regjimit venedikas qyteti dhe krahinat morën zhvillim të ndryshëm.

Gjatë administrimit të provincave arbërore Venediku nuk mbajti parasysh as ekonominë dhe as rrethanat e tjera të vendit, thjesht u përpoq të administronte me sa më pak shpenzime. Nga pikëpamja ekonomike Arbëria nuk shfaqte interes për Venedikun, rëndësi kishin vetëm portet detare, por jo të gjitha, për shembull, Vlora nuk u preferua për shkak të skelës së keqe të saj. Përfshirja e një vendi në shtetin Venedikas ishte *ultima ratio*, pasi nuk kishte dhënë rezultat asnjë metodë tjetër. Strategjia e Venedikut ishte mbështetja me të holla dhe mjete luftarake të udhëheqësve vendas të vegjël të ndodhur nën kërcënim. Në qoftë se rreziku nuk pakësohej, Venediku ngrinte një protektorat, i cili në thelb qëndronte në mbrojtjen e vendit përkatës<sup>197</sup>. Para se të vendosej në një trevë të caktuar, Venediku mbështetej te një grup qytetarësh të tij të vendosur më parë në këto vende, pasi rreth tyre mbledhej një grup vendas besnik ndaj tij. Nuk mund të konsiderohet vendosja venedikase si një kolon e pestë, pasi Venediku nuk mund të ndikonte vullnetin politik në Arbëri. Rolin kryesor në vendimmarrjen e ngulimeve venedikase e kishte gjithmonë Senati, i cili tregoj mjaft i kujdesshëm. Ai udhëhiqej nga ruajtja e boshtit të politikës në Europën Juglindore dhe vlerësohej me shumë maturi kërkesat e princërve të vegjël ballkanikë, të cilët parashtronin situatë të vështirë ekonomike. Venediku i ka qëndruar gjithmonë

---

196. Oliver Jens. Schmitt, *Arbëria Venedike 1392-1479*, f. 222 .

197. Valentini, Appunti 212v.

besnik synimit të tij kryesor: zgjerimit të tregtisë në Levant dhe jo krijimin e një perandorie koloniale bregdetare të Arbërisë. Dokumentet që pasqyrojnë veprimtarinë venedikase në asnjë rast nuk flasin për ekzistencën e një plani perandorak. Këtë e kishin kuptuar mjaft mirë edhe princat arbërorë, të cilët kishin besim të plotë se vetëm Venediku do t'i mbështeste në zmbropsjen e osmanëve, prandaj u forcua shumë bashkëpunimi mes tyre.

Kishte raste kur trysnia e Perandorisë Osmane bëhej kaq e padurueshme, sa që princat vendas ishin të gatshëm të bënin lëshime për Venedikun, si për shembull, rasti i Gjergj Topisë në vitin 1388, i cili u dorëzoi kullën e portit dhe kontrollin mbi skelën më të rëndësishme detare, gjithashtu iu lejua kapitenit të trupës ndihmëse ndikim i gjerë në politikën qytetare<sup>198</sup>. Venedikut i duhej të mbante ekuilibrin midis strukturave të pushtetit në Ballkan dhe njëkohësisht pozicionin e vet në Italinë e Veriut. Të dyja këto anë të peshores kishin synime të ndryshme: Levanti kishte sigurimin e rrugëve detare dhe pengimin e ekspansionit osman drejt brigjeve duke ngritur baza për flotat detare, Italia e Veriut kishte jetike mbajtjen e rrugëve për qarkullimin e mallrave dhe pengimin e strukturave të reja hegjemone. Pjesa veriore e Italisë i siguronte Venedikut rrugën ndërlidhëse me Gjermaninë për të përcjellë atje mallrat e Orientit. Pra, duke vlerësuar këto politika të Venedikut, Arbëria ishte një qëllim dytësor. Nga trashëgimia e shtetit bizantin Venediku mori kontrollin mbi rrugët tregtare në Detin e Zi.

## 2. Legjislacioni që zbatoi Venediku në Arbëri

Pozita juridike e qarqeve arbërore të *Stato da mar* ishte e përcaktuar nga fakti se si kishin rënë dakord me *Sinjinë* në kohën e zbarkimit të tyre në trevat shqiptare. Arbëria në vigjilje të vendosjes së Venedikut karakterizohej nga kushtetutat e veta qytetare (statutet) dhe nga një traditë e mirë vetadministrimi. Nëpërmjet këtyre dy elementeve qarqet arbërore i mbrojtën me ngulm të drejtat e tyre. Po ta krahasojmë me Greqinë e asaj kohe, konstatojmë se Greqisë i mungonin këto struktura që kishte Arbëria, për këtë arsye Venediku ndryshoi politikën e tij atje, duke kërkuar një pushtet të plotë, që e kishte më parë perandori bizantin. Ekzistenca e një tradite

---

198. AAV II 360, 361, 367, *Ducellier, façade, 495.*

komunale e detyroi Venedikun që t'u përshtatej të drejtave të sundimtarëve të mëparshëm, situatë kjo e përcaktuar në statutet e qyteteve<sup>199</sup>.

Për të bërë një analizë të saktë e të plotë të situatës ligjore të asaj kohe, duhet të kemi parasysh se Arbëria Venedikase u karakterizua nga trazira politike dhe territoriale, tipar që u pasqyrua edhe në një legjislacion pa një strukturë monolite. Qytete të ndryshme të Arbërisë Venedikase u udhëhoqën nga një status shumë i ndryshueshëm juridik i sundimit venedikas. Në kohë të ndryshme regjimi juridik i Venedikut figuron i ndryshëm për qytete të ndryshme. Kështu, gjatë sundimit të parë venedikas, po të shohim qytetet Durrës dhe Shkodër, duke përfshirë dhe Drishtin, kemi një tablo të qartë të statusit juridik. Venediku kishte lidhur marrëveshje të qarta me sundimtarët e këtyre qyteteve, duke anashkaluar marrëveshjet e veçanta me qytetarin, në mënyrë që të përvetësonte të gjitha të drejtat e sundimit përkundrejt një pensioni vjetor që duhej t'u jepte sundimtarëve vendas. Kjo marrëveshje ishte e barabartë me heqjen dorë nga sovraniteti i sundimtarëve vendas ndaj këtyre qyteteve (Balshaj, Topiat). Humbja e sovranitetit dhe marrja e të gjitha të drejtave të sundimtarëve nënkuptonte administrimin e plotë të të gjitha pronave dhe tokave në këto qytete. Venediku trashëgonte të gjitha trojet e këtyre trevave, me përjashtim të atyre të trashëguara familjare. Kalimi në një mënyrë të tillë i qyteteve të blera si objekte juridike solli pabarazi në strukturën administrative.

Në lidhje me të drejtën vendase zakonore Venediku parapëlqeu që ta respektonte atë për aq kohë sa nuk binte ndesh me parimet kryesore të legjislacionit të tij. Megjithatë, duhet theksuar se ai zotëronte shumë mjete të tjera për të ndryshuar gamën e lëshimeve të tjera të bëra kundrejt normativave vendore, si: të drejtën e tërheqjes, zotësinë ligjvënëse të vetë princit, kontrollin mbi apelin etj. Konfirmimi i normave vendore kishte jo vetëm vlerë simbolike, por konsiderohej si garanci e rëndësishme nga ana e komuniteteve, që ishin të vendosura në mbrojtjen e të drejtave të tyre. Konkretisht kjo situatë citohet në librin e Valentinit ku thuhet se “Komuniteti duhet të qeveriset duke iu përmbajtur sa të jetë e mundur statuteve, rregullave dhe traditave, duke ruajtur, natyrisht, nderimin kundrejt Zotit dhe respektin për sunduesin. Në rast se duhet, të veprohet ndryshe, po ashtu, kur statutet, rregullat e traditat mungojnë, do t'i mbani e do t'i qeverisni ato

---

199. Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedikase 1392-1479*, f. 316.



vende e ata njerëz sipas asaj që do t'ju duket e drejtë dhe e arsyeshme në respektimin e Zotit dhe të drejtësisë.”<sup>200</sup>.

Në Lezhë sundimtarët dukagjinas i dhanë Venedikut sovranitetin e qytetit dhe të krahinave rreth tij, duke mbajtur për vete një të tretën nga të ardhurat e tregtisë së kripës, si një kufizim të sovranitetit venedikas mbi portin lumor të Drinit. Paraqitet shumë efikase mbrojtja e të drejtave komunale nga ana e vetë komunave, duke e detyruar kështu Venedikun të reduktonte sa më shumë oreksin e tij për të përfitur toka në këto treva. Në këto rrethana, komunat arritën të ruanin vetadministrimin e tyre, ndërsa Venediku shfaqte praninë e tij nëpërmjet një mëkëmbësi dhe një numri të vogël ushtarësh në këto zona. Pra, shfaqen komunat nën protektoratin venedikas, duke i ruajtur të gjitha të drejtat e tyre zakonore. Nga ky këndvështrim ato ngjasojnë shumë me komunat e Italisë së Veriut të asaj kohe<sup>201</sup>. Durrësi, edhe pse e dobësoi ndikimin e tij juridik në komunat e veta, arriti ta ruante ndikimin mbi autoritet venedikase, një situatë kjo krejt e ndryshme me atë të Ulqinit, ku, edhe pse ekzistonin marrëveshje të shkruara garancie me Venedikun, nuk mundi të ndalonte tjetërsimin e trojeve komunale nga ana e funksionarëve venedikas. Statutet e shkruara të qyteteve, edhe pse kishin garancinë e Venedikut, shkeleshin shpeshherë gjatë zbatimit të tyre dhe duhej ndërhyrja e qytetarisë, kurse përfaqësuesit e Venedikut nëpër komuna krijonin marrëdhënie të tilla me qytetarinë që ndikonin në ruajtjen e interesave komunalë.

Pozita juridike mjaft e ndryshme e komunave arbërore vinte si pasojë e mungesës së unitetit administrativ nën një “drejtues” të vetëm dhe ekzistencës së një numri qarqesh administrative të pavarur, që merrnin udhëzime nga qendra në Venedik. Nëpër qarqe Venediku ndërtoi një administratë heterogjene, me qëllim që të pengonte përqendrimin e pushtetit në duart e një sundimtari të vetëm. Nga ana tjetër, kjo ishte një zgjidhje që i përshtatej respektimit të marrëveshjeve paraprake me komunat. Mëkëmbësit e Venedikut nuk kishin një ndarje sipas hierarkisë, prandaj dërgoheshin nëpunës të ndryshëm për të zgjidhur problemet nëpër komuna. Pra, Venediku nëpërmjet këtij sistemi ka dashur të anashkalonte sundimin qendror të komunave, dhe kjo përputhet me qëllimet e tij, ndër të cilat parësore ishin ato ekonomike dhe jo pushtuese. Rëndësi të veçantë për Venedikun kishte Shkodra, e cila konsiderohej si pararoja e Arbërisë venedikase; ishte qarku i vetëm i Arbërisë Venedikase me 100 fshatra. Këtu Venediku u përpoq

---

200. Valentini, *Appunti sul regime degli stabilimenti veneti*, cit, f. 220.

201. HOCQUET, *Venezia e la Terraferma 113vv*.

të vendoste njëfarë rregulli në marrëdhëniet midis qarqeve administrative. Vlen të përmendim faktin se në vitin 1407 në Shkodër u ngrit një gjykatë apeli, që do të ushtronte funksionet e saj në gjithë Arbërinë venedikase<sup>202</sup>. Ky organizim juridiksioni ishte i vetmi që lidhte qarqet administrative venedikase të Tivarit, Ulqinit, Shkodrës, Drishtit, Danjës, Lezhës dhe Durrësit, që brenda shtetit venedikas të përtejdetit përbënin një qark juridik midis qarkut gjyqësor të Kotorrit dhe qarkut të Korfuzit<sup>203</sup>.

Një shfaqje tjetër të normave juridike të Venedikut ishte *aplikimi i pagesave kompensuese* në trevat arbërore, domethënë qarqet më të pasura, si Durrësi dhe Lezha, me urdhër të Senatit paguanin për qarqet më të varfra. Por ky nuk ishte një detyrim i përhershëm.

*Hierarkia që zbatonte Venediku në trevat arbërore:*

- Zbatimi në radhë të parë nga *ius scriptum* i vetë komunitetit, e thënë ndryshe, *statua ed ordiner*.
- Në mungesë të tyre mund t'u kërkohej ndihmë normave tradicionale.
- Në rast se edhe tradita nuk e zgjidhte problemin, i drejtohej arbitrimit të gjykuesit, përtej normës dhe aty ku ajo nuk arrin, referimi ka të bëjë vetëm me të drejtën e gjykimit dhe me ndërgjegjen e mirë<sup>204</sup>.

Ndër tiparet e autonomisë qytetare bënte pjesë prerja e monedhave, masa, pesha vetjake si dhe vula e qytetit. Statutet e qyteteve përcaktonin shumë qartë normat juridike që rregullonin jetën ekonomike të qytetarëve, për shembull: mbi bujqësinë, tregtinë, blegtorinë. Pronari i kafshëve detyrohej të paguante për çdo dëmtim. Jeta e qytetarëve-bujq rregullohej në statute në disa drejtime, si për shembull: sanksionohej detyrimi i të gjithë qytetarëve për të marrë pjesë në shuarjen e zjarreve në fusha gjatë verës së nxehtë; sanksionimi i pagimit të gjobës për çdo person që vendoste zjarrin me qëllim. Nga legjislacioni i asaj kohe del qartë karakteri agrar i qyteteve arbërore. Kështu, brenda dhe jashtë mureve të qytetit gjendeshin sipërfaqe toke të shumta, në të cilat kultivonin pemëtari dhe fruta, perime të ndryshme, që përbënin bazën e ushqimit të tyre. Dallimi mes një qytetari dhe një fshatari në kohën e Venedikut ishte shumë i vogël, pasi si brez lidhës mes tyre vepronte qytetaria agrare. Format ekonomike dhe mënyrat e jetesës ishin të

---

202. AAV V1302.

203. Valentini, *Appunti* 862v.

204. L.Pansolli (1970), *La gerarchia delle fonti nella legislazione medievale veneziana*, Milano, f. 113.

ngjashme mes tyre: të dy kultivonin vreshta, ullishte, kullotnin bagëtinë. Por në këndvështrimin juridik ka një ndryshim të madh mes tyre. Qytetet ishin të rrethuara me mure dhe bashkësitë e tyre qytetare gëzonin të drejta qytetare, vetadministrim, emblemë sovraniteti, si: monedha, vula, masa dhe pesha. Nga ana tjetër, kemi një vend ku ekziston ende trashëgimia bizantine, një fshat me një larmi juridiksioni, mbijetesa e bashkësisë së vjetër fshatare, por edhe bashkëjetesa e Kishës Katolike me atë Ortodokse dhe pjesëtarë të bashkësive baritore, që vinin e vendoseshin kudo nëpër fshatra.

Në marrëveshjet e realizuara me princat vendas për dorëzimin e komunave del qartë pozicioni i zakoneve ligjore kundrejt së drejtës venedikase të sapovendosur. Dallohet përsëri ekzistenca e një sistemi jo të njëjtë edhe këtu. Pas marrjes së qytetit të Durrësit, Venediku në vitin 1392 premtonte se do të zbatonte të drejtën dhe drejtësinë sipas Statutit dhe rregulloreve të qytetit të Durrësit, çka nënkupton uzurpimin e plotë të së drejtës durrsake. Gjithashtu ishte pranuar se në ato raste kur statutet vendore nuk parashikonin zgjidhje për situata të ndryshme, do të aplikoheshin drejta venedikase. Po të analizojmë situatën në Shkodër, vihem para një situatë tjetër. Këtu Venediku u tregua më i rezervuar. Konkretisht, edhe pse premtoi se do të merrte parasysh rrethanat lokale të kësaj treve, ai parashikoi një rezervë ligjore: “gëzonte të drejtën për të kapërcyer ato dispozita të statutit shkodran që binin ndesh me të drejtën venedikase”. Termi i përdorur nga Venediku si peshore drejtësie ishte “dukej e drejtë dhe e arsyeshme”<sup>205</sup>.

Në lidhje me zbatimin e drejtësisë në këto treva u krijua një dualitet midis gjykatësve dhe rektorëve. Edhe pse me pranimin e statuteve gjykatësit komunalë u përfshinë në sistemin gjyqësor, ai që vendoste përfundimisht ishte rektori, kurse gjykatësit komunalë kishin thjesht funksione këshilluese. Të bie në sy fakti që rektori gëzonte pushtet të plotë për zbatimin e së drejtës penale, duke mënjeluar kështu çdo ndikim të brendshëm. Ky pushtet i rektorit bëri të mundur që shumë shpejt të gjitha normat penale venedikase të zëvendësonin ato vendase. Në të drejtën civile gjykatësve komunalë u njihej e drejta për ta aplikuar atë vetëm për rastet që kishin një vlerë të paracaktuar limitore në të holla.

Kjo situatë paraqitej në qytetet me një traditë të dobët komunale, si Lezha, në të cilën mungonin krejt gjykatësit komunalë, ndërsa në Durrës kemi gjykata lokale tepër të forta. Venediku në aspektin e sistemit juridik parapëlqente të ngrinte një sistem të vetin, sesa t’u jepte prioritet zakoneve vendore. Kjo dukej në veprimet e rektorëve, të cilët përpiqeshin të anashkalonin

---

205. AAV II 630.

vendimet e gjykatave lokale, edhe pse parimisht kjo nuk lejohej nga Senati. Rektori, duke pasur pozitën e gjykatësit të apelit, krijonte varësi të gjykatësve lokalë edhe për atë fushë ku ata kishin të drejtë të vepronin.

Përkundrajt kësaj superfuqie venedikase sistemi juridik vendas mundi të mbijetonte duke e kalimtar kohën vetëm me çështje të vogla me natyrë civile në disa zona, të cilat pushteti qendror i kishte lënë të lira.

Nuk ekzistojnë dokumente të shkruara për të parë se si kanë funksionuar gjykatat lokale, për të analizuar pastaj pasojat e njëjtësimit të sistemit juridik. Gjithsesi, aplikimi i legjislacionit venedikas nuk ka sjellë pakësimin e sigurisë ligjore. Sistemi juridik venedikas mbështetej tek e drejta për apelimin e vendimeve të mëkëmbësve venedikas. Qëllimi i Venedikut për të centralizuar pushtetin gjyqësor u shfaq me ngritjen e Gjykatës së Apelit në Shkodër, që drejtohej nga konti i Shkodrës, e cila bashkonte të gjitha qarqet në një çati, fakt ky që u kundërshtua nga vendasit dhe qarqe si Drishti dhe Tivari, pasi cenonte ndjeshmërinë e komunave rivale. Pati një rebelim të dukshëm ndaj kësaj gjykate, madje u kërkua që apeli të bëhej në Venedik e jo në Shkodër. Më në fund Venediku bëri një ndarje të çështjeve sipas një vlere të paracaktuar, duke kategorizuar kështu të drejtën e apelit edhe në Venedik për çështje me vlerë 100 dukate.

Po t'i referohemi fondit *Auditori Vecchi e Novi* në arkivin shtetëror venecian, do të gjejmë të dhëna mbi mënyrën se si ka funksionuar Gjykata e Apelit të Venedikut. Të bie në sy numri i paktë i çështjeve që arbëreshët kanë çuar aty për gjykim. Kjo shpjegohej me faktin se kanë qenë të pakta çështjet me një vlerë aq të lartë, prej 100 dukatesh, dhe udhëtimi për në Venedik ishte tepër i kushtueshëm. Ankuesit janë shtetas venedikas ose shtresa e lartë arbërore, për shembull, ekziston apeli i peshkëve të Shkodrës lidhur me një çështje për ekonominë e peshkimit.

Statutet dhe kushtetuta mund të konsideroheshin si një mendim juridik që mund të kuptohej vetëm prej fisnikëve arbër e senatorëve venedikas, kurse shumica e popullsisë së provincës venedikase e gjenin mendimin juridik te puna e gjykatësve apo noterëve. Ishin këta që sollën të menduarit juridik vendas dhe zakonet vendase në sistemin gjyqësor e në administratë, duke garantuar kështu vijimësinë e drejtësisë komunale. Venediku gjatë marrjes në dorëzim të qyteteve i kishte konfirmuar të gjitha vendimet dhe dokumentet e administratës së mëparshme, por në të njëjtën kohë kishte refuzuar çdo përgjegjësi ligjore për padrejtësitë që ishin bërë kohë më parë. Në këtë mënyrë garantohej siguria legale, por shmangej njëkohësisht gjallërimi i mënyrave të vjetra të veprimtimit.

Të gjitha çështjet me rëndësi të vogël Venediku ua la gjyqtarëve lokalë, numri i të cilëve në Shkodër dhe Ulqin ishte katër. Rektori kishte të drejtë të përqaste të drejtën lokale me atë venedikase sipas dijes dhe ndërgjegjes së tij. Një rëndësi të madhe për autonominë qytetare kishin noterët, puna e të cilëve dëshmonte se krahas autoriteteve venedikase vazhdonte të jetonte edhe komuna e vjetër<sup>206</sup>. Të gjitha qytetet, kur u vendos Venediku, kërkuan që noterët e tyre të vazhdonin punën, duke kundërshtuar kështu zëvendësimin e tyre nga mëkëmbësit venedikas. Megjithatë, u vu re se gradualisht në gjykata dhe në noteri po zhdukej ndikimi i komunave. Kjo nuk u bë qëllimisht nga Venediku, por u diktua nga procesi i gjatë i konkurrencës së noterëve venedikas me ata vendas. Pozita e noterëve venedikas u rrit si pasojë e fuqizimit të së drejtës venedikase dhe nga kryerja e shumë veprimeve nga ana e mëkëmbësve venedikas. Këta noterë, duke qenë në marrëdhënie të shpeshta me rektorin, arritën të njihnin sistemin ligjor në Venedik shumë më mirë se ata vendas. Këtë fakt e tregojnë kancelaritë venedikase në Arbëri.

### **3. Venediku, e drejta zakonore dhe takimi i tyre me Perandorinë Osmane**

Venediku ka qenë një prej fuqive kryesore detare në Mesdhe dhe, si i tillë, ka pasur rol dominues në tregtinë e Perandorisë Osmane me botën e krishterë. Këtë e tregon edhe fakti që Venediku ka pasur mbretërinë e vet koloniale në Lindje, gjë që i komplikonte akoma më shumë marrëdhëniet e tij me Perandorinë Osmane. Shtrirja e kësaj Perandorie në dëm të Bizantit për Venedikun nënkuptonte humbjen e territoreve tregtare, që deri atëherë i kishte eksploruar siç kishte dashur: i çliruar nga të gjitha taksat dhe nga çdo lloj kontrolli. Qeveria lokale në vendet më të rëndësishme të Lindjes, që përfshinin hapësirën prej detit Azov deri në Aleksandri, i ka lejuar Venedikut dhe Gjenovës privilegje tregtare.

Trysnia osmane, që vinte në rritje, sillte si pasojë afrimin e Arbërisë me Venedikun, kjo edhe për shkak se princat vendas nuk ofronin asnjë alternativë politike të re. Viti 1430 solli një ndryshim në Arbëri, pasi nën mbrojtjen e Venedikut u përmirësua mënyra e administrimit dhe jeta ekonomike e vendit. Ky zhvillim i dukshëm në periudhën 1430–1463 u siguroi nga Venediku

---

206. Oliver Jens Schmitt, *Arbëria Venedike*, f. 415.

me anë të një politikë që u përshtatej osmanëve dhe që nuk i merrte në konsideratë fisnikët e Arbërisë përballë sulltanit.

Për shkak të mësymjeve luftarake, Arbëria militarizoi një pjesë të konsiderueshme të shoqërisë, që u rekrutuan në ushtri si pronjarë ose si këmbësorë me rrogë në sistemin mbrojtës venedikas. Nga njëra anë pretendohet për monopolin e pushtetit shtetëror nga Venediku, nga ana tjetër kemi prirjen e vendasve në viset joqytetare për t'i zgjidhur vetë konfliktet e tyre me anë të vetëgjyqësisë. Mungesa e monopolit të pushtetit të një shteti qendror i hapi rrugë aplikimit të së drejtës zakonore, kanunit. Përhapje të madhe mori fenomeni vetëgjyqësisë, i pranuar edhe nga Venediku si një çështje e vështirë për t'u menaxhuar, për faktin se të dërguarit e Venedikut nuk largoheshin nga vendet e fortifikuara, duke lejuar kështu që vendasit nëpër krahina të vendosnin vetë rendin e tyre. Një rast i kësaj situatë të krijuar është ai i vitit 1445 në viset e Pastroviqit, ku disa përkras të Venedikut në këtë bashkësi kishin vrarë një të afërm dhe për të ndaluar hakmarrjen e njerëzve të tij u lidh një marrëveshje, një besë<sup>207</sup>, e cila u shkel, pasi të afërm të viktimit vranë dy nga njerëzit e vrasësit. Venediku, edhe pse iu kërkua nga familjarët e të vrarëve, nuk ndërhyri drejtpërdrejt në këtë konflikt, por u kujdes për familjarët e mbetur<sup>208</sup>. Venediku ushtronte vetëm një lloj proteksioni, ndërsa administrimin e çështjeve të brendshme ua kishte lënë vetë bashkësive. Pra, nuk kishte asnjë dispozitë të vendosur nga Venediku për fenomenin e gjakmarrjes, megjithatë duhet thënë se nuk mungonte vullneti nga ana e tij për të favorizuar pajtimin mes njerëzve të përfshirë në konflikt.

Vihet re një prirje e Arbërisë Venedikase për t'i zgjidhur konfliktet sociale jashtë ndikimit të sundimit venedikas në sistemin juridik. Kështu, si për shembull, konfliktet për vreshtat në zonën e Shkodrës apo të Ulqinit ishte i predispozuar për t'i zgjidhur me dhunë<sup>209</sup>. Dhunën e përditshme me natyrë kriminale shteti venedikas e toleronte më shumë. Bashkëveprimi i faktorëve përball kërcënimit të jashtëm, mungesa e sigurisë së brendshme, një monopol shtetëror i kufizuar, tradita e vetëgjyqësisë dhe gjendja e vazhdueshme e luftës bënë që shoqëria e Arbërisë së Veriut ta humbiste kontrollin mbi përdorimin e dhunës, siç kishte gjetur dikur shprehje e drejta penale serbe në Statutet e Shkodrës dhe të qyteteve të tjera. Kjo shpërbërje e monopolit shtetëror të dhunës në shoqërinë e Arbërisë Venedikase nxiti formimin e mekanizmave të rinj mbrojtës të

---

207. *Oliver Jens Schmitt, Arbëria Venedike, f. 415.*

208. *AAV XIX 5125.*

209. *AAV XVI 3938.*

shoqërisë në trajtat e fiseve e në plan afatgjatë forcimin e së drejtës zakonore të trashëguar gojarisht<sup>210</sup>.

Nënshkrimi i traktatit të paqes me Rusinë shënoi një fitore të re të përkrahësve të luftës me Venedikun në oborrin osman, ndërsa udhëheqësi i tyre, Armëtar Damat Ali pashai, mori postin e kryevezirit (27 gusht 1713–6 gusht 1716). Trysnia e brendshme mbi sulltanin për të synuar rimarrjen e Moresë u mbështet jo vetëm nga fanariotët, por edhe nga banorët ortodoksë, të cilët bënë thirrje për ndihmë ndaj sundimit katolik nën qeverisjen venedikase. Më në fund lufta u shpall (8 dhjetor 1714) kur Venediku trazoi një kryengritje në shkallë të gjerë kundër osmanëve në Mal të Zi dhe dërgoi anijet e tij për të bastisur anijet osmane të tregtisë e të pelegrinazhit që lundronin mes Egjiptit dhe Stambollit, duke shkelur kështu detyrimet e Traktatit të Karloviçit. Përmes një ekspedite tokë–det (verë 1715) kryeveziri arriti ta rimerrte pa ndonjë vështirësi të madhe Morenë. Interesat e Spanjës dhe të vendeve të tjera të Perëndimit diktonin vazhdimin e paqes së Habsburgëve me osmanët, por kërcënimi i sulltanit ndaj Dalmacisë e Kroacisë i shtyu austriakët që të rifreskonin marrëveshjen e tyre me Venedikun (13 prill 1716) dhe të kërkonin tërheqjen e plotë të osmanëve nga pushtimet e tyre më të fundit, si dhe të siguronin kompensim për Venedikun. Disa ministra osmanë, duke sjellë ndër mend humbjet e tyre ndaj Eugenit të Savojës, këmbëngulën që të tregohen kujdes, por kryeveziri e bindi sulltanin se osmanët ishin aq të fuqishëm, sa t'i mposhtnin Habsburgët dhe të rimerrnin Hungarinë. Lufta çoi shpejt në fatkeqësi të reja. Rakoçi Ferenc II, që kishte ikur në Paris pas pushtimit Habsburg të Hungarisë dhe Transilvanisë, u bashkua me sulltanin, me shpresën e rivendosijes së sundimit të tij pas fitores së pritshme (23 maj 1716). Fitorja e lehtë në More duket se krijoi te kryeveziri një vetëbesim të tepruar, sepse, kur u vu në marshim drejt Veriut, ai i la tartarët e Krimesë të ruanin vendin kundër ndonjë sulmi të mundshëm rus dhe dërgoi forca rrethuese në Shqipëri që t'i bashkoheshin një sulmi të pritshëm në Korfuz. Kjo i pakësoi forcat e tij në diçka më shumë se 100 mijë burra, të cilët u shpartalluan me lehtësi nga Eugjeni në Petervaradin, mbi Danub (5 gusht 1715). Kampi ra edhe një herë në duart e forcave perandorake dhe Serbia që e hapur për një pushtim të lehtë. Austriakët morën Timishoarën dhe Beogradin (20 gusht), duke shtënë njëkohësisht në dorë gjithë artilerinë dhe armatimin e osmanëve si dhe mijëra robër lufte. Forcat mbrojtëse boshnjake qëndruan fuqishëm përgjatë Drinës dhe Unës, por venedikasit, të

---

210. *Oliver Jens Schmitt Arbëria Venedikase 139–1479.*

mbështetur me anije nga Papa dhe kalorësit e Maltës, sulmuan prapavijën osmane dhe morën Prevezën e më pas i zbarkuan trupat në Dalmaci, megjithëse osmanët mundën të mposhtin një kontingjent jashtë kepit të Matapanit (korrik 1717) dhe të pengonin një përpjekje të armikut për të rimarrë Morenë. Humbjet e rënda në Veri e çuan në rrënim palën që mbështeste luftën dhe sollën zëvendësimin e pushtetit të saj me palën e paqes, të udhëhequr nga skllavi dhe këshilltari i afërt i sulltanit Nevshahirli Damat Ibrahim pashai (26 gusht 1717), i cili gjatë kohës që ushtri detyrën e kryevezirit u bë edhe i autorizuar kryesor i sulltanit për t'i dhënë fund luftës. Damt Ibrahim fitoi edhe mbështetjen e elementëve të luftës që trembeshin se Rusia mund t'i shfrytëzonte humbjet si një rast i mirë për të pushtuar principatat bashkë me austriakët. Perandori u detyrua të bënte paqe, për të vënë në vend humbjet e tyre si dhe nga sulmet e spanjollëve kundër pozicioneve të tij në Itali. Kështu, me ndihmën e ambasadorit britanik dhe atij holandez më 21 korrik 1718 u arrit paqja në Pasaroviç dhe të gjitha palët mbajtën atë që kishin pushtuar. Si rrjedhojë, Habsburgëve iu la kontrolli mbi Beogradin e Semendrinë si dhe vendet mes Timokut e Unës, duke i njohur Savën dhe Drinën si kufi të ri dhe si pjesë të rëndësishme të Serbisë në duart e austriakëve. Priftërinjtë katolikë në territorin osman fitonin përsëri përparësinë e tyre të mëparshme, duke i bërë përsëri Habsburgët mbrojtës të tyre, të gatshëm për të ndërhyrë në punët e brendshme të osmanëve në emër të tyre. Një marrëveshje e nënshkruar veçmas siguroi tregtinë e lirë mes tregtarëve dhe palës nënshkruese, ndërsa Austrisë i lejohej të mbronte tregtarët e huaj brenda kufijve të sulltanit dhe të vendoste konsujt e saj kudo që dëshironte nëpër Perandori, çka i dha mundësi më të mëdha për të trazuar shtetasit e sulltanit. Habsburgët praktikisht e braktisën Venedikun, të cilin e kishin përdorur si pretekst për të hyrë në luftë, duke u lejuar osmanëve të qëndronin në More, ndërsa Venediku mbajti vetëm Dalmacinë dhe ishujt e Jonit, si dhe fortesat që kishte pushtuar në Hercegovinë dhe në Prevezë. Humbja nuk qe aq e hidhur sa ç' mund të kishte qenë, megjithatë qe e rëndësishme. Osmanët pësuan jo vetëm humbje në territore e në njerëz, por edhe në moral. Disfatat u kishin treguar si osmanëve, ashtu dhe europianëve se, sado që mund të përmirësonin gjendjen e ushtrisë dhe të qeverisjes osmane, nuk mund të krahasoheshin me këmbësorinë dhe artilerinë e Europës. Pas kësaj osmanët u treguan shumë më të kujdesshëm për të bërë thirrje për luftëra të reja europiane, si dhe shfaqën më tepër vullnet për të pranuar epokën e re të paqes dhe të shmangies së përplasjeve që do të paraqitej gjatë regjimit dymbëdhjetëvjeçar të kryevezirit Damat Ibrahim pasha (1718–1730).



## **KAPITULLI VI**

### **Legjislacioni osmanë në Shqipëri , vështrim krahasues me ligjin bizantin .**

#### **1. Pushtimi otoman, vendosja e regjimit të tij**

Perandoria Bizantine ka lënë gjurmët e saj në të gjithë Ballkanin si në kulturë, ashtu dhe në drejtime të tjera në këto popullsi të krishtera të bizantinizuara. Gjatë sundimit të saj ekonomia karakterizohej nga struktura të llojit feudal, që përfshinin bashkësi tradicionale fshatare, si dhe ekzistonte një ndryshim i dukshëm midis zonave fushore dhe atyre të malësisë. Të parat ishin më të predispozura për të përqafuar ndryshimin, progresin, kurse të dytat ruanin me fanatizëm të drejtën e tyre zakonore. Nga Perandoria Bizantine nuk kishte mbetur veç kryeqytetit me rrethinat e tij. Territori grek ishte i copëzuar, një pjesë në duart e dukatit të Athinës, Peloponezi i ishte shitur navarezëve nga anzhuinët, ndërsa Venediku kishte ndarë ishujt e Egjeut me rivalen e tij, Gjenovën. Nga ana tjetër, territoret që kishin qenë nën sundimin e mbretit serb Dushanit, tashmë ishin ndarë në shumë principata, që karakterizoheshin nga një paqëndrueshmëri e dukshme. Në këtë gjendje paraqitej edhe Arbëria. Kjo ishte në vija të përgjithshme panorama e Ballkanit në vigjilje të pushtimit osman, histori kjo që daton në vitin 1365 me zhvendosjen nga sulltani Murati I (1362-1389) të kryeqytetit të tij nga Brusa në Adrianopojë dhe përfundon me vdekjen e Mehmetit II në vitin 1481. Kjo situatë e gjendur në planin politik e ushtarak e bënte shumë të thjeshtë avancimin e trupave otomane drejt Ballkanit. Në aspektin fetar – element ky që paraqiste rëndësinë e vet – gjendja nuk dukej e vështirë. Të gjithë popujt ballkanikë kishin përqafuar Kishën e Lindjes dhe selia e Kostandinopojës drejtonte popullsitë e rritit grek dhe sllav. Perandori bizantin Jovani VIII, për t'i bërë ballë rrezikut osman, ndërmoi iniciativën e bashkimit të Kishës së Lindjes me të Perëndimit, një marrëveshje kjo që nuk u zbatua kurrë përveçse rriti intensitetin e armiqësisë ndaj Perëndimit. Kjo lëvizje u ndërmor prej tij për të siguruar mbështetjen e princërve europianë të krishterë ndaj revanshit otoman. Pushtimi i Perandorisë Osmane kaloi në dy faza: në fazën e parë osmanët e lanë sovranin në vendin e tij, por si vasal; gjatë fazës së dytë osmanët i zhdukën popujt dhe territorin e tyre e kthyen në provincë të Perandorisë. Këtë strategji

e gjejmë të përdorur edhe nga Perandoria Bizantine, perandori i së cilës u bë vasal i sulltanit që më 1372, përpara se të zhdukej bashkë me shtetin e tij më 1453.

Perandori bizantin Jovan V Paleolog iu drejtua për ndihmë kundër osmanëve shumë shteteve, që nga Hungaria e deri te Papati, duke bërë një aderim solemn në fenë e Romës, që u vlerësua si një veprim personal i tij, pasi nuk u shoqërua nga asnjë përfaqësues i Kishës së Kostandinopojës. Në rrugën e kthimit ky perandor qëndroi në Venedik, ku u burgos për shkak të borxheve që Bizanti i kishte Venedikut. Nga ana tjetër, përpjekje në Ballkan për ndihmë bëri dhe cari i Serbisë Stefan Dushani, i cili i kërkoi Papës së Romës titullin “kapiten i përgjithshëm” i një kryqëzate që ai po përgatiste ndaj osmanëve, por që mbeti e porealizuar për shkak të vdekjes së tij më 1355. Historia vazhdoi me drejtimin e Perandorisë nga dy djemtë e car Dushanit, të cilët u përpoqën të ndalnin pushtimin osman, por pa sukses, gjë që çoi në copëzimin e principatave dhe kthimin e drejtuesve të tyre në vasal të osmanëve. Pa u mbushur 20 vjet nga vendosja e parë e osmanëve në Ballkan, tri perandoritë e vjetra: ajo Bizantine, Bullgare dhe Serbe, ishin katandisur në gjendje vasaliteti të emirit të Adrianopojës. Përplasja e parë e shqiptarëve me trupat otomanë ishte ajo në Fushë-Kosovë, në të cilën morën pjesë trupa të Gjergj Balshës dhe të Dhimitër Jonimës, gati 10 mijë trupa. Pasi e shndërroi Serbinë në bazë nisjeje për veprimet ushtarake, sulltani iu drejtua tokave shqiptare. Beu Isak Evrenozi nënshtroi sinjorët që ishin komprometuar me Venedikun, ndër të cilët Gjon Kastriotin, të atin e Skënderbeut. U aneksuan të gjitha zotërimet feudale të Shqipërisë së Mesme, duke formuar nga kjo krahinë një sanxhak, pashai i të cilit e kishte selinë në Gjirokastrë. Në këtë sanxhak u krijuan shumë timare, por këto ndryshime ngjallën një pakënaqësi të madhe. Nga ana tjetër, nga të krishterët lufta udhëhiqej nga Gjergj Araniti, me të cilin mbreti i Hungarisë, Sigismundi, donte të lidhte një aleancë antiosmane. Figura e Skënderbeut hyn në histori në kohën e Mehmetit I. Gjon Kastrioti kishte marrë nga osmanët një feud në bregdet dhe Mehmeti I, pasi zaptoi Krujën, u kërkoi feudalëve fqinjë që t’i dorëzonin nga një djalë si peng dhe familja e Gjonit dërgoi Skënderbeun në Edrene, i cili u pajis me një edukatë myslimane në shkollën e pazhëve të Pallatit, ku mori emrin “Aleksandër”, që në turqisht do të thotë “Skënder”. Ai u pajis me diplomën si spahi dhe në vitin 1438 u kthye në Krujë me titullin “bej” si administrator i saj (vali). Në 1443 ai u shkëput nga kampi turk, mori Kalanë e Krujës dhe ngriti flamurin e fisit të tij në të. Ishte mbreti i Hungarisë, ai i Napolit dhe Venediku që e ndihmuan Skënderbeun, ndërsa Papa Nikolla V e përshëndeti si “atlet i Krishtit”. Në viset shqiptare osmanët u ndeshën gjithmonë me Skënderbeun dhe feudalët që ai bashkoi në

Besëlidhjen e Lezhës më 1444. Por kjo Besëlidhje qe paqëndrueshme, e kundërshtuar gjithmonë nga sinjorët e tjerë të krahinës, si Dukagjinasi, që preferuan të merreshin vesh me sulltanin, ndërsa Aranitasit u lidhën me Venedikun. Skënderbeu në fillim kërkoi ndihmë nga Hungarezët, pastaj i kërkoi ndihmë mbretit të Napolit, me të cilin nënshkroi edhe një marrëveshje aleance në Gaeta në vitin 1451. Pas rënies së Konstandinopojës Skënderbeu bëri një udhëtim në Napoli, ku siguroi 2000 këmbësorë dhe topa aragonas, që i erdhën në ndihmë ushtrisë së Besëlidhjes. Dështimi i një sulmi kundër kështjellës osmane në Berat solli përçarje në familjen e Skënderbeut. Papa Piu II deshi ta shfrytëzonte qëndresën e Skënderbeut për të organizuar një kryqëzatë dhe Skënderbeu e pranoi ofertën e Venedikut, që sapo i kishte shpallur luftë Sulltanit. Rifilluan luftimet, por vdekja e Papës solli mosrealizimin e kryqëzatës. Duke mbetur pa asnjë përkrahje, Skënderbeu rezistoi për katër vjet, duke përballuar sulme si ato të Ballaban pashës. Pas vdekjes së tij më 1468 osmanëve iu deshën gati 10 vjet për të shtënë në dorë gjithë kështjellat shqiptare. Më 1479 sulltan Mehmeti I lidhi një marrëveshje me Venedikun, duke i lënë këtij vetëm portin e Durrësit dhe të Shkodrës, gjithë pjesa tjetër u bë osmane për pesë shekuj me radhë.

Nuk është vështirë të kuptohet dhe të shpjegohet se pse turqit e morën kaq lehtë Ballkanin. Perandorisë Osmane i shkonin për shtat copëzimet politike, për më tepër që shumë mbretër të pavarur, despot dhe mëkëmbës të principatave të vogla ballkanike nuk ngurruan të kërkonin ndihmë nga jashtë për t'u dhënë fund përçarjeve të tyre të brendshme. Osmanlinjtë i shfrytëzuan për qëllimet e veta këto kontradikta.

Në dallim nga rrëmuja që mbizotëron në Ballkan, otomanët ndoqën një politikë të përpiktë, si dhe dispononin forcat ushtarake dhe pushtetin qendror, që ishin të domosdoshme për të realizuar një politikë të tillë. Ata kishin edhe korparmatën e jeniçerëve, efektivit i parë ushtarak në Europë, që përbënte një përparësi tjetër të madhe. Sulltani këtë korparmatë e formoi prej robërve të luftës pasi mori Edrenenë dhe ajo gjendej nën komandanten e tij të drejtpërdrejtë. Në të njëjtën kohë në secilin shtet ballkanik ekzistonte nga një fraksion i gatshëm të lidhej me Hungarinë apo me të krishterët e tjerë latinë, si dhe fraksioni që ishte i gatshëm të bashkëpunonte me osmanët. Thënë shkurt, aristokracia, shtresa e lartë klerike, njerëzit e penës dhe oborrtarët ishin kthyer nga bota e krishterë perëndimore për të kërkuar ndihmë. Popullata ortodokse greke e kundërshtonte me fanatizëm dominimin e italianëve dhe çdo ndikim të katolicizmit, ndërsa osmanët, të cilët nxitnin përplasjet ballkanike, të krishterët ortodoks filluan t'i konsideronin vasalë të tyre.

Ekspansionit osman në Ballkan i shkonin për shtat si rrethanat politike, ashtu dhe ato shoqërore<sup>211</sup>. Studimet kanë provuar se rënia e pushtetit qendror në Bizant dhe në shtete të tjera ballkanike ka vazhduar krahas zhvillimit të feudalizmit. Manastiret dhe personalitetet autoritare nëpër provinca e merrnin në pronësi tokën e ashtuquajtur *proni*, e cila më parë ishte nën mbikëqyrjen e shtetit. Të ardhurat prej taksave të këtyre pasurive përdoreshin për shpenzimet ushtarake. Duke marrë koncesione financiare dhe ligjore prej shtetit, prodhimet e fushës ata i shndërronin në prona me të drejtë të përhjetshme shfrytëzimi, në këtë mënyrë mundnin të rritin taksat dhe tatimet feudale, që i nxirrnin prej fshatarëve<sup>212</sup>. Këto prona të regjioneve në administrimin e drejtpërdrejtë osman u gjendën përsëri nën mbikëqyrjen shtetërore dhe u shndërruan në timare, ose iu shpërndanë bujqve turq si dhurata për pjesëmarrjen e tyre në ushtri si këmbësorë. U hoqën tatimet e vendit që nuk ishin të caktuara në urdhrin kryesor të Kanunit Osman (ligji osman). Vetëm me dekret të sulltanit mund të përfitohej ndonjë e ardhur apo privilegj. Çdo hollësi duhej të vërtetohej më parë me urdhër, zbatimi i të cilit i është besuar kadiut, që vepronte pavarësisht nga pushteti lokal. Regjimi osman, duke i dhënë orientimet e përgjithshme, në vend që t'ua lëshonte sizerenëve të caktojnë tatimet dhe privilegjet, ka vënë administratën e centralizuar në vend të decentralizimit feudal<sup>213</sup>. Regjimi i ri për fshatarësinë ishte hap përpara në krahasim me të vjetrin. Që të kuptohet superioriteti i administratës osmane në krahasim me administratat lokale ballkanike, mjafton thjesht të krahasohen ligjet osmane me ligjet e carit serb Stefan Dushani. Për shembull, ligji i Dushanit urdhëron që fshatari të punonte për zotërinë e tij dy ditë në javë, kurse dispozitat përcaktojnë që raja të punojë vetëm tri ditë në vit në pronën e spahiut. Parimi themelor i administratës osmane ishte që të mbronte fshatarësinë nga eksploatimi i pushtetit lokal. Megjithatë, osmanët zyrtarisht e pranuan Kishën Ortodokse e në parime shtypin atë katolike në tërë tokat e Perandorisë së vet. Të gjithë këta faktorë janë me rëndësi për të shpjeguar përhapjen e shpejtë të turqve në Ballkan dhe arsyen pse fshatarësisë i kërkohet që të mos u bashkëngjitet zotërinjve të vet për t'u bërë qëndresë osmanëve. Mirëpo osmanët nuk e konsideronin veten bartës të çfarëdo parimi të veçantë, qoftë dhe shoqëror. Ata e dinin se duke zbatuar një politikë paqësore ndaj të krishterëve mund t'i zgjeronin lehtë territoret

---

211. H.Inalcik, *L'empire ottoman*, Raports, The First International Congress of South-East European Studies, Sofje, 1969, 80–85.

212. G.Ostrogorski (1954) *Pour l'histoire de la feodalite byzantine*, Brussels, f. 94–135.

213. H.Inalcik, (1959). *Osmanilarda Rayyet Rusumu*, Belleten XXIII, f. 575–610, H.Inalcik Cift-resmi në Encyclopedia of Islam.

e tyre dhe t'i shtonin burimet e të ardhurave të tyre. Po ashtu marrëdhënia tolerante ndaj aristokracisë së vendit dhe klasës ushtarake ishte pjesë përbërëse e doktrinës së tyre ekspansioniste. Osmanët, nëse veçohen ata që e kundërshtuan haptazi, merrnin pjesëtar të klasës ushtarake në shërbimin e tyre, prandaj në Bullgari, Serbi, Maqedoni e Shqipëri ua vërtetonin statusin mijëra luftëtarëve të njohur sipas emrit sllav “vojnik”. Ata fitonin të drejtën që të shfrytëzonin të ardhurat e tokës shtetërore në një madhësi të caktuar, liroheshin nga pagesa e tatimit dhe shërbenin si luftëtar në ushtrinë osmane. Shumë ushtarë që i mblidhnin turqit në shtetet vasale, shërbenin në ushtrinë osmane nën komandën e princërve të tyre ose të zotërinjve të betuar e që nuk e kishin të detyruar të pranonin patjetër islamin. Ndërkohë islami fitonte gjithnjë e më shumë ithtarë të rinj, por nga fundi i shekullit të 15-të ende kishte pronarë timaresh, familjet e të cilëve deri në tri apo katër gjenerata e ruajtën besimin e krishterë. Osmanizimi i disa regjioneve të nënshtruara nuk nënkuptonte transformim të shpejtë dhe radikal, por zhvillim gradual<sup>214</sup>.

## **2. Karakteristikat e administrimit osman**

Perandoria Osmane vendosi në çdo territor të pushtuar prej saj, përfshirë gjithë Gadishullin Ballkanik, një model tjetër administrimi, shoqërie e kulture të dalë nga një trashëgimi turkomane dhe irano-arabe. Bashkimi i këtyre dy modeleve zgjati gati pesë shekuj dhe i dha Gadishullit atë specifikë që njihet sot në histori si “ballkanike”.

Njësia territoriale bazë e Perandorisë ishte sanxhaku apo provinca, siç njihej ndryshe. Ajo i besohej nga sulltani një beu dhe një numri spahinjsh. Meqenëse sanxhakbejlerët nuk u treguan shumë besnikë ndaj Portës së Lartë, doli në skenë figura e superbejlerit ose bejlerbejllëku, i cili ushtronte kontroll mbi çdo pjesë të sanxhakut.

Në fund të shekullit të 16-të numëroheshin 32 të tilla në gjithë Perandorinë. Vetëm në territorin european numëroheshin pesë të tilla: e Rumelisë, Bosnjës (me kryeqytet Sarajevën), arkipelagu i Egjeut, e Budinit dhe ajo e Tamishvarit. Këto provinca të mëdha që nga viti 1590 morën emrin “vilajete” dhe kreu i tyre u quajt “pasha”. Kjo është edhe arsyeja që rreth shekullit të 18-të

---

214 . H.Inalcik (1954), *Ottoman Methods of Conques*, Studia islamica II , f. 103–129 B

vilajeti u quajt “pashallëk”. Vetë sanxhakët ndaheshin në *subashllëqe*, në krye të cilëve qëndronin subashët, të cilët kishin nën drejtim e tyre ushtri të vogla. Në fund të shekullit të 16-të Ballkani numëronte 30 të tillë. Karakteri ushtarak i sanxhakut u ruajt deri në shekullin e 19-të dhe sanxhakbeu përfaqësonte kryetarin e spahinjve dhe të trupave të tjera të rekrutuara në njësinë e tij territoriale.

Figura e dytë e rëndësishme ishte kadiu, kreu i drejtësisë, përfaqësues i pushtetit gjyqësor të sulltanit. Ai ishte i ngarkuar nga Porta e Lartë të siguronte dhe kontrollonte zbatimin e Sheriatit dhe të kanuneve, nuk kishte lidhje varësie në këtë drejtim me beun e sanxhakut dhe kishte të drejtën t’i drejtohej personalisht sulltanit. Gjykimin kadiu e bënte në bazë të kërkesës së beut, i cili duhej të siguronte zbatimin e vendimit të marrë nga kadiu. Ai mbikëqyrnin edhe korporatat artizanale si dhe tregjet urbane.

Nga pikëpamja gjyqësore sanxhaku ndahej në *kaza* dhe në *nahije* me kadiun përkatës. Drejtësia e sulltanit ishte e detyrueshme për të gjithë, edhe pse të krishterët përpiqeshin t’i shmangeshin asaj, duke preferuar gjykatat e milletit të tyre. Kadilerët kishin të drejtë të mbanin një pjesë të gjobave që vileshin si dhe dhuratat që u jepeshin. Kemi të bëjmë me një drejtësi që kushtonte shumë, por që qëndronte si baraspeshë ndaj pushtetit arbitrar të sanxhakbeut.

Personi i tretë i rëndësishëm i sanxhakut ishte *defterdari* ose kryetari i thesarit, i cili varej nga kryetari i Thesarit të Stambollit. Katër fushat e ushtrimit të pushtetit osman: ushtria, rendi publik, drejtësia dhe financat, nuk gjenin zbatim të njëjtë në territoret e pushtuara, dhe kjo varej nga lloji i popullsisë në to. Vendet me popullsi myslimane gëzonin të drejtën të mbanin armë. Në krye të timareve qëndronin spahinjët, të cilët mbanin pranë një grup njerëzish të quajtur “xhebelutë”, që furnizonin me kuaj e ushqime ushtarët në fushatat luftarake. Në provincë kishte edhe garnizone me 300 deri 500 ushtarë ose jeniçerë nëpër fortesa, me detyrë të mbronin udhëtarët e rëndësishëm, si për shembull ambasadorët, apo të ruanin karvanet që transportonin arë dhe argjend.

Interesant paraqitet sistemi fiskal i Perandorisë, që mbështetej në sistemin e timareve dhe në vjeljen e taksave që duhej të paguanin rajatë. Ekzistonte një regjistrim i përpiktë për çdo të ardhur në familje, pasi mbi bazën e kësaj bëhej vjelja e taksave, një pjesë e cilave kalonte për shtetin, një pjesë për personalitetet e larta dhe pjesa tjetër ndahej midis timareve të atij territori. Në fshat ishte taksa e *xhezas*, që ishte taksë mbi tokën, e cila në qytete u zëvendësua nga *mukatatë*, që ishte taksë mbi prodhimin e artizanatit dhe të tregtisë, si: mbi peshkun, kripën,

kafenë etj. Sistemi i taksave nuk zbatohet në mënyrë uniforme në gjithë Perandorinë, kishte vende si ato që shtriheshin përgjatë rrugëve të mëdha nga Stambolli në Beograd që liroheshin nga taksa të mirëmbanin rrugët dhe urat, të furnizonin me kuaj korrierët e zyrtarëve.

Karakteristike paraqitet situata në Shqipërinë e Veriut, që ruajti një pavarësi faktike të mbështetur në strukturat fisnore të vetat dhe të kufizuar vetëm nga një haraç, i cili në të shumtën e rasteve nuk paguhej.

Interes paraqet studimi i sistemit të timareve, si lindi ky sistem, pse u instalua nga Perandoria dhe dha rezultatet e pritshme. Me shtrirjen e gjerë territoriale të Perandorisë Osmane ishte imediat kapërcimi i vështirësive për qarkullimin monetar për pagimin e rrogave të ushtarakëve të tyre, që ruanin territoret. Ky ishte një problem që ishte shfaqur edhe në periudhat e sundimtarëve të mëparshëm dhe zgjidhja ishte dhënia e një territori një luftëtari për të mbajtur veten dhe vartësit e tij. Perandoria Bizantine e kishte aplikuar këtë sistem me emërtimin “*pronja*”, tashmë po e vinte në zbatim sulltani nën emërtimin “*timare*”<sup>215</sup>. Ky sistem zbatohet mbi tokat e pushtuara, që konsideroheshin plaçkë e xhihadit, nga të cilat sulltani merrte një të pestën, ndërsa pjesën tjetër ua jepte krerëve të ushtrisë së tij. Kemi tri lloje tokash të Perandorisë: 1) *tokat mirie*, që zinin 87 për qind, ishin tokat pasuri shtetërore, kryesisht ishin toka bujqësore dhe ishte fondi që dispononte sulltani për krijimin e timareve; 2) *tokat vakëf* e xhamive dhe institucioneve fetare; 3) *tokat mylk*, që ishin pronë private në kuptimin romak të fjalës, të cilat në Ballkan ishin në një numër tepër të vogël. Njësoj si në Bizant, sistemi i timareve mbështetej në shfrytëzimin e rregullt të tokës. Fshatari kishte në përdorim tokën, kështu që u bënte ballë detyrimeve të tij fiskale dhe mund t’ua kalonte pa problem tokën trashëgimtarëve me të njëjtat detyrime. Ai nuk kishte të drejtë ta shiste, pasi toka ishte në pronësi të shtetit. Perandoria kishte parashikuar sanksione për rastet e largimit të tyre nga toka. Duke gjykuar nga koha kur toka përbënte gjënë më të vyer, duhet vlerësuar fakti që timarliut i ishte lënë një pjesë e saj për familjen e tij, e cila i kalonte djalit të madh pas vdekjes së spahiut.

Të drejtat dhe detyrimet mes spahinjve dhe fshatarësisë rregulloheshin nga sistemi ligjor i parashikuar nga *kanunnametë*. Statusi i fshatarësisë kristiane gjatë regjimit otoman nuk përbënte një ndryshim nga e kaluara bizantine. Duhet theksuar këtu se Perandoria Osmane e kishte lënë të paprekur rendin tradicional të fshatarëve, i cili ishte i kodifikuar në Perandorinë Bizantine nga ligji agrar. Sipas këtij ligji, fshati ishte një bashkësi solidarisht përgjegjëse për pagimin e taksave,

---

215. St. Shaë, *History of the Ottoman Empire*, VII, f.208.

por që vetadministrohej nga një asamble kryetarësh të familjeve përdoruese dhe një kryetar fshati të caktuar prej saj. Sipas këtij përcaktimi, u krijuan qendrat rurale, që ndryshonin sipas rajoneve gjeografike, por kishin edhe elemente të ngjashme, shtëpi dhe kopësht të kufizuara me mure ose gardhe, që mbyllnin atë që konsiderohej si pronë familjare e trashëgueshme sipas ligjeve të grupit, kishte fusha të punuara, që konsideroheshin pronë private, më pas ishin pyjet dhe kullotat, malet, që përdreshin nga bashkësia në tërësi sipas zakoneve tradicionale. Përveçse në zonat e kolonizimit, ku ardhësit e rinj sollën me vete organizimin e tyre të ndryshëm me ambientin që gjetën, pushtuesit otomanë i lanë të ekzistonin këto forma të bashkësisë fshatare. Karakteristikë në këto bashkësi ishte kryetari i tyre, i cili mbante një emra të ndryshëm (në varësi të vendit ku jetonte, për shembull, në Serbi quhej *knez*, në viset greke *arbont*). Zgjedhja e tij i ishte besuar asamblesë së kryetarëve të familjeve të bashkësisë, që thirreshin me emërtimin “pleqtë”. Zakonisht ky person zgjidhej nga ato familje që kishin spikatur për mençuri në breza. Këto kuvende ishin rregullatorë të jetës së bashkësisë fshatare dhe mbështeteshin në aplikimin e së drejtës së tyre zakonore, e cila ishte trashëguar verbalisht brez pas brezi ndër ta. Me kalimin e kohës ishin bërë përpjekje për t’i përpunuar këto zakone, edhe pse ishte tepër e vështirë për shkak të etnolinguistikës së ndryshme të tyre, duke pasur një stil jetese të ndryshëm në treva të ndryshme, megjithatë ajo që binte në sy ishte mbizotërimi i trashëgimisë bizantine. Ekzistenca e këtyre zakoneve kishte një anë tepër pozitive për Portën e Lartë, pasi ajo i kufizonte në minimum kontaktet me të, duke evituar në këtë mënyrë përplasjet mes tyre. Në rastet kur spahiu, përfaqësuesi i osmanëve, banonte në fshat, roli i tij në lidhje me problemet fiskale dhe rendin publik ishte i kufizuar. Faktet historike tregojnë se ishin të rralla rastet kur spahiu banonte në fshat, pasi ai vinte aty vetëm për të marrë taksën ose haraçin, siç njihej ndryshe. Kalimi i tij shoqërohej me shumë abuzime, të cilat denoncoheshin te kadiu. Kanunet e kishin parashikuar numrin dhe kohën e qëndrimit të tyre në fshat për marrjen e taksës, por këto parashikime nuk zbatoheshin nga spahinjët, të cilët vinin me një numër të madh shoqëruesish dhe qëndronin për disa ditë me radhë. Interesant ishte ankimi në gjykatat osmane, pasi ishte ankim kolektiv në emër të të gjithë bashkësisë, që përfaqësohej nga kryetari i saj.

Ndryshe paraqitet tabloja në qytetet ballkanike, për të cilat roli politik-ushtarak dhe ekonomik ishte i njohur që nga Roma e deri te Bizanti. Termi që përdorej në Perandori për qytetin ishte “shehër” dhe ishte me origjinë persiane. Përdorej dhe kasabaja, qendër e veprimtarisë artizanale



e tregtare; kemi *palankën*, që ishte qytezë e fortifikuar, dhe varoshi, që ishte një lagje e vjetër bizantine, ku përfshihej pjesa kristiane e qytetit.

Qendrat urbane ndaheshin në lagje, ose mëhalla, ku banorët grupoheshin sipas besimit fetar. Prona ndahej në tri kategori: *miri*, *vakëf*, *mylk*. Të ardhurat e vjela nga taksat e qyteteve siguronin gjysmën e të ardhurave të Thesarit të Shtetit. Administrata e qyteteve ishte në kompetencën e autoriteteve provinciale: bejlerëve, sanxhakbejlerëve, subashëve, të cilët ushtronin pushtetin e policisë përballë kadilerëve, që ishin zotër të gjykatave. Për shqiptarët ishte karakteristikë fakti që banonin në të njëjtën mëhallë si turqit dhe ushtronin funksione si ndërtues kalldrëmësh, gërmues puseh ose shitës ambulant. Nga ana tjetër, kishte shumë prej tyre që kishin bërë karrierë në ushtrinë osmane, të cilët i siguronin mbrojtje pjesës tjetër.

U përhap me shpejtësi kultura islamike, që mund të cilësohet si kultura osmane, meqenëqë mbajtësit e saj ishin sunduesit osmanë. E bazuar në Sheriatin dhe në traditat, adetet e islamit sunit, ajo mbështetej në strukturën e shtetit, i cili kishte ngritur një hierarki doktorësh të ligjit, si myftinj të për të bërë interpretimin e ligjit, kadilerët si zbatues të tij, myderrizët, mësuesit e tij nëpër shkollë. Shqiptarët e kishin përzier trashëgiminë kristiane me mësimet e profetit, i kishin mbetur besnikë gjuhës së tyre dhe në krahinat jashtë qyteteve nuk njihej pothuajse fare gjuha turke. Kultura e grupeve etnike mbijetoi dhe u zhvillua mbi bazën e transmetimit gojor të shprehive teknike dhe normave shoqërore. Atje mund të merrnin një zhvillim të ndryshëm struktura të tilla si familja patriarkale greke apo fisi i shqiptarëve, duke përfunduar në mënyrë jetese dhe në sisteme vlerash të shprehura nga letërsitë e pashkuara, nga festat sipas zakoneve, nga artet tradicionale. Të gjitha këto përfshiheshin në atë që njihet si fusha e etnografisë dhe e folklorit, që kanë mbajtur gjallë për shekuj me radhë identitetin e një kombi, duke ruajtur vlerat e tij nga elementi i huaj.

### **Administrata dhe shoqëria**

Pavarësisht nga keqadministrimi ekonomik, paaftësia administrative, korrupsioni politik dhe politikat e mbështetura më fort në interesa grupi se në interesa shtetërore, shteti dhe shoqëria mbijetuan me shumë më pak përçarje nga ç'mund të përfytyrohet. Si u bë e mundur kjo?

Procesi i rregullimit në qendër karakterizohej nga një tejzgjerim në numër e funksione të korpusit të shkruesve (*kuttap*), të cilët e shtrinin pushtetin e tyre në të gjitha degët e klasës qeverisëse, duke formuar një nënstrukturë të përhershme burokratësh karriere, që vazhdonin të administronin ligjin dhe të zbatonin funksionet e administratës, që ishte shumë e pakujdesshme ndaj uljeve-ngritjeve dhe ndërlikoheshin e ndikoheshin nga esnafi i shkruesve, që përgatiste, mbante, siguronte dhe urdhëronte shkruesit, që zbatonin çdo detyrë sipas traditës dhe sistemeve të tyre dhe i drejtoheshin nominalisht vetëm zyrtarëve nga të cilët drejtoheshin. Kështu, kryeqatipi (*reisu'l-kuttap*), kreu i shkruesve, që zyrtarisht ishte vetëm drejtues i arkivit të Këshillit Perandorak nën urdhrat e kryevezirit dhe i barabartë me kreun e thesarit dhe agallarët e korpuseve ushtarake, i kapërcente ata për nga pushteti nëpërmjet pozitës së tij paralele si udhëheqës i korporatës së shkruesisë. Ajo ishte e ndërtuar sipas një hierarkie të ndërlikuar urdhërimi e shërbimi nën drejtimin e tij, duke ekzistuar paralelisht, por e ndarë nga administrata e Këshillit Perandorak, nga thesari dhe nga degët e tjera të qeverisjes. Në detyrat e saj instruktuese ajo caktonte anëtarë të rinj si çirakë të papaguar apo si studentë ose e qeverisë dhe ndihmonte shkruesit, të cilët, si anëtarë të esnafit, u mësonin atyre kaligrafinë, kompozimin, llogarinë dhe punë të tjera të zyrave të tyre të veçanta. Çirakët dhe studentët, sapo të kishin fituar aftësitë e nevojshme, bëheshin pjesë e grupit të shkruesve të qeverisë menjëherë pas ceremonive të diplomimit të organizuara nga esnafi sa herë që kishte vende të lira. Mbi rangun e shkruesit (*katip*) anëtarët mund të ngriheshin, nëse do të kishte vende të lira, në rangun (*paye*) e sekretarit (*haflife*), të kryesekretarit (*serhalife*), të mbajtësit të fondeve (*kisedar*) dhe të kreut të tryezës së shkrimit (*hace*). Ata që zinin këtë pozitë të fundit ishin anëtarë të vjetër të esnafit, të quajtur “haxhegjan” (*hacegan*), të cilëve u jepeshin poste të përhershme të shkruesisë e të sekretarisë. Kjo i bënte ata në hierarkinë zyrtare të barabartë ose një rang më lartë se kryeqatipi, ndërsa në esnaf ata kishin të njëjtin pushtet. Esnafi i shkruesisë ushtronte pushtet nëpërmjet posteve që mbaheshin nga anëtarë në gjithë klasën qeverisëse nën drejtimin e kryeqatipit, e cili, megjithëse nën urdhrin nominal të eprorit të vet, kryevezirit, kontrollonte zyrat e qeverisjes, duke bërë të gjitha emërimet dhe shkarkimet. Detyrat dhe fuqitë e tij shumëfarëshe pasqyroheshin në ofiqet e shumta, që u vunë nën kontrollin e tij vetjak. Më i vjetri prej këtyre ofiqeve ishte ai fillestar: drejtor i Arkivit të Këshillit Perandorak (*Divan-I Humayun Kalemi*), që përmbante katër funksione: 1) *Zyra e Bejllëkut* (Beylik), e cila lëshonte dhe regjistronte vendime dhe dokumente të tjera lidhur me veprimtaritë jozyrtare të qeverisë, përfshirë marrëdhëniet me vendet e huaja

dhe regjistrimet e myhimesë (*muhimme*) të vendimeve të Këshillit; 2) Zyra e Transfertës (*Tahvil*), e cila lëshonte, regjistronte dhe në këtë mënyrë kontrollonte dokumentet e emërimit (*beraf*) për postet më të rëndësishme; 3) departamenti “Ru’us”, i cili bënte të njëjtën gjë për poste më të ulëta; dhe 4) Zyra e Korrespondencës (*Amedije*), e cila vepronte si një sekretariat privat i kryeqatipit dhe merrej me korrespondencën e tij, përfshirë edhe atë me vende të huaja, duke qenë kështu zyrë e përafërt me një ministri të jashtme. Veç kësaj zyra e kryevezirit, e cila fillimisht nuk kujdesej për asgjë tjetër, veç zbatimit të urdhrave të Këshillit Perandorak dhe trajtimin e çështjeve të vogla, me të cilat Këshilli nuk kishte kohë të merrej, mori në dorë përfundimisht detyra të tilla ekzekutive, sa që në fillim të vitit 1654 ajo kishte ndërtesat e veta në vende të ndryshme jashtë Pallatit, gjë që vazhdoi deri në shekullin e 18-të, kur asaj iu siguroa një bashkim zyrash me emrin “Bab-I Ali” (*Porta e Artë*) ose “Bab-i Asafi”. Gjatë epokës së rënies së Perandorisë ajo i mori gjithnjë e më tepër detyra Këshillit Perandorak dhe Thesarit. Kjo kulmoi në vitin 1794, kur kryeqatipi u transferua nga Këshilli për të drejtuar veprimtaritë e Portës së Lartë, duke sjellë me vete zyrat e bejllëkut dhe të korrespondencës, ndërsa Këshilli Perandorak mbajti vetëm detyrën e ruajtjes së regjistrimeve të myhimesë. Për t’u marrë me detyrat e reja pranë Portës, kryeqatipi ngriti një zyrë të re nën drejtimin e tij: Dhomën e Lëtërshkruesit të Kryevezirit (*Mektubi-I Sadaret Odasi*), e cila ishte e ngarkuar me korrespondencën e kryevezirit me të gjitha departamentet e tjera të qeverisë dhe, si e tillë, ndihmonte kryeqatipin edhe në detyrat klerikale, edhe në ato administrative. Zyra Amedije, e cila mbetej përsëri sekretariati vetjak i kryeqatipit, përgatiste të gjitha raportet dhe komunikimin me sulltanin, mbante shënime rreth bisedimeve me përfaqësues të huaj dhe mblidhte pagesat që i bëheshin kryeqatipit nga të gjithë ata që merrnin garancinë (*beraf*) e emërimit. Porta e Lartë u kthye kështu në departamentin kryesor ekzekutiv dhe administrativ. Kryeveziri vetëm bënte një mbikëqyrje të përgjithshme, ndërsa pushtetin në të vërtetë e kishte në dorë kryeqatipi, i cili përfaqësonte korporatën e shkruesisë. Zyra *Mektuije* u bë në veçanti më e çmuara e të gjitha departamenteve që ishin të hapur ndaj shkruesve.

Zyra e fundit e rëndësishme që drejtohej nga kryeqatipi, nominalisht nën kontrollin e Këshillit Perandorak, por në të vërtetë krejt e pavarur prej tij, ishte ajo e përkthyesit të Këshillit Perandorak (*Divan-I Humayun Tercumani*), kryekallauzi legjendar. Deri në këtë kohë kjo zyrë ishte përbërë tërësisht nga jomyslimanë, kryesisht grekë. Si e tillë, ajo kishte mbetur jashtë korporatës së shkruesisë, megjithatë ushtronte ndikim të ndjeshëm në politikën e jashtme dhe

përmes rolit të saj të ndërmjetësimit në emër të përfaqësuesve të huaj arrinte të ushtrojë ndikim edhe në punët e brendshme. Ajo fitoi dukshëm më shumë rëndësi në çështjet e shkruesisë pas vitit 1826, kur u pastrua nga anëtarët e saj jomyslimanë për shkak të revolucionit grek dhe një korpus i ri shkruesish e përkthyesish myslimanë u përgatitën për të shërbyer në një zyrë të re, të ngritur veçanërisht për të drejtuar e kontrolluar punën e tyre. Kjo zyrë u quajt “Dhoma e Përkthyesish” (*Tercume Odasi*). Përveç Portës së Lartë dhe Këshillit Perandorak, arkivat e të cilëve kontrolloheshin drejtpërdrejt nga kryeqatipi në cilësinë e tij zyrtare, korporata e shkruesisë e shtrinte ndikimin e saj edhe në institucione të tjera qeverisëse. Institucioni i kryevezirit shtiu në dorë edhe një sërë detyrash të Thesarit Perandorak (*Hazine-I Amire*), që mori emrin “Bab-I Deferit” (*Departamenti i Regjistrimit*) për të treguar detyrën e tij kryesore, ndërsa funksionet e tij më të shumta të lidhura më shkruesinë zbatoheshin nga esnafi i shkruesisë. Pushteti i shkruesisë u shtri gjithashtu edhe në institucionet e reja ushtarake nëpërmjet anëtarëve që vepronin si sekretarë e përgjegjës të Thesarit në korpuset përkatëse, duke kontrolluar shpërndarjen e rrogave dhe të furnizimeve, ndërsa veprimtaria e agallarëve sa vinte e kufizohej gjithnjë e më shumë në detyra thellësisht ushtarake. Shkrues të tjerë kalonin shpesh në institucionin perandorak duke u bërë vezirë apo bëheshin guvernatorë në vende të tjera, ministra, madje duke u ngritur edhe në pozitën e kryevezirit, por duke mbetur gjithmonë nën ndikimin e grupit që i kishte nxitur e përkrahur. Kjo nuk do të thotë se institucionet e tjera të klasës qeverisëse nuk zotëronin pushtet. Ministrat e institucionit perandorak vazhdonin të qeverisnin shtetin, por ata u dobësuan shumë nga luftërat politike dhe ndarjet e brendshme si dhe nga koha relativisht e shkurtër që qëndronin në detyrë. Institucioni ushtarak ruajti një pozitë të pushtetshme nëpërmjet nxitjes së dhunës dhe frikës apo nëpërmjet vendosjes së shumë prej anëtarëve të tij në poste të larta, por edhe ai humbi shumë pushtet për shkak të anarkisë dhe kalbëzimit të brendshëm të korpusit të tij, si një instrument i rëndësishëm ushtarak. I vetmi institucion i klasës qeverisëse që mundej të konkurronte me shkruesit, ishte institucioni i *Ilmijes* (Ilmiye), që ishte organizimi fetar dhe kulturor i ulemasë. Pa dyshim, përgatitja fetare ishte një përbërës themelor i arsimimit të çdo osmani, pavarësisht nga institucioni që i përkiste dhe anëtarët e ulemasë vazhdonin të ndikonin në institucionet e tjera, si mësuesit, kujdestarët dhe këshilltarët e zyrtarëve të lartë. E drejta e ulemave për të shpallur të pavlefshëm çdo lloj urdhri apo veprimi administrativ, u jepte atyre autoritet dhe pushtet të madh në rrjedhën e përditshme të çështjeve. Monopoli i tyre i arsimimit mbi miletin mysliman u jepte atyre pushtet mbi mendjet e masave, si dhe të anëtarëve të klasës

qeverisë. Aftësia e tyre për të nxjerrë me mijëra studentë nëpër rrugë u jepte ulemave një pushtet që përveç korpusit të jeniçerëve askush nuk e kishte. Kontrolli i tyre mbi gjysmën e pasurisë së Perandorisë nëpërmjet fondacioneve fetare u jepte atyre pushtet të jashtëzakonshëm financiar dhe fonde të bollshme për të shpërblyer e mbajtur jo vetëm anëtarët e tyre, por dhe të tjerë që mbështetnin dëshirat dhe synimet e tyre.

Por ulematë, që kishin ngjashmëri më të madhe me ushtarakët sesa me shkruarit, ishte dobësuar ndjeshëm për shkak të kalbëzimit të brendshëm. Qysh nga fillimi i shekullit të 17-të fanatizmi dhe obskurantizmi i kishin mposhtur arsyen dhe mjetet e mendimit e të logjikës, që i kishin dhënë ulemasë aftësinë për t'iu përgjigjur kushteve të reja, kishin humbur. Standardet e të mësuarit, të ushtruarit dhe të efikasitetit, të ngritura në epokën e madhështisë, ranë ndjeshëm, për shkak se emërimet dhe ngritjet në përgjegjësi ishin bërë nëpërmjet ryshfetit, lidhjeve personale dhe politikës së palëve. Si pasojë, megjithëse ulemaja e ruajti deri diku ndikimin e saj, ajo e humbi kohezionin në mendim e veprim, si dhe aftësinë për të vepruar në ndjekje të objektivave dhe politikave të përbashkëta, që e kishin aftësuar atë të bëhej një element force dhe baraspeshe në qeverinë osmane. Madje edhe fuqia e saj financiare, që e kishte burimin te kontrolli i fondacioneve fetare, ishte dobësuar shumë, pasi ulemaja i përdorte këto burime më shumë për përfitime të individëve apo palëve të caktuara sesa në interesin politik apo fetar të grupit. Një numër i vogël alimësh (pjesëtarë të ulemasë), i mbështetën reformat e shekullit të 18-të, me shpresën se do të përmirësonin gjendjen e institucionit të tyre, por pak reformatorë guxuan t'i afrohen një institucioni të mbuluar me kaq shumë shenjtëri e fe, sado i korruptuar që ishte. Kështu, në pjesën më të madhe të tij ky institucion ndryshoi fare pak deri në shekullin e 20-të, megjithatë qëndroi gjithmonë si një rival i fuqishëm, por pa unitet, ndaj zotësisë së shkruarëve për të depërtuar në shumicën e institucioneve të qeverisë osmane.

Si u përgjigj shoqëria në provincë, ku pushteti rrëshqiti nga njerëzit e qeverisë te pronarët e çifligjeve dhe të shquarit? Edhe në provincat feudale e në ato të fermave rendi sigurohej nga elementët me pushtet, që kishin pjesën e luanit në mbajtjen e burimeve, nga çifligarët e mëdhenj, njerëzit me pushtet dhe guvernatorët. Ishin katër faktorë kryesorë që siguronin njëfarë mbrojtjeje për shtetasit. I pari ishte interesi vetjak i guvernatorëve dhe i çifligarëve. Ata nuk mund të ishin aq shtypës sa t'i flaknin tej të gjithë prodhuesit e të ardhurave. Ata që ishin të pakërcënuar në pronat e tyre, kishin interes të drejtpërdrejtë për t'i mbrojtur prodhuesit dhe për këtë arsye siguruan një qeverisje të arsyeshme e të mirë, në shumë raste shumë më të mirë nga ajo që

siguronin vetë zyrtarët e rregullt osmanë. Vështirësitë lindnin kur të pushtetshmit dhe çifligarët fillonin të konkurronin e të luftonin me njëri-tjetrin për të siguruar për vete të ardhura të vazhdueshme. Në raste të tilla forcat në konkurrim kishin pak kohë për të vrarë mendjen për rritjen e prodhimit në shkallë të gjerë. Secili prej tyre mendohej të imponohej forcërisht në qytezat e fshatrat e diskutueshëm dhe shtypja bëhej e padurueshme.

Elementi i dytë i qëndrueshmërisë dhe mbrojtjes në Perandorinë Osmane në kohën e rënies së saj sigurohej nga garnizonet e jeniçerëve, të shtrirë nga provincat e fermave të taksave deri te provincat feudale kur forcat e timareve ranë. Megjithëse ishin nën kontrollin e guvernatorëve të provincave, këto garnizone përbënin një element relativisht të pavarur të pushtetit. Komandantët e tyre ishin të barasvlershëm me guvernatorët e provincave dhe përdroreshin kundër tyre nga Porta e Lartë për të siguruar shërbimet e garnizoneve sa herë që qeveria ndihej e pafuqishme. Jeniçerët shpesh ishin shumë shpërthyes dhe ushtronin dhunë mbi banorët e varfër të qytezave e të zonave ku ata ishin vendosur, por në shumë raste krijuan lidhjet e tyre me pronarët vendas. Në shumë qytete ata u martuan në popullsinë vendëse, u bënë tregtarë e artizanë me të ardhura të pavarura dhe filluan të përdorin korpusin për të mbështetur ndërmarrjet vendëse. Me kalimin e kohës jeniçerët u kthyen në garantues të mbrojtjes ushtarake për popullsitë vendëse kundër kërkesave shtrënguese të të shquarve dhe forcave të leventëve.

E lidhur ngushtë me rënien e qeverisjes osmane në nivel lokal ishte ngritja e ulemave si administratorë kryesorë të Perandorisë. Vetëm ulemaja kishte një organizim të gjerë në mbarë Perandorinë, me rrethet gjyqësore (kazatë) të përbëra nga kadilerët dhe naipët, që mund të merrnin përsipër detyrat e njerëzve të klasës perandorake e financiare. Kështu, në kohën e shpërbërjes detyrat e ushtruara nga kadilerët në shekullin e 16-të u bënë të pashmangshme. Ata u bënë përgjegjës kryesorë të autoritetit dhe vepronin për të mbrojtur masat e popullit nga pasojat e shpërbërjes së qeverisjes osmane. Gjithashtu ata vepronin për të organizuar e siguruar të gjitha shërbimet e nevojshme nga anëtarët e komunitetit mysliman, që u siguroheshin jomuslimanëve nga komunitetet e tyre përkatëse. Në të vërtetë ishte pikërisht kjo nënstrukturë tradicionale për shoqërinë e Lindjes së Mesme që u ngrit me kadilerët për të mbushur hendekun e lënë nga sistemi osman në rënie dhe për të përbërë një faktor të katërt qëndrueshmërie në Perandorinë Osmane, që po merrte fund. Sfera e veprimtarisë së qeverisë i kishte lënë gjithmonë shumë çka në dorë komunitetit dhe ata vazhdonin të siguronin shkollat, drejtësi, shërbime shoqërore e të tjera si këto. Po në gjithë këtë ata bënë atë që kishin bërë gjithmonë, me të vetmin ndryshim: i

kushtuan më tepër rëndësi rritjes së mirëqenies së shtetasve. Shtresa që u zgjerua më shumë ishte ajo e esnafëve. Kjo ishte e natyrshme, pasi ata kishin përfshirë gjithmonë shumë anëtarë të klasës qeverisëse dhe kishin bashkëvepruar me qeverinë në fushën ekonomike. Tani esnafët vepronin si lidhje administrative mes qeverisë dhe popullsisë së qyteteve, duke imponuar rregullat e qeverisë, duke çmuar e mbledhur taksa, duke bashkëvepruar me qeverinë për të vënë nën kontroll inflamacionin, si dhe duke i siguruar qeverisë shërbimet e nevojshme. Në këtë mënyrë esnafët, në bashkëpunim edhe me komunitetet siguronin bërthamat autonome të qeverisjes lokale, që përgjithësisht mungonte në shoqërinë e mëvonshme osmane. Sigurisht që aftësia e esnafëve për të përmbushur detyrat e tyre u dobësua nga rënia që po pësonin dalëngadalë tregtia dhe industria osmane. Kontrolli i deteve lindore kaloi nga portugezët te flotat detare shumë më të fuqishme të Anglisë dhe Holandës nuk shkoi gjatë dhe mallrat e Indisë e të Kinës filluan të çajnë përmes Iranit e Kaukazit matanë territoreve të Muskovit, apo përreth Afrikës së Jugut për në Europë, duke i dhënë kështu plotësisht fund tregtisë mes Lindjes dhe Perëndimit nëpërmjet Lindjes së Mesme. Flotat tregtare të Europës tashmë sundonin edhe Mesdheun, duke vënë nën kontroll tregtinë osmane nga Europa apo për në Europë, duke e pakësuar kështu komunikimin e osmanëve me Egjiptin dhe Afrikën e Veriut, që u bënë autonome dhe thuajse të pavaruara. Rusia, tashmë nën kontroll të pellgut të Vollgës dhe të Kaukazit Verior, mori përsipër rolin e luajtur më parë nga tregtarët osmanë për të vepruar si ndërmjetës për tregtinë mes Europës dhe Azisë Qendrore. E ndodhur në kushtet e izolimit të plotë ekonomik, Perandoria Osmane iu nënshtrua fuqisë tregtare në zgjerim të Europës, tregtarët e së cilës përdornin kapitulationet për të nënshtruar tregtarët osmanë dhe për të përpirë nga Perandoria lëndët e para, aq të domosdoshme për pronarët e fabrikave. Përballë kësaj situatë esnafët osmanë morën masa shtrënguese ndaj tregtarëve në territoret e tyre. Ata shfrytëzuan lidhjet me qeverinë për të ruajtur atë tregti e industri vendëse që kishte mbetur për anëtarët dhe fëmijët e tyre, duke penguar kështu lëvizjet e brendshme futjen e teknikave të reja, që mund t'u kishin mundësuar atyre të mbroheshin dhe të konkurronin me manifakturat e Europës. Kështu, ndërsa ndihmonin për të organizuar dhe mbrojtur shoqërinë e qyteteve, ata i prenë udhën lindjes së shpirtit konkurrues dhe e penguan Perandorinë Osmane nga ndjekja e Europës në përshtatjen ndaj kushteve të reja ekonomike të kohë.

### 3. Legjislacioni otoman që u zbatua në Shqipëri

Perandoria Osmane e mbështeti pushtetin e saj në një legjislacion që përbëhej nga tri shtylla kryesore:

1. Sheriati ose, siç njihej nga të gjithë, “Ligji i shenjtë”
2. Kanunametë, që nuk përmbanin elementin fetar, të njohura si “ligjet laike”.
2. Kapitulationet

Perandoria osmane kishte ndërtuar një sistem të tërë medresesh për të aplikuar në to mësimdhënien e shkencës së jurisprudencës, që njihej me termin “fikh”. Në shekullin e 11-të medresetë quheshin “nizamije” dhe themeloheshin për të përmbushur qëllimin e vetëm: nxjerrjen e juristëve të “fikhu”-ut, që njiheshin me emrin “fakirë”. Në medresetë e para, *nizamijet*, kishte lëndë të tilla si “fikhu” dhe lëndë që jepeshin në gjuhën arabe, si morfologjia dhe sintaksa. Më vonë, në shekullin e 13-të, u ngritën medrese të tjera, që shërbenin për të studiuar traditën profetike, komentet e Kuranit dhe sintaksën<sup>216</sup>. Të gjitha mësimet e ndjekura nëpër këto institucione duhej të ishin në përputhje me ligjin islam, Sheriatin.

Kodi Ligjor, ose Kanuname, i përgatitur nga Sulejmani I në lidhje me edukimin, tregon se është i rëndësishëm të kuptosh misterin e krijimit, të formosh një shtet që operon në mënyrë të rregullt dhe të zbulosh reletet e kësaj bote për të siguruar vazhdimësinë e rregullit dhe mirëqenien e njerëzimit. Që të realizosh këto, është e rëndësishme të kuptohet universi i krijuar nga Zoti, si dhe të përvetësohen mësimet e Profetit. Aq sa mund të përcaktohet qartë nga Kodi, i shkruar në stilin e përdorur për dokumentet zyrtare gjatë asaj periudhe, këndvështrimet e administratorëve osmanë në lidhje me arsimimin tregojnë se qëllimi primar i arsimit ka të bëjë me ngritjen e nivelit të shkencës dhe të dijes dhe më pas me zgjerimin e virtytit, të talentit, fesë dhe Sheriatit, si dhe me zhvillimin e aftësive dhe kapacitetit njerëzor. Për kryerjen e të gjitha këtyre sulltani konsiderohej personalisht përgjegjës<sup>217</sup>.

---

216. R.Hillenbrand, “*Madrasa*”, 1129–1130.

217. C.Baltaci, XV-XVI Arsilar, 623–627.



Interpretimin e ligjit e bënin ulematë, që ishin të përgatitur teologjikisht dhe juridikisht për këtë funksion. Karakteristika kryesore e legjislacionit otoman, i veshur me petkun e së drejtës së shenjtë, ishte përjashtimi nga aplikimi i parimit të territorialitetit, pasi kjo binte në kundërshtim me vetë nocionin themelor të saj. Nga analiza e normave juridike otomane e drejta gjendet e shkrira me fenë dhe moralin, dhe kjo buronte nga konceptimi i vetë legjislacionit si shprehje e vullnetit të Zotit. E drejta myslimane i është nënshtruar një procesi në ndryshim nga njerëz të përgatitur posaçërisht në medrese për ndryshimin apo evoluimin e saj dhe mund t'i klasifikojmë në katër shkolla që modifikuan këtë të drejtë: *hanefit*, *melezit*, *shefeit*, *banbalit*. Roli i shtetit në gjithë këtë proces kufizohet vetëm në zbatimin dhe mbrojtjen e ligjit, dhe kjo përputhet me konceptimin e tij si një aparat teokratik, që duhet të ruante kultin e Allaut. Nga katër sistemet në vendin tonë deri në periudhën e reformave të tanzimatit është aplikuar *hanefiti*.

Sheriati konsiderohej kushtetutë e së drejtës myslimane dhe ishte një përzierje e normave fetare me ato juridike. Burime të saj janë Kurani, tradita, gjykimet, *ixhma* dhe analogjia.

Kurani, ose Libri i Shenjtë, i zbriti profetit të fundit, hazretit Muhamet, me qëllimin e përcaktuar për t'ia transmetuar njerëzimit. Ai është shpallur jo në formën e një akti momental, por në formën e një procesi unikal, të pashembullt, që ka zgjatur 23 vjet: nga viti 609 deri në vitin 632, të formësimit burimor të pazëvendësueshëm të fesë islame. Kurani kishte vendin kryesor për myslimanët, si një urdhëresë e shenjtë drejtuar njerëzimit nëpërmjet Profetit Muhamet. Prejardhja e tij hyjnore nuk linte vend për diskutim dhe, nëse haseshin kundërthënie mes dy rregullave të Kuranit, ishte gjetur si zgjidhje të zbatohesh normat më të reja. Interpretimi i Kuranit nuk u takonte njerëzve të thjeshtë, por personave të caktuar, që përgatiteshin në medresetë dhe merreshin vetëm me këtë punë. Çdo përsiatje, çdo meditim kërkon një ndërmjetësi ngulmuese, universal të fuqive mendore njerëzore për të kuptuar mesazhin hyjnor të Allahut, si zbulues, si dashuri e pacakshme, si fjalë e përjetshme. Perandoria Osmane e kishte të qartë se ndërmjetësia për të shpjeguar fjalën e Zotit është jashtëzakonisht e vështirë dhe kërkon kualitete intelektuale ndër më të lartat, është një proces i pafundmë, i gjallë i konceptualitetit, i dhuntive njerëzore për të kuptuar fizikisht dhe mendërisht mesazhin hyjnor, për të kapërcyer kufizimet njerëzore. Studiuesit e Kuranit i kanë ndarë urdhërimet e tij prej 114 suresh në dy grupe: 90 sure të Mekës (ato që Zoti ia shpalli Profetit në Mekë) dhe 24 sure të Medinës (për shkak të shpalljes së tyre në Medinë).

Burimi i dytë, *tradita*, karakterizohet nga prejardhja hyjnore, pasi përmbledh të gjitha udhëzimet verbale të Profetit dhe veprat apo qëndrimet e tij me miratim apo heshtje në situatë të ndryshme. *Ixhma* konsiderohej si një burim plotësues i dy të parëve, pasi përmblihte gjykimet e predikuesve të mëdhenj të fesë islame për shumë çështje që nuk gjenin zgjidhje të drejtpërdrejtë në Kuran apo në traditë.

*Analogjia* shërbente si një proces referues për t'u dhënë zgjidhje çështjeve analoge të zgjidhura sipas normave të Kuranit apo udhëzimeve.

Nëse do të shohim normat juridike të së drejtës myslimane, vihet re se nuk ka një ndarje strikte të degëve të ndryshme, pasi parimet, institutet dhe dispozitat juridike janë shpërndarë pa ndonjë kriter në burimet e përmendura më lart. Të bie në sy përzierja e tyre me udhëzimet fetare dhe porositë morale. Në vija të përgjithshme mund të bëjmë këtë ndarje: a) *norma të fushës civile*, ku gjejmë dispozita që rregullojnë zotësinë për të vepruar, kufizimet e saj; b) *norma me natyrë familjare*, si: martesë, kuptimi i saj, të drejtat dhe detyrimet që buronin prej saj, zgjidhja e saj, përcaktohej roli i gruas në familje në raport me bashkëshortin; c) *norma me karakter penal*, që dalloheshin për karakterin e tyre të ashpër. Përmendim këtu aplikimin e *talionit*, prerja e organeve të ndryshme, si formë sanksioni për kryerjen e veprave penale si vrasja apo plagosja. Përrjashtoheshin nga aplikimi i *talionit* gratë shtatzëna dhe të paralindurit. Ekzistonte mundësia e zëvendësimit të tij me një shumë të caktuar të hollash. Sanksioni më i rëndë, ekzekutimi me vdekje, zbatohej për këto vepra penale: mohimi i fesë, fyerja e Profetit, marrëdhëniet jashtëmartesore, grabitja. Vepra të tjera dënoheshin nga kadiu sipas gjykimit të tij të lirë. Sanksioni që aplikohet për këto vepra penale ishte goditja me shkop dhe gjoba. Procedura e gjykimit zbatohet vetëm nga kadiu, pa anëtarë të tjerë. Interesant paraqitet fakti që të gjitha seancat e gjykimit zhvilloheshin në territorin e xhamisë dhe po aty duhej të bëheshin edhe ekzekutimet e dënimeve, me përjashtim të dënimeve me vdekje. Drejtësia myslimane njihet dy figura të ngarkuara me zbatimin e së drejtës: *myftiu* dhe *kadiu*. I pari ishte funksionar shteti i përgatitur teologjikisht dhe juridikisht. Roli i tij konsistonte në dhënien e përgjigjeve për çështje juridike të diskutueshme ose për çështje për të cilat Ligji i Shenjtë nuk përmbante udhëzime të shprehura. Të dyja këto veprime njiheshin me emrin “fetva”. Këto nuk jepeshin për raste të veçanta, por zgjidheshin në parim dhe ishin të detyrueshme për t'u zbatuar nga kadiu ose nga administrata, nëse çështjet ishin paraqitur për diskutim nga myftiu.

Kadiu ishte funksionari (gjqytari) i ngarkuar nga Porta e Lartë që të jepte drejtësi në emër të sulltanit, në dorë të të cilit ishte emërimi dhe shkarkimi i tij. Ai ushtronte funksionin e tij në një territor të gjerë juridikisht dhe gëzonte të drejtën të vendoste vetë për llojin e dënimit, nëse nuk ishte parashikuar nga Kurani. Përveç detyrës së gjyqtarit ai kryente edhe rolin e kujdestarit për administrimin e pasurive të personave të paaftë për të vepruar dhe kujdestarin e grave për lidhjen e martesave.

### **3.1. Kanunametë ose ligjet laike**

Sulltani, duke e quajtur veten mëkëmbës të Profetit, gëzonte të drejtën të ushtronte veprimtari të kufizuar legislative, që konsistonte në nxjerrjen e udhëzimeve për zbatimin e drejtë të doktrinës fetare ose udhëzimeve plotësuese për aparatin administrativ, të cilat duhej të ishin në përputhje me Ligjin e Shenjtë. Sulltani arriti të nxirrte dekrete dhe të shpallte ligje plotësisht me iniciativën e tij, ligje të pavarura nga Sheriati, që u njohën me emrin *Kanun*. Këto ligje ishin të bazuara në parimet racionale dhe jo në ato religjioze dhe pikësëpari bënë pjesë në fushën e legjislacionit publik dhe administrativ. Këto përmbanin dispozita që u referoheshin çështjeve të ndryshme të veprimtarisë së shtetit në tërësi ose në krahina të veçanta të Perandorisë. Pra, sulltani ishte mbrojtësi dhe zbatuesi i Sheriatit. Zgjerimi i Perandorisë Osmane tregoi se në vende të ndryshme kishte shumë situata që nuk mund të zgjidheshin me anë të Sheriatit. Kjo solli domosdoshmërisht lindjen e rregullave apo ligjeve të reja, që u quajtën *kanunare*, të cilat ishin përmbledhje ligjesh të Perandorisë Osmane, që përmbanin normat themelore për rregullimin e regjimit feudal-ushtarak e të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore dhe që vlenin për gjithë shtetin ose vetëm për krahina të veçanta (sanxhakë). Të tilla ishin: kanunametë për sanxhakun e Shkodrës, Vuçiternit, Vlorës, Elbasanit etj. Kanunametë përmbanin dispozita edhe mbi çmimet e prodhimeve bujqësore, mbi regjimin doganor etj. Normat kryesore të regjimit ushtarak osman në këto kanunare ishin të njëjta, por në to gjenden norma që pasqyronin shkallën jo të barabartë të zhvillimit ekonomik e shoqëror të popullsisë në krahina të ndryshme.

Pushteti qendror në planin ligjvënës operonte edhe me dy forma të tjera: *beratet* dhe *fermanet*. I pari ishte një akt që nxirrej nga sulltani, me anë të të cilit emërohej një person në një detyrë

shtetërore, për caktimin e shpërblimit të funksionarëve, për njohjen e së drejtës për të përfituar timare etj. Edhe fermani ishte një akt i nxjerrë nga sulltani për çështje konkrete të organizimit të administratës. Fermanët njihnin të drejtat dhe privilegjet për persona fizikë ose juridikë.

Disa studiues mendojnë se Kanuni ishte i tepërt, pasi përqendrohej vetëm në dekretet e sulltanit, duke pohuar se Sheriati, ligji fetar islam, u jepte zgjidhje të gjitha çështjeve juridike. Një grup tjetër studiuesish mendojnë se kanuni jo vetëm ishte i nevojshëm, por edhe legal, nëse në Sheriat nuk jepeshin zgjidhje për çështje kontestuese, nëse ishte harmonizuar me ndonjë parim të pranuar nga të gjithë, që do të mund të shërbente si bazë për analogji, nëse ishte i domosdoshëm për të mirën e bashkësisë islame, nëse sulltani mund ta zbatonte me sukses dhe nëse nuk përmbante asgjë që ishte në kundërshtim me Sheriatin. Në parathënien e kanunave, e përpiluar nga fundi i shekullit të 15-të, thuhej: “*Me urdhër të sulltanit është kodifikuar ky kanun osman, sepse dispozitat e tij janë mjaft me rëndësi për përparimin e gjinisë njerëzore dhe për zgjidhjen e problemeve në popull*”<sup>218</sup>.

Me zgjerimin e Perandorisë Osmane nga mesi i shekullit të 11-të, parimet e kanunit u ngulitën fort në praktikën e legjislacionit islam, sepse, sipas traditës turke, sovraniteti i sundimitarit dhe konstatimi i kodit të tij, torusë, janë të lidhura ngushtë. Parimi i kanunit lëshoi rrënjë në Lindjen e Afërt që nga periudha që i parapriu drejtpërdrejt përparimit të Perandorisë Osmane.

Kanuni Osman përfshihej në fermanet, ku thuhej se “çdo gjë që urdhëron sulltani, është ligj i tij”, prandaj ai përmbante një sërë dekretesh, që ndonjëri nga sulltanët i sillte duke iu nënshtruar rrethanave të caktuara. Për këtë arsye çdo sulltan pas kurorëzimit të tij duhej t’i vërtetonte.

Sheriati ishte ligj themelor dhe i pandryshueshëm, ligji fetar islam. Secili ferman përmbante frazën “është në pajtim me Sheriatin dhe me kanunin e konstatuar më parë”.

Ekzistonin tri kategori kanunesh. Në kategorinë e parë futen dekretet me karakter ligji, që sulltani i lëshonte në raste të veçanta. Koleksionet e shpërndara të këtyre dokumenteve përmbanin mijëra dekrete të tilla ligjore, që përbënin pjesën më të madhe të kanunit osman. Në kategorinë e dytë futen dekretet që kishin të bënin me ndonjë fushë të posaçme ose shtresë shoqërore<sup>219</sup>. Në kategorinë e tretë hyjnë të gjitha kanunametë që janë zbatuar në tërë Perandorinë.

---

218. M.Arif tarikhi, *Osmani endjumeni mecmu’asi*.

219. J.Von Hammer (1815), *Des Osmanischen Reichs Staatsverfassung und Staatsverëaitung Vjenë*.

Të shumtën e këtyre ligjeve e kishte sjellë qeveria qendrore, varësisht nga problemet ose nevojat administrative, kurse formën e fermanit sekretarët e qeverisë. Dokumente të tilla më parë i kontrollonte Veziri i Madh, pastaj nishanxhiu ia dërgonte sulltanit dhe pasi sulltani i vërtetonte me gojë ose me shkrim, fitonin fuqi ligjore. I njëjti veprim është zbatuar në rastin e sjelljes së të gjitha ligjeve, pa marrë parasysh kush i ka propozuar i pari. Ka pasur edhe raste të rralla që sulltani e shpallte ligjin pa kaluar nëpër fazat e para. Përpilimi i kanunames ose komentimi i ndonjë çështjeje ligjore ka qenë kompetencë e nishanxhiut. Librat e tatimit dhe të regjistrimit të kadastrave të popullatës jepnin posaçërisht shkak për miratimin e ligjeve të reja. Sa herë ndërmerrnin ndonjë regjistrim të tillë në ndonjë krahinë të re të nënshtuar, hapi i parë që bënin turqit ishte të vërtetonin ligjet dhe adetet që kishin qenë në fuqi në atë vend para ardhjes së tyre. Perandoria nuk ka vepruar duke i anuluar të gjitha ligjet, adetet dhe institutet në atë territor, por kanë ruajtur një sërë të zgjidhjeve ligjore përkatëse lokale. Arsyeja kryesore pse Perandoria ndoqi këtë strategji ishte fakti se ndryshimet drastike të legjislacionit zvogëlonin të ardhurat tatimore.

Në vendet e pushtuara, kur osmanët bënin regjistrimet, ato institucione që mendohej se në veprimtarinë e tyre binin në kundërshtim me Sheriatin dhe me parimet ligjore osmane, nuk regjistroheshin. Të tjerat i regjistronin dhe i dërgonin në kryeqytet, që sulltani t'i miratonte. Kishte raste që Perandoria Osmane i përvetësonte ligjet në atë formë që i gjente në shtetet e pushtuara. Zyrtari që bënte regjistrimin kishte të drejtë t'i drejtohej me letër sulltanit, ku pasi bënte sqarimet përkatëse, t'i propozonte që ndonjë ligj të anulohej ose të rishikohej. Kjo për shkak të ankesave të popujve vendas ose nga domosdoshmëria që të rriteshin të ardhurat shtetëroren. Nëse sulltani i pranonte propozimet e dhëna dhe lëshonte ferman, ligjet e atij vendi plotësoheshin në zbatim të dekretit të tij, prandaj çdo regjistrim i ri ishte vendimtar për vërtetimin dhe modifikimin e dispozitave ligjore të ndonjë regjioni.

Mund të thuhet me siguri se në periudhën e parë të Perandorisë dispozitat lokale zinin një vend të theksuar ndër ligjet osmane dhe është fakt i pamohueshëm se shumë kanë ndikuar në zhvillimin e kanunit tipik osman<sup>220</sup>. Çdo sanxhak që ishte njësi themelore administrative e Perandorisë Osmane ka pasur defterin e vet të regjistrimit, kurse prej kohës së Bajazitit II është

---

220. H.inalcik (1959), *Ralyyet Rusumu, Belleten XXIII*, f. 575–608.

bërë ligj që çdo defter t'i paraprinte kanunameja e sanxhakut të caktuar, në bazë të së cilës zgjidheshin konfliktet lokale<sup>221</sup>.

Qëllimi kryesor i kanunamesë së një sanxhaku ka qenë caktimi i sasisë dhe mënyrës së tubimit të tatimeve në timare. Kjo do të thotë se në kanunname janë komentuar ligjet për trashëgiminë e pronës, për kalimin e pronësisë, për statusin legjitim të rajasë, ose për lirimin e saj eventual nga tatimet. Shumë rrallë në to gjendeshin ligjet penale ose ligjet që përcaktonin statusin e shtesës ushtarake.

Edhe pse çdo sanxhak kishte ligjet e veta, në thelb ato ishin në përputhje me ligjin themelor të shtetit: Kanuni Osman. Në realitet ka ekzistuar një sistem ligjor specifik i osmanlinjve, sistem fundamental për këtë regjim, kështu që osmanlinjtë çdo adet që binte në kundërshtim me atë sistem, nuk e kanë lejuar. Ishte Mehmet Fatiu ai që ka sistemoi për herë të parë në dy kanunametë e tij përmbledhjen e ligjeve të titulluar *Kanuni Osman*.

Kodi i parë i referohet rajasë dhe kreu i parë përmban grupin e ligjeve ndëshkuese që janë zbatuar ndaj tërë rajasë. Flet për tatimin e rajasë: e dhjeta, puna dhe më në fund detyrimet e tregut. Kjo kanunname është një kod që ka qenë në fuqi deri në kohën e Mehmed Fatiut, prandaj është e natyrshme që aty të jenë të pranishme ndikimet e forta lokale.

Kanunameja e dytë i përket viti 1476 dhe i referohet organizimit shtetëror. Këtu janë shënuar personalitete e larta të Portës së Lartë, gradat e tyre, rrogat, pensionet, protokollet dhe dënimet. Mënyra e të shkruarit dhe e të përpiluarit të tyre ishte plotësisht turke (islame) dhe jo bizantine, siç mendohej dikur<sup>222</sup>.

Krahas këtyre dy kanunameve të përgjithshme Mehmet Fatihu ka nxjerrë edhe disa dekrete legjislative, që kishin të bënin me minierat, me farkimin dhe qarkullimin e monedhave, me doganën, me monopolin, me tatimet, si dhe dispozita që rregullojnë statusin e disa shtresave<sup>223</sup>. Të gjitha këto dispozita e kanë shtrirë efektin e tyre deri në shekullin e 17-të dhe kanë pasur një ndikim të madh lokal.

Kanunameja e parë që përcaktonte statusin e rajasë, edhe pse më vonë i janë bërë plotësime dhe modifikime, paraqet thelbin e Kanunit Osman. Plotësimet e para të mëdha janë bërë para vitit 1501, gjatë sundimit të Bajazitit II. Parimet themelore të Kanunit Osmani janë formuluar nga

---

221. L.Barkan (1943), *XV-XVI mali inci asiriarda Osmanil imperatoriugunda zirai ekonominin hukuki vemail esiasiari, instambul*.

222. M.F.Koprulu (1953), *Alcune osservazione intorno all'influenza delle istituzioni byzantine sulle istituzioni ottomane*, Rome.

223. R.Anhegger dhe H.Inalcik (1956), *Kanunname-I sultani ber muceb-I orf-I Osmani*, Ankara.

fundi i shekullit të 14-të, pra shumë kohë më parë kodifikimit të tyre në kanunametë e Mehmet Fetiut. Prej kanunave nga fundi i shekullit të 16-të vihet re se parimi themelor i Kanunit Osman ka qenë se “rajaja dhe toka i takojnë sulltanit”. Kjo do të thotë se askush nuk ka pasur të drejtë dhe as ka mundur të zotërojë në ndonjë mënyrë tokën dhe të sundojë fshatarësinë pa autorizim të posaçëm të sulltanit. Ky parim sulltanit i siguronte sovranitet absolut në Perandori dhe përfundimisht i shmangu të gjitha format e sundimeve legale nëpër provinca. Ky parim në thelb ka qenë bazë e regjimit autokratiko-centralist osman. Parimisht Kanuni Osman i ka gjykuar shërbimet e punës, duke i zëvendësuar në të shumtën e rasteve me pagesë në të holla. Me këtë u fut sistemi fiskal, i cili në pikat themelore ka qenë më i thjeshtë sesa sistemet e mëparshme të shërbimeve feudale<sup>224</sup>, megjithatë nuk linte shteg për abuzim. Caktimi i taksave sipas pasurive dhe mbledhja e tatimeve në pajtim me ligjin janë parime që kanë rëndësi në sistemin tatimor.

Ligji penal zbatohet në gjithë Perandorinë, ai plotësohet nga Sheriati dhe mbi bazën e tyre gjykonin kadilerët. Për krimet e rënda, si: vrasja, grabitja, plaçkitja, parashikonte si dënim prerjen e ndonjë pjesë të trupit dhe ndalonte kategorikisht zëvendësimin e këtij dënimi me pagimin e të hollave. Kapituj të veçantë u kushtoheshin llojeve të ndryshme të vjedhjeve dhe dënimet e tyre, që nga gjrobat e deri te rrahja me shkopinj.

Ligji penal përshkohej nga fryma e parimit *lex tallons*, i cili përbënte bazën e Sheriatit. Ky ligj ka përfshirë dënimet dhe gjrobat që Sheriati nuk i ka përcaktuar qartë, për shembull, vjedhësit të kuajve i pritej dora ose ishte i detyruar të paguante patjetër gjobën prej dyqind akcesh, rreth pesë dukatë ari. Për pirjen e alkoolit kadiu caktonte numrin e rrahjeve me shkopinj, ndërsa ligji i sulltanit ka parashikuar gjobë. Interesant është parashikimi për rastet kur krimineli nuk gjendej. Në një rast të tillë ligji parashikonte dënimin e gjithë fshatit. Ashpërsia e dënimit varej edhe nga fakti nëse personi që kishte kryer krimin ishte mashkull apo femër, ishte i lirë apo rob, i martuar apo beqar, mysliman apo i ndonjë besimi tjetër. Në varësi të këtyre gjoba paguhej përgjysmë.

Sulltani, vezirët dhe përfaqësuesit e tjerë të pushtetit në konfliktet që lidheshin me punët publike kanë mundur të aplikojnë edhe faljen, dhe për këtë nuk i ka ndaluar kanunaveja. Dënimi me vdekje pa derdhje gjaku, që ekzekutohej me zënien e frymës me gajtan, ka qenë i paraprirë për anëtarët e dinastisë dhe për personalitet me pozita të larta.

Ligji osman ka pranuar zbatimin e precedentit dhe u ka lënë mundësi gjyqtarëve që, referuar fermanit, të vepronin në mënyrë modeste në pajtim me ligjin, i cili zbatohet sipas adeteve. Për

---

224. H.Inalcik (1959), *Osmanlilar'da Ralyyet Rusumu, Belleten*, XXIII, f. 575–608.

shembull, në një nga kanunametë parashikohej: “*Në rast se kanunameja nuk parashikon dispozitë të shkruar qartë, çështjen kontestuese kadiu duhet ta dërgojë zyrtarisht në kryeqytet. Duke vepruar në pajtim me urdhrin e dhënë, ai duhet të sjellë vendimin, të cilin është i detyruar ta regjistrojë në regjistrin e tij dhe pastaj zbatohet në raste të ngjashme.*”

Sulltani i emëronte kadilerët me dekret dhe urdhëronte që t’i komentonin dhe zbatonin njësoj Sheriatin dhe Kanunin. Kadilerët kanë përdorur përmbledhjet e kanuneve dhe kanë gjykuar në bazë të tyre. Ishte lënë në vullnetin e tyre që, nëse e shihnin të nevojshme, t’i shënonin modifikimet e tyre në kopjet e kanunave që dispononin. Kjo është arsyeja pse ligji osman ishte gjithmonë në zhvillim, ka pasur qindra kanunare me shënime, që kanë mbërritur deri në ditët e sotme. Sulltanëve u është dashur në praktikë që të aplikonin *adaletnametë*, shkrime me të cilat kanë rregulluar keqpërdorimin e pushtetit provincial.

Kanunametë janë ndër dokumentet më të rëndësishme të shtetit osman në shekujt XV–XVII. Në version ideal ato ofrojnë konceptin legal për të drejtën dhe për traditën turke të shtetformimit dhe të shtetadministrimit. Për pasojë, së bashku me defterët kadastralë osmanë, mes faqeve të para të të cilëve gjenden, ato parashirojnë më së miri politikën e vendosjes dhe të stabilizimit të sundimit në çdo hapësirë ku u shtri kjo Perandori.

Kanunametë osmane gjithashtu ofrojnë të dhëna të vyera edhe për sistemet shtetërore që osmanët gjetën në të gjitha territoret ku kjo Perandori shtri autoritetin e saj, duke përfshirë hapësira të tilla ndërkontinentale që fillonin nga Gadishulli Iberik e Lindja e Mesme e deri në Hungari, nga Afrika Veriore e Qiproja deri në Gjeorgji.

Ne sot disponojmë konunave për të gjitha territoret ku shteti osman vendosi sundimin e vet, pasi koha e hartimit të kanunave përkon me vendosjen e sundimit osman në të gjitha territoret e pushtuara rishtazi, ndaj informacioni që ato ofrojnë reflekton jo vetëm veçoritë specifike të politikës sunduese osmane në rajone të ndryshme të saj, por dhe diversitetin brenda territoreve që para pushtimit osman banohehin nga një grup etnik i caktuar.

E veçanta e kanuneve osmane qëndron në faktin se ofrojnë informacion jo vetëm për të drejtën historike që ka ekzistuar në territoret islame, por dhe për ato në territoret jomyslimane, ku osmanët vendosën sundimin e tyre. Tashmë është një fakt i pamohueshëm që osmanët gjetën Ballkanin, një hapësirë që banohej kryesisht nga popullsi jomyslimane dhe në fund të sundimit të tyre nuk e lanë sërish jomyslimane, por tashmë me shumicë dërrmuese myslimane.



Kanunametë përbëjnë burimin e dorës së parë prej nga mësojmë realisht për sundimin osman, ku konsistonte ai dhe si ai arriti të mbijetonte kaq gjatë edhe në territore që më parë nuk e kishin njohur sundimin e një shteti mysliman.

Kanunametë dhe i gjithë dokumentacioni legal osman janë shprehje e përpjekjeve për institucionalizimin e një tradite shtetformuese, që i ka rrënjët në historinë turke e më gjerë në traditën shtetformuese të vendeve të Lindjes.

Në tekstet e hershme juridike indiano-iraniane (*nasiahtname ve Siyasetname*) shteti përkufizohet kështu: “*Shteti nuk është gjë tjetër përveçse fuqia dhe autoriteti i sundimtarit.*”.

Në parim në çdo shtet të këtij lloji populli gjendet nën pushtetin e një sundimtari absolut patrimonial, i cili e merrte fuqinë nga Zoti dhe përgjigjej vetëm para tij. Po ndërsa përgjigjej vetëm para Zotit, sundimtari njëkohësisht ishte edhe autoriteti i vetëm dhe më i larti që mund t’i jepte fund një padrejtësie në tokë, pra ishte institucioni i fundit që mund t’i drejtoheshin taksapaguesit për të marrë drejtësi.

Ndërsa koncepti i drejtësisë në doktrinën politike indiano-iraniane është formuluar në këtë mënyrë: “*Fuqia e sundimtarit mbështetet në fuqinë ushtarake; fuqia ushtarake mbështetet në Thesarin e Shtetit; Thesari i shtetit mbështetet tek taksat që paguajnë fshatarët, kurse rritja e taksave është e lidhur drejtpërdrejt me zbatimin e drejtësisë. Drejtësia është themeli i administrimit të shtetit.*” Pra, me “drejtësi kuptoj akti i mbrojtjes së atij që kishte nevojë për të: subjektit taksapagues.

Në veprën “*Kutadgu Bilig*”, një ndër më të hershmet e turqishtes së shkruar, thuhej: “Fshatari që nuk jeton me sigurinë e jetës dhe të pronës, nuk mund të prodhojë e për pasojë i bie edhe kapaciteti taksapagues. Në një situatë të tillë, për të mbajtur buxhetin gjithmonë plot me para, bëhet e domosdoshme që sundimtari të sillet me maturi ndaj fshatarit-raja, gjendja e të cilit kërkonte të aplikohet një administrim të drejtë”.

Në traditën e hershme shtetformuese turke ekzistenca e shtetit garantohej nga një sundimtar që vendoste ligj. Turkomongolët e Azisë së Mesme kanë pasur *codex*-et e tyre, të cilat kanë rregulluar organizimin e tyre social e politik. Këtu e ka bazën ligjore edhe nxjerrja e *fasa*-së (kanunname) nga Xhengis Hani në kohën që shtetin e tij e shpalli perandori botërore. Madje edhe pasardhësit e tij i urdhëroi të mos i largoheshin kësaj tradite të administrimit të shtetit.

Kjo traditë juridike u plotësua me kanunet (ligjet) që nxorën kohë pas kohe sundimtarët e tjerë turq, duke hedhur kështu bazat e asaj tradite legale që në jurisprudencën turko-osmane njihet me termin *orf*.

Tradita juridike në fjalë gjithmonë ka përbërë themelin e organizimit shtetëror dhe të sundimit të turqve, në themel të të cilit qëndron filozofia se sundimtari zotërimet dhe popullin e tij mund ta mbajë të disiplinuar vetëm me anë të ligjit (kanunit). Vetëm autoriteti i sundimtarit qëndronte mbi ligjin. Sundimtari nxirrte ligje dhe i miratonte ato. Të gjitha grupet sociale statusin e tyre e kishin të bazuar dhe të përcaktuar prej vullnetit apo dëshirës së sundimtarit. Me fjalë të tjera, vënia në vend e drejtësisë ishte një e drejtë që varej tërësisht nga dëshira e sundimtarit. Nga ana tjetër, ishte vetëm koncepti shtetëror i drejtësisë ai që mund ta kufizonte autoritetin e pakufi të sundimtarit. Në traditën turke të shtetformimit detyrat e sundimtarit, që mishëronte përmbushjen e drejtësisë në shtetin e tij, ishin:

- Të mbante të pastër monedhën në qarkullim.
- Popullin e tij ta qeveriste me ligje të drejta dhe të mos u linte hapësirë padrejtësive të të fortëve ndaj më të dobëtvë.
- Të eliminonte të gjitha bandat që prishnin rendin publik.
- Rrugët e komunikimit brenda territoreve të tij t'i mirëmbante, në mënyrë që ato të ishin të qarkullueshme dhe të sigurta.
- Çdo individ brenda shtetit të trajtohej në përputhje me rangun që i përkiste.

Në sistemin shtetëror patrimonial, që mbështetej në pushtetin absolut të sundimtarit, vënia në vend e së drejtës përkundrejt dhunës së më të fortit ndaj më të varfrit konsiderohej detyra më e rëndësishme për një sundimtar.

Në traditën e tyre shtetformuese turqit i sollën islamit dimensionin e themelimit dhe të ruajtjes së një shteti të fortë. Në traditën shtetformuese turke shteti barazohej me sundimin e dinastisë drejtuese, që e mbështeste autoritetin e saj në personin e sundimtarit të plotfuqishëm - sulltanit. Ishin këto interesa të larta që në periudha të caktuara diktonin faktin që krahas Sheriatit të funksiononte edhe tradita juridike, së pari, si shprehje e koncentruar e proceseve shtetformuese dhe së dyti, si shprehje e vullnetit të sundimtarit të kohës. Thënë ndryshe, fuqia e traditës

shtetformuese e mishëruar te kanuni ishte e reja që turqit i sollën doktrinës islame në shekullin e 11-të, kur u konvertuan në islamë.

Rivaliteti mes ligjit islam dhe ligjit tradicional në Lindjen e Mesme në terren ishte manifestuar në rivalitetin mes dijetarëve islamë dhe mbartësve të autoritetit shtetëror në çdo kënd të perandorive islame.

Sundimtarët turq, ndonëse u shfaqën si respektuesit më të mëdhenj të fesë islame, autoritetin dhe interesat e shtetit i vunë mbi gjithçka. Për të mbrojtur këto interesa ata nxirrnin ligje, kanune. Në këtë kontekst, turqit besonin se ekzistenca e sulltanit ishte e domosdoshme për të ruajtur sistemin, kohezionin social, ndaj ai duhej të gëzonte një autoritet të plotë dhe absolut.

Në Perandorinë Osmane gjithkush ishte nën juridiksionin e ligjit, vetëm sulltani ishte përmbi ligjin. Vetëm sulltani kishte tagrin të nxirret ligje dhe t'i miratonte ato. Për pasojë, të gjitha grupet sociale statusin e tyre e kishin të bazuar dhe të përcaktuar prej vullnetit apo dëshirës së sulltanit. Përveç kësaj sulltani kishte jo vetëm fuqinë të nxirrte ligje, por dhe t'i ndryshonte ligjet apo edhe t'i revokonte ato kur e shihte të arsyeshme. Pra, sulltani gëzonte fuqi në terma absolutë, çka bënte që shumicën rasteve të ishte arbitrar. Kur sulltani vdiste, sulltani i ri nuk njihte statusin e askujt dhe të asnjë grupi social, pasi ishte përcaktuar nga sulltani i mëparshëm. Ripërtëritja e dekretëve perandorake nga sulltani i ri do të thoshte vazhdim ose abrogim i statusit të një individi apo grupimi social. Edhe kanunameja dhe defteri kadastral duheshin miratuar nga sulltani i ri që të fitonin serish fuqi ligjore.

Në këtë kuadër, nxjerrja e kanunameve nga sulltan Mehmeti II, përtej kontekstit ligjor islam, duket se ishte i lidhur me traditën turko-mongole dhe me projektin e tij që shtetin e deriatëhershëm osman ta shndërronte në një perandori botërore, ku sulltani, si figura simbol e tij, të gëzonte atë fuqi absolute që në literaturën shkencore historiko-sociologjike njihet me termin “sulltanizëm”.

Kanunametë janë një burim i mirë për të gjykuar edhe politikën osmane dhe normat e praktikës juridike turke krahasuar me Anadollin e islamizuar dhe Ballkanin, një territor i marrë rishtazi nën sundim dhe ku dominonte popullsia jomyslimane. Në një vështrim krahasues mes kanunave të Ballkanit dhe atyre të Anadollit mund të na çojë në vizionin që kishin osmanët për Ballkanin dhe Anadollin.

Sipas rëndësisë që kishin në ekonomi produkte të caktuara dhe rëndësisë që kishin në aspektin financiar të ardhurat e një takse, natyrës së relievit dhe pozicionit gjeografik, kanunet osmane paraqitin edhe veçoritë e tyre formale e tematike.

Kanunametë ofrojnë informacion të gjerë për kulturat bujqësore: drithërat, llojet e tyre, mënyrën dhe kohën e kultivimit, për vreshtarinë dhe prodhimin e mushtit e të verës, për frutikulturën, bletarinë, mullinj të etj. Identifikimi i kulturave bujqësore për shkak të taksimit të tyre zë vendin hyrës pothuajse në të gjitha kanunametë e formatit klasik të sanxhaqeve. Nga njëra anë, kjo tregon se me çfarë kulturash bujqësore ushqej popullsia dhe, nga ana tjetër, se bujqësia përbënte aktivitetin ekonomik kryesor me të cilin ishte e angazhuar shoqëria shqiptare e asaj kohe.

Kanunameja e qytetit të Shkupit është një burim krejt origjinal informacioni për jetën urbane dhe ekonominë zeytare të një qytetit të rëndësishëm nën administrim osman aty nga gjysma e dytë e shekullit të 15-të. Kurse dy kanunametë e sanxhakut të Vlorës pjesën e parë dhe më të rëndësishme të tyre ia kanë kushtuar aktivitetit tregtar detar dhe doganave, të cilat me sa duket rezervonin edhe burimin kryesor të të ardhurave të këtij sanxhaku. Në qytete si Kosturi dhe Hrupishta, dy qytetet me pozicion gjeografik specifik, kanunametë trajtonin vetëm problematikën e shkëmbimit tregtar të mallrave me një spektër shumë të gjerë prodhimi dhe konsumi.

Kur një kulturë bujqësore ose një produkt artizanal bëhej objekt taksimi, ajo dëshmonte rëndësinë e saj për ushqimin e popullsisë dhe për interesat ushtarake të shtetit. Marrë në tërësi, kanunametë që kemi përfshirë në këtë studim përbejnë vetëm një pjesë të kanunaveve osmane kushtuar rajonit të Ballkanit, por me shumë vlerë për të analizuar si politikën që osmanët zbatuan në gjithë rajonin, ashtu dhe në pjesë të veçanta të tij.

Në vitin 1957 një ekip i specializuar osmanistësh nga Sarajeva përgatitën për botim një përmbledhje kanunamesh osmane, kryesisht për ato territore që në atë kohë përfshiheshin brenda hapësirës politike të shtetit jugosllav. Kjo ishte përpjekja e parë për të paraqitur të gjitha kanunametë që ekzistojnë për një sanxhak. Versioni origjinal osmanisht me germa shtypi është shoqëruar edhe me përkthimin në gjuhën serbokroatë. Në këtë përmbledhje të bie në sy saktësia filologjike në deshifrimin dhe përkthimin e kanunaveve.

Gjithashtu me interes është fakti që aty janë përfshirë edhe disa kanunave të sanxhakut të Shkodrës, të Dukagjinit dhe të Malit të Zi, pasi organizimi territorial dhe administrativ osman i

shekujve XV–XVI ishte i ndryshëm nga konfigurimi politik i kësaj pjesë të Ballkanit në mes të shekullit XX, kohë kur u përgatit ky vëllim.

Përpyekjen e parë për botimin e një vëllimi të tillë me kanune të veçanta për nga tematika dhe rajonet të cilave u drejtohen e shënon vëllimi që përfshin kanune të hartuara gjatë mbretërimit të sulltanëve Mehmet II (1444–1446, 1451–1481) dhe Bajaziti II 1481–1512). Kjo përmbledhje kanunësh, e përgatitur nga studiuesi gjerman R. Anhegger dhe studiuesi turk H. Inalcik, ofron versionin osmanisht me germa latine shoqëruar me faksimilen e plotë të këtij vëllimi dokumentar.

Përveç prezantimit të problematikës juridiko-fiskale me të cilën është përballur sundimi osman në Ballkan dhe Anadoll gjatë shekullit të parë të tij, ky botim shërben edhe si një bazë fillestare për të njohur ndërtimin diplomatik të një akti juridiko-fiskal osman, madje ka shërbyer edhe për të hedhur dritë mbi ecurinë e procesit të kalimit nga një kanun me tematikë specifike në hartimin e një kanunemeje sanxhaku.

I pari studiues që ka treguar interes për njohjen e kanunemeve për viset shqiptare është historian austriak Joseph von Hammer. Orientalisti i madh austriak përgatiti për botim gjermanisht një përkthim të pjesshëm të kanunemesë së sanxhakut të Delvinës të vitit 1583 dhe përmbledhje të kanunemeve të sanxhakut të Vlorës dhe të Elbasanit, po të vitit 1583.

Me cilësinë e shkruarit të dokumentacionit zyrtar, qatipët janë autoritetet shtetërore osmane që hartonin apo kopjonin kanunametë osmane. Natyrisht, niveli i tyre profesional dhe kulturor ka përcaktuar edhe cilësinë e kanunemeve që ata kanë shkruar.

Termi “kanun” në shqip jo gjithmonë përkon me termin “ligj”<sup>225</sup>. Ky term, nga më të rëndësishmit dhe më të përdorshmit nëpër kanunare, sipas kontekstit, në shqip është përkthyer me fjalët “*ligj*”, “*rregull*”, “*praktikë juridike*”, “*praktikë fiskale*”, “*normë*”, “*zakon*”.

Rasti tipik ilustrimi i këtij fenomeni është zëri me numër rendor 40 i kanunemesë së Vlorës, e vitit 1583, ku brenda një paragrafi hasim një larmi të tillë kuptimore të këtij termi, çka na ka detyruar të përdorim termat e sipërcituar për ta sjellë në një shqipe efikase.

*Llojet e kanunemeve gjatë pushtimit osman janë:*

- kanuneme të përgjithshme perandorake;

---

<sup>225</sup> *Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë*, Dritan Egro, faqe 43.

- kanunname të sanxhaqeve;
- fermane (urdhra) dhe berate (dekrete) me fuqinë e ligjit të lëshuara nga sulltani për çështje të caktuara.

Kanunametë e përgjithshme të Perandorisë Osmane, më të hershmet që disponojmë sot të kësaj kategorie, përbëjnë burimin kryesor për njohjen dhe organizimin qendror dhe provincial të saj. Këto kanunname të përgjithshme janë hartuar gjatë mbretërimit të sulltan Mehmetit II pas shtënies në dorë të Stambollit nga osmanët dhe janë produkt i periudhës së kalimit të Turqisë nga shtet në perandori. Këto dokumente jo vetëm reflektojnë nivelin e zhvillimit të legjislacionit osman të asaj kohe, por reflektojnë edhe personalitetin e sulltanit të kohës dhe problematikën juridike me të cilën përballlej shteti osman në këtë periudhë kohore.

Forma kryesore juridike që u përdor për rregullimin e marrëdhënieve agrare ishin kanunametë në hartimin e të cilave ishin marrë parasysh edhe kushtet ekonomike – shoqërore, edhe traditat zakonore të Shqipërisë. Kanunamet për Shqipërinë sanksiononin gjendjen e pronësisë mbi tokën, pozitën feudale të spahijve dhe të pronarëve të tokave, detyrimet e feudalëve dhe detyrimet e tjera feudale të popullsisë së nënshtruar, duke patur si qëllim mbrojtjen e pronës feudale ushtarake mbi tokën.<sup>226</sup> Kanunametë e sanxhaqeve administronin vise dhe popullsi shqiptare apo territore ku dëshmohej prania e elementit shqiptar. Si të tilla përmenden kanunametë e sanxhakut të Shkodrës dhe të vilajetit të Malit të Zi, të përfshira në defterët e sanxhakut të Shkodrës dhe të sanxhakut të Dukagjinit; kanunametë e sanxhakut të Lepantos dhe të Eubesë në jug.

Është interesant fakti që sanxhaku i Janinës nuk ka kanunname. Me sa duket, dorëzimi i qytetit osmanëve në vitin 1430 ka ndikuar në faktin që ky qytet të jetë një rast tipik kur osmanët kanë pranuar situatën ligjore ekzistuese, dhe kjo situatë specifike ka vazhduar gjatë gjithë periudhës osmane.

Mes kanunameve të sanxhaqeve në aspektin formal diplomatik nuk hasim vetëm kanune të formatit klasik, siç janë kanunametë e sanxhakut të Elbasanit (1583), të Vlorës (1583) dhe Ohrit (1583, 1613), por edhe kanune dhe kanunname të pjesshme (kanunameja e sanxhakut të Vlorës,

---

<sup>226</sup> *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri* “ Prof.Dr.Paskal Haxhi, faqe 12.

1520; kanuni i tregut i Kosturit, 1529; kanuni i tregut të Hrupishtës, 1543 etj.), të cilat trajtojnë aspekte dhe problematika që ishin specifike për rajonet në fjalë.

Mes kanunave më të spikatura të asaj kohe janë ato të sanxhakut të Shkodrës, të cilat, ndonëse të hartuara vetëm për një sanxhak, paraqesin një ndryshim të madh si në aspektin formal diplomatik, ashtu dhe për nga përmbajtja, ndryshime të cilat kanë ndodhur vetëm brenda një shekulli (fundi i shekullit të 15-të, fundi i shekullit të 16-të).

Larmi vërejmë edhe për sa i përket frekuencës në kohë të hartimit të kanunave. Frekuencë me e lartë vërehet për ato sanxhaqe ku sundimi osman ka hasur vështirësi në instalimin e tij. Qartësisht këtë e vërejmë në sanxhakun e Shkodrës, ndërkohë që për sanxhaqet e tjera mesatarisht janë përpiluar vetëm nga dy kanunave.

Sanxhaqet osmane të kësaj pjesë të Ballkanit përgjithësisht shtriheshin rreth e rrotull qytetit emrin e të cilit kanë marrë. Por kanunametë e vilajetit të Malit të Zi, për shkak të afërsisë gjeografike, gjenden brenda defterëve kadastralë të sanxhakut të Shkodrës apo atij të Dukagjinit.

Interesant është edhe fakti që mes kanunave të hartuara për vilajetin e Malit të Zi një kanunave u kushtohen tërësisht rasteve të fajit dhe figurave të krimit, pra është një kod penal lokal. Kjo kanunave, e cila del tërësisht jashtë formatit të një kanunave sanxhaku, përbën një bazë të mirë studimi dhe analize krahasuar me kodin penal osman të aplikuar në nivel perandorak.

*Fermanet* (urdhurat) dhe *beratet* (dekrete) perandorake janë hartuar për t'u dhënë zgjidhje disa prej problemeve me të cilat përballej shteti osman ndërkohë që zgjeronte territorin e tij dhe vendoste për herë të parë autoritetin e vet të centralizuar. Këto urdhra dhe dekrete i janë kushtuar problematikës relativisht të hershme me të cilën është përballuar shteti osman në viset e banuara nga popullsi shqiptare. Me ndonjë përjashtim, ato përkohë me kohën kur ende nuk ishin hartuar kanunametë e para për sanxhaqet me popullsi shqiptare, pra janë hartuar para se sundimi osman të vendosej në të gjitha territoret me popullsi shqiptare. Por mes tyre ka edhe kanune, të cilat, ndonëse nuk kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me viset dhe popullsinë shqiptare, nga problematika që trajtojnë shërbejnë si modele veprimi për të njëjtën problematikë edhe në viset shqiptare.

Urdhurat sulltanorë me karakter ligji (*fermanet*) kanë shërbyer si bazë praktike për ndërtimin e kapitujve të veçantë të kanunave të sanxhaqeve dhe kryesisht kanë të bëjnë me rajone të veçanta të Perandorisë dhe për probleme që janë specifike për to. Por nuk përjashtohen edhe

rastet kur këto kanune për probleme të veçanta të evidentuara në një vend të caktuar më pas kanë shërbyer si precedent për hartimin e një trajte më të zgjeruar kanuni për të njëjtin problem, por për vise të tjera të Perandorisë, madje edhe për të njëjtën problematikë, por në nivel perandorak. Një rast tipik është fermani për vjeljen e haraçit për kokë ose, siç njihet ndryshe, *taksën e xhizjes* në rajonin Zagori–Përmet, dokument i cili më pas shërbeu si bazë për të ndërtuar ligjin për vjeljen e haraçit në rajonin e Ballkanit.

Një kategori e veçantën e urdhrave me fuqinë e ligjit ishin edhe *yasakname*-të (urdhër ndëshkimi), e thënë ndryshe, fermanet e sulltanit për t'i dhënë fund një herë e mirë një padrejtësie ose një realiteti që binte ndesh me normat e ligjit osman, që përgjithësisht nxirreshin mbi bazën e konstatimeve të bëra nga emisarët e sulltanit.

Kanunametë dhe i gjithë dokumentacioni legal osman, madje edhe të gjitha kodet juridike osmane që dolën gjatë periudhës së Tanzimatit, në fakt janë një vazhdim i traditës së nxjerrjes së ligjeve me karakter laik, përpjekje që i ka rrënjët e thella në historinë turke. Sistemi juridik që rëndom njihet me emrin “Kanuni Osman” përbën një prej kolonave për të shpjeguar jetëgjatësinë e Perandorisë Osmane, për të argumentuar bëmat e sulltanëve osmanë. Gjithashtu sistemi i Kanunit Osman i jep edhe origjinalitet traditës turke të shtetformimit mes popujve myslimanë të Lindjes së Mesme.

## **Kapitulacionet**

Perandoria Osmane vendoste regjime të veçanta për përfaqësuesin e shteteve europiane dhe për qytetarët e tyre që qëndronin ose kalonin në tokat e saj me anë të një dokumenti që njihet me emrin “kapitulacione”. Kapitulationet u njihnin shumë të drejta, imunitet vendeve të ndryshme dhe privilegje. Në shekullin e 8-të me anë të një marrëveshjeje që iu imponua Turqisë nga shtetet evropiane nga koncensione këto u shndërruan në detyrime kontraktore. Turqia i aplikoi ato në interes të zhvillimit të tregtisë, edhe pse ato kufizonin sovranitetin e saj në favor të shteteve të tjera.

### **3.2. Reformat në fushën agrare para Tanzimatit**



Me vendosjen e sundimit osman në tokat shqiptare gjatë shekullit të 15-të shteti osman bëri të mundur regjistrimin e tokave në kuadër të sistemit të timareve, duke i shpallur të gjitha tokat në të punueshme dhe të papunueshme (arat, livadhet, kullotat, pyjet, korijet), pavarësisht se në duart e kujt ndodheshin. “Perëndia” ishte pronari juridik i tokave shtetërore, të cilat u administruan prej sulltanit. Ky i fundit ua dha feudalëve ushtarakë dhe funksionarëve të administratës civile, fetare dhe gjyqësore, me kusht që të paguanin taksën e së dhjetës dhe të merrnin pjesë në luftë me njerëzit e tyre. Megjithëse tokat *mirie* u ndanë dhe iu dhanë në zotërim feudalëve të ndryshëm, shteti osman mbeti gjithnjë pronar i vërtetë i këtyre tokave<sup>227</sup>.

Veprimi i parë që bënte osmanët për vendosjen e regjimit ekonomik, shoqëror dhe politik të tyre ishte shpronësimi i klasës feudale shqiptare nga toka. Ky proces u krye në një periudhë gati njëshekullore (nga fundi i shekullit të 15-të deri në fund të shekullit të 16-të) në saje të dhunës ushtarake dhe mjaft masave e metodave të tjera të njohura osmane të karakterit ekonomik, politik, ideologjik e fetar, siç ishin marrja peng e fëmijëve të feudalëve vendas për t’i përgatitja si kuadër të klasës sunduese osmane. Pushteti osman nuk mundi të bënte shpronësimin e plotë dhe të menjëhershëm të klasës feudale për shkak të qëndresës të ashpër të saj dhe të fshatarësisë shqiptare<sup>228</sup>.

Pronësia feudale osmane mbi tokën e vendosur në trevat shqiptare njohu format e zakonshme të zbatuara edhe në vise të tjera të Perandorisë: pronësinë shtetërore (tokat *mirie*), atë të feudalëve të veçantë (*mylk*) dhe atë të institucioneve fetare (*vakëf*). Pronësia shtetërore (*mirie*) zinte sipërfaqen më të madhe të tokave dhe i jepte përmbajtjen themelore regjimit feudal ushtarak osman. Ajo u bë mbizotëruese dhe së bashku me format e tjera të pronësisë përbënte një formë të veçantë të pronësisë të klasës feudale osmane, që zëvendësoi pronësinë private të sundimtarëve feudalë shqiptarë ekzistues para pushtimit në pjesën më të madhe të vendit<sup>229</sup>.

Për sa u përket tokave shtetërore (*mirie*) ato iu dhanë në zotërim feudalëve spahinj dhe zotërimi i tyre ishte personal, i patrashëgueshëm dhe i patjetërsueshëm. Ndërsa pronari i tokës *mylk* zotëronte të gjitha të drejtat që zotëron në ditët e sotme një pronar, sikurse janë e drejta e trashëgimisë dhe e tjetërsimit.

---

227. Haxhi P. (1998), “Regjimi juridik i tokës në Shqipëri”, Tiranë f. 12.

228. Pulaja S. (1988), ‘Pronësia feudale mbi tokat shqiptare’, Tiranë. f 6.

229. Po aty, f. 8.

Ndërsa kategoria e tretë, që ishin tokat *vakëf*, ishin të përjashtuara nga detyrimet ushtarake. Pronari i këtyre tokave caktonte një kujdestar për t'u kujdesur për to dhe të ardhurat që siguronte prej tyre i investonte për vepra bamirësie, si për shembull, ndërtimin e xhamive, të tyrbeve dhe shkollave<sup>230</sup>.

Duhet theksuar fakti juridik se pjesa më e madhe e tokave shqiptare i përkiste formës të tokave shtetërore (*mirie*). Këto përbënin fondin e tokave të përfshira në sistemin e timarit në disa kategori. Në radhë të parë bënin pjesë tokat e punueshme: arat, livadhet në zotërim të fshatarëve. Tipar dallues i këtyre tokave (*rajatike*) ishte fakti se fshatarët që i zotëronin ato ishin të detyruar të shlyenin një varg detyrimesh si ndaj spahiut, ashtu dhe ndaj shtetit. Legjislacioni nuk lejonte ndryshimin e statusit të tyre dhe ruante dallimin fetar midis bashtinës dhe çifligut. Në rast se një mysliman merrte një bashtinë, i shlyente detyrimet si i krishterë<sup>231</sup>.

Përveç tokave rajatike kishte edhe disa toka jorajatike, truallishtet (*mezra*), që ishin tokat djerre të fshatrave dikur të banuara, por që ishin braktisur nga popullsia. Ato mund të punoheshin dhe të mbilleshin nga fshatrat fqinje. Prej tyre merrej vetëm e dhjeta e prodhimeve bujqësore. Spahiu kishte të drejtë t'i jepte me tapi dhe taksën e tapisë ta merrte shteti. Punimi i këtyre tokave mund të bëhej edhe nga fshatarë të ardhur. Të njëjtin status me këto toka kishte edhe toka djerre brenda timareve të lëna si kullota dimërore dhe verore. Spahiu kishte të drejtë të vilte taksën për dimërimin dhe verimin e bagëtive nga fshatarët që sillnin bagëtitë për kullotë, por jo nga fshatarët e fshatit ku ndodhej kullota<sup>232</sup>.

Në periferi të qyteteve tokat nuk ishin privatë, por as toka rajatike. Përreth qyteteve kishte mjaft çifligje të ngarkuara me të dhjetën dhe taksën e kashtës.

Një kategori më vete përbënin tokat që u ishin dhëna në zotërim personave të ngarkuar me shërbime ushtarake në luftë, në prapavijë ose me shërbime administrative. Këto u jepeshin si bashtina ose çifligje *vojnukëve*, stalljerëve dhe rritësve të shpendëve ose gjuetisë, pjesëtarëve të korpusit ushtarak. Tokat ushtarake trashëgoheshin dhe ishin të përjashtuara nga e dhjeta, *xhizja*, taksat e jashtëzakonshme shtetërore dhe nga çdo detyrim tjetër përkundrejt detyrimit ushtarak<sup>233</sup>.

---

230. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT, "*Burime të zgjedhura*", "Shqipëria nën sundimin feudal ushtarak osman, f. 9, Tiranë, 1962.

231. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, "*Historia e popullit shqiptar*", shtëpia botuese "Toena", vëllimi I, f. 518, Tiranë 2002

232. Po aty

233. Po aty.

Toka shtetërore u nda në zotërime të veçanta, të cilat në varësi të të ardhurave që jepnin u quajtën *has*, *zimaet* dhe *timar*. Të ardhurat mesatare vjetore maksimale të *hasit* që u jepeshin pjesëtarëve të aristokracisë feudale (sulltanit, vezirëve, bejlerëve, sanxhakbejlerëve) i kapërcenin të 100 mijë akçet, të *zimaetit* i kapërcenin 99 999 akçet dhe të ardhurat e timarit, që zakonisht u jepeshin feudalëve të vegjël, nuk i kapërcenin 19 999 akçet. Është interesant fakti që nga dy regjistrime të ndryshme që u bënë gjatë një shekulli numri i timareve kaloi nga 471 që ishin në vitin 1431 në 2070 në vitin 1533<sup>234</sup>.

Timaret, *ziametet* dhe *haset* u jepeshin spahinjve kundrejt detyrimeve të caktuara të pushtetit qendror. Timarliu ose *zaimi* gëzonte Timarin apo *ziametin* me kusht që me shpenzimet e veta të shkonte në luftë si kalorës i armatosur nën urdhrat e sanxhakbeut sa herë ta thërriste sulltani. Kushtëzimi i dhënies së zotërimit të një timari në favor të një spahiu me detyrimin për të kontribuar me ushtarë i dha sistemit të timareve në fazën e parë të tij një karakter të theksuar ushtarak. Kur sulltani me anë të një urdhri (fermani) kërkonte grumbullimin e forcave ushtarake, të gjithë spahinjët së bashku me xhebelinjët, të armatosur dhe të pajisur për luftë me shpenzimet e tyre, paraqiteshin pranë sanxhakbeut, që ishte i detyruar të shkonte me gjithë forcat ushtarake të sanxhakut<sup>235</sup>.

Pronësia feudale osmane në trevat shqiptare pati po atë përmbajtje dhe po ato tipare që e karakterizuan edhe në viset e tjera të Perandorisë. Ajo u vu në jetë mbi të njëjtat parime, rregulla dhe norma juridike. Rrjedhimisht edhe regjimi feudal ushtarak i ngritur këtu ishte i njëjtë si gjetiu<sup>236</sup>.

Zotërimi i tokës që kishte për veçori shërbimin e detyrueshëm në ushtri ose në administratë, ishte baza e gjithë sistemit të timareve. Ky sistem pronësie me kusht i siguronte pushtetit qendror një ushtri të madhe dhe të interesuar për luftëra pushtuese, si dhe një aparat administrativ të përshtatur me nevojat e sundimit. Zotërime në formën e timareve u jepeshin edhe personave që kryenin shërbime në administratën qendrore ose lokale. Kështu, për shembull, gjatë shekullit të 15-të në tokat shqiptare u ishin dhënë timare kadilerëve, shkruesve etj<sup>237</sup>.

Zotërimi i timarit nuk ishte i përgjeshëm. Biri i spahiu mund të trashëgonte zotërimin vetëm nëse përmbushte po ato detyrime ndaj sulltanit që kishte edhe i ati. Spahinjët nuk gëzonin

---

234. Po aty, f. 519

235. Po aty.

236. Vep e cit., Selami Pulaja, f. 9.

237. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, “*Historia e popullit shqiptar*”, shtëpia botuese “Toena”, vëllimi I, f. 520, Tiranë 2002.

pronësinë e plotë mbi tokat e zotërimit, pasi as nuk mund t'i shisnin dhe as nuk mund t'i dhuronin. Sipas juriskonsultëve osmanë, toka *mirie* nuk ishte as e timarliut, as e atij që e punonte (fshatarit raja), pasi pronari i vërtetë i këtyre tokave ishte shteti osman, rrjedhimisht spahiu konsiderohej vetëm zotërues i tokës (sahibi erz). Duke qenë pronar toke i kufizuar, pushteti i tij mbi fshatarin-raja ishte i kufizuar, pasi ai nuk mund ta dëbonte fshatarin-raja, në rast se ky i fundit përmbushte detyrimet shtetërore që kërkonte ligji.

Çdo familje fshatare banuese në një feud kishte ngastrën e vetë të tokës, që e punonte së bashku me pjesëtarët e saj. Ngastrat që u ndodhën në duart e fshatarëve të krishterë u quajtën *bashtina*, si dhe më parë, kurse ato që ishin në përdorim të fshatarëve myslimanë u quajtën *çifligje* (çift - një palë, një pendë, në kuptimin e një toke që mund të punohej me një pendë qe). Meqenëse bashtinat dhe çifligjet ishin tokë shtetërore, fshatari gëzonte mbi to vetëm të drejtën që ta përdorte dhe ta gëzonte kundrejt detyrimeve që duhet t'i jepte shtetit. Fshatari gëzonte disa të drejta të kufizuara, p. sh., ai nuk mund të dëbohej nga toka prej spahiut, në rast se punonte dhe paguante detyrimet. Gjithashtu fshatari-raja mund t'ia shiste një fshatari tjetër të drejtën e përdorimit të bashtinës pa e copëtuar atë, por vetëm me lejen e spahiut, të cilit në këtë rast blerësi duhej t'i paguante taksën e tapisë. Kur fshatari nuk paguante rregullisht detyrimet e caktuara ose e linte tokën pa punuar për më tepër se tre vjet, spahiu kishte të drejtë t'ia merrte tokën dhe t'ia jepte një tjetri duke i marrë këtij taksën e tapisë<sup>238</sup>.

Fshatari-raja gëzonte të drejtën e një trashëgimie të kufizuar mbi bashtinën apo çifligun e tij. Djali ose djemtë e tij e trashëgonin të drejtën e punimit të tokës, por pa e pjesëtuar atë. Ata nuk ishin të detyruar të nxirrnin tapi të re dhe të paguanin taksën e tapisë. Të drejtën e trashëgimisë e gëzonin edhe të afërmit e tjerë të fshatarit-raja (bijat, vëllezërit dhe motrat), kur ky nuk linte trashëgimtar mashkull. Pra, e drejta e pronësisë së tokës *mirie* ishte e pjesëtuar midis shtetit, që ruante për vete të drejtën e disponimit; midis spahiut, që gëzonte të drejtën e zotërimit; dhe midis fshatarit, që kishte të drejtën dhe detyrën e shfrytëzimit dhe punimit. Kjo ndërthurje bëri që pushteti i spahiut të mos kishte pavarësi dhe imunitet të plotë financiar, administrativ dhe gjyqësor<sup>239</sup>.

Kategorinë e dytë të pronave tokësore nën sundimin osman e përbënin tokat në pronësi private. Zakonisht fshatarët kishin pranë banesave të tyre nga një sipërfaqe të vogël toke, që nuk e

---

238. Po aty.

239. Po aty

kalonte një dynym, mbi të cilën gëzonin pronësinë e plotë. Këto toka ishin kryesisht kopshte , vreshta, ullishte etj. Prona private ishin edhe ndërtesat, kasollet, plevicat e shtëpisë dhe mullinjtë. Këto prona *mylk* mund të shiteshin dhe të dhuroheshin nga pronarët e tyre, pa kufizimet që ekzistonin për tokat shtetërore të analizuara më sipër. Vetëm në rast se fshatari e humbiste tokën-bashtinë ose largohej nga timari pa lejen e spahiut, atëherë ky kishte të drejtë të vinte dorë mbi pronat e tij *mylk*. Në kategorinë e pronave private mbi tokën vendin kryesor e zinin zotërimet e dhëna përgjithmonë dhe të pakushtëzuara me detyrim ushtarak<sup>240</sup>.

Një formë tjetër e pronës private *mylk*, më e madhe në sipërfaqe se ajo që shpjeguam më sipër, ishte ndryshimi i destinacionit të një ngastre të madhe toke shtetërore (*mirie*) në një tokë private (*mylk*). E drejta për të bërë këtë kalim i takonte sulltanit, i cili nga fondi i tokave shtetërore me anë të një akti të veçantë pronësimi (*mylk*) urdhëronte komandantët e shquar të ushtrisë ose funksionarët e lartë të administratës për merita të veçanta ndaj shtetit osman t'i kalonin fshatra ose krahina të tëra në formë *mylku*, të quajtura ndryshe edhe *mylqe tokësore*. Pronarët e këtyre zotërimeve gëzonin mbi to të gjitha të drejtat e një prone të plotë. Ata mund t'i shisnin, t'ua linin trashëgim pasardhësve të tyre, t'i dhuronin ose t'i kthenin në prona për institucionet fetare myslimane (toka vakëf)<sup>241</sup>.

Në truallin shqiptar gjendeshin edhe toka në pronësi të institucioneve fetare myslimane (*vakëfe*), që ishin prona të kategorisë private, sepse përbëheshin nga toka të dhuruara prej sulltanëve në formë *mylku* dhe nga toka *mylk* të dhuruara nga besimtarët. Tokat në pronësi të institucioneve fetare myslimane ishin të paprekshme edhe nga vetë sulltani. Për këtë arsye shumica e pronarëve të *mylqeve tokësore* nuk ngurruan t'i kthenin pronat tyre të kësaj kategorie në prona institucionesh fetare myslimane sipas rregullave të institucionit të vakëfit, duke caktuar sipas vullnetit të tyre administratorin (*myteveliun*) dhe mënyrën e ndarjes së të ardhurave të kësaj prone. Duke përfituar nga këto rregulla, pronarët e këtyre *mylqeve*, pasi linin një pjesë të të ardhurave në dobi të ndonjë institucioni fetar, siguronin për vete dhe për trashëgimtarët e tyre brez pas brezi pjesën tjetër të të ardhurave, si dhe të drejtën e administrimit të pronave të veta. Në këtë mënyrë ata u shmangën jo vetëm detyrimeve financiare, por dhe rrezikut të konfiskimit

---

240. Po ay, f. 522.

241. Po aty.

të këtyre tokave nga ana e sulltanit. Tokat e vakëfuara ose vakëfet nuk mund të shiteshin, të dhuroheshin ose të ktheheshin në prona individuale<sup>242</sup>.

Periodha e shekujve XV–XVI ishte gjithashtu etapa e lulëzimit të pronësisë *mirie*, gjë që u shpreh ndër të tjera në rritjen e numrit të feudeve, në thellimin e mëtejshëm të shfrytëzimit të fshatarësisë, në centralizimin dhe në fuqinë e madhe ushtarake-administrative të shtetit osman, në varësinë e plotë të feudalëve të veçantë prej pushtetit qendror, në faktin se renta në dobi të shtetit osman ishte më e madhe se ajo në dobi të feudalëve të veçantë etj.<sup>243</sup>. Sikurse e theksuam më sipër, regjimi juridik i pronësisë që u vendos në këtë periudhë, i quajtur ndryshe “sistemi i timareve”, kishte karakter ushtarak. Për angazhimin në operacionet ushtarake të Perandorisë Osmane çdo timari shpërblehej me tokë në një nga format e lartpërmendura. Zotërimi feudal mbi tokat e timarit në këtë kohë gëzohej mbi bazën e një dekreti<sup>244</sup>.

Nëpërmjet regjimit të timareve shteti osman administronte tokat e Perandorisë nëpërmjet formave të shpërndarjes të saj, por dhe mënyrën se si arkëtoheshin të ardhurat që nxirrnin feudalët timarlinj për veten e tyre dhe për buxhetin e saj. Përmes sistemit të timareve shteti u jepte anëtarëve të klasës sunduese që dëshironte t’i shpërblente për shërbimet e tyre ushtarake të drejtën për të mbledhur në emër të tyre dhe për llogaritë shtetërore disa taksa në vend të pagesës. Taksat e mbledhura nga spahinjët ishin disa lloje, si: *yshyr*, *duhan*, *tapu*, *gjerdek*, *resime*, *neyabet*, *xhinajet*, *badihava*, *serbest*<sup>245</sup>. Fshatari nuk mund të ishte bashkëpronar me pronën feudale, as pjesëtar në shfrytëzimin e prodhuesve të drejtpërdrejtë, por kishte thjesht të drejtën e përdorimit dhe të gëzimit<sup>246</sup>.

Siç dihet, çështjet e regjimit juridik të tokës gjatë pushtimit osman, kryesisht në vendet ballkanike, kanë pasur një trajtim të gjerë nga mjaft autorë europianë të shekullit të 19-të. Këta autorë kanë mbajtur qëndrim të ndryshëm për sa i përket emërtimit juridik të pronës shtetërore dhe pozitës juridike të fshatarëve në lidhje me të drejtën e përdorimit të tokave pronë shtetërore. Përveç emërtimit *tokë mirie* këta studiues tokat shtetërore në regjimin osman i quajnë “toka nacionale” dhe fshatarët thjesht zotërues të përkohshëm, si qiramarrës. Në veprat e tyre nuk

---

242. Po aty, f. 523

243. Vep e cit, Selami Pulaja, f. 11.

244. Po aty, f. 9.

245. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, “*Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*”, f.571, Tiranë 2009.

246. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT, “*Burime të zgjedhura*”, “Shqipëria nën sundimin feudal ushtarak osman”, f. 14, Tiranë 1962

shihet pronësia shtetërore (*mirie*) si një formë e veçantë e pronësisë së klasës feudale osmane mbi tokën, nuk trajtohen marrëdhëniet e pronësisë si marrëdhënie midis klasave në prodhim, midis klasës feudale pronare të tokës dhe klasës së fshatarësisë së zhveshur nga pronësia. Ky qëndrim ka të bëjë me një botëkuptim më perëndimor që këta autorë shikonin te rregullat e sundimit osman gjatë kësaj periudhe për sa i përket së drejtës tokësore, e cila për hir të së vërtetës gjatë shekujve XIV–XVI ishte mjaft e konsoliduar<sup>247</sup>.

Për sa i përket pronësisë shtetërore mbi tokat (*mirie*), ajo u shpreh në mënyrë konkrete me krijimin e feudeve osmane nëpërmjet regjistrimit të tokave dhe të popullsisë (*tahrir defterleri*). Regjistrimi që u bë gjatë shekullit të 15-të menjëherë pas pushtimit dhe që u fiksua në defter, na jep mundësinë të njohim rrugët dhe metodat e përdorura për zbatimin e parimit se toka dhe të ardhurat menjëherë pas pushtimit bëheshin pronë e klasës feudale osmane në tërësi dhe nëpërmjet shtetit i ndaheshin asaj në formën e timareve, të ziameteve dhe të haseve. Sistemin e regjistrimit të tokave dhe të popullsisë në defter, që si metodë në disa drejtime i ngjante “praktikumit bizantin”, principata e osmanëve, ashtu sikurse principata të tjera të Anadollit, e trashëgoi nga shteti i selxhukëve. Me anë të tij vihej në jetë dhe mbahej nën kontroll në radhë të parë pronësia feudale mbi tokën dhe mbi fshatarët. Kuptimi i fjalës “defter”, sikurse del nga praktika e përgjithshme e regjistrimeve kadastrale në Perandori si dhe nga dëshmitë e kronistëve bashkëkohës osmanë, është vendosje e pushtetit osman, të regjimit të ri feudal ushtarak të ngritur mbi pronësinë *mirie*<sup>248</sup>.

Megjithëse sistemi i timareve preku sipërfaqet më të mëdha të vendit tonë gjatë sundimit osman, ai nuk arriti të bënte pjesë të tij tokat që shtriheshin në zonat e thella malore të vendit tonë, të cilat ngelën të paprekura nga sistemi i timareve, për shkak të pavarësisë që arritën të ruajnë këto krahina. Për evidentimin e tokave të vendit tonë në vitin 1506 u bë një regjistrim i përgjithshëm i të gjitha tokave, të cilat u përfshinë në dy zona të mëdha. Në njërin zonë bënin pjesë tokat ku ishte zbatuar sistemi i timareve, që ndryshe quhej “zona e yshyrit”, kurse zona tjetër përfshinte

---

247 Për më tepër shiko J.Hammer, “*Des Omanischen Reiches Saatsverfassung, und Staatsverëaltung*”, Band I-II, Ęein 1815; M.Belin, “*Du regime des fiefs militaires dans l’islamisme et principalement en Turquie*” në *Journal Asiatique*, S.VI, Tome XV, Paris 1870, mars –avril, fq 187-301.P. Tichendorf, “*Das lehenëesen in den moslemischen Staatën, insbesondere im Osmanischen Reiche*”, Leipzig 1872

248. Vep, e cit. f. 30.

krahinat malore të vetëqeverisura, ku nuk u zbatua sistemi i timareve. Këto zona i jepnin pushtetit qendror një taksë (haraç) fikse, prandaj quheshin “zona haraçi”<sup>249</sup>.

Për t’u theksuar është fakti se sistemi i timareve, si një element i rëndësishëm i ekonomisë bujqësore osmane, u praktikua suksesshëm nga fillimi i krijimit të shtetit osman deri në fund të shekullit të 16-të. Pas këtij shekulli nisën të dukeshin shenjat e rënies së këtij sistemi<sup>250</sup>.

Në fund të shekullit të 18-të regjimi i timareve e pa veten në fazën e shthurjes, pasi funksionet e këtij sistemi kishin filluar t’i shmangeshin kontrollit shtetëror dhe secili feudal përpigëj të forconte pozitat e veta ekonomike. Në këto kushte, feudalët nuk shikonin veçse interesat vetjake, pa u vënë veshin pasojave të këqija të veprimeve të tyre arbitrare<sup>251</sup>.

### **3.3. Zëvendësimi i sistemit të timareve me atë të pronës çifligare, shkaqet dhe pasojat e kësaj reforme në trevat e vendit**

Nocioni juridik dhe funksional i çifligjeve ka lidhje të ngushtë me *timaret* dhe *ziametet*. Ato kanë qenë hapësira të mëdha territoriale, pararendëse të çifligjeve dhe ku realizoheshin një sërë funksionesh. Siç e theksuam më lart, tokat e pushtuara nga ushtria turke kaluan në pronësi të sulltanit, si përfaqësues i Profetit. Tokat e pushtuara u regjistruan si lokalitete të banuara, që i përkisnin çdo krahine, ku u evidentuan kufijtë e krahinës, popullsia që jetonte në të, ndërtesat, tokat e punuara, kullotat dhe pyjet si dhe sasia e shpërblimit që i korrespondonte një të dhjetës. Mbi bazën e kësaj evidence sulltani, për të nxitur dhe shpërblyer ata që kishin treguar trimëri në luftë ose që kishin kontribuar në zgjerimin dhe fuqizimin e Perandorisë, u akordoi një sipërfaqe toke bujqësore me të drejtën e shfrytëzimit të përjetshëm kundrejt detyrimit për të mbajtur dhe armatosur një numër kalorësish, të cilët i dërgonin për luftë sa herë ishte e nevojshme. Sipërfaqes që iu dha çdo spahiu (ushtarak i thjeshtë ose graduar) varej nga shërbimet që kishte dhënë, nga trimëria që kishte treguar etj.<sup>252</sup>.

---

249. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë “*Historia e popullit shqiptar*”, shtëpia botuese “Toena”, vëllimi I, f. 517, Tiranë 2002

250. Po aty, f. 517

251. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT, “*Burime të zgjedhura*”, “Shqipëria nën sundimin feudal ushtarak osman, f. 17, Tiranë 1962.

252. Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT, “*Burime të zgjedhura*”, “Shqipëria nën sundimin feudal ushtarak osman, f. 10, Tiranë 1962.



Në kohën e sundimit turk çifligjet ishin sipërfaqe të mëdha toke bujqësore të përbëra prej një ose më shumë fshatrash, së bashku me ndërtesat e banimit, stallat, punishtet, kafshët etj., në të cilat punonin detyrimisht bujkrobërit, që quheshin “çifçinj”. Ata ishin të detyruar t’i jepnin çifligarit ose subashit një sasi të caktuar drithërash në formë “qesimi”, sipas zakoneve të veçanta të krahinës ose marrëveshjes që mund të ekzistonte. Me dobësimin e pushtetit qendror dhe me degjenerimin e instituteve të vjetra turke, feudalët timarllinj iu shmangën gjithnjë e më shumë detyrimeve të tyre kundrejt shtetit dhe dalëngadalë u shndërruan në pronarë absolutë tokash, domethënë në çifligarë. Ata përpiqeshin t’i zgjeronin kufijtë e çifligjeve të tyre ose të shtinin në dorë me çdo mënyrë fshatra të tjera të lira dhe t’i shndërronin në çifligje. Si pasojë e këtij procesi shumica e tokave më të mira ranë në kthetrat e ushtarakëve çifligarë.

Çifligu ishte një zotërim i madh tokësor privat feudal, i pakushtëzuar me detyrime ushtarake, i cili u përhap në kurriz të timareve dhe të zameteve. Vlera e çifligut përcaktohej në radhë të parë nga sipërfaqja e tokës dhe nga numri i çifçinjve. Zotërues i një çifligu mund të bëhej spahiu, pastaj beu ose agai, në raste të veçanta fshatari i pasuruar, po ashtu dhe fajdexhiu, tregtari ose zejtari i pasur. Rrugët kryesore të formimit të çifligjeve në trojet shqiptare ishin dhuna, shitblerja, borxhet dhe hapja e tokave të reja. Metoda e dhunës ka qenë më e rëndomtë për shpronësimin e fshatarësisë nga toka në kushtet e dobësimit të pushtetit qendror e të korrupsionit të aparatit administrativ-gjyqësor.

Në fillim të viteve ’40 të shekullit të 19-të timari feudal turk zyrtarisht nuk ekzistonte më në Perandorinë Osmane. Ai ishte suprimuar me ligj nga Porta e Lartë qysh në vitin 1834. Timari nuk ekzistonte më për tokat më pjellore të viseve shqiptare, të cilat kishin hyrë në sistemin e çifligut përpara se ai të hiqej zyrtarisht. Ky sistem vepronte ende vetëm në fshatrat me toka buke të pakta, por edhe këtu zotëruesit e tyre, spahinjët, në shumicën e rasteve ishin kthyer në feudalë derebej. Si të tillë, ata i ruanin pozitën sunduese vetëm në saje të përkrahjes që detyrohej t’u jepte sulltani me anë të sistemit të harxheve<sup>253</sup>. Për rrjedhojë, pas vitit 1834 spahinjët nuk u ngjanin atyre të shekujve të kaluar, pasi nuk e gëzonin më *tesarufin* (zotërimin mbi tokat e fshatit), duke humbur në këtë mënyrë zotërimin feudal mbi tokën. Po edhe pse kishin humbur *tesarufin*, spahinjët derebej, duke u mbështetur në forcat e tyre të armatosura dhe në përkrahjen e Portës të Lartë, vijuan të ushtronin pushtet mbi fshatarët e zonës së tyre.

---

253. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, “*Historia e popullit shqiptar*”, shtëpia botuese “Toena”, vëllimi II, f. 57, Tiranë 2002.

Me heqjen e sistemit të timarit dhe me njohjen zyrtarisht të pronësisë private mbi tokën pronësia çifligare u njoh ligjërisht nga shteti osman. Bejlerët çifligarë fituan të drejtën jo vetëm të administronin, por dhe të zgjeronin lirisht pronat e tyre, që për më tepër hyri në mbrojtjen e drejtpërdrejtë të Perandorisë Osmane, madje Porta e Lartë shumicën e çifligjeve që ua kishte konfiskuar feudalëve të dënuar si kryengritës (Ali Pashë Tepelena, Ibrahim bej Vërlaci, Ibrahim bej Alltuni, Osman bej Kryekuqi) i shpalli pronësi private në zotërim të shtetit turk, duke e kthyer Perandorinë Osmane në një pronare të madhe çifligare. Të drejtën e pronësisë private e fituan edhe institucionet fetare islamike dhe të krishtera. Si rrjedhim, me likuidimin e pronësisë feudale-ushtarake, ajo feudale-çifligare u bë forma kryesore e pronësisë tokësore mbi të cilën mbështetej shteti feudal turk. Në vitet '40 të shekullit të 19-të çifligjet në viset e katër vilajeteve të Shqipërisë kapnin rreth 700 mijë ha ose 55 për qind të tokave të punueshme, por shpërndarja e tyre nuk ishte e njëjtë kudo, nga 70 për qind të territorit që zinin në vilajetin e Janinës ato shkonin në 40 për qind në vilajetin e Kosovës<sup>254</sup>.

Pronësia çifligare nuk ishte shpërndarë njëllë, ajo paraqiste diferencime për sa u takon sipërfaqeve të tokës që zinin çifligjet edhe brenda secilit vilajet. Ajo ishte shtrirë kryesisht në viset fushore, ku ndodhej pjesa më e madhe e tokave të punueshme. Nga të dhënat për vilajetin e Janinës del se në vitin 1850 në rrethet e sotme të Fierit dhe të Lushnjës të gjitha fshatrat pa përjashtim (184 fshatra) ishin kthyer në çifligje. Shumica dërmuese e pronës çifligare, rreth 76 për qind e sipërfaqes të saj, ishte në pronësi të bejlerëve feudalë, mjaft nga të cilët e kishin grabitur atë gjatë 200 vjetve të kaluar. Gjatë viteve '40 të shekullit të 19-të ajo ndodhej e përqendruar në duart e pak familjeve feudale, që të gjitha me origjinë shqiptare, për shembull: familja e Skifterajve të Libohovës zotëronte 28 mijë ha, Kokatët e Delvinës zotëronin rreth 18 mijë ha, Toptanët e Tiranës rreth 15 mijë ha, Bushatllinjët e Shkodrës rreth 8500 ha<sup>255</sup>.

Pas bejlerëve feudalë vendin e dytë si pronarë latifondistë e zinte vetë shteti osman, që zotëronte rreth 20 për qind të pronës çifligare, ku pjesa dërmuese e çifligjeve shtetërore, rreth 105 mijë ha, afërsisht 75 për qind e sipërfaqes së tyre, ndodhej në vilajetin e Janinës.

Institucionet fetare myslimane zinin vendin e tretë dhe zotëronin rreth 4 për qind të sipërfaqes të përgjithshme çifligare dhe gati gjysma e tyre ndodhej në vilajetin e Janinës. Gjatë viteve '60-'70

---

254. Po aty, f. 58.

255. Po aty, f. 59.

të shekullit të 19-të u rritën shumë edhe zotërimet tokësore të Kishave Ortodokse dhe asaj Katolike, të cilat zotëronin rreth 1300 ha tokë të punueshme dhe pyje<sup>256</sup>.

Me gjithë shtrirjen e madhe çifligare, numri i bujqve të vendosur nëpër çifligje ishte i vogël në krahasim me mundësitë e shfrytëzimit të saj. Në të vërtetë, ndërsa çifligjet zinin rreth 55 për qind të tokave të punueshme, aty punonin rreth 25 për qind e familjeve fshatare. Më shumë se 2/3 e tokave çifligare ishin lënë djerr.

Te bejlerët çifligarë që nuk iu përshtatën kushteve të reja që u krijuan me zhvillimin ekonomik monetar, përfshirja e tokës në sferën e tregtisë solli copëzimin e saj në duart e trashëgimtarëve të ndryshëm dhe pastaj shitjen e saj pjesë-pjesë. Ky proces, që vijoi deri në fund të sundimit osman, i dobësoi çifligarët e familjeve të vjetra feudale të vendit, siç ishin Kokatët, Skifterajt, Alizotët, Delvinajt, Toptanët, Bushatllinjët etj. Përkundrazi, disa familje të tjera feudale u hyri lakmia për të shtënë në dorë toka bujqësore dhe çifligjet e tyre u zgjeruan me ritme të shpejta. Shitblerja e tokave, si një nga format për krijimin e çifligut, u përhap shumë, sa që toka u kthye në mall. Shpronësimi i fshatarësisë për shkak të borxheve që u përhap në shekullin e 18-të, e sidomos në shekullin e 19-të, tregon se pushteti i parasë u bë një mjet i ri për shpronësimin e tokave. Tregtari, zejtari i pasur, çifligari u bënë fajdexhinjtë më të njohur.

Çifligjet që u përqendruan në duart e feudalëve, të çifligarëve, të fajdexhinjve, të tregtarëve dhe zejtarëve të pasur përfshinë kryesisht tokat e fshatarëve nën sistemin e timarit; tokat e përbashkëta të fshatit (*metruqe*), të quajtura edhe “*hyrie*”; tokat e lëna djerr (*mavatil*); tokat private (*mylqi*); tokat fetare (*vakëf*).

Deri në vitin 1864, që njihet si viti i likuidimit të plotë të timareve, kur Perandoria Osmane u riorganizua përfundimisht sipas sistemit administrativ francez, fshatarët që kishin mundur të ruanin tapitë për ngastrën e tokës ku punonin, njiheshin juridikisht si zotërues të tokës, por jo në kuptimin e vërtetë të pronësisë për shkak të kufizimeve që përmbante ende legjislacioni i ri agrar osman.

Fshatarët që deri atëherë kishin punuar tokën e timareve me të drejtën e përdorimit (*tesarufin*) të përfaqësuar nga tapia, me heqjen e timareve u quajtën pronarë të tokës dhe tani kishin të bënë drejtpërdrejtë me organet shtetërore. Ata formuan një shtresë të gjerë pronarësh të vegjël, ndonëse shteti ruante ende disa të drejta, që e kufizonin pronësinë e tyre të plotë mbi tokën.

---

256. Po aty.

Me njohjen zyrtarisht të pronësisë private mbi tokën pronësia çifligare u njoh ligjërisht nga shteti turk. Bejlerët çifligarë fituan të drejtën jo vetëm të administronin, por dhe ta zgjeronin lirisht pronën çifligare, e cila hyri në mbrojtjen e drejtpërdrejtë të Perandorisë Osmane. Madje Porta e Lartë shumicën e çifligjeve që u kishte konfiskuar dikur feudalëve të dënuar si kryengritës, i ktheu në pronësi private e shtetërore, duke e kthyer vetë Perandorinë Osmane në një pronare të madhe çifligare. Të drejtën e pronësisë çifligare e fituan edhe institucionet fetare islamike dhe të krishtere.

Krahas zgjerimit të pronësisë çifligare u duk njëkohësisht edhe procesi i deçifligarizimit, i kthimit të saj në pronë të vogël fshatare në zotërim të prodhuesit të drejtpërdrejtë bujqësorë. Ky proces u krye me anën e blerjes së tokave-çifligje si nga ana e fshatarëve të vegjël, që nuk kishin tokë të mjaftueshme, ashtu dhe nga vetë bujqit çifçinj, të cilët me sakrificë të mëdha u kthyen në pronarë të vegjël. Megjithatë, rastet e deçifligarizimit pak ndikuan në zvogëlimin e sipërfaqeve të pronës çifligare në tërësi<sup>257</sup>.

Për sa i përket zgjerimit të pronës çifligare, duhet thënë se rruga kryesore ishte shtënia në dorë apo grabitja e tokave shtetërore “vakante”, që quheshin të tilla sepse kishin mbetur prej shumë kohësh të papunuara. Shumë çifligarë arritën të zgjeronin çifligjet e tyre me tokat e përvetësuara, duke ndryshuar edhe tapitë nëpërmjet ryshfetit ndaj zyrtarëve të lartë. Një rrugë tjetër e zgjerimit të çifligjeve ishte shtënia në dorë e ngastrave të tokës së fshatarëve të vegjël nga ana e bejlerëve të pasur si rrjedhojë e mosshlyerjes së borxheve që u kishin dhënë këta të fundit fshatarëve të vegjël. Një tjetër rrugë ishte shitja nga Porta e Lartë të pronave shtetërore sa herë që ndodhej në vështirësi financiare, sidomos tokat shtetërore që ishin të shpërndara kudo dhe jashtë çdo kontrolli. Çifligarët i zgjeruan sipërfaqet e tyre edhe duke blerë çifligjet që vinin në shitje disa feudalë për arsye të ndryshme<sup>258</sup>.

Një rrugë tjetër e krijimit të çifligarëve dhe çifligjeve të reja ishte shtënia në dorë e sipërfaqeve të tokave apo dhe çifligjeve të tëra nëpërmjet trashëgimisë.

Rritja e numrit të çifligarëve të rinj nëpërmjet rrugëve të mësipërme (përvetësim, shitblerje dhe trashëgim) veç të tjerash shkaktoi diferencim ekonomik të çifligarëve, pasi krahas çifligarëve të mëdhenj u rrit numri i çifligarëve të mesëm dhe të vegjël. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të

---

257. Haxhi P. (1998), “Regjimi juridik i tokës në Shqipëri”, f. 32.

258. Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, “Historia e popullit shqiptar”, shtëpia botuese “Toena”, vëllimi II, f. 60, Tiranë 2002.

19-të u rrit edhe prona çifligare vakëfore, kryesisht në kurriz të pronës çifligare shtetërore (12 fshatra të Myzeqesë në vitet '80 të këtij shekulli u kthyen nga pronësi shtetërore në pronësi vakëfore). Krahas zgjerimit të pronës çifligare, që erdhi edhe përmes rrënimit të fshatarëve të vegjël të zhytur në borxhe, ndodhi edhe një procesi i kundërt: fshatarët që kishin mundur të siguronin të ardhurat e nevojshme, mund të blinin ngastra toke nga çifligarë të pasur, që u shisnin atyre pjesë të caktuara të çifligut, duke krijuar në këtë mënyrë pronësinë fshatare mbi tokën<sup>259</sup>.

Për sa u përket viseve malore të vendit tonë duhet thënë se në to u ruajt bashkësia familjare (bashkëpronësia). Ruajtja e bashkësisë familjare edhe gjatë kohës së feudalizmit osman i dedikohet në radhë të parë faktit se ky institut i së drejtës tokësore shqiptare i përshtatej mirë marrëdhënieve pak të zhvilluara, që ishin karakteristike për ekonominë e mbyllur gjysmënatyrore të asaj epoke. Kanuni i Lekë Dukagjinit njihte edhe pronën private mbi tokën me titullar të zotin e shtëpisë, kryetarin e familjes. Këtë e vërtetojnë një tok urdhërimesh të veçanta, si ato mbi trashëgiminë dhe kujdestarinë. Këto urdhërime pasqyrojnë kushtet e reja ekonomike-shoqërore që kishin filluar të krijoheshin edhe në disa malësi të Veriut. Kishte filluar edhe atje shthurja e familjes së madhe dhe krijimi i familjeve të vogla, të cilat përbëheshin nga prindërit dhe fëmijët e tyre, që bashkëjetonin me të atin gjersa ai jetonte. Udhëzimet e qarta të këtij Kanuni dëshmojnë për kalimin e pronësisë së përbashkët (*kuries*) në pronësi private të personave të veçantë. Prona private mbi mjetin kryesor të prodhimit, siç ishte toka, atje ishte stabilizuar prej mjaft shekujsh. Ajo ishte sanksionuar në mënyrë të theksuar edhe në të drejtën zakonore me të gjitha tiparet e saj kryesore, siç janë shitja, blerja e çdo lloj tjetër tjetërsimi<sup>260</sup>.

Krijimi i borgjezisë çifligare ishte një tjetër proces që ndodhi gjatë shekullit të 19-të, proces që erdhi si pasojë e zgjerimit të tregtisë nga ana e çifligarëve, të cilët, të etur për më shumë investime në bujqësi dhe industri, i dhanë një tjetër karakteristikë pronësisë çifligare. Forcimi i kësaj borgjezie bëri të mundur që pronarët çifligarë të kishin në zotërim jo vetëm veglat e punës dhe të prodhimit, por dhe mbajtjen dhe përpunimin e prodhimeve bujqësore, ngritjen e punishteve të zejtarisë dhe atyre të prodhimit të produkteve industriale. Në këtë mënyrë klasa e re jo vetëm iu përshtat mirë nevojave të tregut për më shumë prodhim dhe të ardhura, por e

---

259. Po aty, f. 61.

260. Xhai V, Cevi K. (1984), "Regjimi juridik i tokës në Shqipëri", shtypshkronja e dispensave Tiranë, f. 20.

ridimensionoi vizionin në lidhje me shfrytëzimin sa më të mirë të ngastrave bujqësore të përfshira në çifligje<sup>261</sup>.

#### **4. Sistemi ligjor, idetë mbi ligjin që u zhvilluan nën sundimin osmanë**

Përveç muderrisëve klasa e ulemave përfshinte edhe praktikuesit dhe zbatuesit e ligjit në gjykata si jurstë (kadilerët) dhe konsulentë ligjorë (myftinjë), të cilët studionin dhe interpretonin ligjin. Cili ishte ligji islamik që zbatohet në Perandorinë Osmane dhe në ç'mënyrë ishin strukturuar institucionet e Ilmijes për ta aplikuar dhe interpretuar atë?

#### **Ligji**

Idetë mbi ligjin që u zhvilluan nën osmanët përbënin një kombinim të traditave të perandorive turke dhe persiane të së kaluarës me ato islame. Nga persianët vinte koncepti që u zhvillua në erën e abasidëve se sunduesi ishte absolut dhe të gjitha aktet ligjore dhe të drejtësisë ishin në mbështetje të pushtetit të tij suprem. Ndërsa nga turqit u zhvillua koncepti i ligjit suprem (*jasal/jasak*) se sunduesi duhej ta ushtronte pushtetin e tij me drejtësi, pa marrë parasysh dëshirat e tij personale. Në të njëjtat ide me të sipërmet vinte ideja islame e ligjit fetar, Sheriatit, i cili zbriste nga Kurani dhe traditat e hershme islame. Ndërsa Sheriati ishte jashtëzakonisht i zhvilluar në fushat e sjelljes së individit dhe jetës komunitare, në shumë çështje të ligjit publik nuk kishte zhvillime të gjera, sidomos në fushat e organizimit shtetëror dhe administrativ. Në shumicën e rasteve Sheriati ndryshimit për krijonte platformat mbi të cilat mundësitë e interpretimit dhe të çështje specifike nga sunduesi dhe qeveria e tij ishin të shumta. Shumica e teoricienëve të ligjit islamik njihnin të drejtën e sulltanit, i cili, i nisur nga e drejta për të sunduar (*orf*), merrte iniciativën dhe nxirrte kanun në çështje që nuk mbulohehin nga Sheriati. Në këtë mënyrë komuniteti islamik osman kishte dy ligje: ligjin e caktuar nga sulltani (*orf-I sulltan*) dhe ligjin fetar. Personat e ngarkuar për të ekzekutuar dhe detyruar obligimet e ligjit të parë njiheshin si *ehl-I orf*, ndërsa ulematë ishin ata që ekzekutonin dhe zbatonin ligjin islamik në Perandori dhe në

---

261. Po aty, f. 64

veçanti mbi komunitetin myslimane. Sheriati mbulonte çështjet personale të komuniteteve myslimane dhe ideonte principet e ligjit publik për qeverinë, ashtu siç shpjegoheshin dhe zbatoheshin edhe ligjet fetare të komuniteteve jomyslimane nga paria fetare. Por duhet të kemi parasysh se anëtarët e ulemave kishin të drejtë të zhvlerësonin çdo ligj që ishte në konflikt me Sheriatin. Megjithatë, kjo gjë ndodhte rrallë, pasi, si anëtarët e klasës qeverisëse, ata emëroheshin dhe mund të pezulloheshin nga sulltani. Si pasojë, sulltani gëzonte liri të bënte ndryshime në mënyrë të lirshme për t'u bërë ballë problemeve që i dilnin në ushtrimin e detyrës, mjaft që këto ligje të ishin brenda normave të Sheriatit.

### **Kadilerët**

Interpretuesit kryesorë fetarë ishte klasa e ulemave, ndërsa shkenca që merrej me studimin dhe interpretimin e tij quhej *fikih*. Megjithatë, ndërmjet personave që studionin dhe interpretonin ligjin apo konsulentëve juridikë (myftinjët) dhe atyre që e zbatonin atë në gjykata si gjyqtarë (kadilerët), që në disa raste njiheshin edhe si arbitruer (*hakim*), kishte ndryshime. Vetë Perandoria ndahej nëpër provinca juridike (kaza), ku secila kishte gjykatësit e saj (*mahkeme*) dhe gjyqtarët me zëvendësit e tyre (*naip*) dhe asistentë të tjerë. Edhe pse në islam ekzistojnë katër shkolla të sunizimit, në gjithë Perandorinë Osmane pranohej vetëm shkolla e Abu Hanifes. Si rrjedhojë, në gjykata punësoheshin vetëm kadilerët e shkollës juridike hanefite. Por, meqë në disa pjesë të Perandorisë, sidomos në Egjipt dhe Siri, populli dhe udhëheqja fetare pranonte shkolla të tjera ligjore, zyrtarëve të provincave në fjalë u lejohej të njihnin parinë e ulemave vendas si këshilltarë dhe të rekomandonin vendimet e tyre ndaj kadilerëve e shkollës hanefite zyrtarë të provincave përkatëse. Çdo kadi gëzonte funksione administrative dhe juridike. Si gjyqtar i gjykatave myslimane lokale, ai kishte për detyrë të zbatonte ligjin islamik së bashku me kanunet e sulltanit për popullin dhe anëtarët e klasës qeverisëse. Ai kishte për detyrë të siguronte që gjykata të ishte e hapur për të gjithë myslimanet që kërkonin drejtësi dhe që procesi i drejtësisë të ishte i shpejtë dhe i drejtë, të mos lejonte ndërhyrjen e avokatëve profesionistë dhe personat që nuk ishin të aftë të mbronin veten, siç ishin gratë, fëmijët dhe jetimët, të gëzonin një mbrojtje të veçantë. Popullatat e *kazveisahin*, të bindura se Sheriati, që transmetohej nga kadiu, ishte garanci për mbrojtjen e të drejtave të tyre, të cilat nuk mund t'ua mohonte asnjë zyrtar i sulltanit. Nga ana tjetër, zyrtarët, si shërbëtorë të sulltanit që ishin, i nënshtroheshin dëshirës së

tij absolute. Ata edhe mund të ekzekutoheshin dhe t'u konfiskoheshin pasuritë pa ndonjë arsye të deklaruar dhe pa pasur të drejtën e mbrojtjes nga kadiu. Ky i fundit përdorte zyrtarët e tij për të hetuar çështjet, për të thirrur dëshmitarët dhe për të ndëshkuar fajtorët. Por në funksionet në fjalë ai ndihmohej nga sanxhakbeu i vendit dhe subashi (shefi i policisë), të cilët operonin nën mbikëqyrjen apo të paktën në praninë e përfaqësuesve të komunitetit mysliman. Supozohej se sanxhankbejlerët dhe kadilerët ndanin bashkë autoritetin e vendosur, por, ngaqë të parët në shumicën e rasteve ishin nëpër fushata, këta të fundit ishin ata që kishin pushtetin e vërtetë. Zakonisht çdo qytet dhe qytezë kishte subashin e saj, i cili mund të arrestonte shkelësit e ligjit nëpërmjet kompetencave të tij apo me kërkesën e kadiut. Në rastet kur shtetasit donin të ankoheshin për aktet ilegale, ata ankoheshin te muhtesipi kur çështja kishte të bënte me tregjet, ndërsa në rastet kriminale i drejtoheshin subashit. Megjithatë, muhtesipit i duhej të siguronte ndihmën e subashit në rastet kur abuzuesit e pazareve refuzonin t'i bindeshin atij. Subashët kompetencat e tyre i merrnin nga sanxhakbejlerët dhe përgjigjeshin vetëm përpara tyre, por në rastet kur vetë ata e thyenin ligjin, dërgoheshin përpara kadiut për t'u gjykuar dhe dënuar. Për këtë arsye mbeteshin figurat më të rëndësishme në shoqëri. Nga kadiu pritej që ligji fetar dhe ai shekullar të zbatoheshin në të njëjtën mënyrë. Dhe për vendimet që merrnin gëzonin autonomi të plotë. Rastet kur sulltani ose ndonjë nga zyrtarët e tij apo eprorët e kadiut në Stamboll ndërhyenin për të ndikuar apo komanduar gjykimet pasi ato ishin dhënë, ishin tepër të rralla.

Të ardhurat më të larta të lejuara për kadilerët e kazave ishin 150 akçe në ditë, ndërsa për ata të rangjeve më të ulëta ishin deri në 40 akçe në ditë. Këto të ardhura nxirreshin nga gjyqet dhe nga pagesa e certifikatave të lindjeve, martesave, ndarjeve, vdekjeve etj. Për më tepër, shumë kadilerë mblidhnin shuma të mëdha nga gjobat dhe administratorët e vakëfeve që ata mbikëqyrnin. Ata kishin të drejtë edhe të emëronin mësuesit dhe punonjësit e mejtepeve dhe të medreseve zonale, ku mundësitë ishin për të përfituar pagesa nga kandidatët e zgjedhur.

Kadilerët mbulonin edhe detyrime administrative vendore. Këto përfshinin mbikëqyrjen dhe administrimin e vendeve të tyre, të vërtetonin listat e përcaktimeve të taksave dhe paranë e mbledhur, të ndërhyenin për të arbitruar në rastet e konflikteve të autoritetit apo kompetencave dhe në disa raste të autorizonin pezullimin e zyrtarëve vendas që shkelnin ligjin dhe të kryenin detyrën e këtyre të fundit derisa nga Stambolli të arrinin zëvendësit. Kadilerët mbikëqyrnin edhe veprimet e anëtarëve të klasës ushtarake në zbatimin e rendit dhe shqyrtonin ankesat e popullit ndaj veprimeve arbitrare, nëse kishte të tilla. Kadilerët mbikëqyrnin edhe procesin e mbjelljes



dhe korrjes së drithërave dhe më pas përcaktimin dhe mbjelljen e taksave. Nga kadilerët shpesh mbikëqyrej edhe mobilizimi i forcave ushtarake vendase, gjendja e policisë dhe e garnizoneve të *derbentëve*, funksionimi i bashkive në rregullimin e tregjeve, kontrollin e çmimeve dhe marrëveshjet që lidheshin për mirëmbajtjen e rrugëve dhe rrugicave të qyteteve. Ndërsa qeveria osmane, duke filluar nga shekulli i 16-të përpiquej të largonte nga kontrolli i saj shumicën e provincave, kadilerët ishin ata që përveç detyrimeve juridike dhe legale do të merrnin në duar edhe kontrollin administrativ dhe financiar të tyre, madje në shumë zona ata përbënin qeverinë e vërtetë.

Të ardhurat ditore të kadiut të Stambollit ishin 500 akçe në ditë, duke e kthyer postin e tij në më të kërkuarin dhe luksozin nga të gjitha postet e klasës së ulemave. Përveç detyrimeve standarde kadilerët e Stambollit, Ejupit, Gallatës dhe Yskydarit merrnin pjesë në takimet e të Mërkurave të Këshillit të Kryevezirit për të dëgjuar ankesat në lidhje me vendimet apo veprimet e kadilerëve gjatë Perandorisë, duke themeluar në këtë mënyrë Gjykatën e Lartë. Kadiu i Stambollit kishte për detyrë edhe mbikëqyrjen e tregjeve dhe kontrollin e çmimeve të qytetit së bashku me mbikëqyrjen e standardeve të nderimit, ndriçimin e rrugëve dhe mirëmbajtjen e tyre, furnizimin me ujë dhe pastërtinë. Detyrimet në fjalë ai i mbikëqyrte së bashku me ndihmësit e tij, *ihtisap* agën (përgjegjës in e tregut), mimarbashin (kryearkitektin për rrugët dhe ndërtime), subashin (shefin e policisë), çopluksubashin (përgjegjës in e pastrimit) dhe të tjerë. Të gjithë këta përbënin stafin bashkiak të qytetit, që mbulonte funksionet jashtë atyre që mbuloheshin nga miletet, artizanët dhe esnafët e ndryshëm.

Postet juridike që qëndronin mbi nivelin e lagjeve cilësoheshin të radhës së mevlevijetit dhe mbajtësit e tyre njiheshin si *mollá*. Pasi për postet në fjalë numri i kandidatëve ishte gjithnjë më i madh sesa i vendeve të mundshme, punësimet bëheshin për jo më shumë se një vit për postet e larta juridike dhe për 20 muaj për kadilerët e kazave. Në përfundim të këtij afati individët me poste largoheshin nga puna dhe hynin në radhën e të përjashtuarve (mezul) dhe emrat e tyre viheshin në fund të listës së kandidatëve për punë. Gjatë kohës që këta persona ishin të papunë, atyre, ashtu si edhe anëtarëve të klasës qeverisëse, që për një arsye apo tjetër ishin të papunë, u jepej një pension special i quajtur *arpalik*, që konsiderohej të ishte pagesa e pensionit për personat që largoheshin nga puna falë moshës së vjetër, sëmundjes dhe si kompensim për të papunët, që ishin në pritje. Për disa zyrtarë të lartë osmanë arpaliku jepej me hase apo timare. Megjithatë, shumica vinte në formë pagese në para nga arka e shtetit.

Anëtarët *mezul* (të përjashtuar) të klasës së ulemave në disa raste shërbenin edhe si asistentë (mulazim) në zyrat e kazaskerëve apo si gjyqtarë (kassam) për trashëgimitë që nuk hynin në kompetencat e kadilerëve, punë që u siguronte të ardhura shtesë ndaj pensionit që gëzonin. Kadilerët e kategorisë *mezul* zakonisht qëndronin të papunë për dy vjet përpara se të mundnin të aplikonin për poste të reja në vende të preferuara. Përveç emërimeve në postin e kadiut klasa e *mezulëve* mund të punësohej edhe në pozicione të tjera. Këto përfshinin *toprak kadis* (gjykatësit e tokave), të cilët shërbenin si shpjegues të rrugëve për kadilerët e rregullt, sidomos në provincat feudale, kur të fundmëve u duhej të shkonin për të hetuar ankimet e sundimit apo veprimeve ilegale nga ana e zyrtarëve apo feudalëve vendas dhe merrnin vendime kur lindte nevoja. Kadilerët dërgoheshin edhe si *mehajif mufettishleri* (inspektorë krimesh) për të dëgjuar ankimet e popullit kundër kadilerëve dhe naipëve vendas dhe në të njëjtën kohë gëzonin pushtetin për t'i pezulluar të fundit në rastet e shkeljeve apo që ankesat e marra t'i transmetonin te kazaskeri apo Këshilli Perandorak për të marrë masat e duhura. Kadilerët e rangjeve të larta caktoheshin si gjyqtarë ushtarak (*ordu kadilari*) me kompetenca për të zëvendësuar kazaskerët kur i fundit mungonte. Në rang të barabartë me *mollatë* ishin edhe anëtarët e ulemave që punësoheshin në shërbimin e oborrit të sulltanit për poste fetare dhe kulturore. Këtu hynte hoxha i sulltanit, detyra e të cilit ishte udhëzimi dhe instruktimi i tij në fe, i cili gjatë shekullit të 14-të ishte në të njëjtën kohë edhe kryetar i ulemave; dy imamët perandorakë, që drejtonin faljet në xhamitë që sulltani zgjidhte për të ofruar lutjet e Xhumasë, së bashku me xhaminë e Topkapi Pallatit; kryemjeku i sulltanit (*hekimbashi*), që shërbente pak a shumë si udhëheqës i esnafit të mjekëve në Perandori; kyreastrologu i tij (*munexhim bashi*), i cili e këshillonte për datat kur duhej të ndërmernte veprime.

### **Myftinjtë**

Meqenëse ligji islamik ishte rezultat i një studimi dhe diskutimi të gjatë ndërmjet ekspertëve ligjorë nëpër shekuj. Meqenëse ai nuk kishte kode fikse, zgjidhja eksplicite e çështjeve nuk mund të bëhej duke u mbështetur vetëm në literaturën ligjore ekzistuese. Myftinjtë, që aplikonin parimet e përgjithshme ndaj të përveçmeve, fillimisht njiheshin si *muxhtehidsë*, që do të thotë “ata që përpiqen për të gjetur zgjidhjen e vërtetë ligjore”. Nga vendimet e tyre rrodhën edhe shkallët e ndryshme ligjore të islamit sunit, por pasi këto shkallë u pranuan nga masat, aftësitë e

muxhtehidëve apo anëtarëve të tjerë të ulemave për të interpretuar rastet sipas gjykimeve të tyre mori fund. Si rrjedhojë, dyert e interpretimit u mbyllën dhe anëtarëve të ulemave që duhej të vendosnin për çështje të ndryshme apo të interpretonin ligjet, u duhej të ndiqnin me rigorozitet interpretimin e shkollës së cilës ata i përkisnin. Ulematë që merreshin me interpretimin e ligjit, sipas bazës së këtyre kodeve, njiheshin si *fakihë*, ndërsa vetë shkenca e komentimit u njoh si *fikh* (jurisprudencë). Në kohët osmane *fakihë* ishin myftinjët, të cilët nxirrnin *fetva* (deklarata për çështje ligjore) në kundërpërgjigje të problemeve që hasnin kadilerët, zyrtarët apo personat e thjeshtë, si dhe kërkonin përgjigje për të shpjeguar sjelljet ligjore në rastet e tyre specifike. Në të vërtetë myftinjët nuk mund të shpiknin apo jepnin gjykime personale duke u mbështetur në ekzaminimet e tyre të burimeve. Përgjigjet ata mund t'i jepnin duke u mbështetur në kodet e degëve specifike të ligjit islamik dhe në precedentët historikë. Megjithatë, në praktikë ka pasur raste kur myftinjët nxirrnin përgjigjet që u interesonin duke zgjedhur ato pjesë të ligjit që u interesonin dhe injoronin të tjerat që mund të shkonin kundër argumentimit të tyre. Në të njëjtën mënyrë vepronin edhe kadilerët. Në kundërshtim me kadilerët, që emëroheshin nga qeveria, anëtarët e ulemave që plotësonin kushtet e të qenit kështu, mund të vetëdeklaroheshin *myfti* dhe të praktikonin detyrën, nëse personat që kërkonin *fetva* kishin besim tek ata. Në kohën e sulltan Sulejmanit u bënë përpjekje për të ndërtuar një organizatë për myftinjët sipas modelit të kadilerëve. Për këtë arsye u ngrit zyra e *shejhulislamit* (kryetarit të islamit), qëllimi i së cilës ishte të shërbente si kryemyftinia e Perandorisë dhe myftinia e Stambollit e në të njëjtën kohë të shërbente si zyrë koordinuese ndërmjet punës së kazaskëve dhe kadilerëve. Pas kësaj myftinjët zyrtarë për secilin qytet dhe shumë kaza kryesore të Perandorisë emëroheshin nga shejhulislami, i cili kishte për detyrë edhe të lëshonte *fetva* kur kjo kërkohej nga kadilerët dhe autoritetet provinciale e vendore. Në postet e myftinjve të zonave të rëndësishme emëroheshin ulematë që kalonin nëpër gjithë sistemin edukativ të medreseve, ndërsa për në vendet më pak të rëndësishme emëroheshin ata që kishin në të gjitha shkallët e sistemit të medreseve. Meqenëse shkolla juridike *hanefite* ishte shkolla që njihej zyrtarisht për interpretimet ligjore në Perandori, shumica e myftinjve, ashtu si dhe kadilerët, i përkisnin asaj. Por në provincat ku praktikoheshin shkollat e tjera, si shkolla “Shafi’i” në Egjipt, në Siri dhe në qytetet e shenjta emëroheshin myftinjët e shkollave përkatëse me kërkesë të guvernatorëve apo udhëheqjes fetare vendase. Si kadilerët, ashtu dhe myftinjët nuk paguheshin me rrogë dhe jetonin me pagesat që nxirrnin nga *fetvatë* që

lëshonin, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me ato të myftinjve zyrtarë. Në këto raste rangu dhe prestigji i myftiut ishte ai që vendoste edhe rëndësinë që opinioni i jepte fetvasë.

### **Ulematë e rangjeve të ulëta**

Në Perandori kishte disa qindra ulema që nuk mbanin poste zyrtare, por që ishin anëtarë të klasës qeverisëse falë dijeve që ata zotëronin. Të edukuar vetëm në shkallët e para të medreseve, ata shërbenin si hoxhallarë nëpër xhami apo si udhëheqës të faljeve publike, duke qenë në këtë mënyrë pak a shumë drejtues të xhamive, apo hatibë, të ngarkuar për të mbajtur fjalime (*hutbe*) nëpër xhami gjatë ditëve të faljes publike të të Xhumasë. Hatibët kishin funksionin e rëndësishëm të kujtimit të emrit të sunduesit që pranohej në zonën ku ndodhej xhamia. Përveç këtyre ulema të tjera shërbenin si shejhë të thjeshtë, apo udhëheqës fetarë me detyrë edukimin e popullit për obligimet fetare. Ata mbanin mësim gjatë ditëve të javës nëpër xhami ndaj besimtarëve që mblidheshin, ndërsa muezinët kishin për detyrë thirrjen e besimtarëve në falje nga minaret dhe leximin e lutjeve të ndryshme gjatë faljes. Megjithatë, emërimi i myezinëve nuk bazohej në njohuritë që ata kishin, por mbi cilësinë e zërit të tyre, për këtë arsye renditeshin në rangun më të ulët të ulemave.

Përveç këtyre ulema të tjera pajtoheshin për shërbime të vogla fetare, siç ishin kujdesi për varrezat, lutjet për të vdekurin, mirëmbajtja e vendeve të shenjta, sidomos për qytetet e shenjta dhe lutjet për popullin. Të gjitha ulematë e rangut të ulët emëroheshin dhe paguheshin nga mbikëqyrësit e vakëfeve që ishin themeluar për të mbështetur aktivitetet e tyre apo personat për të cilët ata shërbenin. Me kalimin e kohës shumë prej tyre kishin mundësi të bëheshin administratorë vakëfesh, duke fituar në shumë raste të ardhura dhe pushtet shumë më të madh sesa ai që kishin shumë ulema të shërbimeve edukative dhe ligjore.

### **Udhëheqja e institucionit të Ilmijes**

Edhe pse gjykatat dhe kadilerët ekzistonin që para krijimit të Perandorisë, vetëm në kohën e sulltan Muratit I u bënë përpjekje serioze për t'i organizuar dhe kontrolluar ata. Për këtë qëllim u krijua edhe posti i kadiut të ushtrisë, *kadiaskerit* apo *kazaskerit*. Fillimisht posti i kazaskerit përfshinte detyrën e mbledhjes së ulemave, duke sjellë njerëzit e ditur nga qendrat e vjetra islame

dhe caktimi i tyre në poste juridike etj. dhe pajtimi i tyre për të edukuar shtetasit osmanë, të cilët më pas do të ndërtonin sistemin e medreseve. Rreth mesit të shekullit të 15-të ky proces rezultoi kaq i suksesshëm, sa që detyra e drejtimit të ulemave ishte mjaft e vështirë për një njeri të vetëm. Si pasojë, posti i kazaskerit u nda në degë të veçanta për Anadollin dhe Rumelinë. Duke filluar nga fundi i shekullit të 15-të udhëheqja e Ilmijes ndahej ndërmjet kazaskerëve dhe kryemyftiut të Stambollit, në cilësinë e udhëheqësit të esnafit të myftinjve të Perandorisë dhe si personi që kishte të drejtën të lëshonte fetva për pozitën e shejhulislamit (udhëheqësit të islamit). Gjatë periudhës së gjatë të shërbimit të Ebu Us-Suud Efendiut si shejhulislam në kohën e sundimit të Sulejmanit të Madhërisëm pozitat e balancuesve të pushteteve ndryshuan, pasi mbajtësit e këtij posti në fund të shekullit të 16-të gëzonin të ardhura ditore që shkonin deri në 750 akçe në ditë. Ebu Us-Suudi siguroi edhe të drejtën e emërimit të të gjithë kadilerëve, myderizëve dhe myftinjve të shkallës së lartë, që paguheshin nga 40 akçe në ditë apo më shumë, gjë që i çoi kazaskerët të kontrollonin në mënyrë efektive vetëm ulematë e rangut të ulët. Megjithatë, këta të fundit vazhduan të kishin ndikim mbi gjithë sistemin e Ilmijes falë anëtarësisë në Këshillin Perandorak. Ndërsa fetvatë e nxjerra nga myftinjtë duhej të respektoheshin nga kadilerët, të cilët nuk detyroheshin ligjërisht t'i pranonin ato, përveç fermanëve që lëshoheshin nga sulltani. Shejhulislamit i mungonte autoriteti për t'u treguar kadilerëve si të zbatonin ligjin në gjykata. Këtë kompetencë e ushtronte vetëm sulltani, nën autoritetin e të cilit kadilerët zbatonin ligjin, por në disa raste kjo detyrë ushtrohej nga kryeveziri pas këshillimit me kazaskerët në vend të shejhulislamit. Nga ana tjetër, edhe pse autoriteti administrativ ligjërisht nuk ishte i detyruar të pranonte fetvatë, për shkak të prestigjit të myftinjve u bindeshin shpesh kërkesave të anëtarëve të rëndësishëm të Ilmijes.

## **5. Analizë krahasuese e ligjit bizantin me legjislacionin otoman**

E drejta feudale ishte e ndikuar edhe nga e drejta bizantine, por ajo nuk duhet njehsuar me të. Ngjashmëria midis tyre duhet parë në shkallën e zhvillimit të rrethave ekonomiko-shoqërore me të cilat ato u formuan.<sup>262</sup>

---

<sup>262</sup> Haxhi P(1998) "Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri" Tiranë fq 11

Në territorin shqiptar turqit në përgjithësi vendosën regjimin e tyre juridik, që mbështetej në pronësinë feudale ushtarake mbi tokën. Dispozitat ligjore që nxorën turqit gjatë pushtimit ishin në përshtatje me kushtet e reja. Forma kryesore juridike që u përdor për rregullimin e marrëdhënieve agrare ishin kanunamete që e kishin burimin të Kurani dhe kodet e sulltanit.

Turqit bënë regjistrimin e tokave dhe i shpallën të gjitha tokat e punueshme dhe të papunueshme (arat, livadhet, kullotat, pyjet, korijet) pavarësisht se në duart e kujt ndodheshin, pronë shtetërore. Juridikisht, pronari i tokave shtetërore quhej “Perëndia” dhe administroheshin prej Sulltanit. Tokat shqiptare të shpallura tokë e mirie, hynin në fondin e përgjithshëm të tokës së shtetit Osman, në dispozicion të Sulltanit, i cili ia jepte feudalëve ushtarakë dhe funksionarëve të administratës civile, fetare dhe gjyqësore, me kusht që të paguanin taksë dhe të merrnin pjesë në luftë me njerëzit e tyre. Meqenëse tokat mirie u ndanë dhe iu dhanë në zotërim feudalëve të ndryshëm, shteti Osman mbeti gjithnjë pronar i vërtetë i këtyre tokave.<sup>263</sup>

E drejta feudale mbi tokën që jepej nga sulltani nuk ishte e drejtë pronësie, mbasi shteti i ruante të drejtën e pronësisë, ndërsa feudali ushtronte të gjitha atributet e nevojshme për shfrytëzimin e timarit si pronë feudale, por gjithmonë me autorizim të shtetit dhe brenda kufijve të përcaktuar në kanunametet përkatëse. Pozita e timarliut ishte si ajo e feudalit, që nuk ushtronte efektivisht atributet e pronarit, por me delegim të Sulltanit, njihej si përfaqësues i shtetit dhe i klasës feudale në tërësi. Ndonëse feudali turk nuk e gëzonte pronësinë e plotë mbi tokat e timarliut, ky si nëndorës faktik i tyre, gëzonte të drejtën të merrte prej fshatarëve një varg detyrimesh në natyrë e në të holla.

Feudalët ose funksionarët, si administratorë, kishin të drejtën t’ua jepnin tokat me tapi fshatarëve për t’i përdorur e shfrytëzuar, t’ua hiqnin këtyre kur nuk plotësonin detyrimet ose kërkesat e tjera, siç ishin: punimi i tokës dhe moslargimi prej saj, etj.

E drejta feudalëve mbi këto toka ishte e pakushtëzuar me përmbushjen e detyrimeve ushtarake ndaj Perandorisë Osmane.

---

<sup>263</sup> Haxhi P(1998)” *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*” Tiranë fq 12

Familja fshatare nga tokat mirie kishin ngastrën e tyre (bashtina) që punonte bashkërisht me pjesëtarët e saj. Nga pikpamja juridike, pronari I bashtinës ishte shteti dhe shfrytëzuesi I tyre ishte feudali, ndërsa fshatari gëzonte mbi bashtinën e vet vetëm të drejtën e përdorimit (tesarufin). Tesarufi nuk ishte një e drejtë pronësie, as element i një pronësie të pjestuar. Fshatari nuk mund të ishte bashkëpronar me pronën feudale, as pjesëtar në shfrytëzimin e prodhuesve të drejtëpërdrejtë, por ishte tjesht nëndorësi. Kjo ishte një e drejtë që Tokën e kishte në dorë dhe e përdorte një njeri, por duke mos pasur të drejtën që të bënte ndryshime thelbësore mbi të, p.sh. të mbillte dru, të ngrinte godinë pa lejen e posaçme dhe pëlqimin e shtetit. Ai nuk kishte të drejtë të bënte akt për kalimin ose kufizimin e tesarufit, pa lejen dhe miratimin e shtetit. Nga tokat që nuk punoheshin si kullotat etj, merrej qeraja që quhej ixharei – muexhele. Kur shteti nxirrte në ankand tokë për shitje, ai që merrte tokën dhe i paguante shtetit shumën e të hollave si fitues i ankandit, nuk quhej blerës i tokës, por marrës me qira. Këtu përfshiheshin dy lloje qerash: shumata që i paguante shtetit fituesi i ankandit dhe që quhej qera e parapaguar (qera pa afat) dhe e dhjeta e prodhimeve që i paguante çdo vit shtetit që quhej qira me afat.<sup>264</sup>

Ky karakter i së dhjetës del nga përmbajtja e ligjit të tokave, sipas të cilit, në qoftë se: nga pakujdesia toka shtetërore lihet e papunuar, pa dhënë prodhime për tre vjet, dhe si pasojë e ketyre pa u marrë e dhjeta, shteti kishte të drejtë të anulonte qeranë, të merrte tokën dhe ta nxirrte rishtazi në ankand, duke ia dhënë atij që ia jepte çmimin më të lartë. Pra burimi fillestar i çdo tesarufi mbi tokën ishte shteti.

Fshatari mund ta përdorte tokën bashtinë me lejen e Spahiut. Ai i'a jepte këtë leje vetëm nëse fshatari përmbushte disa kushte: a) t'i paguante zotëruesit të tokës taksën e tapisë; b) t'i jepte atij rregullisht detyrimet e caktuara feudale.<sup>265</sup>

Fshatari kishte të drejtë që këtë tokë, e cila quhej bashtinë, ta kalonte tërësisht me ose pa shpërblim një fshatari tjetër për ta punuar përgjithmonë, por kurdoherë me lejen e spahiut. Ky, sipas rregullit, lëshonte në këtë rast tapinë e fshatarit tjetër të cilit i kalonte bashtina. Për çdo kalim të së drejtës së përdorimit Spahiu merrte taksën dhe lëshonte tapinë. Kalimi i bashtinës me anë trashëgimie nga i ati tek i biri bëhej me tapi. Persona të tjerë (vajzat, vëllezërit, motrat)

---

<sup>264</sup> Haxhi P(1998)“ *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*” Tiranë fq 13.

<sup>265</sup> Po aty, f.13.

kishin vetëm të drejtën te parapëlqeheshin ndaj të tjerëve, d.m.th kur vdiste personi që kishte tesarufin deh nuk kishte fëmijë mashkull. Tokën e dispononte feudali dhe vendoste ai si ta çmonte më mirë për interesat e veta, por gjinia parapëlqehesh ndaj të tjerëve. E drejta e pronësisë së tokës që u vendos në Shqipëri nuk ishte e pjestueshme. Pronari ishte vetëm klasa feudale e përfaqësuar nga Sulltani. Të drejtat e timarliut dhe të fshatarit ishin të prejardhura nga sulltani pronar. Shteti gëzonte të drejtën e disponimit, timarliu të drejtën e nëndorësisë dhe fshatarët të drejtën e përdorimit. Por ai që gëzonte të drejtën e pronës feudale ishte timarliu. Ky, pavarësisht nga formulimet juridike dhe kufizimet, gëzonte të drejtën e përvetësimit nga fshatarët të rentës feudale, që ishte kryesore për ekzistencën e regjimit feudal.<sup>266</sup>

Fshatari përveç bashtinës, mbi të cilën kishte të drejta të kushtëzuara, kishte dhe një ngastër të vogël jo më shumë se një dynym, si: kopshte, vresshta, etj., erzimylk, dhe dhe të cilin e dispononte pa ndonjë kufizim, pa lejen e spahiut, por me vërtetim të kadiut. Pronari i tyre mund t'i shiste, t'i trashëgonte dhe t'ia dhuronte pa kufizimet që ekzistonin për tokat e bashtinës.

Nga fondi i pronës shtetërore mirie Sulltani si shpërblim ose në shenjë dashamirësie iu jepte tokë funksionarëve për shërbime të veçanta. Kjo quhej tokë mylk. E drejta e tij mbi këtë tokë ishte e drejtë pronësie e plotë dhe e pakushtëzuar me detyrime. Ai që dispononte kishte të drejtë ta shiste, ta dhuronte, ta kthente vakëf, etj. Edhe pas humbjes së ofiqit pronari e ruante të drejtën mbi tokën. Toka mylk u kalonte në trashëgimi njerëzve të afërm sipas ligjit. Në mungesë të trashëgimtarëve kjo u mbetej shtetit.

Gjithashtu gjatë pushtimit Osman në Shqipëri, pas shekullit XV-të u zhvillua edhe vakëfi. Toka vakëf ishte ajo tokë që shteti ua jepte institucioneve fetare. Ajo ishte pasuri e patjetërsueshme dhe e lirë nga taksat dhe tatimet. Të ardhurat e saj shkonin në dobi të institucionit fetar. Prona tokësore që kthehej në vakëf iu jepej për përdorim fshatarëve.

Varfërimi i mëtejshëm i fshatarëve në shekullin XVI-të diktoi nevojën që në kanunametë e Shqipërisë të futeshin disa dispozita të reja në dobi të fshatarëve, por që nuk çënonin interesat e spahijve. Fshatarëve raja iu njohën të drejta më të plota mbi pronat mylk, mbi shtëpinë, kopshtin, vreshtën, livadhet. Në këtë kohë u bënë ndryshime edhe në të drejtën e trashëgimisë. Ndërsa më

---

<sup>266</sup> Haxhi P(1998)'''' Tiranë fq 14



parë tokën bashtinë të një fshatari raja mund ta trashëgonte vetëm i biri i tij, në ate kohë u sanksionua edhe e drejta e trashëgimisë në vijë femërore. Kur fshatari nuk kishte djalë, tokën e tij e trashëgonin kundrejt pagesës së taksës së tapisë, sipas një rradhë të caktuar, e bija, *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri* i vëllai, i jati ose e ëma. Në kanunametë fshatarët e nënshtruar u përcaktuan si raja të përhershëm. Feudali gëzonte të drejtën absolute për të përvetësuar rentën nga fshatari.

Ligjet osmane të shekullit XVI-XVII-të ndalonin të ktheheshin bashtinat ne çifligje. Por kanunametë nuk e pengonin spahiun të vepronte dhe të merrte në përdorim disa bashtina në timare të tjera dhe ti qeveriste ato si çifligje me anë të fshatarëve bujq. Filluan kështu të lindin çifligjet, të cilat morën një përhapje të madhe, sidomos gjatë shekujve XVII-XIX-të.<sup>267</sup>

Çifligu ishte një zotërim i madh tokësor privat feudal, i pakushtëzuar me detyrime ushtarake, i cili u përhap në kurriz të timareve dhe zeameteve. Vlera e çifligut përcaktohej në rradhë të parë nga sipërfaqja e tokës dhe nga numri i çifçinjve. Zotëruesi i një çifligu mund të bëhej spahiu, pastaj beu ose agai, në raste të veçanta fshatari i pasuruar, po ashtu edhe fajdexhiu, tregatri ose zejтари i pasur.

Shtiblerja e tokave, si një nga format për krijimin e çifligut, u përhap shumë saqë toka po kthehej ne mall. Çifligjet, që u përqëndruan në duart e feudalëve, të çifligarëve, të fajdexhinjve, tregtarëve dhe zejtarëve të pasur përfshinë kryesisht:

1. toka-ngastra të fshatarëve nën sistemin e timarit.
2. toka të përbashkëta të fshatit (metruqe) të quajtur edhe hyrie.
3. toka dierre (mavatil)
4. toka private (mylqi)
5. toka fetare (vakëf).

Pra, në sistemin e çifligut u përfshinë toka që parashikonte edhe ligji për tokën.<sup>268</sup>

---

<sup>267</sup> Haxhi P(1998)'' *Regjimi juridik i Tokës në Shqipëri*'' Tiranë fq 15

<sup>268</sup> Po aty, fq 14

Për të bërë krahasimin e ligjit agrar “*Nomos Georgios*” me legjislacionin otoman duhet të kemi parasysh që krahasimi të kryhet me kanunametë që Stambolli zbatoi për trevat shqiptare gjatë sundimit të tij. Pika e takimit mes dy legjislacioneve është prioriteti që u kanë dhënë trevave fshatare, rregullimit të jetesës së tyre në çdo aspekt të ekonomisë.

Regjimi otoman i dha prioritet sektorit të bujqësisë dhe atij blegtoral, dy zërat kryesorë të ekonomisë. Në masën 87 për qind pronar i tokës ishte shteti, i cili sipas Kanunit Osman gëzonte të drejtën e tjetërsimit.

E drejta e shfrytëzimit të tokës njihej me emrin “*tasarruf*”.

Fshatarët nuk mund ta shisnin, nuk mund ta linin peng, nuk mund ta kthenin në vakëf dhe nuk mund t’ua linin trashëgim fëmijëve të tyre në përputhje me rregullat islamike të ndarjes së trashëgimisë.

Fshatari gëzonte të drejtën e pronësisë së plotë (*mylk*) mbi lloje pasurish të tilla si: shtëpi, vreshta, pemishte, kopshte, mullinj dhe furra buke<sup>269</sup>. Detyrimet në taksa ndaheshin në dy kategori: *taksa kanonike* dhe *taksa të caktuara nga sulltani*. Këto të dytë ishin përsëritje e zakoneve të kohës para pushtimit osman. Tatimet ishin kodifikuar me saktësi në kanunametë përkatëse, që ishin të veçanta për çdo provincë, në mënyrë që tatimet të mos bëheshin të padurueshme për popullsinë<sup>270</sup>.

Perandoria Osmane kishte rregulluar çdo detaj të ekonomisë e tregtisë në kanuname. Për të kuptuar se si funksiononte në trevat shqiptare ky rregullim dhe sa i përafërt ishte me ligjin bizantin, do t’i referohemi kanunamesë së sanxhakut të Shkodrës<sup>271</sup>. Gjëja e parë që të bie në sy është përcaktimi i çmimeve fikse i tregut, që bëhej nga sulltani me anë të urdhrave.

Në sanxhakun e Shkodrës çmimet e fiksuara të tregut për prodhimet bujqësore ishin si më poshtë<sup>272</sup>:

*Në nahijen e Pejës, në nahijen e Budimles dhe të Izla Rjekës:*

---

267. Mantranit R., *Historia e Perandorisë Osmane*. f.206.

268. Po aty, f. 207.

269. v. 297/1529.

270. Egro D., *Ligji osman ndër shqipta rët e mesjetës së vonë* .f. 82.

- barra e grurit, që është e barabartë me gjashtë kile të Stambollit, çmohet me tridhjetë e gjashtë akçe;
- barra e thjerrzave, e qiqrave, e bathëve dhe e pllaqive është e çmuar aq sa vlera e barrës së grurit;
- barra e thekrës dhe e melit është llogaritur e barabartë me njëzet akçe;
- barra e tërshërës, e grashinës dhe e urofit është çmuar tetëmbëdhjetë akçe;
- barra e arrave është çmuar njëzet e katër akçe
- çuburit të mushtit, që është i barabartë me katër medre, i është vendosur një vlerë prej njëzet e pesë akçesh.
- njëqind dirhem i lodrës së safranit është llogaritur i barabartë me gjashtëmbëdhjetë akçe;
- njëmijë copë mëshikëza të krimbit të mëndafshit njëmbëdhjetë akçe
- pesëmbëdhjetë goxhe trëndafili një akçe
- pesëdhjetë kokrra qepë dhe pesëdhjetë kokrra hudhra një akçe;
- njëmijë fije lini, 3 cm secila, gjashtëdhjetë akçe.

*Në nahijen e Shkodrës, në viset përreth dhe në nahijen e Podgoricës:*

- barra e grurit, që gjithashtu është e barabartë me gjashtë kile të Stambollit, çmohet me tridhjetë e tetë akçe;
- barra e thjerrzave, e qiqrave, e bathëve dhe e pllaqive është e çmuar aq sa vlera e barrës së grurit;
- barra e thekrës dhe e melit është llogaritur e barabartë me njëzet akçe;
- barra e tërshërës, e grashinës dhe e urofit është çmuar tetëmbëdhjetë akçe;
- medreja e mushtit është llogaritur e barabartë me pesë akçe e gjysëm;
- barra e arrës është çmuar e barabartë me njëzet e katër akçe.

*Ruajtja e monopolit dymujor për shitjen e prodhimit të mushtit është ligj i vjetër. Timarioti, në se dëshiron, monopolin mund ta mbajë për dy muaj e një javë dhe në se gjithashtu dëshiron, një muaj mund ta mbajë në një stinë dhe një muaj në një stinë tjetër.*

*Mushtin që prodhohet nga vreshtat e fshatrave që sanxhakbeu i ka në zotërim me statusin hassa, subashët e sanxhakut e çuakan në qytetin e Shkodrës dhe monopolin e shitjes së saj e mbajtkëshin për të dymbëdhjetë muajt e vitit. Kjo praktikë tashmë është shfuqizuar me urdhër të*

*sulltanit. Monopoli të mbahet vetëm për dy muaj, ashtu siç e parasheh ligji i vjetër. Përtej kësaj kohe, ky ligj i vjetër të mos dhunohet dhe askujt të mos i bihet në qafë.*

*Transportimi në treg i së dhjetës së timariotit është detyrim i rajasë, madje fshatarët raja, për të ruajtur të dhjetën në fshatrat e tyre, kanë përgjegjësi t'u përgatisin timariotëve edhe hambarët.*

*Timarioti të marrë menjëherë të dhjetën e koshereve të bletëve dhe të lirit.*

*Në se timarioti nuk ka tokë për t'ia dhënë rajasë dhe për pasojë rajaja mbjellë në një vend tjetër, timariotit zot të tokës t'i japë të dhjetën, sipas zakonit.*

*Ligji agrar ka të përcaktuar në nocionin e “morten” ose “qeraja” pagimin e 1/10 së prodhimit të tokës, konkretisht një qiramarrës i tokës së huaj ka detyrimin e pagimit të qerasë në masën 1/10 të prodhimit të asaj toke që i është dhënë me qira.*

*Nga mullinjtë që punojnë me dorë e që funksionojnë gjithë vitin, të merren tridhjetë akçe; nga mullinjtë që punojnë me dorë e funksionojnë gjysmën e vitit dhe nga mullinjtë e dërstilës pesëmbëdhjetë akçe; mullinjtë me ujë që punojnë gjithë vitin, të merren gjashtëmbëdhjetë akçe.*

Shohim se, ashtu si ligji bizantin, edhe legjislacioni otoman ka rregulluar pothuajse të njëjtat situata në jetën ekonomike të fshatit.

Vendet nën sundimin otoman zotëronin një ekonomi që prirej drejt sektorit fshatar, duke e vënë theksin te bujqësia dhe blegtoaria, që ndryshonin në varësi të relievit dhe të popullsisë. Toka ishte në përdorim të rajave të krishterë apo myslimanë, të cilët nuk kishin të drejtë ta shitnin, ta linin peng apo t'ua linin në trashëgimi fëmijëve, por vetëm ta shfrytëzonin, *tasarruf*. Pronar i tokës në masën 87 për qind ishte shteti, i cili e quante këtë pronësi *mirie*. Fshatarët gëzonin të drejtën e pronës së patundshme, si: shtëpi, vreshta, pemishte, kopshte, mullinj. Kanuni Osman në këtë rast kishte zënë vendin e Sheriatit, madje i kundërviehej atij<sup>273</sup>.

Përveç normave të karakterit civil ligji ka parashikuar edhe disa norma që marrin në mbrojtje pasurinë, pronën private dhe atë të bashkësisë. Në pjesën më të madhe të këtyre normave është parashikuar vepra penale e vjedhjes, konkretisht:

---

271. Mantranit R., *Historia e Perandorisë Osmane* . f. 207.

- *“Nëse dikush vjedh një patë apo një rosë, kadiu ta dënojë, në vend të çdo dy goditjeve me shkop, t’i merret një akçe gjobë.”*
- *“Nëse dikush vjedh një dele apo një koshere bletësh, t’i merren pesëmbëdhjetë akçe gjobë.”*
- *“Nëse dikush vjedh një kokë bagëti të trashë, të mos i pritët dora. Nëse vjedhësi është i kamur sa të zotërojë një mijë akçe dhe më tepër, gjoba t’i merret njëqind akçe. Nëse është në gjendje të mesme ekonomike, t’i merren pesëmbëdhjetë akçe. Nëse është i varfër, t’i merren dyzet ose tridhjetë akçe gjobë.”*
- *“Nëse dikush vjedh një kalë, t’i pritët dora; nëse nuk ia presin, t’i merren dyqind akçe gjobë.”*

Ligji agrar i ka kushtuar disa dispozita veprës penale të vjedhjes kundër gjësë së gjallë, si për shembull:

Neni 41: *“Në qoftë se dikush vjedh një ka ose një gomar edhe zbulohet, mbasi të rrihet, ta paguajë atë në dyfishin e punës së tij.”*

Neni 42: *“Në qoftë se dikush duke dashur të vjedhë një ka nga një kope bën që kopeja duke u shpërndarë të bëhet pre e bishave, të verbohet.”*

Neni 46: *“Në qoftë se një shërbëtor duke dashur të vjedhë natën nxjerr bagëtitë nga vatha dhe ato humbasin ose i hanë bishat, të ngulet në hu si drurës.”*

Neni 47: *“Në qoftë se shërbëtori i dikujt ka vjedhur shumë herë kafshë natën ose ka bërë shumë herë grabitje bagëtish, të gjobohet i zoti i tij për ato që kanë humbur, si njeri që është në dijeni se shërbëtori është shkaktar, kurse shërbëtori të ngulet në hu.”*

Vepra e vjedhjes në legjislacionin otoman është parashikuar si e tillë edhe kur kryhej ndaj pasurive të tjera, si toka dhe produktet e saj, për shembull:

- *“Dikush që vjedh të korrat apo akçet e dikujt, nëse është i kamur, gjoba t’i merret dyzet akçe; nëse është në gjendje të mesme ekonomike, t’i merren njëzet akçe; nëse është i varfër, t’i merren dhjetë akçe gjobë.”*

- “Nëse dikush vjedh një torbë apo një shami/çallmë koke, të mos i pritët dora, kadiu ta dënojë: në vend të çdo goditjeje me shkop, t’i merret një akçe gjobë.”
- “Nëse djali vjedh babain, babai vjedh djalin, vëllai vjedh vëllain apo burri vjedh gruan ose gruaja burrin, kadiu t’i dënojë: në vend të çdo goditjeje me shkop, të merret një akçe gjobë.”
- “Në se dikush vjedh diçka nga mullari, diçkaja e vjedhur të kthehet për llogari të shtetit.”

Konstatohet se sanksioni përkatës i parashikuar është edhe ai fizik, edhe ai ekonomik, por pritët drejt vjeljes së gjobës dhe në raste më të rralla është parashikuar dënimi me prerjen e gjymtyrëve. Duke iu referuar *ligjit agrar*, konstatohen ngjashmëri në dispozitat ligjore për marrjen në mbrojtje të pronës private, për shembull, neni 33 i ligjit agrar thotë: “Në qoftë se një ruajtës pemësh frutore kapet duke vjedhur në vendin ku ruan, të privohet nga rroga e tij dhe të rrihet fort.”<sup>274</sup> Pra, ligji merr në mbrojtje pasurinë që buron nga pemëtaria, si një pjesë e rëndësishme e ekonomisë familjare dhe asaj të bashkësisë. Sanksioni përkatës është edhe ai fizik, edhe ai ekonomik, pra privimi i marrjes së të ardhurave në të holla për punën që shkelësi do të bënte dhe ka abuzuar me atë.

Në nenin 61 ligji parashikon: “Ata që hyjnë në vreshtat ose në plantacionet e manave të të tjerëve për të ngrënë, qofshin të pafajshëm. Në qoftë se hyjnë për të vjedhur, të zhvishen dhe të rrihen.”<sup>275</sup>

Gjithashtu janë parashikuar dispozita për mbrojtjen e veglave bujqësore nga vjedhja, për shembull:

Neni 62: “Ata që vjedhin parmendë, plor, zgjedhë ose vegla të tjera, të gjobiten sipas sasisë së ditëve, duke llogaritur që nga dita e kryerjes së vjedhjes nga 12 follë për çdo ditë.”<sup>276</sup>

Neni 63: “Ata që djegien apo vjedhin një qerre të huaj, ta paguajnë në sasi të dyfishtë.”<sup>277</sup>

---

<sup>274</sup> Ligji Agrar, neni 33.

<sup>275</sup> Po aty, neni 61.

<sup>276</sup> Ligji Agrar, neni 62.

Neni 68: “Ai që gjendet në hambar duke vjedhur grurë, të rrihet me kamxhik, herën e parë me 100 të rrahura dhe t’i paguajë dëmin të zotit. Në qoftë se do të kapet përsëri, të gjobitet në sasi të dyfishtë të asaj që ka vjedhur. Në qoftë se e përsërit dhe për të tretën herë, të verbohet.”

Neni 69: “Ai që vjedh natën verë nga qypi, nga kadja ose nga fuçia, t’i nënshtrohet të njëjtit dënim siç është shkruar në kapitullin e mësipërm.”

Neni 722: “Bani e i vodh kush të zot veglat e bulkisë: parmendën, zhgjedhen jase ndoj vegël tjetër, cubi ka detyrë me i la të zot aq punëtorë sa i shkuen hups për me gjetë vjedhjen ene me ja prue veglat ke shpija.”

Në ligjin agrar gjejmë dispozita që mbrojnë dëmtimin e pronës private me anë të zjarrvënies, për shembull:

Neni 64: “Ata që vënë zjarr në lëmë ose në qipitë e grurit për hakmarrje kundrejt armiqve, le të digjen në zjarr.”<sup>278</sup>

Neni 65: “Atyre që vënë zjarr në kasollen e barit ose të bujkut, t’u priten duart.”<sup>279</sup>

Të dy legjislacionet kanë parashikuar dispozita për respektimin e së drejtës së pronës së tjetrit pa cenuar kufijtë e saj. Kështu, neni i parë i ligjit agrar i referohet nocioni të kufijve midis pronave private dhe detyrimit për të mos i cenuar ato. Në këtë nen thuhet: “Bujku që punon në arën e vet duhet të jetë i drejtë dhe të mos përvetësojë hullitë e fqinjit. Në qoftë se ndonjëri duke shkelur kufijtë përvetëson dhe zvogëlon pjesën e tokës që gjendet shumë afër tij, në qoftë se këtë e bën në lërimin e parë të tokës së lënë djerr, e humbet lërimin e saj; në qoftë se këtë shkelje e ka bërë në kohën e mbjelljes, bujku shkelës humbet farën, mbjelljen e saj dhe prodhimin.”

Për këtë legjislacioni otoman parashikon:

- “Timarioti të mos mbajë më shumë vend se ai i çifligut të tij; tokën që i takon rajasë t’ia japë rajasë.”

---

<sup>277</sup> Po aty, neni 63.

<sup>278</sup> Po aty, neni 64.

<sup>279</sup> Po aty, neni 65.

• *“Ai që krijon çiflig në një tokë djerrë në tokat e turqve, të mos e mbajë atë vend pa lejen e sulltanit.”*

• *“Nëse timarioti mban vendin e rajave, t’u japë këtyre të varfërve taksën e së drejtës së vendit.”*

• *“Nëse dikush, i nxjerr syrin apo i thyen dhëmbin dikujt me qëllim, të mos bëhet shpagim. Kur autori është i kamur, t’i merren dyqind akçe gjobë; nëse është në gjendje të mesme ekonomike, t’i merren njëqind akçe; nëse është në një gjendje ekonomike më të dobët, t’i merren pesëdhjetë ose dyzet akçe; nëse është shumë i varfër, t’i merren tridhjetë akçe gjobë; nëse zihen fëmijët e vegjël, nuk ka gjobë.”*

Për taksën e tapisë së tokës legjislacioni osman parashikon:

• *“Kur sipërfaqja e tokës është më e madhe sesa për një shtëpi, të merret pesëdhjetë akçe; prej atyre që kanë më pak, dyzet ose tridhjetë akçe; prej atyre që janë të varfër, njëzet ose dhjetë akçe.”*

Nga krahasimi i dispozitave të dy legjislacioneve vihet re se janë marrë në mbrojtje sendet pa zot, në mënyrë që të mos përvetësohen nga kushdo. Për këtë ligji agrar në nenin 44 parashikon: *“Në qoftë se ndonjëri gjen në pyll një ka, e ther atë dhe merr mishin e tij, t’i priten duart.”*<sup>280</sup>

Ndërsa legjislacioni osman ka parashikuar:

• *“Nëse dikush gjen qe, pela apo dhen në një vend të pabanuar dhe për këtë fakt nuk nxjerr zë, nëse është i kamur, t’i merren tridhjetë akçe gjobë; në gjendje të mesme ekonomike, njëzet akçe; i varfër, dhjetë akçe. Nëse ky fakt bëhet i njohur, por kafshëve nuk u gjendet i zoti, ato t’i dorëzohen kadiut; kadiu t’i marrë në ruajtje, por nëse i humb ato pasi fakti është bërë publik, nuk paguan gjobë; të veprohet ashtu siç parashikohet për raste të tilla në Ligjin Islam.”*

---

<sup>280</sup> Ligji Agrar, neni 44.



- *“Nëse dikush duke kaluar në rrugë rrëmben kos dhe bukë, kadiu ta detyrojë të paguajë, ta dënojë. Në vend të çdo goditjeje me shkop, t’i merret një akçe gjobë.”*

Nga krahasimi i këtyre dy dispozitave kuptojmë se ligji agrar parashikon një sanksion penal të ashpër për përvetësimin e një sendi pa zot: prerjen e duarve.

Një nga ligjet më të spikatura të periudhës otomane , është Ligji i sulltan Mehmetit II .Disa nga parashikimet e tij i paraqesim si më poshtë:

- *“Nga shuma e të ardhurave prej shpagimit të gjakut gjysmën ta marrë subashi dhe gjysmën tjetër timarioti.”*
- *“E dhjeta e produkteve të ngrënshme, frutave, mëshikëzave të krimbit të mëndafshit dhe safranit të merret në masën një në dhjetë; salarije të mos merret.”*
- *“Prej koshereve e dhjeta të merret në masën një në dhjetë koshere, si nga kosheret e cilësisë së mirë, ashtu dhe nga kosheret e cilësisë së dobët.”*
- *“Nga një lug i mullirit që punon me ujë, sipas mydit të Edirnesë, të merret një myd drith, ku gjysma të jetë grurë dhe gjysma tjetër elb.”*
- *“Nga një lug i mullirit që punon me dorë e që është në punë gjithë vitin, të merret një myd; nga ai që punon gjashtë muaj, të merret gjysmë mydi; nga ai që punon më pak se 6 muaj, sipas mydit të Edirnesë, të merret gjysmë mydi grurë dhe gjysmë mydi elb, pra të merret gjysmë për gjysmë grurë dhe elb.”*
- *“Mulliri me erë të japë, sipas mydit të Edirnesë, gjysmë mydi drith në vit; në proporcion gjysmë për gjysmë, ku gjysma të jetë grurë dhe gjysma tjetër elb.”*

- *“Një fshatar raja që ka tokë dhe e lë atë papunuar, nëse mbjell tokën e një timarioti tjetër, atëherë ky raja të paguajë të dhjeta: një për tokën e mbjellë të timariotit tjetër dhe një për tokën e tij të lënë papunuar.”*
- *“Nëse timarioti nuk ka tokë për t’ia dhënë rajasë dhe për pasojë rajaja mbjellë në një vend tjetër, timariotit zot të tokës t’i japë të dhjetën sipas zakonit.”*
- *“Në qoftë se një mysliman vjen nga provinca dhe shet shajak, jelekë shajaku, lëkurë të papërpunuar, mjaltë, gjalpë dhe produkte të tjera të ngjashme me to, t’i merret një akçe në dyzet akçe vlerë malli për llogari të baxhit.”*
- *“Për agrumet, nëse në treg vjen një barrë, të merret një akçe; nëse në agrumet vijjnë në sasi më të madhe, të merret një akçe për çdo dy apo tri barrë.”*
- *“Rritësit e qenve, jeniçerët, fajkuarritësit, djemtë që përkujdesen për kuajt, lajmësit dhe të tjerët të jenë të kujdesshëm të japin atë për çka ata urdhërohen prej urdhrin perandorak në lidhje me ushqimet e kafshëve, ushqimet e njerëzve, kuajt etj. Të mos detyrohen të japin gjë më tepër. Nëse nuk është urdhëruar të merret ndonjë gjë prej tyre, atëherë të japin të dhjetën. Të blenë gjithçka u duhet. Askush të mos dhunohet; të mos ndërhyhet për asgjë për sa kohë që unë nuk kam urdhëruar; nëse zyrtarët e mi veprojnë pa pasur urdhër, t’i bëhet me dije Sarajit. Dhunuesit të ndëshkohen; të mos marrin asgjë nga askush.”*
- *“Nëse kali, kau apo pela e dikujt hyn në të mbjellat e dikujt tjetër, të zotit të kafshës t’i merren pesë akçe gjobë për çdo kokë kafshe dhe t’i jepen pesë goditje me çomange.”*
- *“Nëse në të mbjellat e dikujt tjetër hyn viç motak, të zotit të kafshës t’i merret një akçe gjobë dhe t’i jepet një goditje me çomange.”*
- *“Nëse në të mbjellat e dikujt tjetër hyjnë dele, të zotit t’i merret një akçe gjobë për çdo dy dele dhe t’i jepet një goditje me çomange.”*

• “Nëse më parë është shkruar një hyxhet dhe pas shkrimit të tij sërish nuk i vihet veshi këtij dokumenti dhe kafshëve nuk u vihet fre, por ato sërish gjenden në të mbjella dhe i dëmtojnë ato, të zotët e tyre të gjobiten sipas kësaj praktike:

- t’i jepen goditje me çomange;

- të dëmshpërblejnë dëmin e shkaktuar;

- të kërcënohen që të mbajnë nën kontroll kafshët e tyre, që ato të mos dëmtojnë më të mbjellat e të tjerëve.”

• “Nëse pranë fshatrave, në mes të fshatrave apo te vendet ku qëndrojnë kafshët dhe rrugës për të shkuar atje ka sipërfaqe të mbjella që mund të shërbejnë si vend pushimi për kafshët, vendeve të tilla u thonë ‘avllagu’.

Çdo krijesë njerëzore, pa dallim se cili është ai, nëse shkel këtë ligj, meriton të qortohet dhe të konsiderohet fajtor e mëkatar; kështu të dihet. Ky ligj të njihet patjetër nga të gjithë.”

Ky ligj ka parashikuar nocionin e dhënies së një të dhjetës të prodhimit i cili është sanksionuar më parë në ligjin Agrar të Bizantit dhe aplikohet në trevat Shqiptare .Në rastin kur dëmtohen të mbjellat e pronarit të tokës nga kafshët e të tjerëve , ligji otoman në dallim nga ligji Agrar i cili parashikonte si sanksion vetëm dëmshpërblimin , kparashikon edhe sanksionin fizik i cituar si “t’i merret një akçe gjobë dhe t’i jepet një goditje me çomange.”Pra vihet re një ashpërsim i dënimit në respekt të mbrojtjes së pronës së tjetrit.

## **6. Krahasimi i ligjit osman me të drejtën zakonore shqiptare**

Shteti osman ishte mbështetur në baza juridike të shumëfishta. Pushtimi nga osmanët i tokave bizantine, serbe dhe bullgare, që kishin tradita juridike krejt të ndryshme nga ato të islamit, i detyroi sulltanët që të bëjnë lëshime, të cilat nxjerrin në pah pragmatizmin e drejtuesve të shtetit të ri. Më pas sulltani në rregullat që nxirrte përmendte të drejtën zakonore ose të drejtën e lashtë të popujve ballkanikë, ndërsa për Egjiptin kujtonte ligjet e mamlukëve<sup>281</sup>. Sheriati u jepte mundësi drejtuesve vendorë të nxirrnin ligje të reja sa herë që e drejta fetare myslimane nuk e lejonte që t’u jepte zgjidhje gjendjeve dhe çështjeve që nuk parashikoheshin në të. Gjatë

---

279. Vepër e cituar, *Robert Mantranit. f. 120.*

sundimit të tyre në Ballkan osmanët për problemet që nuk gjenin zgjidhje nga ligji kuranik, kanë vënë në përdorim ligjin sakson.

Numri i ligjeve zakonore që nxori Mehmeti II ishte aq e madhe, saqë e detyroi sulltanin në gjysmën e dytë të shekullit të 15-të t'i përmbliidhte në një vëllim të vetëm, që përbën një kod të vërtetë zakonor, një kanun. Juristët osmanë mblodhën një varg rregulloresh, që ishin nxjerrë për punishtet e monedhës, për vetë monedhën, për kriporet, për regjimin e tokës, për tatimet, për doganat, për tregjet dhe portet. Megjithatë, kjo përmbledhje nuk e mbulonte numrin e stërmadh të strukturave të shtetit, ndaj Mehmeti II nxori një kod të ri ligjesh. Ky kod, i përbërë nga tre vëllime, trajton të drejtën penale, statusin e timariotëve dhe të fshatarëve-raja, të nomadëve dhe të banorëve të disa krahinave ballkanike, organizimi i të cilave, siç provohet nga shumë terma institucionalë, ishte bërë qysh në fillimet e Perandorisë Bizantine<sup>282</sup>. E veçanta e shtetit osman ishte se për të siguruar mbarëvajtjen e shtetit në trojet e pushtuara përpiquej të zbatonte të drejtën që ishte në fuqi në këto troje. Shteti oman me “të drejtë zakonore” nuk kuptonte vetëm rregullat juridike të mbrytura nga përvoja mijëvjeçare e një populli që i kishte kodifikuar marrëdhëniet midis bashkësive dhe individëve, midis vetë bashkësive dhe midis bashkësive dhe pushtetit qendror.

Ndryshe nga e drejta bizantine e drejta zakonore osmane përfshinte çdo ligj, çdo dispozitë juridike që mungonte në Sheriat, qoftë edhe ligj i shpallur nga administrata e një vendi të pushtuar. Kjo është arsyeja që kodet zakonore osmane veç praktikave juridike të përpunuara gjatë shekujve përmbajnë edhe ligje të nxjerra jo shumë kohë më parë nga popullsitë e krishtera dhe myslimane. Në përmbledhjen e ligjeve të sulltanit gjejmë edhe elemente të legjislacionit romak, bizantin, sllav dhe gjermanik.

Në trojet e pushtuara nga Perandoria Osmane bazat juridike mbështeteshin në dy shtylla: në të drejtën myslimane (Sheriati) dhe në të drejtën zakonore të popujve të pushtuar. Kjo mund të vlerësohet si një politikë e mprehtë e sulltanit për të drejtuar me sa më pak rezistencë në vendet e pushtuara, shumë herë edhe i diktuar nga ekonomia për të ndjekur traditat vendase. Nuk mund të flitet për një pushtet absolute kur i referohemi legjislacionit që është aplikuar në kohën e pushtimit osman. Osmanët ishin të detyruar të respektonin disa ligje të veçanta, edhe pse feja e tyre ishte e ndryshme nga feja e tij.

---

280. Vepër e cituar, *Robert Mantranit*, f. 121.

Krahasimi i legjislacionit otoman me të drejtën zakonore shqiptare do të bëhet duke iu referuar kanuneve të trevave të ndryshme. Siç thamë më lart, karakteristika e asaj kohe dhe e atij pushtimi ishte se nuk u arrit asnjëherë një zbatim i plotë i ligjit osman, pasi rrethanat dhe politika e ndjekur nuk ia lejuan sulltanit. Pa dyshim, bazën juridike të së drejtës zakonore shqiptare e përbën Kanuni i Lekë Dukagjinit, apo Kanuni i Maleve, me një përhapje mjaft të gjerë në trevat e Veriut. Me këtë Kanun rregullohej jeta e njerëzve, dhe kjo e bënte të pamundur zbatimin e Sheriatit në këto troje. Kanuni ruajti nderin dhe dinjitetin e njeriut dhe dinjitetin kombëtar gjatë më shumë se 500 vjetve.

Në kreun *“Mbrapër shembulltina kundër pasurisë”* Kanuni ka parashikuar veprën penale të vjedhjes sipas objekteve të ndryshme. Kështu, në nenin 718, të titulluar *“Të thyemtë e shtegut të oborrit, të arrës, të veshtit”*, thuhet: *“Bani kush ene i thej kuj shtegun e oborrit, të arës, të veshtit, të kopër shembulltit, të livadhit të xanë me gardh jase me pengesa të tjera, i ka gjobën dheut 500 groshë, të zot i ka punën për të ndreqmen e të thyemës. Me ndodhë i huaj ene me u ngatërrue në shtigje të xanëme, ka detyrë me i ba me dije të zot ene me i lypë të falun.”*

Edhe në ligjin otoman gjejmë mjaft dispozita ligjore për mbrojtjen e pronës private dhe atë të bashkësisë. Në pjesën më të madhe të tyre është parashikuar vepra penale e vjedhjes, për shembull:

- *“Dikush që vjedh të korrat apo akçet e dikujt, nëse është i kamur, gjoba t’i merret dyzet akçe; nëse është në gjendje të mesme ekonomike, t’i merren njëzet akçe; nëse është i varfër, t’i merren dhjetë akçe gjobë.”*
- *“Nëse dikush vjedh një torbë apo një shami/çallmë koke, të mos i pritët dora, kadiu ta dënojë: në vend të çdo goditjeje me shkop, t’i merret një akçe gjobë.”*
- *“Nëse djali vjedh babain, babai vjedh djalin, vëllai vjedh vëllain apo burri vjedh gruan ose gruaja burrin, kadiu t’i dënojë: në vend të çdo goditjeje me shkop, të merret një akçe gjobë.”*
- *“Në se dikush vjedh diçka nga mullari, diçkaja e vjedhur të kthehet për llogari të shtetit.”*

• “Nëse dikush vjedh një patë apo një rosë, kadiu ta dënojë. Në vend të çdo dy goditjeve me shkop, t’i merret një akçe gjobë.”

• “Nëse dikush vjedh një dele apo një koshere bletësh, t’i merren pesëmbëdhjetë akçe gjobë.”

• “Nëse dikush vjedh një kokë bagëti të trashë, të mos i pritët dora. Nëse është i kamur sa të zotërojë një mijë akçe e më tepër, gjoba t’i merret njëqind akçe; nëse është në gjendje të mesme ekonomike, t’i merren pesëmbëdhjetë akçe; nëse është i varfër, t’i merren dyzet ose tridhjetë akçe gjobë.”

• “Nëse dikush vjedh një kalë, t’i pritët dora; nëse nuk ia presin, t’i merren dyqind akçe gjobë.”

Të gjitha këto situata me objekt mbrojtjen e gjësë së gjallë nga vjedhja në Kanunin e Lekë Dukagjinit janë përmbledhur në nenin 719, me titullin “Vjedhja e gjasë së gjallë”, ku thuhet: “Me ba me vjedhë gjanë e huej në kullotë, vjedhësi i ka detyrë të zot dypërnjahren. Me u vjedhë gjaja në vathë, në t’banat jase në shpi, cubi i lanë të zot dypërnjahren ene dheut 500 groshë për shpi të thyeme.”<sup>283</sup>

• Në pikën 7 të nenit 633 të Kodit të Lekë Dukagjinit është parashikuar: “Për mullar bari jase kashte të djegun: damin të zot me sanë jase kashte ene një pendë qe katundit.”<sup>284</sup> Siç shihet, ashtu si te ligji osman, nuk parashikohet sanksion i rëndë.

• Ndërsa në nenin 633/6 parashikohet: “Për ksollë të djegun: damin të zot ene një ka katundit.”<sup>285</sup>

• Në nenin 716, me titull “Vjedhja e rrethit të shpisë”, Kanuni i Lekë Dukagjinit parashikon: “Çdo përdhesë në oborr të shpisë jase rrethit të saj, me ba ene me u thye ka gjobën 500 groshë ene dypërnjahren për gjanë e hupme.”<sup>286</sup>

---

<sup>283</sup> Kanuni i Lekë Dukagjinit, Neni 719.

<sup>284</sup> Po aty, Neni 633.

<sup>285</sup> Po aty, Neni 633/6.

• Në nenin 557, me titull “Tagër e detyrë për gjanë e gjallë”, thuhet: *“Me ndodh ene me gjet ndojë gja të gjallë jase mall udhës, malit, nën tokë e mbi tokë, tager ke me e marrë ene me e çue te shpija jote. Por detyrë ke mos me e mbajtë mfshetë gjanë e gjetme. Me e mbajtë të mfshet, bahesh me fjalë ene ndiqesh për cubni.”*<sup>287</sup>

Për dëmtimin e pronës së tjetrit legjislacioni osman parashikon:

- t’i jepen goditje me çomange;
- të dëmshpërblejnë dëmin e shkaktuar;
- të kërcënohen që të mbajnë nën kontroll kafshët e tyre, që ato të mos dëmtojnë më të mbjellat e të tjerëve.

## **KAPITULLI VII**

### **Konkluzione dhe rekomandime**

Sikundër shihet përgjatë gjithë vëzhgimeve dhe analizës së legjislacionit bazë të Perandorisë Bizantine (Agrotikos Nomes )- mënyrës së tij të formulimit , natyrës formale të strukturës së dispozitave , sanksioneve dhe llojet e sanksioneve që atopërcaktonin, kohëzgjatja e aplikimit të këtij ligji në shekuj, shtrirja gjeografike(juridiksioni i tij) dhe (vecantitë e zbatimit në zona të thella e të vështira), ndikimet e tij nga traditat zakonore vendore, nga legjislacioni i mëparshëm , ndikimet nga natyra e popujve , ndikimet nga faktorët dhe produktet ekonomike të rajoneve të ndryshme, etj kemi konkluduar në disa përfundime:

**1**-Legjislacioni bizantin i aplikuar në territorret e Arbërisë mesjetare për shumë shekuj la gjurmë të thella në jetën morale , ekonomike dhe atë zakonore të Shqiptarëve duke formuluar elemente të rinj të antropologjisë e cila do të regjizoj dhe trashgohej në shekuj edhe pas rënies së kësaj Perandorie.

---

<sup>286</sup> Po aty ,Neni 716.

<sup>287</sup> Po aty, Neni 556.

2- Legjislacioni Bizantin, sikundër trajtohet në temë la gjurmë të thella edhe në legjislacionet që pasuan pas rënies së Perandorisë Bizantine, në legjislacionin e Perandorisë Osmane. Kjo Perandori mori mjaft nga standartet ligjore të mëparshme dhe i implimentoi ato në ligjet që hartoi. Mjaft nga dispozitat që rregullonin sistemin fiskal dhe taksat, për llojet e ndryshme të produkteve bujqësore, blegtorale apo artizanale u përcollën nga legjislacioni bizantin në atë osman pa asnjë ndryshim.

3-Perandoria me ndryshimin e strukturës sociale dhe ekonomike ajo e zgjeroi pasurinë dhe e ndryshoi atë të mëparshmen duke sjellë risi.

4-Ligji agrar për shkak të bashkëjetesës shumëshekullore me normat zakonore ka marrë nga traditat tona, duke lënë gjurmë në trojet dhe qytetet shqiptare që iu nënshtruan sundimit të Perandorisë Bizantine.

Në qoftë se u referohemi dispozitave të tij, konstatojmë se kemi të bëjmë me një ligj që shtrihet në të gjitha territoret shqiptare dhe zbatohet për të gjithë qytetarët që jetonin dhe ushtronin veprimtarinë e tyre në kufijtë e Bizantit dhe në qytetet arbërore. Ky ligj nëpërmjet regjimit të pronës së përbashkët rregullonte jo vetëm marrëdhëniet e pronësisë dhe të detyrimeve, por edhe marrëdhëniet dhe veprimtarinë administrative, financiare, fiskale, penale të territoreve dhe popullsisë të Bizantit.

Nga ana tjetër, e drejta zakonore shqiptare me veçoritë krahinore, me zakonet, traditat, folklorin, gjuhën, që karakterizohet nga dialektet dhe nëndialektet, na paraqitet në shumë pamje. Ajo përbëhet nga një bazë e fortë normash me burim tepër të lashtë vendas, por gjejmë në të edhe ndikime nga jashtë, nga kodet e ndryshme greko-bizantine, romane, nga Sheriati, nga zakonet e vendeve të ndryshme që sunduan në trevat tona për shekuj me radhë. Ndikimet e huaja kanë lënë gjurmë jo të barabarta në treva të ndryshme. Dhe pikërisht në këtë kontekst nuk duhet lënë pa u përmendur ndikimi i padiskutueshëm i ligjit agrar në të drejtën zakonore, gjurmët e të cilit i ndeshim në disa prej kanuneve më të rëndësishme, që plotësojnë dhe identifikojnë të drejtën zakonore dhe që kanë karakteristika të veçanta, të cilat lidhen ngushtësisht me krahinat ku janë formuar dhe konsoliduar. Kjo vihet re në faktin se për situata të njëjta kanune të trevave të ndryshme parashikojnë pasoja të ndryshme. Kjo mospërputhje apo kundërshti për mendimin tonë shpjegohet me tri arsye: së pari, kemi përplasje mes formave shumë arkaike të normave me format e evoluara; së dyti, normat vendase bien në kundërshtim me disa norma të hyra nga jashtë; së treti, krahas një shtrese unitare mbaretnike ka dhe veçori të caktuara krahinore, që



lidhen me veçoritë gjeografike, klimatike, burimet ekonomike të krahinave të ndryshme më të hapura e më të mbyllura drejt qendrës.

## 2. Çfarë ishte kultura ligjore bizantine?

Veçoritë kryesore të kulturës ligjore bizantine të paraqitura në këtë studim po i përmbledhim si më poshtë:

Mbi të gjitha kultura ligjore bizantine ishte e vlefshme për shumë shërbime si në mënyrën se si përshtatej ligji, ashtu dhe në mjetet që përdorehin në praktikë. Është shumë e rëndësishme të bëjmë dallimin mes kulturës së jashtme dhe të brendshme ligjore, që e kemi përcaktuar që në fillim të këtij studimi. Në përgjithësi kjo kulturë ligjore ishte në gjendje të angazhohej me traditën juridike romake në një nivel më të sofistikuar. Juristët bizantinë ishin të përqendruar jo vetëm në njohuritë praktike, por dhe në shkrimet juridike, në enigmat ligjore. Megjithatë, pavarësisht arritjeve të jashtëzakonshme të kësaj klase, autorët e “Bazilikës”, shkrimet ligjore, komentet, trashëgimia e ligjit bizantin në pjesën më të madhe janë pjesë e kulturës së jashtme ligjore. Ndërsa përfaqësuesit e kësaj kulture të jashtme ligjore e konsideronin veten po aq romakë sa juristët e kulturës së brendshme, ata përsëri e konceptonin dhe formulonin lidhjen e tyre me ligjin, me çështjet ligjore dhe traditën juridike romake në një mënyrë krejtësisht të ndryshme. Tradita e krishtere, *Lex Christiana*, siç e ka quajtur Peter Pieler, ishte me e rëndësishme për kulturën e jashtme ligjore sesa për traditën ligjore romake në vetvete, edhe pse kjo traditë tashmë ishte kristianizuar tërësisht. Ligji dhe jurisprudenca janë interpretuar në tema kryesisht etike dhe morale. Studiues si Kekaumenos dhe autorët e *Nomoi e Shën Gregentios (Nomos Georgikos)* janë përfaqësues të kësaj kulture të jashtme ligjore.

Popullariteti i *Nomos Georgikos* mund të trajtohet duke pasur parasysh përfaqësuesit e përmendur më sipër të kësaj kulture të jashtme ligjore, përfaqësuesit e elitës, të cilët nuk ishin profesionistë ligjorë, por që janë gjendur në situata ku mund të ushtronin kompetencat e tyre ligjore.

Megjithatë, bazuar në rivlerësimin e burimeve që mendohet të jetë bërë në periudhën e sundimit isaurian, në këtë studim jemi përpjekur të argumentojmë se *Nomos Georgikos* në të vërtetë ishte krijuar në një periudhë të supozuar si klasike, brenda teksteve të përfaqësuesve të epokës klasike.

### **3. Zhvillimet e kulturës ligjore bizantine për studimet e ardhshme të ligjit dhe shoqërisë bizantine**

Rezultatet e studimit të kulturës ligjore bizantine sugjerojnë ndryshime në metodologjinë me të cilën historianët e ligjit bizantin shqyrtojnë çështjet ligjore. Juristët e njohur bizantinë çuan më tej kontributin e paraardhësit të tyre Teofili. Ata lanë gjurmë në mendimin juridik bizantin, pasi juristë të tillë si Stefnos ishin të një niveli të tillë, saqë mund të thuhet se shkrimet e tyre, duke pasur parasysh edhe interpretimet e korpusit të Justinianit, kishin statusin e ligjit. Pra, historianët për qëllimet e tyre studimore mund të shfrytëzojnë tekstet që kishin në dispozicion juristët bizantinë.

Ndoshta është më mirë që ligji bizantin të mos trajtohet si një sistem i kodifikuar me dekrete, të paktën deri në gjysmën e dytë të shekullit të 12-të, kur u vendos që “Bazilika” të ishte përmbledhja zyrtare e ligjit laik.

Në këtë studim jemi përpjekur në mënyrë modeste të hedhim dritë mbi rëndësinë dhe ndikimin që kishin një pjesë e shoqërisë bizantine dhe familja perandorake mbi ligjin. Duke pasur parasysh rëndësinë e perandorit, si krijuesi dhe mbajtësi i ligjit, ashtu dhe rëndësinë e së drejtës si pjesë përbërëse e ideologjisë politike perandorake, nuk është e habitshme që kjo të këtë ndikuar në studimin e ligjit bizantin. Gjithashtu ky studim ka treguar se si është zbatuar ligji në Perandorinë e mesme Bizantine. Pavarësisht se mungonte roli i sanksionimit në krijimin e ligjit, elita forcoi pozitën e saj në shoqëri, duke ushtruar pushtetin e saj me anë të ligjit dhe sistemit ligjor.

### **Bibliografia**

- Alexander Kazhdan and Mark C. Bartusis, “*Custom*” in *ODB*, vol. 1.
- Angeliki E. Laiou and Simon. D (eds) (1994), *Law and Society in Byzantium: Ninth-Twelfth Centuries*, Washington, D.C.: Dumbarton Oaks Research Library and Collection.

- Anselme. J & Mortreuil. B. (1843), *Histoire du droit byzantin: ou du droit dans l'Empire d'Orient, depuis la mort de Justinien jusqu'à la prise de Constantinople, en 1453*, 3 vols. Paris: E. Guibert.
- Akademia e Shkencave të Shqipërisë, “*Historia e popullit shqiptar*”, shtëpia botuese “Toena”, vëllimi I, f. 518, Tiranë, 2002.
- Aristidh P. Kola, “*Arvanitasit dhe prejardhja e grekëve*”.
- Bell. J. (2001), *French Legal Cultures*, Laë in Çontext (London: Butteröorths); Blankenburg. E and Bruinsma. F. (1994), *Dutch legal culture*, 2nd ed. (Deventer; Boston: Kluëer Laë and Taxation Publishers).
- Bernard H. Stolte (1998), “*Not neë but novel. Notes on the historiography of Byzantine laë*”, *BMGS* 22.
- Biçoku K., “*Kastriotët në Dardani*”.
- C. A. Spulber, *Les Nouvelles de Leon le Sage*.
- Ch. Èickham (1993), *Lachute de Rome n'aura pas lieu*, *Le Moyen Age* 99.
- D. Gini (1989), “*Përshkrimi i historisë së jurisdiktionit parabizantin*”, Athinë, 1966, K. Picakis, “*Jeta e përditshme në Bizant*”, Athinë.
- D. Lopçic (1992), *Srednjovekovni statut Budve. Archiv za pravne i drustvene nauke*.
- D'Emila (1947–1949), *Lezioni Di Diritto Bizantino*, Rome, “*Tradita shumëshkrimore universitare*”.
- E. Champion (1996), *Moulinset meuniers carolingiens*, Paris.
- E. Demougeot (1951), *De l'unité a la division de l'empire romain*, Paris, 93 e në vijim.
- E. Seidi, *Basilikenscholien im Tipukeitos*, *BZ*, 44 (1951).khr edhe F. Dolger dhe
- D. Egro, “*Ligji osman ndër shqiptarët e mesjetës së vonë*”, .f. 82.
- F. Brandileone (1897), *Il Diritto Bizantino nell Italia Meridionale dal VIII secolo al XII secolo*, Napoli, Jovene.
- Freshfield E. Hanson (1928), *A Manual of Eastern Roman Laë: the Procheiros Nomos*, (Cambridge [Cambridgeshire]: University Press, p. vii.
- G. Duby (1962), *L'economie rurale et la vie des campagnes dans l'Occident medieval*, Paris.
- G. Bardy (1948), *La question des langues dans l'eglise ancienne*, Paris.
- G. Ostrogorski (1954), *Pour l'histoire de la feodalite byzantine*, Brussels.
- H. G. Beck 1981, *Nomos, Kanonund staatrason in Byzanz*, Vjenë.

- H. Inalcik (1959), *Osmanilarda Rayyet Rusumu*, Belleten XXIII, f. 575–610, H.Inalcik Cift-resmi në Encyclopedia of Islam.
- H. Inalcik, *L'empire ottoman*, Raports, The First International Çongress of South-East European Studies, Sofje, 1969, 80–85.
- H. Inalcik (1954), *Ottoman Methods of Çonques*, Studia islamica II.
- H. Inalcik (1959), *Osmanlilar'da Ralyyet Rusumu*, Belleten, XXIII.
- H. Inalcik(1959), *Ralyyet Rusumu*, Belleten XXIII.
- P. Haxhi (1998), “Regjimi juridik i tokës në Shqipëri”, Tiranë.
- I. P. Medvedev (2001), *Правовая культура Византнйской империи* (St. Petersburg: Aleteï ia).
- Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, USHT, “Burime të zgjedhura”, “Shqipëria nën sundimin feudal ushtarak osman”, Tiranë 1962.
- J. Maridhakis (1992), “Juridiksioni qytetar brenda rajave të mbretërve bizantinë”, Athinë.
- J. G. Hahn, *Reise durch die Gebiete des drin und Ęardar, Ęien* 1967.
- J. Hammer, *Des Osmanischen Reiches Saatsverfassung und Staatsverëaltung*, Band I-II, Ęien 1815;
- J. von Hammer (1815), *Des Osmanischen Reichs Staatsverfassung und Staatsverëaitung*, Vjenë.
- James L. Gibson and Gregory A. Caldeira, *The Legal Cultures of Europe, Laë & Society Revieë* 30.1 (1996).
- K. G.Ostrogorsky. (1936). *Die byzantinische Staatenhierarchie*, SK 8.
- K. Rostovtzeff, *Gesellschaft und Ęirtschaft*, II 238 e në vijim, A.H.M.Jones. (1940). *The Greek City from Alexander to Justinian*, Oksford, 85 e në vijim.
- Kasteleti Xh., “Normat e së drejtës zakonore shqiptare”.
- Kazhdan P. Alexander (1989), *Do Ęe Need a Neë History of Byzantine Laë?*, JÖB 39. f. 1–28.
- Shih idem, Κοινωρία (1988), *Che cosa chiede lo storico di bisanzio allo storico del diritto?*, f. 129–144.
- Keebet von Benda-Beckmann, “Legal Anthropology” in Stanley N. Katz (ed.), (2009), *The Oxford International Encyclopedia of Legal History* (e-reference edition) (Oxford [UK]; Neë York: Oxford University Press.

- L. Barkan (1943), *XV-XVI mali inci asiriarda Osmanil imperatoriuğunda zirai ekonominin hukuki vemail esiasiari, instambul.*
- L. Pansolli (1970), *La gerarchia delle fonti nella legislaslazione medievale veneziane*, Milano
- Ligor Mile (1984), “Çëshjtje të historisë agrare shqiptare”, Akademia e Shkencave e RPSSH, Tiranë.
- Lingenthal von Zachariä K. Eduard (1892), *Geschichte des griechisch-römischen Rechts*, 3rd edition Berlin: Eiedmannsche Buchhandlung. f. 128.
- Lingenthal von Zachariä. K. Eduard.(1839), *Historiae juris graeco-romani delineatio. Cum appendice ineditorum*, (Heidelberg: sumtibus Christiani Friderici Einter).
- *Literatur der Byzantiner*. Handbuch der Altertumsëissenschaft 12/5, 2 vols (Munich: Beck, 1978), vol. 2, f. 343–480.
- M. Bloch, *Avenement et çonquetes du moulin a l’eau*, in *Annales d’histoire economique et sociale* 7 (1935): 538–563, repr. in idem, *Melanges historiques* (Paris, 1963).
- M. Bloch (1995). *Histoire et historiens*, Paris.
- M. Arif tarikhi, *Osmani endjumeni mecmuasi*.
- M. Belin, *Du regime des fiefs militaires dans l’islamisme et principalement en Turquie në Journal Asiatique*, S.VI, Tome XV, Paris 1870, mars –avril, f. 187–301.
- M. F. Koprulu (1953), *Alcune osservazione intorno all’influenza delle istituzioni bizantini sulle istituzioni ottomani*, Rome.
- M. Mitard, *Le pouvoir imperial au temps de Leon VI Le Sage* , *Melanges Diehl*, I (1930).
- R. Mantranit, “*Historia e Perandorisë Osmane*”.
- Mark Goodale and Elizabeth Mertz, *Anthropology of Laë in Encyclopedia of Laë & Society*, vol. 1.
- N. Biraben and J. Le Goff (1969), *La peste dans le haut Moyen Age*, *Annales ESC* 6.
- Nelken. D, *Culture, Legal* in David S. Clark (ed.), (2007), *Encyclopedia of Laë & Society: American and Global Perspectives*, 3 vols. (Los Angeles: Sage Publications, vol. 1.
- Nicol, *Despotate 160 vv’Antonovic 163v*.
- Oliver Jens Schmitt, “*Arbëria Venedike*” 1392–1479.
- P. Alexandre (1987), *Le climat en Europe au Moyen Age*, Paris. f.18.
- P. Tichendorf (1872), *Das lehenëesen in den moslemichen Staaten, insbesondere im Osmanischen Reiche*, Leipzig

- P. Toubert, *L'Italie rurale aux VIIIe–IXe siècles: Essai de typologie domaniale*, in *I problemi comuni dell'Europa nel secolo VIII* (Spoleto, 1973).
- P. Toubert, *La part du grand domaine dans le decollage economique de l'Occident* (VIIIe–Xe siècles), in *La croissance agricole du haut Moyen Age*, ed. Ch. Higounet (Auch, 1990), 53–86.
- P. Noaille dhe A. Dain, *Les Nouvelles de Leon VI le Sage ecc.cit.* 182, 184, 270.
- Pertusi, Dulcigno: Për Tivarin 218 shënimi 21, Valentini Amministrazione 880v, shënimi 6.
- Peter E. Pieler, *Byzantinische Rechtsëissenschaft* in Hubert Hunger (ed.), *Die hochsprachliche profane*.
- Pulaja S. (1988), “*Pronësia feudale mbi tokat shqiptare*”, Tiranë.
- Q. Haxhihasani (1953), “*Tregim i mbledhur në fshatin Brest të Dibrës*”.
- R. Anhegger dhe H. Inalcik (1956), *Kanunname-I sultani ber muceb-I orf-I Osmani*, Ankara.
- R.J. Macrides (1999), *Kinship and justice in Byzantium, 11th-15th centuries*, Variorum collected studies series (Aldershot, Hamper shembullire, Great Britain; Brookfield, Vt: Ashgate/Variorom).
- R.S Lopez, *Byzantine Laë in the Seventh Century and its Reception by the Germans and the Arabs, BYZ*, 16 (1942–1943).
- Sarris. P (2011), *Laë & Custom in the Byzantine Countryside from Justinian to Basil II* (c. 500–1000) in Alice Rio (ed.), *Laë, custom, and justice in Late Antiquity and the Early Middle Ages: Proceedings of the 2008 Byzantine Colloquium* (London: Centre for Hellenic Studies, King's College London, *Occasional Publications*).
- Sh. Gjeçovi (1993), “*Kanuni i Lekë Dukagjinit*”, Tiranë.
- Shih, H. K. Schulze, ed. (1985), *Städtisches Um- und Hinterland in vorindustrieller Zeit*, Cologne- Vienna.
- Simon. D. (1973), *Rechtsfindung am byzantinischen Reichsgericht, Èissenschaft und Gegenëart*; Juristische Reihe 4(Frankfurt am Main: V.Klostermann).
- Sp. Troianos (1991), *Ligji Nomos und Kanon in Byzanz*, Kanon 10.
- Spoleto (1993), *Mercati e mercanti nell'alto medioevo: L'area euroasiatica e l'area mediterranea*.
- St.Shaë. *History of the Ottoman Empire*, VII.
- Stein, Geschichte, I & E. Demougeot (1951), *De l'unite a la division de l'empire romain*, pp-410 Paris, 143 e në vijim.

- Th. Bochove. E. (1996), *To date and not to date: on the date and status of Byzantine laë books*, Groningen: E. Forsten.
- Troje, H. Erich (1971), *Graeca leguntur: die Aneignung des byzantinischen Rechts und die Entstehung eines humanistischen Corpus iuris civilis in der Jurisprudenz des 16. Jahrhunderts*, Cologne: Böhlau.
- Valentini G., “*Studime dhe tekste juridike*”.
- Valentino, *Appunti sul regime degli stabilimenti veneti*.
- Valentini. G., “*Studime dhe tekste juridike*”.
- Veerhulst (1989), *Agrarian Revolutions: Myth or Reality?*, Sartoriana 2.
- Verhulst (1991), *The Decline of Slavery and the Economic Expansion of the Early Middle Ages*, Past and Present 133.
- Ë. Ashburner (1910), *The Farmer’s Laë*.
- Xhai V, Cevi K., (1984), “*Regjimi juridik i tokës në Shqipëri*”, shtypshkronja e dispensave, Tiranë.
- Y. The Bert, eds (1989), *Les cadastres anciens des villes et leur traitement informatique*, Rome.